



KOMISIONI
EVROPIAN

Bruksel, 9.11.2016

DPS (2016) 364 përfundimtar

**DOKUMENT PUNE I STAFIT TË KOMISIONIT
RAPORTI I VITIT 2016 PËR SHQIPËRINË**

shoqëron dokumentin

KOMUNIKIM I KOMISIONIT

**PËR PARLAMENTIN EVROPIAN, KËSHILLIN, KOMITETIN EKONOMIK
DHE SOCIAL EVROPIAN DHE KOMITETIN E RAJONEVE**

Komunikim i vitit 2016 për Politikat BE-së për Zgjerim

{KOM (2016) 715 përfundimtar}

Tabela e përmbajtjes

1.	HYRJE	5
	1.1. Konteksti	5
	1.2. Përmbledhje e raportit	5
2.	KRITERI POLITIK.....	7
	2.1. Demokracia	7
	2.2. Reforma në administratën publike	11
	2.3. Shteti i së drejtës	15
	2.4. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve.....	25
	2.5. Çështjet rajonale dhe detyrimet ndërkombëtare.....	27
3.	KRITERI EKONOMIK	27
	3.1. Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale	29
	3.2. Aftësia për të përballuar presionet e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda BE-së	35
4.	AFTËSIA PËR TË MARRË PËRSIPËR DETYRIMET E ANËTARËSIMIT	35
	4.1. Kapitulli 1: Lëvizja e lirë e mallrave.....	35
	4.2. Kapitulli 2: Liria e lëvizjes së punëtorëve.....	41
	4.3. Chapter 3: Kapitulli 3: E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime.....	42
	4.4. Chapter 4: Kapitulli 4: Lëvizja e lirë e kapitalit.....	42
	4.5. Kapitulli 5: Prokurimi publik	43
	4.6. Kapitulli 6: E drejta e shoqërive tregtare	45
	4.7. Kapitulli 7: E drejta e pronësisë intelektuale	46
	4.8. Kapitulli 8: Politika e konkurrencës.....	47
	4.9. Kapitulli 9: Shërbimet financiare	49
	4.10. Kapitulli 10: Shoqëria e informacionit dhe media	50
	4.11. Kapitulli 11: Bujqësia dhe zhvillimi rural.....	51
	4.12. Kapitulli 12: Politika e sigurisë ushqimore, veterinare dhe fitosanitare	52
	4.13. Kapitulli 13: Peshkimi.....	53

4.14.Kapitulli 14: Politikat e transportit.....	54
4.15.Kapitulli 15: Energjia.....	56
4.16.Kapitulli 16: Tatimet.....	58
4.17.Kapitulli 17: Politika ekonomike dhe monetare.....	59
4.18.Kapitulli 18: Statistikat	60
4.19. Kapitulli 19: Politika sociale dhe Punësimi	62
4.20.Kapitulli 20: Ndërmarrjet dhe politika industriale.....	64
4.21.Kapitulli 21: Rrjetet transeuropiane	65
4.22.Kapitulli 22: Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore	67
4.23.Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore.....	68
4.24.Kapitulli 24. Drejtësia, liria dhe siguria	82
4.25.Kapitulli 25: Shkenca dhe kërkimi.....	91
4.26.Kapitulli 26: Arsimi dhe kultura	92
4.27.Kapitulli 27: Mjedisi dhe ndryshimet klimatike	93
4.28.Kapitulli 28:Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit	97
4.29.Kapitulli 29: Bashkimi doganor	99
4.30.Kapitulli 30: Marrëdhëniet me jashtë.....	100
4.31. Kapitulli 31: Politika e jashtme, sigurisë dhe e mbrojtjes.....	100
4.32. Kapitulli 32: Kontrolli financiar.....	102
4.33.Kapitulli 33: Dispozitat financiare dhe buxhetore	105
 Shtojca I: Marrëdhëniet midis BE - Shqipërisë.....	 106
Shtojca II: Shtojca statistikore.....	108

1. HYRJE¹

1.1. Konteksti

Në qershor 2014, Këshilli Evropian i dha Shqipërisë statusin e vendit kandidat. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) ka qenë në fuqi që prej prillit 2009 dhe Shqipëria ka plotësuar mirë detyrimet e saj. Dialogu i rregullt politik dhe ekonomik midis BE-së dhe Shqipërisë ka vijuar nëpërmjet strukturave përkatëse në përputhje me MSA-në. Qeveria u angazhua në ndërmarrjen e reformave që lidhen me BE-në dhe vazhdoi të bëjë përparim në plotësimin e objektivave të identifikuara në pesë prioritetet kyçe për hapjen e negociatave për anëtarësim.

1.2. Përmbledhje e raportit

Në lidhje me **kriterin politik**, duke kapërcyer polarizimin e mëparshëm, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar me unanimitet ndryshimet kushtetuese, për të filluar një reformë të thellë dhe gjithëpërfshirëse në sistemin e drejtësisë dhe për përjashtimin e të dënuarve për vepra penale nga detyrat publike. Duke pasur parasysh zgjedhjet e ardhshme të përgjithshme që do të mbahen në vitin 2017, Shqipëria pritet të miratojë në kohën e duhur ndryshimet në Kodin Zgjedhor dhe reformat që lidhen me të. Këto duhet të adresojnë, në veçanti, mungesën e paanësisë politike dhe profesionalizmit të administratës zgjedhore. Miratimi i ligjit për ngritjen e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile siguroi kornizën e nevojshme për konsultime më të strukturuar me organizatat e shoqërisë civile.

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur lidhur me reformën në administratën publike. Ka vazhduar zbatimin, në mënyrë më transparente, i procedurave për rekrutimin e nëpunësve civilë, si dhe i strategjive për reformën në administratën publike e për reformën në menaxhimin e financave publike. Përparimi i mëtejshëm është kyç për të konsoliduar arritjet drejt një administrate publike më eficiente, të depolitizuar dhe profesionale.

Sistemi gjyqësor në Shqipëri është deri diku i përgatitur. U miratuan ndryshimet kushtetuese që lidhen me organizimin dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë. Kjo i hap rrugën reformës së plotë dhe gjithëpërfshirëse në sistemin e drejtësisë. Gjithashtu, ka avancuar puna për legjislacionin zbatues përkatës: u miratua ligji për rivlerësimin (verifikimin) e gjyqtarëve, prokurorëve dhe këshilltarëve ligjorë, si dhe një sërë ligjesh të rëndësishme, të nevojshme për riorganizimin institucional të strukturave gjyqësore. Përveç kësaj, janë në faza të ndryshme të përgatitjes rreth 40 projektligje të tjera. Nevojitet përparim i mëtejshëm për miratimin dhe zbatimin e këtij legjislacioni. Dhënia e drejtësisë vazhdon të jetë e ngadalshme dhe inefficente; korrupsioni mbetet i përhapur në të gjithë sektorin.

Në lidhje me luftën kundër korrupsionit, Shqipëria është deri diku e përgatitur. U miratua ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve. Prokurorët dhe policia kanë rritur aksesin në regjistrat elektronikë kombëtarë publikë, me qëllim shkëmbimin e informacionit sensitiv dhe rritjen e efikasitetit të hetimeve. Nevojitet përparim i mëtejshëm për krijimin e një historiku të qëndrueshëm (*track record*) të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve. Nevojiten më shumë përpjekje për të luftuar korrupsionin në nivel të lartë. Hetimet proaktive, vlerësimet sistematike të riskut dhe bashkëpunimi ndër-institucional duhet të përmirësohen. Korrupsioni mbetet i përhapur në shumë fusha dhe vazhdon të jetë një problem serioz.

¹ Ky raport mbulon periudhën nga tetor 2015 deri në shtator 2016. Ai bazohet në të dhëna të marra nga një larmi burimesh, përfshirë kontributet e Qeverisë shqiptare, Shtetet Anëtare të BE-së, raportet e Parlamentit Evropian dhe informacione nga organizata të ndryshme ndërkombëtare dhe jo-qeveritare. Si rregull, legjislacioni apo aktet që janë ende në fazë përgatitje ose në pritje të miratimit nga Kuvendi nuk merren në shqyrtim.

Në lidhje me luftën kundër krimit të organizuar, vendi ka arritur një farë niveli përgatitjeje. U bë njëfarë përparimi, sidomos në identifikimin dhe asgjësimin e plantacioneve me kanabis. Policia u modernizua dhe u rrit bashkëpunimi ndërkombëtar policor, sidomos me Europol-in. Megjithatë, bashkëpunimi mes policisë dhe prokurorisë duhet të forcohet më tej për të shpërbërë rrjetet kriminale në mënyrë më efektive. Numri i dënimeve të formës së prerë për rastet e krimeve të organizuara është ende i ulët, duke shënuar vetëm një rritje të lehtë në vitet e fundit. Hetimet financiare në lidhje me grupet e organizuara kriminale nuk janë zhvilluar në mënyrë sistematike dhe efektive. Historiku i ngrirjes dhe konfiskimit të pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme mbetet shumë i ulët.

Kuadri ligjor për mbrojtjen e të drejtave të njeriut është gjerësisht në përputhje me standardet evropiane. Shqipëria ka ratifikuar pjesën më të madhe të konventave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Megjithatë, zbatimi i mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut mbetet për t'u përforcuar. Lidhur me lirinë e shprehjes, Shqipëria ka një farë niveli të përgatitjes/ është mesatarisht e përgatitur. Atmosfera e përgjithshme është e favorshme për të ushtruar lirinë e shprehjes, por kërkohet një zbatim më i mirë i legjislacionit. Pavarësia e autoritetit rregullator dhe transmetuesit publik duhet të forcohet akoma më tej dhe duhet të rritet transparenca e reklamave shtetërore në media. Shqipëria ka ndërmarrë masa për të trajtuar çështjen e kthimit ose kompensimit të pronave të konfiskuara gjatë kohës së komunizmit. Është miratuar ligji i ri që parashikon ngritjen e një mekanizmi kombëtar për kompensimin. Procesi i regjistrimit të pronave gjithashtu duhet të çohet përpara. Kushtet e jetesës për romët dhe egjiptianët² duhet të përmirësohen. Nevojiten më shumë përpjekje për të zhvilluar një historik të rasteve kundër diskriminimit. Mekanizmat institucionale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës dhe përballjen me dhunën me bazë gjinore mbeten të pamjaftueshme. Legjislacioni lidhur me drejtësinë për të miturit mbetet për t'u përafruar me standardet ndërkombëtare.

Shqipëria ka vijuar të ketë një rol konstruktiv dhe proaktiv në bashkëpunimin rajonal dhe mban marrëdhënie fqinjësie të mira në përputhje me zotimet e saj të marra në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Për sa i përket **kriterit ekonomik**, Shqipëria është mesatarisht e përgatitur për zhvillimin e një ekonomie tregu funksionale. U bë njëfarë përparimi në përmirësimin e bilancit buxhetor, luftën kundër informalitetit dhe reformën e sektorit të energjisë elektrike. U përshpejtua rritja ekonomike dhe u përmirësua gjendja e tregut të punës, por niveli i papunësisë mbetet ende i lartë. Borxhi publik është i lartë dhe ende nuk ka filluar të ulet, ndërsa vazhdojnë mosrealizimet e përsëritura të shpenzimeve publike për investime. Sektori financiar është i qëndrueshëm. Megjithatë, sektori bankar është ende i ngarkuar me kredi me probleme dhe kreditimi po rritet me ritme të ngadalta. Aktet ligjore që lidhen me biznesin janë të pavolitshme dhe mangësitë në sundimin e ligjit vazhdojnë të pengojnë investimet. Reforma në vazhdim e sistemit të drejtësisë pritet të ketë një ndikim thelbësor në mjedisin e biznesit.

Shqipëria ka një farë niveli të përgatitjes, në lidhje me kapacitetin e saj për të përballuar presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda Bashkimit. U bë njëfarë përparimi veçanërisht lidhur me përmirësimin e arsimit të lartë dhe atë profesional. Megjithatë, cilësia e arsimit duhet të rritet në të gjitha nivelet për t'i pajisur njerëzit me aftësi dhe njohuri në përputhje me nevojat e tregut të punës. Kanë nisur përpjekjet për të përcaktuar prioritetet në

2 Të gjitha këto grupe përfshihen nën termin e përgjithshëm "Romë" në Kuadrin e BE-së për Strategjitë Kombëtare të Integritimit të Romëve.

investimet në infrastrukturë, por mangësitë në infrastrukturën e transportit, të energjisë dhe atë digjitale vazhdojnë të pengojnë konkurrueshmërinë dhe të kufizojnë tregtinë. Tregtia me jashtë është nën potencial dhe është e përqendruar në disa sektorë, duke e bërë ekonominë më të cenueshme. Kapacitetet për kërkim, zhvillim dhe inovacion mbeten të ulëta.

Shqipëria vazhdoi përafrimin e legjislationit të saj me kërkesat e BE-së në një sërë fushash, duke rritur kështu aftësinë e saj për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit. Në shumë fusha, vendi është mesatarisht i përgatitur, si për shembull në kontrollin financiar, ose ka njëfarë përgatitje, duke përfshirë fushat e prokurimit publik dhe statistikave. Shqipëria do të ketë nevojë të vazhdojë përpjekjet e saj në lidhje me përgatitjet e përgjithshme për miratimin dhe zbatimin e *acquis*-ë të BE-së. Ajo duhet të vazhdojë punën për zhvillimin e rrjetit të transportit dhe të energjisë, gjithashtu me qëllim përmirësimin e lidhjeve në të gjithë rajonin. Kapaciteti administrativ dhe standardet profesionale të organeve të ngarkuara me zbatimin e *acquis* duhet të forcohen dhe të ruhet pavarësia e organeve rregullatore. Rritja e transparencës dhe llogaridhënies, në veçanti garantimi i funksionimit efektiv, eficient dhe transparent i sistemit të prokurimit publik dhe menaxhimit të financave publike vazhdon të jetë çështje thelbësore. Shqipëria ka vijuar përputhjen e plotë me të gjitha qëndrimet e deklaratat e politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të BE-së.

Numri i kërkesave të pabazuara për azil, të paraqitura nga shtetasit shqiptarë në Shtetet Anëtare të BE-së dhe ato të *Schengen*-it mbetet i lartë. Shqipëria duhet të marrë masa të menjëhershme dhe të vendosura, duke përfshirë ato në kuadrin e mekanizmit monitorues pas liberalizimit të vizave, që të adresojë këtë fenomen në mënyrë efektive.

2. KRITERI POLITIK

2.1. Demokracia

Zgjedhjet

Vitin e kaluar është bërë një farë progresi me ngritjen e Komisionit të Përkohshëm (ad hoc) Parlamentar për Reformën Zgjedhore. Kjo reformë pritet që të adresojë rekomandimet e nxjerra nga Zyra e OSCE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSCE/ODIHR). Është e rëndësishme që reforma të përfundohej në një kohë të arsyeshme përpara raundit të ardhshëm të zgjedhjeve të përgjithshme.

Në dhjetor, u ngrit Komisioni i Përkohshëm (ad hoc) Parlamentar për të adresuar mangësitë në sistemin zgjedhor dhe për të adresuar rekomandimet e OSBE/ODIHR-it nga zgjedhjet parlamentare të vitit 2013 dhe ato vendore të 2015. Këto mangësi përfshijnë mungesën e paanshmërisë dhe politizimin e administratës zgjedhore, transparencën e financave të fushatës dhe zgjidhjen e kontestimeve zgjedhore. Komisioni (ad hoc) bashkë-kryesohet nga një përfaqësues i maxhorancës dhe një përfaqësues i partisë kryesore opozitare dhe ka anëtarë nga të gjitha grupet parlamentare. Nën asistimin e ekspertëve të caktuar nga partitë, komisioni ka për detyrë hartimin e ndryshimeve në Kodin Zgjedhor nëpërmjet një qasje gjithëpërfshirëse. Prandaj, mandati i tij është shtrirë deri në qershor. Komisioni ka filluar të përfshijë institucionet e tjera përkatëse, partitë e tjera parlamentare dhe shoqërinë civile. Është e rëndësishme që reforma të përfundohej në një kohë të arsyeshme përpara raundit të ardhshëm të zgjedhjeve parlamentare që do të mbahen në vitin 2017.

Kuvendi

Janë bërë disa përparime në funksionimin e Kuvendit gjatë periudhës së raportimit me miratimin me konsensus të ndryshimeve kushtetuese për reformën në drejtësi dhe për përjashtimin e shkelësve të ligjit nga funksionet publike. Janë përmirësuar kontaktet me zgjedhësit dhe transparenca e gjithë përfshirja e aktiviteteve parlamentare. Vazhdon puna ndër-partiake për reformat kyçe, megjithëse dialogu politik është polarizuar në disa raste.

Në dhjetor, konsensusi ndër-partiak çoi në miratimin e ndryshimeve kushtetuese dhe të një ligji për integritetin e të zgjedhurve dhe zyrtarëve të emëruar, duke ndaluar shkelësit e ligjit që të mbajnë apo drejtojnë funksione publike. Ndryshimet e kaluara në shkurt dhe aktet nënligjore në mars ishin garanci për fillimin e zbatimit brenda afateve ligjore. Efektet paraprake rezultuan në dorëheqje vullnetare dhe shkarkime nga puna në nivel lokal.

Si shumica ashtu dhe opozita janë angazhuar në aktivitete intensive përgatitore për reformat në drejtësi dhe atë zgjedhore. Komisioni (ad hoc) për Reformën në Drejtësi kreu një proces gjithëpërfshirës, transparent, të drejtuar nga ekspertët, duke hartuar një sërë ndryshimesh kushtetuese dhe ligje shoqëruese. Vështirësitë në arritjen e kompromisit ndër-partiak shkaktuan vonesa në përfundimin e paketës së reformës. Ndryshimet në kushtetutë u miratuan me votë unanime në korrik. Vazhdon puna për miratimin e një sërë aktesh legjislativë që lidhen me reformën. Mandati i komisionit (ad hoc) për reformën në drejtësi është shtrirë deri në fund të vitit 2016. Komisioni (ad hoc) për Reformën Zgjedhore u ngrit në dhjetor dhe mandati i tij gjithashtu është shtrirë deri në fund të vitit 2016. Parlamenti miratoi 14 ligje që kërkojnë një shumicë të cilësuar, përfshirë edhe ndryshimet në Kodin Penal dhe Kodin e Punës. Nga të gjitha ligjet e miratuara gjatë periudhës së raportimit, rreth një e treta ka marrë mbështetjen e opozitës (për periudhën e mëparshme të raportimit, vetëm 16 nga 173 ligje siguruan mbështetje ndër-partiake).

Megjithatë, polarizimi politik mbeti në nivel të lartë, duke penguar si dialogun politik ashtu dhe proceset teknike. Në disa raste, opozita ka bojkotuar pjesërisht dhe për një kohë të shkurtër Parlamentin. Etika parlamentare nuk i përmbush dispozitat rregullatore dhe pritshmëritë e publikut. Pritet të miratohet kodi i etikës, i cili ka qenë në procedurë parlamentare që nga fillimi i vitit 2016.

Në mars dhe prill, parlamenti dorëzoi kërkesat për të shqyrtuar nëse tre anëtarët e parlamentit (deputetët) nga maxhoranca qeverisëse kishin respektuar rregullat kushtetuese që rregullojnë mandatin e tyre. Shqyrtimi i mandatit të një deputeti erdhi si rezultat i një vendimi të Gjykatës Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese ka ende për të dhënë vendimet për dy deputetë të tjerë. Një deputet nga një parti e vogël humbi mandatin e tij pasi u arrestua, ndërsa një tjetër deputet nga maxhoranca dha dorëheqjen në tetor në përgjigje të akuzave për afera kriminale në të shkuarën. Dy deputetët presin vendimet e Gjykatës së Lartë.

Në dhjetor u zgjodhën dy anëtarë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe në janar u emërua një anëtar i Bordit të Autoritetit për Mbikëqyrjen Financiare. Katër anëtarë të Autoritetit Audio-vizual të Medias dhe një anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë u zgjodhën në korrik. Kuvendi ka refuzuar pesë dekrete të Presidentit, duke i kthyer ligjet për t'u rishqyrtuar në Parlament (ligji "Për marrëveshjet ndërkombëtare", ligji "Për median audio-vizuale", ligji "Për pronat", ligji "Për arsimin e lartë" dhe ligji "Për turizmin").

Ligji për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit në BE, të miratuar në mars të vitit 2015 duhet të reflektohet në rregulloren parlamentare. Kapacitetet e Këshillit Kombëtar për Integrimin Evropian u rritën me shtimin e një njësie mbështetëse të dedikuar. Këshilli duhet të përmbushë plotësisht rolin e tij si forum për përfshirje të gjerë dhe konsultime për çështje të integrimit në BE. Kapaciteti i përgjithshëm i Kuvendit për të monitoruar zbatimin dhe përputhshmërinë e ligjit të ri me *acquis*-in mbetet i kufizuar. Përveç disa përpjekjeve, nevojitet koordinimi mëtejshëm me degët ekzekutive.

Mandatet e dy Komisioneve Hetimore Parlamentare u shtrinë në shkurt, prill dhe qershor dhe në prill u ngritën dy komisione të reja. Tri nga këta komisione hetimore parlamentare janë ngritur dhe drejtohen nga opozita. Puna e komisioneve hetimore mbetet tepër konfliktuale dhe nuk solli rezultate. Mekanizmat e tjerë mbikëqyrës mbetën më pak të shfrytëzuara. Parlamenti zhvilloi një proces rishikimi më të strukturuar të raporteve vjetore mbi institucionet e pavarura dhe miratoi 16 rezoluta. Gjithsesi, duhet të zhvillohet një sistem gjithëpërfshirës për ndjekjen dhe monitorimin e rekomandimeve të Kuvendit dhe institucioneve të pavarura.

Në pesë qytete kryesore (Fier, Kukës, Shkodër, Gjirokastrë dhe Korçë) janë hapur zyra zgjedhore dhe janë plotësuar me staf parlamentar. Zyra në Korçë funksionon mbi bazën ndërpartiake. Duhet të garantohet mbulimi i 12 qyteteve.

Transparenca dhe gjithë përfshirja në punën e parlamentit vazhdon të ndjekë trendin rritës. Faqja e re e parlamentit, e krijuar në mars, ka përmirësuar ndjeshëm qasjen në dokumentet e parlamentit. Gjithsesi, nevojitet më tepër transparencë në nivel komisioni. Komisionet parlamentare vazhduan konsultimet me palët përkatëse të interesuara, por kërkohet përmirësim në njoftimin e hershëm dhe ndjekjen. Në nëntor u miratua ligji i ri për ngritjen e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC).

Në shkurt u rritën kapacitetet e ekspertëve dhe u miratua rritja e alokimeve buxhetore për trajnime, por kapacitetet kërkimore dhe analitike mbetën të kufizuara.

Qeverisja

Qeveria ka vijuar punën për agjendën e reformave, e përqendruar kryesisht në adresimin e pesë prioritetëve kyçe për hapjen e negociatave dhe stabilizimin e ekonomisë. Është bërë një farë progresi për koordinimin e politikave dhe në nivel të qeverisjes vendore, me miratimin e ligjit të ri për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore. Gjithsesi, nevojiten përpjekje të mëtejshme thelbësore për të rritur kapacitetet administrative të qeverisjes vendore në mënyrë që të përmbushin kompetencat e tyre të zgjeruara dhe për t'u siguruar atyre burimet e nevojshme financiare.

Qeveria mbetet e përkushtuar për integrimin në BE dhe ka ndjekur programin e reformave, që përfshin adresimin e pesë prioritetëve kyçe për hapjen e negociatave për anëtarësim; forcimin e sundimit të ligjit; dhe trajtimin e ekonomisë jo-formale.

Në maj, qeveria miratoi Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015-2020, që përcakton piketat strategjike për pesë vitet e ardhshme. Në nëntor është ngritur Bordi për Integrimin Evropian, i përbërë nga Ministrat përgjegjës për pesë prioritetet kyçe, për të përmirësuar koordinimin në funksion të hapjes së negociatave për anëtarësim në të ardhmen.

Mbetet prezente nevoja për bashkëpunim më të ngushtë dhe koordinim në të gjitha nivelet e qeverisjes, me platforma parlamentare dhe të shoqërisë civile që merren me çështjet e integritit në BE. Është përmirësuar koordinimi i politikave me krijimin e Grupeve të Menaxhimit të Integruar të Politikave në sektorët pilot. Megjithatë, nevojiten më shumë përpjekje për të përmirësuar kapacitetin e grupeve të menaxhimit, sekretariateve të tyre teknike dhe të Departamentit për Zhvillim, Financim dhe të Ndhmës së Huaj, që është organi kryesor koordinues.

Nuk ka pasur asnjë **Vendim të Gjykatës Kushtetuese** që prej tetorit 2015 për funksionimin e institucioneve shtetërore. Disa ministri po zbatojnë programet e transparencës dhe për këtë qeveria ka krijuar një faqe interneti për transparencën. Megjithatë, nevojiten përpjekje të mëtejshme për të komunikuar në mënyrë më efektive përfitimet e reformave kyçe, në veçanti ato me ndikim të madh social dhe ato që lidhen me procesin e integritit në BE. Nevoja për më shumë transparencë dhe llogaridhënie vlen edhe për institucionet e pavarura.

Koalicioni qeverisës ka mbetur i qëndrueshëm. Kabineti qeveritar pësoi tri ndryshime të ministrave, por nuk ka pasur riorganizim politik.

Për sa i përket **qeverisjes vendore**, ka vazhduar zbatimi i reformës territoriale edhe pse konsolidimi financiar dhe administrativ i bashkive të reja të sapokrijuara ishte i ngadaltë. Mbetet për tu garantuar zbatimi i plotë i ligjit për nëpunësit civilë në qeverisjen vendore. Nevojiten burime të mjaftueshme për zbatimin e planeve të trajnimit për stafin e bashkive të reja.

Procesi i decentralizimit u mbështet nga ngritja e Grupit Koordinues Ndër-institucional në kuadër të Grupit të Menaxhimit të Integruar të Politikave për qeverisje të mirë. Shqipëria duhet të sigurojë qëndrueshmëri financiare afatmesme për strategjinë e decentralizimit.

Ligji i ri për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore hyri në fuqi në janar. Ligji decentralizon një numër të madh të kompetencave të reja për bashkitë. Ka mbetur në pritje ngritja e Këshillit Konsultativ mes qeverisë qendrore dhe asaj vendore. Ofrimi i shërbimeve publike me një ndalesë (*one-stop-shops*) është pilotuar në pesë bashki.

Për sa i përket decentralizimit fiskal, ndarja e burimeve të të ardhurave të alokuara për njësitë e qeverisjes vendore u rrit nga 2.2% e PBB-së që ishte në vitin 2015 në 3.2% në vitin 2016, që përbën buxhetin më të madh të alokuar ndonjëherë për njësitë e qeverisjes vendore në Shqipëri. Megjithatë, duke pasur parasysh kompetencat që i janë transferuar nivelit vendor, buxheti 2016 nuk paraqet një rritje neto në asistencën e bashkive.

Nevojitet miratimi i një ligji të ri për financat dhe sistemin e taksave vendore, duke u bazuar në parimet e parashikueshmërisë dhe transparencës së alokimit të fondeve, duke siguruar një mekanizëm të barazimit financiar dhe duke favorizuar të ardhurat vendore, mbledhjen e taksave dhe qasjen në kredi e hua. Transparenca në financat e qeverisjes vendore është përmirësuar me publikimin në formë elektronike të buxheteve të qeverisjes vendore. Buxheti i qytetarëve për buxhetin e qeverisjes vendore mbetet për tu publikuar.

Në fushën e **planifikimit territorial**, në shtator u prezantua një sistem elektronik për ofrimin e shërbimeve me një ndalesë (*one-stop-shop*) për të bërë aplikimet për leje ndërtimi dhe pritjet që kjo të rrisë transparencën e procesit të vendimmarrjes në institucionet e përfshira.

Kapacitetet e njësisve të qeverisjes vendore për përgatitjen e planeve të zhvillimit vendor mbeten të kufizuara dhe miratimi i këtyre planeve ka ecur me hapa të ngadaltë. Fondet e buxhetit të shtetit për vitin 2016, të parashikuara për të mbështetur hartimin e planeve të zhvillimit vendor mjaftojnë vetëm për 26 nga 61 bashki.

Që prej emërimit të tij në vitin 2011, Avokati i Popullit ka promovuar në mënyrë aktive të drejtat e grupeve të cenuara, përfshirë edhe duke paraqitur raporte dhe rekomandime të veçanta. Megjithatë, puna e Avokatit të Popullit mbetet e kufizuar nga mungesa e fondeve dhe personelit dhe zyrat e tij qendrore dhe vendore duhet të përmirësohen në mënyrë që stafi të mund të kryejë punën e tyre në mënyrë të kënaqshme. Në vitin 2016, është rritur alokimi i buxhetit për Avokatin e Popullit, duke mundësuar rekrutimin e Komisionerëve për të Drejtat e Fëmijëve dhe Parandalimin e Torturës, por mbeten për t'u emëruar zyrtarët. Shumica e ankesave të dorëzuara institucionin e Avokatit të Popullit ende lidhen me të drejtat sociale dhe dështimin nga ana e administratës shtetërore për të vepruar brenda afateve ligjore.

Shoqëria civile

Janë bërë disa përparime për zbatimin e kuadrit institucional për konsultimin me shoqërinë civile pas miratimit të ligjit për ngritjen e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile. Kuadri fiskal që rregullon aktivitetin e organizatave të shoqërisë civile (OSHC-ve) ende nuk është i favorshëm për zhvillimin e tyre dhe nevojitet të rishikohet.

Një shoqëri civile e fuqizuar është një komponent i rëndësishëm në çdo sistem demokratik dhe duhet të njihet dhe të trajtohet si e tillë nga ana e institucioneve shtetërore. Kuadri ligjor dhe rregullator i Shqipërisë për të drejtën e lirisë së organizimit është përgjithësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare. Gjithsesi, procesi i regjistrimit në Gjykatën e Shkallës së Parë në Tiranë mbetet i rënduar për shkak të kostos së lartë financiare për regjistrim, procedurave të gjata dhe mungesës së gjyqtarëve të specializuar që merren me çështjet ligjore të OSHC-ve. Në prill, u miratua në parlament ligji për vullnetarizmin, duke përmbushur një nga nëntë prioritetet e identifikuara në Udhërrëfyesin e qeverisë drejt një mjedisi më të favorshëm për zhvillimin e shoqërisë civile.

Në nëntor, parlamenti miratoi ligjin për ngritjen dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC), me qëllim institucionalizimin e bashkëpunimit mes qeverisë dhe shoqërisë civile. Nën kryesimin e Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli përbëhet nga 13 përfaqësues të qeverisë dhe 13 përfaqësues të shoqërisë civile, e ku Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile vepron si sekretariat teknik.

Procesi i përzgjedhjes së përfaqësuesve të shoqërisë civile për KKSHC-në nuk përcaktohej qartë në ligj dhe kjo u përfundua në qershor me ndihmën e ndërkombëtareve. Janë organizuar sesione informuese në të gjithë vendin për të prezantuar KKSHC-në dhe mënyrën se si ai u ngrit. Përfaqësues të shoqërisë civile kanë marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e Këshillit Kombëtar për Integrimin Evropian (KKIE), por roli i tyre, në përgjithësi, mbetet pasiv. Zbatimi efektiv i ligjeve për të drejtën e informimit dhe për konsultimet publike mbetet sfidë, sidomos në nivel lokal.

Pas hyrjes në fuqi të standardeve të reja kombëtare të kontabilitetit për organizatat jofitimprurëse në janar, kuadri ligjor dhe rregullator në sistemin e taksave për OSHC-të duhet të përmirësohet më tej dhe kapacitetet e inspektimit tatimor duhet të përforcohen. Procedura aktuale për rimbursimin e TVSH-së së shpenzimeve nën grantet e financuara nga Instrumenti i Asistencës së Para-anëtarësimit (IPA) nuk është funksionale dhe nuk është bërë asnjë rimbursim. Financimi publik mbetet i kufizuar dhe nuk është rregulluar me ligj në nivel qendror dhe vendor. Legjislacioni aktual nuk parashikon asnjë reduktim taksash për donacione individuale apo të korporatave për OSHC-të.

2.2. Reforma në administratën publike

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në drejtim të reformës në administratën publike. Janë bërë **disa përpertime** për reformën në administratën publike, në veçanti për sa ka të bëjë me procedurat më transparente të rekrutimit të nëpunësve civilë. Ka vazhduar zbatimi i qëndrueshëm i strategjive të reformës në administratën publike dhe të reformës për menaxhimin e financave publike. Vitin e ardhshëm, Shqipëria, në veçanti, duhet:

→ të përshtatë më tej programin buxhetor vjetor dhe programin buxhetor afatmesëm me njëra tjetrën dhe me strategjitë në vazhdim të reformave si dhe me prioritetet e qeverisë;

→ të forcojë kapacitetin e menaxherëve të burimeve njerëzore dhe të anëtarëve të komisionit përzgjedhës për të përmirësuar më tepër procesin e rekrutimit dhe për të mundur shkëmbimin e të dhënave midis Sistemit Informatik për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe Thesarit;

→ të përfundojë përafrimin e legjislacionit për sektorë përkatës me Kodin e Procedurave Administrative dhe të miratojë aktet nën-ligjore përkatëse për të siguruar zbatimin koherent të tij.

Zhvillimi dhe koordinimi i politikës

Shqipëria ka kuadrin e nevojshëm ligjor dhe institucional për një **sistem të mirë të hartimit të politikave**. Gjithsesi, përshtatja mes dokumenteve strategjike dhe programit buxhetor afatmesëm është ende i pamjaftueshëm dhe analiza e kostove duhet të përpunohet më tepër. Zbatimi i të gjitha strategjive kërkon monitorim dhe raportim të vazhdueshëm të përqendruar mbi rezultatet. Pavarësisht vonesave, sistemi për koordinimin e integritit evropian është forcuar nga rritja e numrit të stafit në njësitë e integritit në BE të ministrive të linjës. Koordinimi në përgatitjen e Planit Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE) është përmirësuar më tej, por duhet të integrohet më mirë në sistemin e përgjithshëm të planifikimit të politikave.

Hartimi i politikave dhe legjislacionit ende nuk është mjaftueshëm **gjithëpërfshirës dhe i bazuar në evidenca**. Duhet të miratohet metodologjia për vlerësimin e ndikimit për të siguruar cilësi më të mirë të vlerësimeve të ndikimit rregullator dhe fiskal dhe zbatimin sistematik të tyre. Ekzistojnë procedurat horizontale për përafrim me *acquis-in* dhe tabelat e përputhshmërisë janë të detyrueshme, por ndikimi i përafrimit nuk është analizuar siç duhet dhe kostot e zbatimit nuk janë parashikuar gjithmonë saktë. Kapacitetet institucionale për koordinimin, rishikimin dhe monitorimin e politikave duhet të forcohen më tej.

Konsultimi publik rregullohet me ligj dhe në shtatorë shtë krijuar një faqe interneti për konsultim publik. Cilësia e procesit të konsultimit ka ende nevojë për përmirësime. **Shqyrtimi publik i punës së qeverisë** mbetet ende i kufizuar. Raportet e qeverisë për dokumentet strategjike janë paraqitur në parlament në bazë vjetore, por raportimi shpesh mbulon vetëm zbatimin e aktiviteteve.

Menaxhimi i financave publike

Në maj, qeveria publikoi raportin e parë të monitorimit të **Strategjisë së Reformës për Menaxhimin e Financave Publike (MFP) 2014- 2020**. Pavarësisht vonesave, është bërë një farë progresi në disa fusha si p.sh. likuidimin e detyrimeve të prapambetura; rishikimin e ligjit për sistemin buxhetor, hetimet financiare dhe kontrollit të brendshëm; qasjen elektronike në sistemin e thesarit; sistemin informatik të menaxhimit financiar; fushatat në luftën kundër informalitetit dhe manualitetit të auditimit të jashtëm.

Është përgatitur dhe pret miratimin një matricë më të mirë me tregues rezultatesh për monitorimin e strategjisë MFP. Pas shqyrtimit funksional, struktura e Ministrisë së Financave ndryshoi krejtësisht, duke rritur stafin nga 250 në 293. Në Ministrinë e Financave u krijua një njësi e re për monitorimin e zbatimit të strategjisë MFP-së. Në të njëjtën kohë, në gusht, në Ministrinë e Financave kishte 80 vende të lira të publikuara, duke ndikuar në kapacitetin e saj.

Reformat në periudhën e ardhshme duhet të fokusohen në zbatimin e ligjit të rishikuar për buxhetin organik; përmirësimin e planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit, parandalimin e përsëritjes së detyrimeve të prapambetura; përpunjen me standardet e menaxhimit dhe kontrollit financiar në ministritë; përmirësimin e funksionit shqyrtues të prokurimit publik dhe përpunshmërisë me rregullat e prokurimit; sigurimi i qasjes elektronike për thesarin më shumë institucioneve; garantimi i mbledhjes së taksave më mirë dhe pajtueshmërisë vullnetare; përmirësimin e planifikimit dhe menaxhimit të investimeve; dhe plotësimin e vendeve bosh në Ministrinë e Financave të riorganizuar, dogana dhe administratë tatimore (*shih edhe kapitujt 5, 16, 29 dhe 32*).

Janë ndërmarrë masa për të përmirësuar **transparencën e buxhetit**, por ato duhet të intensifikohen edhe më tej. Që prej vitit 2015 është zbatuar një Udhërrëfyes për transparencën, i cili është përditësuar në 2016, për të adresuar rezultatet e vlerësimit të programit të transparencës dhe rezultatet e vlerësimit të indeksit të buxhetit të hapur.

Janë publikuar buxheti i 2016, buxheti i qytetarit për projekt-buxhetin 2016 dhe lista e investimeve publike në kuadër të programit buxhetor afatmesëm. Gjithashtu janë botuar edhe statistikatat vjetore financiare të qeverisë për vitin 2014 dhe 2015, ndërsa raporti i zbatimit të buxhetit 2015 është publikuar me vonesë. Gjithsesi, struktura e saj nuk lejon të bësh krahasime dhe analizë kundrejt buxhetit fillestar dhe raportimi për asetet shtetërore është i dobët. Raportimi brenda vitit është në dispozicion, por nuk është nxjerrë asnjë raport 6-mujor më vite. Pjesëmarrja e qytetarëve në procesin e hartimit të buxhetit mbetet ende e dobët.

Shërbimi publik dhe menaxhimi i burimeve njerëzore

Ligji për nëpunësit civilë parashikon një fushë të qartë për shërbimin civil, por institucionet që japin shërbime direkte për qytetarët përjashtohen nga fusha e tij. Kjo duhet të trajtohet dhe

duhet të garantohen standarde të përbashkëta për një administratë profesionale dhe të bazuar në meritë.

Ligji përcakton procedurat për **rekrutimin dhe ngritjen në detyrë bazuar në meritë**. Pavarësisht numrit të madh të aplikantëve, rreth 40% e vendeve të lira, të shpallura mbetën të paplotësuar në vitin 2015. Organizimi praktik i procedurave të rekrutimit duhet të përmirësohet më tej, p.sh. përmes planifikimit dhe trajnimit më të mirë të anëtarëve të komisionit përzgjedhjes. Rekrutimi i mëtejshëm i trupës së lartë drejtuese nëpërmjet programit të formimit të thelluar në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike duhet të rregullohet në përputhje me ligjin.

Ndryshimet e 2014 në ligj zgjeruan arsyet për **shkarkimin** e nëpunësve civilë. Departamenti i Administratës Publike duhet të monitorojë nga afër zbatimin e këtyre ndryshimeve për të siguruar që të ruhen procedurat e drejta dhe transparente të shkarkimit. Largimet e shumta të stafit në nivel vendor kërkohet të ndiqen siç duhet. Në tetor 2015, u nxor një urdhër që sqaron procedurën dhe përgjegjësinë për zbatimin e vendimeve të formës së prerë lidhur me ankesat nga nëpunësit civilë. Ky urdhër duhet të zbatohet në mënyrë efektive për të përmirësuar zbatimin e vendimeve të formës së prerë.

Kapaciteti i Departamentit të Administratës Publike (DAP) për të drejtuar **menaxhimin e burimeve njerëzore** është përmirësuar në sajë të rritjes së stafit në 53 anëtarë. Gjithsesi, koordinimi, mbikëqyrja dhe roli i tij si ndihmës duhet të forcohen më tej. Sistemi informatik i menaxhimit të burimeve njerëzore është funksional, por çështjet teknike po pengojnë shkëmbimin e të dhënave me sistemin e thesarit. DAP duhet të sigurojë përfundimin e hedhjes së të dhënave dhe të zhvillojë procedurat për të siguruar përditësimin e rregullt dhe cilësinë e të dhënave.

Institucionet publike kanë treguar bashkëpunim të mirë me Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil. Raporti vjetor i Komisionerit u diskutua në parlament dhe më pas u botua. Duhet të alokohen burime të përshtatshme për Komisionerin që të mund të ushtrojë plotësisht mandatin e tij.

Sistemi i **pagave të nëpunësve civilë**, në parim është transparent dhe bazohet në një sistem të klasifikimit të vendeve të punës. Gjithsesi, zbatimi i sistemit të ri që bazohet në vlerësimin e punës ka mbetur pezull. Prezantimi i shpërblimeve (bonuseve) për nëpunësit civilë që punojnë për integrimin në BE duhet të vlerësohet në mënyrë të rregullt pasi rrezikon që të kompromentojë koherencën e sistemit të përgjithshëm të pagave.

Zhvillimi profesional i njihet si e drejtë çdo nëpunësi civil. Trajnimi ofrohet nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike dhe cilësia e sasia e kurseve në dispozicion është përmirësuar. Buxheti, megjithatë, nuk është i mjaftueshëm për të mbuluar numrin e madh të personave për trajnim, përfshirë dhe në nivel lokal. Është zhvilluar një sistem i ri i vlerësimit të performancës, me vlerësime të përgjithshme që bëhen çdo gjashtë muaj. DAP duhet të monitorojë zbatimin e tij dhe të marrë masat e nevojshme korrigjuese në rast se sistemi i ri krijon një barrë të panevojshme mbi administratën dhe çon në vendime diskrecionale shkarkimi. Kërkohet rritje e ndërgjegjësimin dhe trajnimi i menaxherëve për të siguruar zbatimin e tij.

Në dhjetor 2015 u miratua një ligj i ri për **integritetin** e personave që ushtrojnë funksione publike. Në përputhje me këtë ligj, në prill, Departamenti i Administratës Publike mbledhi 24 000 vetë-deklarime. Verifikimi i tyre çoi në shkarkimin e 24 punonjësve publikë. Perceptimi i korrupsionit mbetet i lartë dhe nevojiten më shumë përpjekje në këtë drejtim.

Llogaridhënia e administratës

Kuadri ligjor për organizimin e administratës shtetërore kërkon modernizim. **Linjat e dhënies së llogarisë** dhe raportimi mes institucioneve janë rregulluar, por ka mospërputhje mes llojeve të ndryshme të institucioneve të varësisë. Gjithashtu, numri i organeve që raportojnë drejtpërsëdrejti tek Kuvendi është shumë i lartë. Delegimi i përgjegjësisë parashikohet në Kodin e Procedurave Administrative. Administrata shtetërore është subjekt i mbikëqyrjes nga ana e institucioneve të pavarura (shih kapitullin 32). Numri i rekomandimeve dhe i kërkesave për informacion të Avokatit të Popullit që nuk kanë marrë përgjigje mbetet i lartë, duke kompromentuar të **drejtën e qytetarëve për administrim të mirë**.

Edhe pse **e drejta për të pasur qasje në informacionin publik** rregullohet me ligj që nga viti 2015, shkalla e përgjigjes ndaj kërkesave të qytetarëve mbetet e ulët. Programet e transparencës janë miratuar në shumicën e institucioneve, por cilësia dhe zbatimi i tyre duhet të përmirësohet më tej. Kapaciteti i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale duhet të rritet në mënyrë që zbatimi i ligjit monitorohet siç duhet.

E drejta për drejtësi administrative rregullohet nga ligji për zgjidhjen e konflikteve administrative dhe ligji për gjykatat administrative. Kapaciteti i përgjithshëm i sistemit të gjykatave administrative të merren me grumbullimi i rasteve duhet të përmirësohet në mënyrë të konsiderueshme. Legjislacioni për mbrojtjen **e të drejtës së qytetarëve për të kërkuar kompensim** në rastet e shkeljes nga autoritetet publike është në fuqi, por për shkak të ndërjegjësimi të kufizuar të publikut, rastet gjyqësore në këtë fushë janë të rralla.

Ofrimi i shërbimeve për qytetarët dhe bizneset

Në maj, qeveria miratoi dokumentin e politikave për **ofrimin e shërbimeve me në qendër qytetarin** për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve publike dhe për të rritur reagimin e qytetarëve. Koordinimi ndër-institucional është përmirësuar falë ngritjes së grupeve tematike për digjitalizimin, e-qeverisjen dhe ofrimin e shërbimeve, si pjesë e grupit të menaxhimit të integruar të politikave për qeverisje të mirë.

Në mars, hyri në fuqi ligji i ri për mënyrën e ofrimit të shërbimeve në sportelet e shërbimit. Ky ligj përcakton standardet për shërbimet publike dhe ka për qëllim të **thjeshtësojë procedurat administrative** së bashku me Kodin e Ri të Procedurave Administrative, që hyri në fuqi në maj. Gjithsesi, për shkak të mungesës së institucionit kryesor koordinues, puna për miratimin e legjislacionit të nevojshëm zbatues, rishikimin e procedurave të veçanta administrative dhe përshtatja e legjislacionit për sektorë përkatës është e kufizuar.

Kuadri strategjik për reformën në administratën publike

Është publikuar raporti i parë vjetor i zbatimit të strategjisë së **Reformës së Administratës Publike** 2015-2020 dhe janë përcaktuar bazat për treguesit e përzgjedhur të performancës. Grupi i menaxhimit të integruar të politikave për reformën e administratës publike (PAR), i

ngritur në shtator të 2015, ende ka nevojë që t'u shndërruar në një forum për zhvillimin e politikave. Duhet të përmirësohet përfshirja e shoqërisë civile dhe komunitetit të biznesit në procesin e monitorimit.

Reforma e administratës publike është një nga prioritetet e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, të miratuar së fundmi, duke konfirmuar **mbështetjen e vazhdueshme politike** në këtë fushë. Zyra e Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike u shtua me katër anëtarë të tjerë. Financimi i strategjisë së RAP është pasqyruar në programin buxhetor afatmesëm. Gjithsesi, hendeku i vlerësuar financiar për zbatimin e strategjisë së RAP ka mbetur në nivelin 29%, duke shkaktuar shqetësime në **qëndrueshmërinë** e zbatimit të tij.

2.3. Shteti i së drejtës

Funksionimi i sistemit gjyqësor

Sistemi gjyqësor shqiptar ka **një farë niveli të përgatitjes**. Gjatë vitit të kaluar është arritur **progres i mirë**, kryesisht me miratimin e një sërë ndryshimesh kushtetuese që i hapën rrugë reformës gjithëpërfshirëse dhe të thellë në Drejtësi. Kjo u pasua nga një proces i gjatë konsultimesh publike dhe bashkëpunimi të ngushtë me Komisionit Evropian për demokraci përmes ligjit (Komisioni i Venecias) në Këshillin e Evropës, i cili miratoi një opinion për ndryshimet kushtetuese. Është miratuar një ligj i ri për rivlerësimin e gjykatësve, prokurorëve dhe këshilltarëve juridikë. Si pjesë e masave për të luftuar korrupsionin dhe për të rikthyer besimin e publikut në sistemin gjyqësor, ligji përcakton rivlerësimin (*vetting-un*) mbi bazën e 3 kritereve: integriteti përmes vlerësimit të pasurisë, vlerësimit të së shkuarës (lidhjet e papërshtatshme me krimin e organizuar), dhe kompetencave profesionale. Zbatimi i tij është pezulluar nga Gjykata Kushtetuese, e cila po rishikon kushtetueshmërinë e tij dhe ka kërkuar *amicus curiae* të shkurtër nga Komisioni i Venecias.

Për më tepër, janë miratuar një sërë ligjesh organike, të identifikuar nga pushteti ligjvënës shqiptar si prioritare për zbatimin e reformës në drejtësi. Këto rregullojnë organizimin e përgjithshëm të gjyqësorit, prokurorisë, statusit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, Gjykatës Kushtetuese, krijimin e institucioneve të specializuara për luftën kundër krimit të organizuar dhe anti-korrupsionit. Përveç kësaj pakete legislative, vazhdojnë përgatitjet për 40 ligjet dhe aktet e tjera nën-ligjore që lidhen me reformën në drejtësi.

Nuk ka pasur progres në plotësimin e rekomandimeve të tjera, të identifikuar vitin e kaluar, përkatësisht për plotësimin e vendeve të lira në Gjykatën e Lartë dhe gjykatat administrative; përdorimin efektiv të sistemit të unifikuar për menaxhimin e lëndëve; dhe publikimin në kohë të të gjitha vendimeve gjyqësore së bashku me bazat e tyre. Për të realizuar prioritetin kyç për reformën në sistemin e drejtësisë, vitin e ardhshëm, Shqipëria, në veçanti, duhet:

→ të çojë përpara zbatimin e dispozitave të reja kushtetuese, gjithashtu përmes miratimit dhe zbatimit të ligjeve përkatëse;

→ të ndjekë reformën sektoriale në kuadër të Strategjisë Ndër-sektoriale të Drejtësisë 2017-2020 dhe planit të saj të veprimit, të miratuar së fundmi, për të siguruar që burimet e mjaftueshme financiare mundësohen vazhdimisht për të arritur objektivat e reformës;

→ të ngrejë organet e punës për *vetting*-un dhe të japë rezultatet fillestare në procesin e rivlerësimit të gjykatësve dhe prokurorëve.

Dokumentet strategjike

Strategjia e mëparshme e reformës në sektorin e drejtësisë përfundoi në 2013. Në nëntor 2016, është miratuar një strategji e re që përcakton kuadrin për zbatimin e reformës në drejtësi deri në 2020. Është gati strategjia afatmesme për prokurorinë 2015-2017.

Organet drejtuese

Nën reformën kushtetuese, trupi aktual që drejton gjyqësorin, Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD), do të zëvendësohet nga një **Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ)**, i cili do të ketë pavarësi më të madhe nga ndikimi politik dhe do të jetë më pak i prirur për korporatizëm dhe korrupsion.

Aktualisht, roli i KLD-së është i kufizuar për gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë, ndërsa kompetenca e KLGJ-së do të shtrihet në Gjykatën e Lartë. KLGJ do të përbëhet nga 11 anëtarë me kohë të plotë, përkatësisht gjashtë prej tyre zgjidhen nga gjyqtarët e të gjitha niveleve dhe pesë anëtarë zgjidhen nga parlamenti, nga radhët e juristëve shumë të kualifikuar. Dy anëtarë porotë do të zgjidhen nga profesionet ligjore, dy nga radhët e pedagogëve të së drejtës dhe të Shkollës së Magjistraturës, si dhe një anëtar nga shoqëria civile. Përzgjedhja e kandidatëve porotë është përgjegjësi e një Nën-komisioni Parlamentar për Çështjet Ligjore, që vepron brenda kompetencave të parlamentit për të miratuar kandidatët e përzgjedhur me 3/5 shumicë ose për të refuzuar këtë listë me 2/3 e shumicës. Presidenti i Republikës do të ulet si anëtar apo të drejtojë Këshillin. Përkundrazi, kryetari do të zgjidhet nga radhët e anëtarëve të KLGJ-së. Ministri i Drejtësisë do të ulet si anëtar në Këshill vetëm kur shqyrtohen çështjet strategjike apo buxhetore.

Njëlloj si KLD, KLGJ është përgjegjëse për vlerësimin, emërimin, promovimin dhe transferimin e gjyqtarëve, si dhe për vendosjen e sanksioneve disiplinore. Gjithsesi, procedurat disiplinore nuk do të fillohen nga Ministri i Drejtësisë por nga **Inspektoriati i Lartë i Drejtësisë**.

Struktura aktuale e Këshillit të Prokurorëve, si organ këshillimor për Prokurorinë e Përgjithshme (PP), do të ndryshohet nën reformën dhe to t'iu japë prokurorëve pavarësi më të madhe nga PP. Do të ngrihet **Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP)** dhe do të ketë përgjegjësinë ekskluzive për menaxhimin e karrierës së prokurorëve dhe për çështje disiplinore. KLP-ja do të përbëhet nga 11 anëtarë: 6 prokurorë të zgjedhur nga kolegët e tyre dhe 5 anëtarë porotë, të zgjedhur përmes së njëjtës procedurë si anëtarët e KLGJ-së. KLP-ja i propozon Kuvendit kandidatin për pozicionin e Prokurorit të Përgjithshëm.

Pavarësia dhe paanësia

Pavarësia e gjyqësorit sanksionohet në Kushtetutë. Gjithsesi, në praktikë ajo rrezikohet nga mënyra tejet të politizuar me anë të secilës emërohen gjykatësit e Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, si dhe nga hapësira e gjerë e diskrecionit që gëzon KLD-ja dhe Prokurori i Përgjithshëm menaxhimin e karrierës së prokurorëve. Ekzistojnë raporte të vazhdueshme për ndërhyrjen politike në çështjet e hetimit dhe të gjykatave.

Sistemi i unifikuar për menaxhimin e çështjeve për ndarjen e çështjeve për gjykatësit përdoret pjesërisht. Praktika jo transparente, të tilla si hedhja me short, ku ndonjëherë shorti zhvillohet në zyrën e kryetarit të gjykatës, zbatohen ende në disa gjykata. Sistemi shërbimit të prokurorisë për menaxhimin e rasteve nuk është ende plotësisht funksional në mbarë vendin, përveçse për qëllimin e regjistrimit rasteve. Rregullat **për përjashtimin e gjykatësve** nga çështje të caktuara përcaktohen në Kodin e Procedurës Civile, Penale dhe Administrative por nuk ka një regjistrim sistematik të rasteve të tilla.

Llogaridhënia

Në lidhje me rritjen e llogaridhënies së sistemit gjyqësor, reforma kushtetuese i jep Inspektoratit të lartë të Drejtësisë pushtet ekskluziv inspektimi, si dhe pushtete ekskluzive për verifikimin dhe hetimin e ankesave kundër gjykatësve dhe prokurorëve. Aktualisht, gjykatësit monitorohen përmes **inspektimeve** nga ana e Ministrisë së Drejtësisë edhe nga KLD-së. Pavarësisht se ka një memorandum mirëkuptimi mes këtyre dy organeve, mbetet rreziku i mbivendosjes së inspektimeve.

Kodi i etikës për gjykatësit, i vitit 2000, nuk ka patur asnjë ndikim konkret mbi llogaridhënien e tyre, pavarësisht se etika profesionale është një nga temat e mbuluara në programin e trajnimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës. Ofrohet trajnim gjatë shërbimit për etikën e prokurorëve, por përputhshmëria me kodin e sjelljes së vitit 2014 nuk është përfshirë në vlerësimin vjetor të tyre. Nuk ka monitorim të mjaftueshëm për respektimin e standardeve etike dhe integritetit të gjykatësve dhe prokurorëve. Nën këtë reformë, parashikohet që respektimi i etikës të përfshihet në vlerësimin e gjykatësve dhe prokurorëve. Kodi Etik i Avokatit është në fuqi.

Gjykatësit dhe prokurorët kanë **detyrimin të deklarojnë pasurinë** e tyre në baza vjetore. Pavarësisht kallëzimeve nga Inspektoriati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) mbi mosdeklarimin e pasurisë nga gjyqtarët, nuk është marrë asnjë masë disiplinore deri më sot. Gjyqësori perceptohet si shumë i korruptuar.

Profesionalizmi dhe kompetenca

Karriera e gjykatësve, përkatësisht **rekrutimi, emërimi, ngritja në detyrë, transferimi dhe shkarkimi** i tyre është kompetencë e KLD-së. Profesionalizmi dhe integriteti nuk janë reflektuar mjaftueshëm në kriteret ekzistuese për emërimet e gjykatësve. Kuadri për vlerësimin e gjykatësve mbetet i dobët dhe karrierat e gjykatësve nuk janë plotësisht transparent dhe jo gjithmonë bazohen në merita dhe kriteret e tjera objektive.

Gjykatësit e Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese emërohen nga Presidenti i Republikës, me pëlqimin e shumicës së thjeshtë të Kuvendit. Kjo ka çuar në politizimin dhe

përplasje në procesin e përzgjedhjes, ku Kuvendi shpesh ka refuzuar kandidaturat e propozuara nga Presidenti. Në Gjykatën e Lartë janë ende tri vende bosh. Nën këtë reformë, Gjykata e Lartë do të shndërrohet në një Gjykatë Kasacioni, anëtarët e së cilës do të emërohen nga Presidenti me propozim të KLGJ-së.

Për të trajtuar çështjen e politizimit të emërimeve në Gjykatën Kushtetuese, reforma parashikon ngritjen e një **Këshilli për Emërime në Drejtësi**, i cili do të jetë përgjegjës për verifikimin e përmbushjen e kërkesave ligjore, si dhe të kriterëve profesionale dhe morale të zbatueshme për kandidatët që të emërohen në Gjykatën Kushtetuese dhe për postin e ri të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në kuadër të reformës së drejtësisë, emërimi i Prokurorit të Përgjithshëm do të bëhet me propozim të KLP-së dhe kërkon pëlqimin e shumicës 3/5 të së parlamentit; më tej, mandati i Prokurorit të Përgjithshëm do të reduktohet nga 9 vjet në 7 vjet, pa të drejtë riemërimi. Prokurori i Përgjithshëm aktualisht emërohet nga Presidenti me pëlqimin e shumicës së thjeshtë të parlamentit, e cila ka rrezikuar pavarësinë dhe besueshmërinë e sistemit të prokurorisë.

Si pjesë e masave për të luftuar korrupsionin dhe për të rikthimin e besimit të publikut në sistemin gjyqësor, reforma parashikon rivlerësimin (*vetting-un*) e të gjitha gjyqtarëve, prokurorëve dhe këshilltarëve ligjorë që janë aktualisht në shërbim. Zbatimi i ligjit përkatës është pezulluar nga Gjykata Kushtetuese, e cila po shqyrton kushtetutshmërinë e saj.

Cilësia e drejtësisë

Trajnimi fillestar dhe ai gjatë punës për gjykatësit ofrohen nga Shkolla e Magjistraturës. Ajo financohet pjesërisht nga donatorë të huaj, pavarësisht rritjes së buxhetit të Shkollës në 2016. Trajnimi për *acquis*-in e BE-së është i kufizuar. Që prej qershorit, Shqipëria është vëzhguese në Rrjetin Evropian për Trajnime Gjyqësore. Shkolla Kombëtare e Avokatisë ka funksionuar që prej vitit 2013 dhe ka trajnuar 660 kandidatë për vitin akademik 2015-16, por nuk ofron trajnime për avokatët gjatë punës.

Ministria e Drejtësisë publikon raportet vjetore për veprimtarinë e gjykatave. Të gjitha gjykatat duhet të hartojnë nga një raport, por jo të gjitha këto raporte publikohen. Disa gjykata nuk kanë faqe interneti.

Buxheti për sektorin e përgjithshëm të drejtësisë në vitin 2016 është 3% më i lartë se në 2015, në shumën prej 91.7 milion Euro, vlerë e cila përfaqëson 0.8% të PBB-së dhe 2.83% të buxhetit të shtetit. Ajo mbulon Ministrinë e Drejtësisë, prokurorinë, gjykatat, Shkollën e Magjistraturës, KLD-në dhe Gjykatën Kushtetuese.

Shqipëria ka 408 gjykatës profesionistë (14 për 100 000 banorë), 336 prokurorë (11.6 për 100 000 banorë) dhe 946 persona në stafin e gjykatës administrative (2.31 punonjës për gjykatës). Ka gjithashtu 1 880 avokatë që ushtrojnë profesionin (65 për 100 000 banorë). Planifikimi dhe shpërndarja e burimeve administrative dhe financiare duhet të përmirësohet.

Alokimet financiare për infrastrukturën e gjykatave janë rritur, por shumë ambiente të gjykatave kanë nevojë për përmirësim të mëtejshëm. Nevojiten salla të tjera. Seancat

dëgjimore vazhdojnë të zhvillohen në zyrat e gjykatësve, praktikë e cila ul transparencën dhe rrit rrezikun ndaj praktikave korruptuese.

Në prill u ngrit Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor, për ruajtjen dhe përpunimin e informacionit të çështjeve gjyqësore. Arkivi nuk është ende funksional. Ekziston një bazë të dhënash me jurisprudencat, por publikimi i vendimeve gjyqësore mbetet i parregullt dhe nuk ka mjete kërkimi efektive. Gjykata e Lartë paraqiti pesë vendime unifikuese të jurisprudencës. Sistemi për njoftimin e palëve dhe dëshmitarëve është i papërshtatshëm. Zgjidhja me ndërmjetësim ka gjetur zbatim më të shpeshtë, si një mekanizëm alternativ për zgjedhjen e mosmarrëveshjeve, sipas ligjit të **ndërmjetësimit**.

Efiçenca

Mbetet shqetësuese efiçenca e sistemit gjyqësor, për shkak të burimeve të pamjaftueshme administrative dhe financiare, planifikimit të papërshtatshëm dhe mungesës së dispozitave ligjore të shëndosha që rregullojnë organizimin e brendshëm të gjykatave. Numri i **rasteve të prapambetura** mbetet i lartë, në veçanti, në gjykatat administrative, gjykatat e apelit dhe në Gjykatën e Lartë. Reforma ka për qëllim të ulë ngarkesën e Gjykatës Kushtetuese duke ngushtuar fushën e kompetencave të saj. Gjykata e Lartë do të shndërrohet në Gjykatë Kasacioni, e do të ketë për detyrë ofrimin e interpretimit ligjor dhe të praktikës së unifikuar gjyqësore për jurisprudencë. Kompetenca aktuale e saj, për të trajtuar akuzat penale kundrejt zyrtarëve më të lartë të shtetit do t'i transferohen një gjykate speciale të shkallës së parë dhe një gjykate të apelit, gjithashtu përgjegjëse për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar.

Ka një mungesë të përgjithshme të kapacitetit për të nxjerrë të dhëna të besueshme statistikore. Vetëm pak gjykata të shkallës së parë përdorin standardet e sanksionuara në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për **matjen e normës së zgjidhjes së çështjeve dhe kohëzgjatjes së procedimeve** gjatë përgatitjes së raporteve të hershme të performancës së gjykatës. Megjithatë norma e zgjidhjes së çështjeve është përmirësuar në disa gjykata të shkallës së parë, ato mbeten problematike në gjykatat administrative, gjykatat e apelit dhe gjykatën e lartë. Kohëzgjatja e përgjithshme e procedimeve është shkak shqetësimi dhe lidhet kryesisht me mungesën e kapacitetit dhe papërshtatshmërisë së dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave. Nuk ka një mekanizëm të monitorimit të brendshëm të unifikuar dhe efektiv që aplikohet në të gjitha gjykatat. Zbatimi i vendimeve gjyqësore është shkak shqetësimi, në veçanti, për çështjet që kanë të bëjnë me pronat.

Lufta kundër korrupsionit

Shqipëria ka arritur **njëfarë niveli të përgatitjes** në luftën kundër korrupsionit. Vitin e kaluar janë bërë **disa përparime**, kryesisht me miratimin e ligjit për mbrojtjen e sinjalizueseve, ligjin për krijimin e një trupe të pavarur dhe të specializuar anti-korrupsion dhe me rritjen e aksesit për prokurorinë dhe policinë në regjistrat kombëtarë publikë elektronikë. Megjithatë, korrupsioni mbetet prevalent në shumë fusha dhe vazhdon të jetë një problem serioz. Janë bërë disa përparime në përmbushjen e dy rekomandimeve të vitit të kaluar, përkatësisht me progresin e mëtejshëm të dukshëm në krijimin e një historiku solid të hetimeve, ndjekjeve

penale dhe dënimeve, si dhe me rritjen e përpjekjeve për të siguruar akses të drejtpërdrejtë në bazat e të dhënave për prokurorët dhe policinë. Nuk janë bërë përpjekje në ndryshimin e legjislacionit për përgjimet dhe mbikëqyrjen, afatet kohore për hetimet dhe pranueshmërinë e provave para gjykatës. Pavarësia dhe efektiviteti i institucioneve të ngarkuara me luftimin e korrupsionit vazhdon të jetë i kufizuar nga presioni politik dhe kapacitetet e dobëta administrative. Në vitin e ardhshëm, Shqipëria, në veçanti duhet:

- të tregojë progres të mëtijshëm në ngritjen e një historiku solid të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve në luftën kundër korrupsionit në të gjitha nivelet, përfshirë rikuperimin e aseteve; sigurimin e hetimeve të mirëfillta dhe ndjekjen penale të rasteve të kallëzuara në prokurori nga Inspektoriat i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit dhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (ILDKPKI);
- të ndryshojë legjislacionin për përgjimet dhe mbikëqyrjen, afatet për hetimet dhe pranueshmërinë e provave para gjykatave për të bërë më efikase hetimet në rastet e korrupsionit, në përputhje me standardet dhe praktikatat më të mira evropiane;
- të ndryshojë kuadrin ligjor për financimin e partive politike, të ngrejë një sistem kontrolli efektiv dhe të besueshëm;
- rrisë më tej aksesin për prokurorinë dhe policinë në regjistrat kombëtarë publikë elektronikë; të shtrijë sistemin e menaxhimit të rasteve në të gjitha prokuroritë dhe të garantojë përdorim efikas të tij.

Historiku i rasteve

Ka patur një prirje pozitive që prej vitit 2010 në numrin e **hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve** të formës së prerë në rastet e korrupsionit për zyrtarët e nivelit të ulët apo të mesëm, megjithatë historiku i të dhënave mbetet i ulët në përgjithësi, veçanërisht për rastet e korrupsionit të zyrtarëve të nivelit të lartë.

Niveli i ulët i bashkëpunimi ndër-institucional dhe shkëmbimit të informacioni vazhdon të cenojë **hetimin proaktiv dhe ndjekjen penale efektive** të korrupsionit. **Hetimi financiar** dhe konfiskimi i pasurisë ishte në nivele shumë të ulëta. Dënimet e dhëna për rastet e korrupsionit kanë tendencën të jenë tepër të lehta. **Ndikimi politik** mbi organet e zbatimit të ligjit dhe korrupsioni në gjyqësor vazhdon të jenë çështje problematike. Infiltrimi i krimit të organizuar në sektorët publik, i ndihmuar nga korrupsioni, duhet të adresohet më shumë.

Deklarimet e pasurisë së zyrtarëve janë publikuar. Numri i kontrollit të deklarimeve të pasurisë dhe akuzave për falsifikim, fshehje dhe mosdeklarim të pasurisë është rritur që prej vitit 2014. Ka shumë pak raste të shkeljeve të **konfliktit të interesit**, për shkak të vakumit ligjor dhe mungesës së kapaciteteve për të kryer kontrole proaktive. Mungon një sistem i pavarur dhe i besueshëm për auditimin e **partive politike dhe financimin e fushatave zgjedhore**. Mekanizmat e kontrollit dhe inspektimit në administratën publike kanë mbetur të dobëta dhe kryesisht kanë synuar nëpunësit civil të nivelit të ulët.

Zbatimi i suksesshëm i ligjit për **aksesin në informacion** është penguar nga kapaciteti i limituar i Zyrës së Komisionerit për Aksesin në Informacion dhe Mbrojtjen e të Dhënave.

Kuadri institucional

Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit (njëkohësisht edhe Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore) është përgjegjës për hartimin, koordinimin dhe monitorimin e politikave anti-korrupsion. Pavarësia dhe përgjegjësia e ILDKPKI-së duhet të forcohet në mënyrë që të ulët ndikimi politik akoma shumë i lartë. Kuadri i kontrollit të brendshëm mbetet akoma për tu strukturuar, me qëllim arritjen e një bashkëpunimi ndër-institucional efektiv dhe të mirë. Fusha e auditimeve të kryera nga auditorët e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe nga auditorët e brendshëm kanë mbivendosje me njëra tjetrën, ndërsa konstatimet e tyre ndryshojnë gjerësisht. Roli i Njësisë së Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Anti-korrupsionit pranë Këshillit të Ministrave duhet të qartësohet më shumë. Hetimet financiare duhet të avancohen për të luftuar mashtrimin me rrezik të lartë, korrupsionin dhe keq-menaxhimin e fondeve publike. Kapaciteti i të gjitha organeve të përmendura më lart duhet të forcohet ndjeshëm.

Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të përmirësuar transparencën e administrimit publik, për të nxitur zbatimin e programeve të transparencës në institucione dhe për të siguruar mundësimin e informacionit me interes publik në kohë dhe në mënyrë eficiente. Nuk ka kod etike për deputetët dhe deklaratat e pasurisë të deputetëve nuk publikohen automatikisht. Shkolla e Administratës Publike ka ofruar trajnime për zyrtarët publikë rreth mirëqeverisjes dhe anti-korrupsionit. Ankesat për korrupsion mund të plotësohen në portalin online të lançuar nga qeveria në vitin 2015. Statistikat e korrupsionit mblidhen nga një grup ndër-institucional i punës i cili përbëhet nga pjesëtarë të Ministrisë së Drejtësisë, Policisë, Prokurorisë së Përgjithshme, Gjykata e Lartë dhe Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit. Nuk ka një vlerësim të rrezikut sektorial të zbatuar as në polici dhe as në nivele të tjera ligj-zbatuese. Akoma nuk aplikohen metodatpa korrupsion gjatë hartimit të legjislationit.

Ngrita e parashikuar e një organi anti-korrupsion duhet të ristrukturojë pushtetet në kuadër të drejtësisë penale dhe të sigurojë specializimin për të luftuar korrupsionin në sektorin ligj-zbatues. ILDKPKI-ja, policia dhe prokuroria nuk kanë akoma akses direkt në disa regjistra dhe baza të dhënash, gjë që pengon kapacitetin e tyre për të ngritur një çështje. Bashkëpunimi ndër-institucional dhe shkëmbimi i informacioni mbetet i pamjaftueshëm, po ashtu edhe burimet njerëzore, teknike dhe financiare në organet ligj-zbatuese. Duhet të rritet më shumë trajnimi i autoriteteve ligj-zbatuese dhe magjistratëve për të trajtuar çështje komplekse penale të korrupsionit, krimit financiar dhe ekonomik.

Që prej miratimit të ligjit për të drejtën e informimit në shtator të vitit 2015, janë caktuar 198 koordinatorë për të drejtën e informimit dhe 108 institucione publike kanë miratuar dhe publikuar programet e transparencës.

Kuadri ligjor

Shqipëria ka ratifikuar të gjitha konventat ndërkombëtare relevante por zbatimi në praktikë mbetet i mbrapa. Janë miratuar ligji për përjashtimin e kriminelëve nga postet publike dhe ligji i sinjalizueseve. Kodi i Procedurës Penale po rishikohet në kuadër të reformës në drejtësi, për të rritur eficientë e hetimeve. Vendi është palë në **Konventën e OKB-së kundër Korrupsionit**. Shqipëria nuk e ka kriminalizuar pasurimin e paligjshëm dhe ka kriminalizuar refuzimin për të deklaruar pasurinë, mos-deklarimin, fshehjen e pasurive, dhe bërjen e

deklaratave false nga ana e personave të zgjedhur, nëpunësit publikë dhe subjektet e tjerë që kanë detyrimin ligjor të deklarojnë pasuritë.

Kuadri strategjik

Shqipëria miratoi strategjinë e saj kombëtare kundër korrupsionit (2015-2020) dhe planin e veprimit (2015-2017), në mars 2015 pas konsultimeve me një sërë palësh të interesuara. Ekziston një kuadër monitorimi dhe raportimi, i ngritur në vitin 2015. Indikatorët tregues të vlerësimit të performancës duhet të përmirësohen më shumë.

Lufta kundër krimit të organizuar

Vendi ka arritur **një farë niveli të përgatitjes** në drejtim të luftës kundër krimit të organizuar. Në përgjithësi, janë bërë **disa përparime**, në veçanti, me identifikimin dhe shkatërrimin e plantacioneve me kanabis. Gjithsesi, policia dhe prokuroria nuk kanë mundur që të identifikojnë grupet kriminale që fshihen pas kultivimit dhe trafikimit të drogës dhe rrallë herë sigurohet ndjekja efikase gjyqësore në ndjekjen penale. Janë bërë pak përparime në plotësimin e rekomandimeve të vitit të kaluar. Policia është modernizuar dhe është rritur bashkëpunimi ndërkombëtar i policisë, sidomos me Europol-in. Gjithsesi, duhet të forcohet bashkëpunimi mes policisë dhe prokurorisë në mënyrë që të shpërbëjnë rrjetet kriminale në mënyrë më efikase. Numri i vendimeve të formës së prerë në rastet e krimeve të organizuara mbetet i kufizuar, duke shënuar vetëm një rritje të lehtë gjatë viteve të fundit. Hetimet financiare që shënjestrojnë anëtarë të dyshuar në grupe kriminale nuk janë kryer në mënyrë sistematike dhe efektive. Historiku i të dhënave për ngrirjen dhe konfiskimin e pasurisë së paligjshme mbetet i ulët. Vitin e ardhshëm, Shqipëria, në veçanti, duhet:

→ të dëshmojë progres në krijimin e një historiku të qëndrueshëm të hetimeve proaktive, ndjekjeve dhe dënimeve penale kundër grupeve kriminale, përfshirë konfiskimin e pasurisë së paligjshme dhe shpërbërjen e rrjeteve kriminale;

→ të përshtasë legjislacionin përkatës me standardet evropiane dhe praktikat më të mira, në veçanti, ligjin anti-mafia, Kodin e Procedurave Penale dhe legjislacionin në fushën e përgjimeve dhe mbikëqyrjes, afatet kohore për hetimet, dhe pranueshmërinë e provave përpara gjykatës;

→ të decentralizojë forcat e specializuara policore, të alokojë burimet njerëzore të mjaftueshme për të luftuar krimin e organizuar dhe të zbatojë një politikë efektive për burimet njerëzore në Policinë e Shtetit, përfshirë rekrutimin sipas meritës, ngritjen në detyrë dhe transferimin brenda zyrave të policisë dhe prokurorisë.

Historiku i të dhënave

Është arritur pak progres në **shpërbërjen efektive të rrjeteve kriminale**. Numri i vendimeve të formës së prerë për veprat e krimit të organizuar (organizata kriminale dhe grupe të strukturuar kriminale) mbetet i ulët dhe ka shënuar një rritje të lehtë vitet e fundit. Një përqindje relativisht e lartë e rasteve të krimit të organizuar të regjistruara nga Prokuroria për Krimet e Rënda u ka kaluar prokurorive të rretheve ose janë pushuar për shkak të mungesës së provave apo cilësisë së dobët të kallëzimeve. Cilësia e vendimeve për pushimin e çështjes duhet të përmirësohet, po ashtu edhe cilësia e kallëzimeve. Për më

tepër, Prokuroria për Krimet e Rënda duhet të koordinojë më tej hetimet me policinë hetimore dhe të mbledhë provat e mjaftueshme, të nevojshme për të hapur një çështje.

Ka një tendencë në rritje në hetimin e rasteve qëëprfshijnë pastrimin e procedurave të veprës penale. Gjithsesi, numri i vendimeve të formës së prerë për **pastrim parash** mbetet i kufizuar. Duhet të përmirësohet kapaciteti i hetimeve financiare të Policisë së Shtetit shqiptar.

Vendimet e formës së prerë për rastet e **trafikimit njerëzor** janë rritur gjatë viteve të fundit por në këndvështrimin e përgjithshëm mbeten të ulëta. **Hetimet financiare** nuk bëhen në mënyrë sistematike dhe efektive për të shënjestruar grupet kriminale. Ngrirja paraprake e pasurisë gjatë fazës fillestare të një hetimi zbatohet rrallë herë. Produktet e veprave penale shpeshherë zhduken, duke çuar në një historik të varfër të **pasurisë së konfiskuar** në momentin e marrjes së vendimit të formës së prerë. Më pak se 50% të rasteve të krimit të organizuar çuar në konfiskimin e pasurisë përtej atyre që gjendeshin në momentin e arrestimit të të dyshuarit. Rrjedhjet e informacionit në shtyp, shkelja e sekretit të hetimeve dhe vënia në rrezik e sigurisë së policëve dhe prokurorëve, janë të shpeshta.

Kapaciteti institucional dhe operacional

Policia e Shtetit ka 9 894 oficerë policie, 232.8 për 100 000 banorë. Struktura e re e organizimit të policisë, që prej dhjetorit, ka përmirësuar kapacitetin e saj në përgjithësi. **Njësitë e specializuara** për krimet financiare dhe ekonomike, pastrimin e parave dhe hetimin e pasurisë së paligjshme janë forcuar, po ashtu edhe Drejtoria e Analizës së Informacionit Kriminal. Gjithsesi, ka mangësi në staf të specializuar për çështje financiare dhe fiskale. Shkalla e lartë e ndryshimeve në staf vazhdon të dobësojë kapacitetet institucionale dhe operationale të policisë. Në përgjithësi, niveli i pajisjeve dhe logjistikës është përmirësuar, por ende është i papërshtatshëm, në veçanti në TI.

Bashkëpunimi ndërmjet prokurorisë dhe policisë në zbulimin dhe hetimin e rasteve penale të ndërlikuara mbetet i dobët. Nuk ka një praktikë mirëkuptimi për hetimet dhe ndjekjet penale. Policia dhe prokuroria nuk kanë akses direkt në shumë baza të dhënash private dhe publike kombëtare. Procedurat e gjata dhe burokratike për të marrë madje edhe informacionin bazë gjatë hetimeve, shkaktojnë vonesa të konsiderueshme.

Shqipëria ka një marrëveshje operationale me Europol dhe që prej vitit 2009, edhe një oficer ndërlidhës në selinë e Europol-it. Shqipëria është përfshirë në projekte operationale dhe në shkëmbimin e informacionit përmes programit të sigurt SIENA. Gjithsesi, Shqipëria merr më shumë kërkesa sesa dërgon (959 të marra dhe 32 të dërguara në vitin 2015). Si e tillë, Shqipëria mbetet partner reaktiv më shumë sesa proaktiv në bashkëpunimin ndërkombëtar mes policive. Prirje e ngjashme është dalluar në lidhje me Interpol-in. Shqipëria duhet të shfrytëzojë plotësisht marrëveshjen operationale me Eruopol-in.

Kapaciteti i policisë për të mbledhur dhe përpunuar **statistikat** mbi krimin është përmirësuar. Që prej shkurtit 2015, policia merr njoftime të përditshme elektronikisht rreth veprave penale të kryera në mbarë botën. Kapaciteti i Drejtorisë së Mjekësisë Ligjore është përmirësuar. Gjithsesi, buxheti për sektorin e ADN-së mbetet ende i pamjaftueshëm për të mbuluar shpenzimet e mbledhjes së ADN-së, duke kufizuar aftësinë për të kryer profilizimin e ADN-së.

Kuadri ligjor

Kuadri ligjor nuk është përafuar plotësisht me *acquis-in*. Legjislacioni përkatës duhet të ndryshohet në mënyrë që të adresojë një sërë mangësish në fazën hetimore. Ligji për konfiskimin e pasurisë së vënë nga veprimtaritë kriminale është pjesërisht i përafuar me *acquis-in*. Kërkohet që të përafrohet procedura për konfiskimin e pasurisë së palëve të treta, konfiskimi i zgjeruar dhe ngrirja paraprake e pasurisë. Duhet të miratohen ndryshimet për ligjin anti-mafia për marrjen dhe konfiskimin e pasurisë. Është e nevojshme të ndryshohet edhe ligji për komunikimin elektronik në mënyrë që të detyrohen operatorët e shërbimit të komunikimit elektronik që t'i sigurojnë policisë dhe prokurorisë akses të lehtë në bazat e të dhënave.

Kuadri strategjik

Strategjia e Rendit Publik 2015-2020 dhe plani i saj i veprimit 2015-2017 mbulojnë fusha të rëndësishme si policimi i bazuar në informacion sekret, hetimet proaktive, hetimet e pasurisë së vendosur nga aktivitetet kriminale, bashkëpunimi ndër-institucional dhe ndërkombëtar si dhe shkëmbimi i informacionit. Policia e Shtetit ka vazhduar me vlerësimin e rreziqeve kryesore nga krimet e organizuara sipas metodologjisë së Europol-it, me përgatitjen e vlerësimeve vjetore kombëtare të rreziqeve nga krimet e rënda dhe të organizuara (SOCTAs). Gjithsesi, përdorimi i produkteve strategjike të shërbimeve sekrete të Europol-it mbeten të kufizuara.

Dispozitat në Kodin Penal për krimin kibernetik janë në linjë me kërkesat e Konventës së Këshillit të Evropës për krimin kibernetik (Konventa e Budapestit).

Lufta kundër terrorizmit

Shqipëria është prekur nga fenomeni i luftëtarëve të huaj terroristë. Një sërë xhamish të paautorizuara, të lidhura me grupet ekstremiste, janë prezentë në Shqipëri dhe përbëjnë rrezik radikalizmi. Ky fenomen mund të zgjidhet me anë të një qasje të shënjestruar nga informacioni sekret, autoritetet ligj-zbatuese dhe institucionet gjyqësore. Ndërkohë që, është përmirësuar në një masë të madhe bashkëpunimi ndërkombëtar, si në nivel operacional ashtu edhe strategjik, duhet të përmirësohen mekanizmat parandaluese me përfshirjen e shoqërisë civile dhe të bashkësive fetare.

2.4. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve

Gjendja e përgjithshme

Kuadri ligjor për mbrojtjen e të drejtave të njeriut është gjerësisht në pajtim me standardet evropiane dhe Shqipëria ka ratifikuar pjesën më të madhe të konventave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Megjithatë, mbetet për tu forcuar zbatimi i të drejtave të njeriut.

Mangësitë prekin në veçanti fushat e mëposhtme:

- Pavarësisht përpjekjeve të bëra, duhet të garantohet zbatimi i të drejtave të pronësisë dhe duhet të përfundohet procesi i regjistrimit, kthimit dhe kompensimit të pronës.
- Duhet të përmirësohen kushtet e jetës së komuniteteve Rome dhe egjiptiane. Përfshirimi

social dhe diskriminimi duhet të trajtohen nëpërmjet zbatimit më të mirë të politikave dhe bashkëpunimit më të mirë ndërinstytucional. Nevojiten përpjekje shtesë për të zhvilluar historik të rasteve kundër diskriminimit.

- Mekanizmat institucionale, për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës dhe për të trajtuar dhunën familjare dhe me bazë gjinore, mbeten të dobëta. Legjislacioni për drejtësinë për të miturit duhet të përafrohet me standardet ndërkombëtare. Shërbimet për viktimat e dhunës familjare duhet të përmirësohen në cilësi, sasi, qasje dhe mbulim gjeografik.

Më poshtë paraqitet një analizë e detajuar për lirinë e shprehjes. Për një analizë të hollësishme të zhvillimeve në të drejtat e tjera të njeriut dhe mbrojtjen e minoriteteve, shiko Kapitullin 23- Gjyqësori dhe të drejtat themelore. Për zhvillimet në fushat e të drejtave sindikale, mos-diskriminimin dhe mundësive të barabarta, shiko, gjithashtu, *Kapitullin 19- Politika sociale dhe punësimi*.

Liria e shprehjes

Vendi ka arritur **një farë niveli përgatitje/ është mesatarisht e përgatitur** në drejtim të lirisë së shprehjes. Gjithsesi, gjatë vitit të kaluar **nuk ka pasur asnjë progres** në këtë drejtim. Rekomandimet e vitit të kaluar për rritjen e transparencës reklamimeve të qeverisë në media nuk janë trajtuar. Mjedisi, në përgjithësi, është kryesisht I favorshëm për ushtrimin e të drejtës së shprehjes, por zbatimi mbetet sfidë edhe ku ka bazë ligjore të shëndoshë. Vitin e ardhshëm, Shqipëria, në veçanti, duhet:

→ të prezantojë legjislacionin në linjë me praktikën më të mira për reklamimet shtetërore për të rritur transparencën;

→ të sjellë kufizimet e pronësisë së operatorëve kombëtarë në linjë me standardet ndërkombëtare përkatëse;

→ të forcojë më tej pavarësinë e autoritetit rregullator dhe televizionit publik.

Kërcënimi ndaj gazetarëve

Sulmet fizike ndaj gazetarëve janë shumë të rralla. Në vitin 2016 janë raportuar dy raste të sulmeve fizike ndaj gazetarëve dhe janë në ndjekje nga prokuroria. Autoritetet kombëtare dhe organizatat për median kanë reaguar menjëherë dhe kanë dënua këto akte.

Kuadri ligjor

Kushtetuta dhe legjislacioni përkatës janë në përputhje me ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, duke garantuar liritë individuale, përfshirë këtu edhe të drejtën e privatësisë, lirinë e shprehjes dhe sanksionet kundër nxitjes së urrejtjes. **Shpifja** mbetet vepër penale, pavarësisht se nuk parashikohet dënimi me burgim si ndëshkim për to. Gjithsesi, gazetarët janë shumë të ekspozuar ndaj gjobave dhe dëmeve potencialisht të mëdha. Rregullat mbi **gjuhën e urrejtjes** janë në pajtim me të standardet ndërkombëtare. Ka pasur tri raste të gjuhës së urrejtjes, të regjistruara nga policia dhe prokuroria në periudhën e raportimit. Pesë ankesa për gjuhën e urrejtjes janë dorëzuar në Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi për arsye të orientimit seksual.

Ligji për **të drejtën e informimit** është në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Zbatimi i legjislacionit/ institucionet

Në korrik, parlamenti zgjodhi katër anëtarë të **Autoritetit të Medias Audiovizive (AMA)**. Megjithatë, procedura e zgjedhjes së anëtarëve nuk është e lirë nga ndikimi politik dhe nuk siguron pavarësinë e rregullatorit. Vendimmarrja AMA-s u ndikua nga mungesa e kuorumit për disa muaj për shkak të mungesës së anëtarëve të nominuar nga opozita, të cilët vënë në pyetje legjitimitetin e bordit. Kjo mungesë afatgjatë e stafit kufizoi aftësinë e AMA-s për të përmbushur mandatin e tij dhe vështirësoi punën e rregullatorit për të marrë vendime të rëndësishme, veçanërisht për licencimin e operatorëve digjital tregtar, që rezultoi në dërgimin e saj në gjykatë.

Radio televizioni publik

Rregullorja e Radio-televizionit Publik (RTSH), është në përputhje me standardet e BE. Gjithsesi, ka shqetësime se procedura e re e përzgjedhjes së drejtorit të përgjithshëm përmes votës së thjeshtë maxhoritare pas tri raundeve, siç parashikohet në ligjin e ndryshuar, do të kufizonte aftësinë e saj për të garantuar emërimin e një figure politike me konsensus.

Faktorët ekonomikë

Pronësia e medias është transparente formalisht dhe e aksesueshme përmes Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Gjithsesi, mënyra se si funksionon tregu I medias mbetet ende I errët, me një numër mediash që mbijetojnë në një treg relativisht të vogël, me burime të kufizuara. Transparenca e **fondeve të qeverisë** e kanalizuar në media për **reklamim** ose për nevoja të tjera duhet të përmirësohet. Duhet të prezantohet legjislacioni për reklamimet e qeverisë në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare. Media vazhdon të përdoret si një mjet për të nxitur interesat publike dhe private.

Interneti

Kodi penal aplikon përkufizime të ndryshme për gjuhën e urrejtjes në internet dhe jashtë tij (offline), ku ky i fundit nuk kërkon nxitje për dhunë. Përkufizimi tepër i gjerë i gjuhës së urrejtjes në internet mbart rrezikun e cenimit padrejtësisht të të drejtave të mediave online në qoftë se ata janë përgjegjës për komentet e lexuesve. Duhet të nxitet vetë-rregullimi për sektorin e mediave online.

Sindikatat profesionale, kushtet profesionale

Gazetaria në Shqipëri është një profesion i pasigurt, me paga të ulëta dhe pak siguri në punë. Zbatimi i dobët i Kodit të Punës mbetet shqetësim madhor dhe shumica e gazetarëve punojnë pa kontratë ose kanë bërë një kontratë e cila mund të përfundohet në mënyrë arbitrare. Vonesat në marrjen e pagës dhe vitet e pagesave të sigurimeve shoqërore të humbura janë një fenomen i përhapur, duke çuar shpesh në vetë-censurë.

Ekziston një Union i Gazetarëve Shqiptarë, por që ka ndikim të kufizuar. Një numër i konsiderueshëm i gazetarëve nuk janë të organizuar ose të përfaqësua në ndonjë formë, duke reflektuar mungesën e traditës së organizatave sindikale të vendit. Duhet për forcohen standardet profesionale dhe etike në gazetari.

2.5 Çështjet rajonale dhe detyrimet ndërkombëtare

Shqipëria ende mban një marrëveshje bilaterale të vitit 2003 me SHBA që i përjashton shtetasit amerikanë nga juridiksioni i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Kjo situatë nuk përputhet me pozitën e BE mbi integritetin e Statutit të Romës ose me parimet e BE-së për marrëveshjet bilaterale mbi imunitetin. Shqipëria duhet të bashkojë qëndrimin e saj me BE-në.

Në fushën e **bashkëpunimit rajonal dhe marrëdhënieve të mira të fqinjësisë**, Shqipëria vazhdon të luajë një rol konstruktiv dhe proaktiv në iniciativat rajonale si SEECIP, NAI, Makro-strategjia EUSAIR, Nisma e Evropës Qendrore, EB6 dhe Iniciativa rajonale për Migracionin dhe Azilin.

Shqipëria është një mbështetës i përkushtuar i **Procesit të Ballkanit Perëndimor** dhe ka një përkushtim të plotë në këtë iniciativë dhe veçanërisht në **agjendën e ndërlidhjes**. Në mars Shqipëria organizoi takimin e vendeve të BP6, ku vendet e rajonit ri-panë stadin e reformave të projekteve të ndërlidhjes dhe zbatimit të masave të buta në transport dhe energji, të identifikuar nga Konferenca e Vjenës para Samitit të Parisit. Në takim u propozua gjithashtu një agjendë bashkëpunimi gjithëpërfshirëse për krizën migratore, duke vendosur theksin në forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit të partneritetit EU –EB6 për migracionin. Gjithashtu filloi puna për ngritjen e Fondit të Ballkanit Perëndimor dhe Qendrës së Bashkëpunimit Rinor (RYCO), të cilat do të kenë selitë përkatëse në Tiranë.

Shqipëria vijon të jetë një partner konstruktiv në rajon, duke zhvilluar më tej **marrëdhëniet bilaterale** me vendet e tjera të paketës së zgjerimit dhe vendet e tjera fqinje, anëtare të BE-së.

Shqipëria nënshkroi me Malin e Zi konventën për bashkëpunimin rajonal, sipas nenit 13, të SAA, ndërsa vijojnë negociatat me Serbinë.

Marrëdhëniet me **Bosnje dhe Hercegovinën** qëndrojnë të mira, nuk ka çështje bilaterale pezull. Presidenti i Shqipërisë vizitoi Sarajevën në shkurt, duke argumentuar dhe mbrojtur njohjen e Kosovës³.

Shqipëria vazhdon marrëdhënie shumë të mira **me Kosovën** dhe advokon për anëtarësimin e plotë të Kosovës në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare. Në qershor shtatë marrëveshje dhe memorandume bashkëpunimi u nënshkruan në takimin e tretë të përbashkët të qeverive në fushën e doganave, tatimeve, energjisë, administratës publike, transportit dhe mjedisit. Shqipëria mbështet Dialogun e Nivelit të Lartë me ndërmjetësinë e BE-së, ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Marrëdhëniet me **Maqedoninë** janë të mira, dhe shkëmbimi i informacioneve u intensifikua pas krizës migratore në të cilin u përfshi Maqedonia, me synimin për të qenë të përgatitur nëse do të kishte një devijim të fluksit migrator.

Marrëdhëniet me **Malin e Zi** janë të qëndrueshme dhe Shqipëria mbështet fuqimisht anëtarësimin në NATO të Malit të Zi.

³Ky përcaktim nuk cenon qëndrimet mbi statusin dhe është në përputhje me UNSCR 1244/1999 dhe Opinionin e GJND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës

Marrëdhëniet me **Serbinë** vijnë të normalizohen, dhe qeveria po tregon një përkushtim politik për të mbajtur një dialog konstruktiv. Marrëdhëniet dypalëshe janë forcuar edhe nga procesi i ËB6 dhe agjenda e përbashkët e ndërlidhjes. Ministrat e jashtëm serb dhe shqiptar morën pjesë në dy takime tripalëshe me homologun e tyre italian, së pari në Romë dhe së fundmi në Tiranë. Kryeministri shqiptar dhe serb hapën së bashku një forum biznesi në Nish në tetor 2016.

Shqipëria vijon të ketë marrëdhënie të mira me **Turqinë**, me një partneritet strategjik që rregullon çështjet dypalëshe. Të dy vendet kanë një bashkëpunim të mirë mbi çështjet e sigurisë dhe luftën kundër terrorizmit.

Marrëdhëniet me **Greqinë** mbeten në përgjithësi pozitive dhe me vizita të shpeshta të nivelit të lartë. Së fundmi u ngrit edhe një mekanizëm i menaxhimit migrator në nivel operacional, ndërmjet Italisë, Shqipërisë dhe Greqisë si përgjigje për krizën migratore. Në përkujtim të 25 vjetorit të Traktatit të Miqësisë ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë dhe vizitës së Ministratit të jashtëm grek në Tiranë, dy vendet diskutuan për krijimin e një mekanizmi të përbashkët për të adresuar çështjet dypalëshe të diskutueshme.

Marrëdhëniet me **Italinë** janë shumë të mira. Në kontekstin e krizës migratore, të dy vendet krijuan mekanizmat e shkëmbimit dhe nënshkruan një Memorandum që forcon kapacitetin e Shqipërisë në patrullimin e kufijve kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe luftën kundër terrorizmit. Gjithashtu janë intensifikuar marrëdhëniet ekonomike me Italinë. Në prill të dyja vendet nënshkruan një projekt për studimin e fizibilitetit në sektorin e infrastrukturës.

3. KRITERET EKONOMIKE

Shifrat kryesore ekonomike	2014	2015
Prodhimi i brendshëm bruto për banorë (në % e BE28 në treguesin e Standardit të Fuqisë Blerëse)	30	30
Rritja e PBB-së (%)	1.8	2.8
Norma e papunësisë (femra; meshkuj)(%)	17.5 (19.2; 15.2)	17.1 (17.1; 17.1)
Norma e aktivitetit ekonomik për personat nga mosha 20-64 vjeç: përqindja e popullsisë në moshat 20-64 vjeç, ekonomikisht aktiv (femra, meshkuj) (%)	68.6	71.3
Bilanci i llogarisë korente (% e PBB)	-12.9	-11.3
Investimet e huaja direkte (IHD) (% e PBB-së)	8.1	8

Burimi: Eurostat

Sipas përfundimeve të Këshillit Evropian në Kopenhagen, në qershor 1993, anëtarësimi në BE kërkon pasjen e një ekonomie tregu funksionale dhe kapacitetet për të përballuar presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian.

Monitorimi i këtyre kritereve ekonomike duhet parë në kontekstin e rritjes së rëndësisë të qeverisjes ekonomike në procesin e zgjerimit. Për të përmirësuar qeverisjen ekonomike përkatëse, vendeve të zgjerimit u kërkohet të përgatisin Programet e Reformës Ekonomike (PRE-të), të cilat përcaktojnë kuadrin afatmesëm të politikave makro-fiskale, së bashku me agjendën e reformave kryesore strukturore që synojnë sigurimin e konkurrencës dhe rritjen gjithëpërfshirëse. PRE-të përbëjnë bazën për drejtimin e politikave specifike të vendit, të miratuara në mënyrë të përbashkët nga BE-ja dhe vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqia, në nivel ministror, në maj të çdo viti.

3.1. Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur për zhvillimin e një ekonomie tregu funksionale. Janë bërë disa përpjekje në përmirësimin e bilancit buxhetor, duke luftuar informalitetin dhe në reformimin e sektorit të energjisë elektrike. Reforma gjyqësore gjithëpërfshirëse ka filluar dhe duhet të zbatohet plotësisht për të përmirësuar ndjeshëm mjedisin e biznesit. Rritja ekonomike ka fituar vrull dhe papunësia është ulur, por është ende e lartë. Borxhi publik po ashtu ka mbetur i lartë dhe ende nuk ka filluar të bjerë. Nën-ekzekutimi i buxhetit të investimeve ka vazhduar. Kreditë me probleme në sektorin bankar ende kufizojnë rritjen e kreditimit. Rregulloret relevante të biznesit mbetën të papërshtatshme dhe mangësitë në sundimin e ligjit vazhduan të pengojnë ndërmarrjet dhe investimet. Në përputhje me udhëzimet e politikave PRE dhe për të mbështetur rritjen afatgjatë, në vitet e ardhshme Shqipëria duhet t'u kushtojë vëmendje të veçantë:

→ përpjekjeve për të përmirësuar mobilizimin e të ardhurave tatimore me synimin për të ulur nivelin e borxhit publik, ndërkohë duke krijuar hapësirë për rritjen e shpenzimeve;

→ forcimit të stabilitetit të sektorit financiar duke zbatuar planin e veprimit të kredive me probleme dhe zhvillimin e një strategjie afatmesme për të nxitur përdorimin e monedhës vendase;


→ rritjes së përfshirjes të politikave aktive të tregut të punës dhe përmirësimin e aktivizimit të personave të papunë dhe jo aktivë, sidomos të rinjtë, gratë dhe të papunët afatgjatë.

Qeverisja ekonomike

Shqipëria mbetet e angazhuar për forcimin e stabilitetit makroekonomik dhe zbatimin e reformave të tregut. Adresimi/ose trajtimi i nivelit të lartë të borxhit publik mbetet në qendër të politikave makroekonomike. Reformat e rëndësishme për përmirësimin e mjedisit të biznesit kanë avancuar, por kërkohen përpjekje të mëtejshme për t'u përfunduar. Udhëzimi për politikën PRE nga 12 maj 2015 është zbatuar vetëm pjesërisht, por është bërë progres në shumë fusha. Stabiliteti dhe rritja janë përforcuar nga përputhshmëria e vendit me kushtet e programit 3-vjeçar me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN), rënë dakord në shkurt 2014.

Stabiliteti makroekonomik

Figura 1 Rritja e PBB-së për Shqipërinë



Rimëkëmbja ekonomike e Shqipërisë është përmirësuar nga mbështetja e investimeve në rritje.

Rritja ekonomike arriti pikën më ulët në vitin 2013, por ka qenë në trendin në rritje që nga atëherë, mbështetur nga politikat e Qeverisë, rriti besimin e konsumatorit dhe biznesit dhe normat e uljes së interesit. Edhe pse kushtet e jashtme ishin sfiduese, rritja reale e PBB-së ishte 2.8% në vitin 2015 dhe u përshpejtua më tej në tremujorin e parë të vitit 2016. Ajo u përshpejtua nga një ringjallje e fortë në investime, e cila përmbysi një turrje 3-vjeçare, dhe nga kontributi

pozitiv i tregtisë së jashtme. Megjithë rritjen e aktivitetit ekonomik, PBB për frymë në treguesin e standardit të fuqisë blerëse qëndron në vetëm 30% të mesatares së BE-28 në vitin 2015, praktikisht i pandryshuar që nga viti 2009.

Deficiti i llogarisë korente ka mbetur i lartë, por financimi i tij ka qenë i shëndetshëm.

Shqipëria ka drejtuar historikisht një deficit të konsiderueshëm tregtar shkaktuar nga prodhimi i pakët dhe baza e eksportit, dhe pjesërisht financiar prej remitancave nga shqiptarët që jetojnë jashtë vendit. Në vitin 2015 deficiti i llogarisë korente u ngushtua me 11.3% të PBB-së nga 12.9% e regjistruar një vit më parë. Bilanci tregtar është përmirësuar në sajë të performancës së mirë të turizmit, që kompensoi uljen e të ardhurave nga eksportet e mallrave, sidomos të naftës. Vlera e importeve gjithashtu ka rënë. Në 5.8% të PBB-së, remitancat kanë mbetur shumë poshtë nivelit të tyre para krizës financiare globale. Fluksi i Investimeve të Huaja Direkte (IHD), të cilat kanë qenë relativisht të larta që nga viti 2007, arriti në 8.5% të PBB-së në vitin 2015 dhe ka vazhduar të financojë pjesën më të madhe të deficitit të llogarisë korente. Rezervat valutore u rritën ndjeshëm në vitin 2015, nxitur nga flukset e IHD-ve dhe rritja e huamarrjes nga qeveria në tregjet ndërkombëtare. Rezervat mbuluan 6.6 muaj importe në fund të vitit, duke siguruar një mbrojtje adekuate kundër goditjeve negative.

Inflacioni vazhdon të jetë poshtë objektivit zyrtar, duke bërë lehtësim të mëtejshëm monetar.

Inflacioni mesatar vjetor ka mbetur poshtë objektivit të Bankës së Shqipërisë prej 3% që nga viti 2012, duke arritur në 1.9% në vitin 2015. Ai u ngadalësua më tej në tetë muajt e parë të vitit 2016 në vetëm 1%, duke reflektuar çmime të ulëta për produktet e importuara dhe presione të dobëta inflacioniste të brendshme për shkak të prodhimit ende nën potencialin ekonomik. Banka qendrore ka reaguar duke vazhduar të ulë normën bazë të interesit në një rekord të ulët prej 1.25% në maj 2016, duke sinjalizuar synimin e saj për të mbajtur normën e interesit të ulët për një periudhë të zgjatur.


Normat e interesit të kredisë gjithashtu kanë rënë, ndërsa huadhënia bankare është penguar nga bankat që shmangin rrezikun dhe ngurrojnë të japin kredi midis një niveli ende të lartë të

kredive me probleme (NPL-të). Kursi i këmbimit të llogarisë rrjedhje ka mbetur shumë i qëndrueshëm kundrejt euros në 5 vitet e fundit.

Niveli i lartë i borxhit shfaq rreziqe makroekonomike dhe kërkon konsolidim të qëndrueshëm fiskal, për të cilin autoritetet mbeten të angazhuara. Borxhi publik në raport me PBB-në është rritur që prej vitit 2011 dhe tashmë ka kaluar 70% të PBB-së, që përbën një përqindje të lartë krahasuar me vendet e rajonit dhe kapacitetin e Shqipërisë për të gjeneruar të ardhura për të shlyer borxhin. Pjesa më e madhe e borxhit publik është afatshkurtër dhe duhet të ri-financohet vazhdimisht. Ky ri-financim mbështetet kryesisht në disa banka të vendit. Në 2015, Shqipëria mori borxh nga tregjet ndërkombëtare, duke I mundësuar qeverisë që të shlyejë një pjesë të borxhit të brendshëm dhe të zgjasë maturimin mesatar të stokut të borxhit. Gjithsesi, duke qenë se Shqipëria mori borxh nga tregjet e huaja, është rritur ekspozimi I vendit ndaj rrezikut të valutës.

Rekomandimi i PRE: ‘Të vazhdohet rregullimi fiskal duke siguruar që të përmbushen objektivat e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe, po ashtu, objektivi i deficitit. Vlerësoni dhe përcaktoni rreziqet fiskale që dalin nga të gjitha partneritetet aktive mes privatit dhe publikut, kontratat koncesionare e nga detyrimet e prapambetura të qeverisjes vendore.’

Figura2 Zhvillimi fiskal i Shqipërisë



Sipas programit të saj të vazhdueshëm me FMN-në, Shqipëria ka marrë përsipër që të forcojë qëndrueshmërinë e borxhit dhe të lajë detyrimet e mëdha të prapambetura ndaj biznesit. Progres është bërë në të dy frontet. Detyrimet e prapambetura që janë identifikuar u ripaguan përpara afatit në periudhën 2014-2015. Deficiti buxhetor ishte më i ulët se sa ishte planifikuar në vitin 2014 dhe në vitin 2015, ai ishte në përputhje me objektivin e 4% të PBB-së.

Të ardhurat nga tatimet në vitin 2015 ishin shumë më të ulëta se sa ishte planifikuar, duke reflektuar supozimet tepër optimiste dhe goditjet e jashtme të tilla si rënia e çmimit të naftës. Shpenzimet gjithashtu nuk arritën parashikimin, duke theksuar mangësitë e konsiderueshme dhe të përsëritura në menaxhimin e investimeve publike. Në përpjekje për të trajtuar këtë çështje, në fillim të 2016, Ministria e Financave, e cila mbikëqyr zbatimin e përgjithshëm të buxhetit, është ngarkuar përgjegjëse për këtë detyrë. Rritja ekonomike dhe përpjekjet për të përmirësuar përputhjen e taksave çoi në një rritje të dukshme të vjeljes së taksave gjatë 7-mujorit të parë të vitit 2016. Shpenzimet mbetën në mënyrë të konsiderueshme më të ulëta se sa buxheti. Borxhi publik në raport me PBB pritet të bjerë këtë vit.

Rekomandimi i PRE: ‘Forconi konsolidimin fiskal duke përmirësuar kuadrin fiskal; në veçanti, (i) përforconi planet buxhetore afatmesme duke

Janë ndërmarrë disa hapa për të përmirësuar qeverisjen fiskale dhe për të adresuar rreziqet fiskale. Po hartohen reforma ambicioze të menaxhimit të financave publike me mbështetjen buxhetore të BE-së, edhe pse me vonesë. Në qershor 2016 u miratua Rregulli Fiskal. Rregulli mandaton një tavan afatgjatë të borxhit në nivelin e 45% të PBB-së dhe balancave buxhetore që sigurojnë një shkallë të rënies së borxhit derisa të arrihet objektivi i vendosur. Gjithsesi, nuk ka asnjë afat se kur do të arrihet objektivi dhe asnjë organ të pavarur për të monitoruar përputhjen. Janë miratuar reformat fiskale për të adresuar prirjen e vazhdueshme optimiste për parashikimet ekonomike; për t'i bërë planet buxhetore afatmesme më të detyrueshme; dhe për të rritur transparencën mbi partneritetin publik-privat. Shqipëria ka ndryshuar kushtet, në bazë të së cilave ajo kompenson ish-pronarët e pronave të shpronësuar gjatë regjimit komunist, për një skemë më të qëndrueshme financiarisht. Gjithsesi, kushtetutshmëria e marrëveshjes së re ka hasur sfida.

fuqizuar parlamentin që të miratojë tavanet detyruese 3-vjeçare në nivel programi dhe duke qartësuar në Programin Buxhetor Afatmesëm se cilat fonde janë realizuar me sukses dhe cilat janë shpenzime të reja nën tavan; (ii) drejtohuni me vendosmëri drejt miratimit të një rregulli fiskal që garanton qëndrueshmërinë, transparencën dhe natyrën kundër ciklikë të borxhit.’

Përzjerja e politikave makroekonomike ka qenë e përshtatshme. Reduktimi i deficitit buxhetor është i nevojshëm për të forcuar qëndrueshmërinë e borxhit publik. Mbajtja në nivele të ulëta të normës së interesit është e përshtatshme pasi ajo ndihmon në rritjen e inflacionit të dobët dhe aktivitetit ekonomik. Gjithashtu, huamarrja më e ulët e brendshme nga qeveria i mundëson sektorit privat që marrë hua më shumë për të financuar investimet dhe konsumin.

Funksionimi I tregjeve të produkteve

Mjedisi i biznesit

Procedurat për të hyrë në treg janë lehtësuar dhe ka pasur rritje të numrit të regjistrimeve, por mbetet për tu miratuar ligji I ri për falimentin. Sporteli i vetëm i shërbimit për regjistrimin dhe licencimin e biznesit u vendos në punë në prill 2016, që ofron edhe shërbime online. Numri i bizneseve të reja të regjistruara në vitin 2015 ishte më shumë se dyfishi, duke pasqyruar veprimet e shumta të qeverisë kundër informalitetit të përhapur. Kjo rritje vazhdoi gjatë tremujorit të parë të vitit 2016. Megjithatë, qasja e firmave në financat formale, në veçanti në fazën fillestare, mbetet sfidë. Një ligj i ri për falimentin, për të thjeshtësuar procedurat e rënduara të daljes nga tregu, për të shmangur abuzimet për të dhe lehtësuar rimëkëmbjen e kolateralit ka mbetur në plan për disa vjet, por ende nuk është miratuar.

Bizneset vazhdojnë të përballen me një mjedis të rëndë rregullator. Janë bërë përpjekje për të lehtësuar të bërit biznes dhe për të përmirësuar komunikimin e qeverisë me ndërmarrjet, por ata ende nuk kanë dhënë rezultate të prekshme në terren. Është përgatitur projektligji për të thjeshtësuar procedurat komplekse dhe kontradiktore tatimore, por ende nuk është miratuar. Moratoriumi i pjesshëm për lejet e ndërtimit, i vendosur në prag të reformës së qeverisjes vendore, është hequr dhe aktiviteti i ndërtimit i është rikthyer rritjes.

Rekomandimi i PRE: ‘Forconi kapacitetet

Të metat në sundimin e ligjit vazhduan të pengojnë mjedisin e biznesit, por reforma në drejtësi ka avancuar. Ekonomia informale vlerësohet se përbën më shumë se një të tretën e PBB-së, duke çuar në humbje të mëdha ardhurave tatimore, mungesë të mbrojtjes në punë dhe konkurrencë të pandershme mes firmave. Zbatimi i joefikas i kontratës, të drejtat e pasigurta për pronën dhe përhapja e korrupsionit janë shqetësimet kryesore të shprehura në mënyrë të përsëritur nga bizneset. Reforma e gjerë në gjyqësor, e cila ka për qëllim që të trajtojë këto probleme të ndërlidhura, ka bërë progres të konsiderueshëm me miratimin me unanimitet në Parlament të ndryshimeve kushtetuese në korrik. Zbatimi me sukses i kësaj reforme kërkon veprime të mëtejshme legjislative dhe ngritje të institucioneve të reja. Qeverisja më e mirë, zbatimi në një mënyrë më të parashikueshme dhe të qëndrueshme të rregullave dhe ofrimi i shërbimeve publike në mënyrë më efektive do të përmirësonin ndjeshëm mjedisin e biznesit

administrative për të garantuar regjistrimin ligjor pa probleme të tokës, funksionimin e plotë të kadastrës në përgjithësi dhe në veçanti, të kadastrës elektronike deri në vitin 2019. Zbatoni procedurën elektronike për lejet e ndërtimit në mënyrë që të shkurtoni burokracitë dhe inkurajoni investimet”.

Ndikimi i shtetit në tregjet e produkteve

Prania e shtetit në ekonomi ka mbetur e kufizuar dhe do të ndërpritet mbështetja publike për sektorin e energjisë elektrike. Pjesa e të ardhurave publike dhe shpenzimeve në PBB ka mbetur relativisht e ulët. Ndihma shtetërore e përgjithshme e raportuar qëndroi në nivelin e 0.4% të PBB-së në vitin 2015, por zbatimi i rregullave të ndihmës shtetërore ka mbetur e pazhvilluar. Reforma në sektorin e energjisë elektrike çoi në një rënie të konsiderueshme në humbjet e shpërndarjes dhe disa përmirësime në shkallën e mbledhjes së faturave të energjisë elektrike, forcimin e gjendjes financiare të ndërmarrjeve shtetërore në këtë sektor. Shqipëria ka shprehur synimin e saj për të eliminuar të gjitha subvencionet në sektorin e energjisë deri në vitin 2020, duke përfshirë garancitë publike dhe politikën e huadhënies neto.

Privatizimi dhe ristrukturimi

Shqipëria është e përparuar në liberalizimin dhe privatizimin e tregut. Sektori privat mbetet dominues në ekonomi, duke siguruar më shumë se 80% të vendeve të punës. Përfshirja e Shtetit në ekonomi mbetet e kufizuar dhe është përqendruar në disa sektorë si energjia. Ligji i vitit 2015 për sektorin e energjisë parashikon një afat kohor të caktuar për liberalizimin e mëtejshëm të tregut, duke filluar nga qershori. Shqipëria ka rinegociuar kushtet e marrëveshjes koncesionare për menaxhimin e aeroportit të Tiranës, duke hequr monopolin e saj në fluturimet ndërkombëtare. Në prill, Shqipëria privatizoi kompaninë plotësisht shtetërore të sigurimeve INSIG. Planet e privatizimit për kompaninë e naftës “Albpetrol” janë lënë në pritje, pasi çmimet në rënie të naftës kanë ulur interesin e investitorëve.

Funksionimi i tregut financiar

Stabiliteti financiar

Sistemi bankar vazhdon të jetë i qëndrueshëm, por është i ekspozuar ndaj rreziqeve. Në përgjithësi, bankat kanë ruajtur imbalancat të përshtatshme për të zbutur tronditjet pasi raportet e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe likuiditetit tejkaluan shumë kërkesat rregullatore. Aftësia përfituese e sistemit bankar u përmirësua në vitin 2015, por pësoi rënie në gjysmën e

parë të vitit 2016. Bankat nuk varen nga bankat-mëmë të huaja për financim sepse norma e kredive për depozitat e brendshme është vetëm 53%. Euroizmi i kredisë mbetet i lartë: kreditë në valutën e huaj për huamarrësit e pambrojtur ende përbëjnë rreth një të tretën e stokut të përgjithshëm të kredisë, duke e bërë shlyerjen e tyre të ndjeshme ndaj zhvlerësimit të madh të monedhës shqiptare (Lek). Letrat me vlerë të qeverisë përbëjnë rreth një të katërtën e aseteve bankare, duke ekspozuar bankat ndaj rreziqeve të mëdha gjithashtu.

Aksesi në financa

Ka mundësi për bankat që të zgjerojnë huadhënien dhe të përmirësojnë mbështetjen për rimëkëmbje ekonomike. Sektori bankar, i dominuar nga bankat e huaja, zotëron mbi 90% të aseteve të sistemit financiar. Me kreditë për biznesin dhe shtëpitë që llogariten në 35% të PBB-së, ka shumë mundësi për rritje të huadhënies bankare. Gjithsesi, rritja e kreditimit bankar ka qenë e ngadaltë vitet e fundit, pavarësisht rënies graduale të normave të interesit si pasojë e kërkesës së ulët dhe ofertës së ngushtë për kredi bankare. Gatishmëria e bankave për huadhënie u ndikua nga proporcioni i lartë i (kredive me probleme) NPL-ve, i cili mbeti 21.2% në korrik. Në shtator 2015, qeveria dhe banka qendrore kanë rënë dakord për një plan veprimi gjithëpërfshirës të NPL-ve që përfshin masa legjislative dhe rregullatore dhe që pritet të përshpejtojë zgjidhjen e çështjes së kredive me probleme dhe rikuperimin e kredisë.

Rekomandimi i PRE: “Vijoni me adresimin e rreziqeve në stabilitetin financiar duke ndjekur planin e veprimit të NPL-ve që është miratuar, dhe duke zhvilluar një strategji afatmesme për nxitjen e përdorimit të monedhës vendase në sistemin financiar, përfshirë të gjithë palët respektive të interesuara. Gjatë këtij procesi, qëndrimi i politikës monetare të bankës qendrore mund të mbetet akomoduese për aq kohë sa rruga për konsolidimin fiskal mbetet e favorshme, por rreziqet që lidhen me lehtësimin e mëtejshëm të politikave duhet të vlerësohen me kujdes”

Madhësia e sektorit financiar jo-bankar është rritur, por ende mbetet e vogël. Ajo përbëhet nga biznese të sigurimit dhe pensioneve private, si dhe fondet e investimeve. Totali i aseteve zë 6.5% të PBB-së. Tregu i kapitalit është në faza fillestare dhe bursa e vlerave ka mbetur e mbyllur. Ka hapësirë të madhe për zgjerimin e financimit me aksione të zakonshme.

Funksionimi i tregut të punës

Forcimi i aktivitetit ekonomik ka përmirësuar kushtet e tregut të punës, por papunësia, në veçanti e të rinjve, mbetet e lartë. Rimëkëmbja ekonomike ka krijuar vende pune dhe shkalla e punësimit është rritur në 52.9% në vitin 2015 nga 49.9% që ishte në vitin 2013 (mosha 15-64 vjeç). Mbi 40% e forcës punëtore është e punësuar në bujqësi, kryesisht në punë me kualifikim të dobët, dhe punësimi informal mbetet i përhapur. Pjesëmarrja e forcës punëtore është rritur në 64.2%, duke reflektuar mundshëm perspektivat e përmirësuar të

Rekomandimi i PRE: ‘Rrisni mbulimin e politikave aktive të tregut të punës dhe përmirësoni angazhimin e personave të papunë dhe joaktivë, në veçanti të rinjtë, gratë dhe personat e papunë për një kohë të gjatë. Përshpejtoni përpjekjet për të arritur një qasje gjithëpërfshirëse për reduktimin e punës së padeklaruar.’

punësimin dhe një tendencë në rënie të reminitancave. Politikat aktive të tregut të punës janë zgjeruar nga ajo që ishte vetëm një bazë e vogël, por ende ato mbulojnë vetëm rreth 4% të të papunësuarve.

Figura 3 Papunësia në Shqipëri (% e popullsisë aktive)





Figura 4 Shkalla e pjesëmarrjes në Shqipëri (% e forcës së punës)



Ka një diferencë të madhe dhe të vazhdueshme në pjesëmarrjen e femrave dhe meshkujve në forcën e punës, ku shkalla e pjesëmarrjes së femrave është rreth 18% më e vogël sesa meshkujt, duke theksuar problemet e mëdha strukturore në tregun e punës. Shkalla e papunësisë (për moshat 15-64 vjeç) ka pësuar rënie nga 17.9% në vitin 2014 në 15.9% në mesin e 2016. Shkalla e papunësisë së të rinjve (mosha 15-29 vjeç) gjithashtu ka pësuar rënie por ende mbetet shumë e lartë, në nivelin 29.9%, duke theksuar një mospërputhje të theksuar midis aftësive. Paga minimale, relativisht e lartë, mund të veprojë si pengesë për punësimin e personave me pak kualifikim dhe të rinjve.

3.2. Aftësia për të përballuar presionet e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda BE-së

Shqipëria ka një farë niveli të përgatitjes në aspektin e aftësive ëpr të përballuar presionet e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda BE-së. Janë bërë disa ëprparime përsa i përket përmirësimin të arsimit të lartë dhe profesional, si dhe prioritizimit të investimeve në infrastrukturë. Gjithsesi, cilësia e arsimit duhet të rritet në të gjitha nivelet, për t'i pajisur njerëzit me aftësi më të mira, në pajtim me kërkesat e tregut të punës. Hapësirat në transport, energji dhe infrastrukturën dixhitale ende pengojnë konkurrueshmërinë e Shqipërisë dhe shtrëngojnë tregun, i cili mbetet nën potencial dhe i përqendruar sipas sektorëve. Kapaciteti i Shqipërisë për kërkim, zhvillim dhe inovacion mbetet i ulët.

Në përputhje me rekomandimet e ERP dhe me qëllim mbështetjen e ngritjes afatgjatë, vitin e ardhshëm Shqipëria duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë:

→ përmirësimin të cilësisë së arsimit;

→ liberalizimit të mëtejshëm të tregut të energjisë në përputhje me Traktatin e Komunitetit të Energjisë, në veçanti, duke shthurur aktivitetet e transmetimit dhe shpërndarjes, në mënyrë që të përmirësohet sigurimi i energjisë dhe të mundësohet hyrje në treg të operatorëve ët pavarur;

→ lehtësimi të tregut përmes thjeshtimit të procedurave dhe heqjes së barrierave jo-tarifore.

Arsimi dhe inovacioni

Shqipëria ka ende hapësira të konsiderueshme për të mbyllur mes rezultateve të arsimit dhe nevojave të tregut të punës. Shpenzimet publike për arsimin mbeten të ulëta, në më pak se 3% të PBB-së. Cilësia e arsimit bazë është e ulët, gjë e cila tregohet edhe në renditjen e dobët të studentëve shqiptarë në testet PISA⁴ të OECD-së. Shkalla e regjistrimeve në arsimin para-shkollor (mosha 3-6 vjeç) është e ulët, në nivelin 33%, duke penguar përpjekjet për krijimin e shanseve të barabarta për fillimin e shkollës fillore.

Niveli i lartë i papunësisë së të rinjve, madje dhe i personave të mirë-kualifikuar, është shenjë e nevojës për përmirësimin e cilësisë dhe përkatësisë së arsimit që merret. Një pjesë e madhe e ndërmarrjeve kanë mangësi në forcë punëtore me kualifikim të duhur.

Është miratuar ligji i ri për arsimin e lartë dhe kanë filluar përgatitjet për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, si dhe zbatimi i procedurave të decentralizuara të përzgjedhjes për praninë në universitet. Është bërë progres i vazhdueshëm me ngritjen e qendrave shumë-funksionale VET dhe vijon puna për Kuadrin Kombëtar të Kualifikimeve (KKK).

Kapaciteti i Shqipërisë për përthithje dhe kërkim teknologjik, zhvillim dhe inovacion (RDI) mbetet i ulët. Ndër pengesat kryesore përmenden: shpenzimet për kërkim dhe zhvillim (rreth 0.4% të PBB-së); lidhjet e dobëta mes sektorëve shkencor dhe privat; si dhe fragmentimi i sistemit kombëtar për kërkim dhe inovacion. Si pasojë e kësaj infrastrukture të dobët të politikave për inovacion, pothuajse të gjithë sektorët e ekonomisë ofrojnë produkte dhe shërbime të teknologjisë së dobët, me përqendrim të lartë të krahut të punës dhe me çmim të ulët. Rritja e financimit dhe një strategji RDI më e përqendruar në një sërë sektorësh specifikë, në veçanti në energji, agro-ushqim dhe turizëm të qëndrueshëm, do të mbështeste aftësinë e vendit për të tërhequr investime në RDI.

Kapitali fizik dhe cilësia e infrastrukturës

Rënia e investimeve u prapësua në vitin 2015, por nevojiten masa të mëtejshme për të ruajtur shpenzimet kapitale.

Investimet si pjesë e PBB-së kanë pësuar rënie nga 33.9% që ishte në vitin 2008 në 24.6% në vitin 2014 dhe pësuan rënie edhe në termat nominalë për periudhën 2012-2014. Gjithsesi, vërshimi në rritje i investimeve të huaja direkte (IHD) në sektorin e energjisë kanë sjellë rritje të vërtetë dyshifrore të investimeve. Kursimet e brendshme janë të ulëta për t'u përputhur me nevojat e mëdha për investime të ekonomisë shqiptare, që mbetet e varur në dyndjen e IHD-ve për të rritur konkurrencën dhe kapacitetet

Rekomandimi i PRE: ‘Zbatoni plotësisht detyrimet në kuadër të Traktatit për Energji në Komunitet, në veçanti, ndarjen e shpërndarjes dhe transmetimit në sektorët e gazit dhe energjisë elektrike për të përmirësuar sigurinë e energjisë dhe për të mundësuar hyrjen në treg të operatorëve të pavarur’.

⁴ Programi i OECD-së për Vlerësimin Ndërkombëtar të Studentëve

prodhuese. Mungesa e një kadastre funksionale dhe qartësisë së zotësisë së pronës përbëjnë ndër pengesat kryesore për investime. Është bërë një farë progresi për forcimin e kuadrit të politikave për investime, kryesisht përmes miratimit të rregulloreve zbatuese të ligjit për investimet strategjike dhe përmes riorganizimit të Agjencisë për Nxitjen e Investimeve të Huaja. Investimet publike u llogaritën në mbi 5% të PBB-së gjatë për vitet e kaluara, por shpesh janë ndikuar nga shkurtimet e përkohshme të investimeve.

Infrastruktura e transportit dhe energjisë, e Shqipërisë nuk është e zhvilluar mjaftueshëm. Përmirësimi i lidhjeve me vendet fqinje dhe rrjetin e transportit të BE-së do të ulnin kostot e transportit dhe do të lehtësonin tregtinë. Investimet në rrjetin kryesor të transportit kanë marrë prioritet nga krijimi i Rrjetit të Projekteve në Sektorin e Mjedisit për projektet më prioritare kombëtare. Gjithsesi, Shqipëria ende nuk ka zbatuar masat e reformës ndërlidhëse të rënë dakord në procesin e Berlinit.

Niveli i papërshtatshëm i furnizimit me energji mbetet sfidë kryesore strukturore duke rritur kostot për bizneset. Është arritur progres në reformën e sektorit të energjisë: është përforcuar dukshmëria financiare e kompanive shtetërore të shërbimit publik dhe është përmirësuar infrastruktura, në veçanti me përfundimin e linjës së interkonjeksionit mes Shqipërisë dhe Kosovës. ka filluar ndërtimi i projektit TAP. Ka plane për përdorimin e partneriteteve publik-privat për të përmirësuar infrastrukturën, por projekte të tilla duhet të jenë transparente dhe të shëndosha nga ana fiskale.

Digjitalizimi i ekonomisë mbetet i ulët, por po avancohet. Penetrimi i internetit në telefoninë fikse është vetëm 9 %, ndërsa penetrimi i internetit në telefoninë e lëvizshme ka arritur në 46% të popullsisë deri në fund të vitit 2015. E-government ka avancuar më tej me një portal (e-Albania) që ofron mundësi për aplikacione online për regjistrimin paraprak të biznesit, dorëzimin e pasqyrave vjetore financiare, konsultimin e të dhënave të biznesit, etj. Shërbimi elektronik i bankës dhe e-commerce janë në rritje dhe kanë potencial të lartë për zgjerim të mëtejshëm.

Struktura sektorale dhe e ndërmarrjeve

Ekonomia shqiptare dominohet nga shërbimet, por bujqësia ende mbetet faktor i rëndësishëm. Në vitin 2015, shërbimet llogariteshin rreth pak më shumë se gjysma e vlerës së shtuar bruto (VSHB), e ndjekur nga bujqësia që zë 22.1%. Përqindja e industrisë është rritur gradualisht që prej vitit 2007 në 14.6% të ekonomisë, kryesisht si rezultat i prodhimit në rritje të naftës krudo. Sektori prodhues është relativisht i vogël (6.3% e VSHB-së) dhe prodhon kryesisht produkte me vlerë të vogël të shtuar dhe që kërkojnë përqendrim të lartë të krahut të punës, të tilla si tekstile dhe këpucë. Përqindja e ndërtimit në ekonomi është zvogëluar shumë gjatë viteve të fundit pas dobësimit të kredive private dhe investimeve, por në vitin 2015 ky sektor shënoi një rritje të lehtë, për herë të parë që prej vitit 2007, duke u rritur në 10.8%.

Përqendrimi sektorial i eksporteve të mallrave mbeti i lartë në vitin 2015, me 78% të llogaritjes totale nga numri i kufizuar i produkteve: tekstile dhe këpucë (37.8%); minerale, karburante dhe energji elektrike (26.5%); dhe materialet e ndërtimit e metalet (14.5%). Kjo mungesë e diversifikimit kontribuon në rritjen e deficitit të jashtëm dhe ekspozon ekonominë

ndaj tronditjeve specifike industrial, siç u theksua nga ndikimi i rënies së çmimit të naftës në eksportet shqiptare.

NVM-të janë një faktor i rëndësishëm i ekonomisë. Ato ofrojnë 80% të punësimit dhe dy të tretën e vlerës së shtuar në sektorin privat jo-bujqësor. Bizneset e vogla, në veçanti, përbëjnë një përqindje të lartë të numrit të kompanive dhe llogariten sigurojnë 43% të punësimit. Skema të ndryshme, me financim nga shteti dhe donator mbështesin konkurrencën e NVM-ve, por nevojiten hapa të mëtejshëm ëpr të forcuar kapacitetet e tyre inovative dhe për të përmirësuar aksesin në financa, siç është zhvillimi i tregut të kapitalit të ndërmarrjeve.


Integrimi ekonomik me BE-në dhe konkurrencën e çmimeve

BE-ja është partneri dominues tregtar për Shqipërinë, por tregtia, në përgjithësi, mbetet nën potencial. Me një total të importeve dhe eksporteve që llogariten në vetëm 71.7% të PBB-së, Shqipëria ka mundësi të mëdha për rritjen e tregtisë. Integrimi më i mirë në zinxhirin e furnizimit global do të ndihmonte në nxitjen e produktivitetit dhe krijimin e më shumë vendeve të punës dhe më të mira.

BE-ja zë rreth 75% të eksporteve të mallrave të Shqipërisë dhe 61.3% të importeve të saj për vitin 2015. Italia është destinacioni kryesor për eksportet shqiptare, duke përthithur rreth gjysmën e mallrave shqiptare që shiten jashtë vendit dhe duke ofruar 30% të importit të mallrave të saj.

Lidhjet tregtare me vendet e Marrëveshjes së Evropës Qendore për Tregti të Lirë (CEFTA) janë gjithashtu relativisht të rëndësishme, kryesisht për shkëmbimet me Kosovën. Të grumbulluara së bashku, gjashtë vendet partnere të Shqipërisë në CEFTA zënë rreth 14% të eksporteve të mallrave të Shqipërisë dhe 8% të importeve të mallrave të saj për vitin 2015. Këto përqindje kanë mbetur kryesisht të pandryshuara që prej vitit 2008, duke treguar një potencial të madh të pashfrytëzuar për rritje në të ardhmen nëse përmirësohen lidhjet ndërrajonale.

Tabela5Integrimi i tregut të Shqipërisë me BE-në



BE-ja mbetet burimi kryesor i IHD në Shqipëri, e cila zë rreth 65% të stokut total të IHD-ve.

Në aspektin e konkurrencës së çmimit dhe kostos, kursi real efektiv i këmbimit u rrit me 3.7% gjatë 12 muajve që i paraprijnë qershorit, ndërsa kostot për njësi të prodhuar mbeten më të ulëtat, krahasuar me vendet e rajonit.

4. AFTËSIA PËR TË MARRË PËRSIPËR DETYRIMET E ANËTARËSIMIT

4.1. Kapitulli 1: Lëvizja e lirë e mallrave

Lëvizja e lirë e mallrave garanton se shumë mallra mund të tregtohen lirisht në BE mbi bazën e rregullave dhe procedurave të përbashkëta. Kur lëvizja e produkteve drejtohet nga rregulla të brendshme, parimi i lëvizjes së lirë të mallrave parandalon krijimin e barrierave të pajustificuara në tregti.

Shqipëria ka një farë niveli të përgatitjes/ është mesatarisht e përgatitur në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave. Janë bërë disa përpjekje gjatë vitit të kaluar, kryesisht në përafrimin me qasjen e re dhe globale acquis dhe rritjen e kapaciteteve për akreditim. Gjithsesi, nevojiten përpjekje të mëtejshme për të garantuar përafrimin legjislativ dhe për të përforcuar kapacitetet zbatuese të institucioneve që veprojnë në këtë fushë, në veçanti Inspektoratit të Mbikëqyrjes së Tregut të sapo ngritur. Vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet, në veçanti:

→ të përafrojë legjislacionin e saj me acquis horizontal, kryesisht në fushat e metrologjisë, standardizimit, akreditimit dhe mbikëqyrjes.

→ të garantojë funksionimin e plotë të Inspektoratit të Mbikëqyrjes së Tregut.

Parimet e përgjithshme

Lidhur me **parimet e përgjithshme**, janë gati rregulloret për **prodhimin, shpërndarjen dhe marketingun** e produkteve industriale për sa ka të bëjë me çmimin e produkteve, licencat ose lejet e importit për mallrat e importuara, dhe detyrimi për të pasur kontenerë ruajtjen e produkteve në zona të caktuara. Legjislacioni kombëtar nuk e ndalon etiketimin në gjuhë të huaja, por kërkon që etiketimi dhe udhëzimet e përdorimit të jenë në gjuhën shqipe. Përafrimi me acquis për Kapitullin 1 parashikohet në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2016-2020, dhe strategjinë për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2020, që përfshin infrastrukturë cilësore. Gjithsesi, Nuk ka një strategji specifike për lëvizjen e lirë të mallrave.

Fusha e pa-harmonizuar

Po përgatitet një Plan Veprimi për Vetë-vlerësimin e Rregulloreve Teknike Kombëtare për të vlerësuar **përputhshmërinë me nenet 34-36** të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU). Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (GDS) është autoriteti kombëtar njoftues dhe pika e informacionit nën Marrëveshjen Botërore për Organizimin e Tregut për barrierat Teknike në Treg (WTO/TBT) lidhur me standardet e draftit, rregulloret teknike të draftit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit të draftit. Nuk ka një sistem lajmërimi për **njoftimet**, por të gjitha njoftimet e WTO/TBT publikohen në faqen e GDS-së.

Fusha e harmonizuar: infrastruktura cilësore

Baza ligjore është përafruar pjesërisht me acquis dhe ekzistojnë strukturat administrative për rregulloret teknike, standardizimin, vlerësimin e konformitetit, metrologjinë, akreditimin dhe mbikëqyrjen e tregut. Strukturat përkatëse janë organe ndërvlerësie të ministrisë përgjegjëse

për çështjet e tregtisë. Struktura e Inspektoratit për Mbikëqyrjen e Tregut u miratua nga qeveria në maj të vitit 2016 dhe ka filluar rekrutimi i stafit. Ka marrëveshje të përbashkëta të bashkëpunimit në fushën e akreditimit, standardizimit dhe vlerësimit të konformitetit me vendet e rajonit dhe jo-anëtare të BE-së.

Në fushën e **standardizimeve**, GDS-ja është bërë anëtare me të drejta të plota e Institutit Evropian të Standardeve të komunikimit (ETSI), anëtare e Komitetit Evropian për Standardizim (CEN) dhe e Komitetit Evropian për Standardizim Elektroteknik (CENELEC), si dhe anëtare e asociuar e Komitetit Ndërkombëtar për Standardizimin Elektro-teknik. Standardet kombëtare përditësohen rregullisht për t'u përafëruar me standardet evropiane, por kjo arrihet kryesisht përmes metodës së përkthimit të “faqes së parë”, ku vetëm faqja e parë është në gjuhën kombëtare. Numri i standardeve të përkthyer plotësisht në gjuhën shqipe mbetet i ulët. Në vitin 2015, GDS-ja miratoi 3 122 standarde, nga të cilat 2 129 janë standard evropiane (standard të CEN, CENELEC dhe ETSI) dhe 498 janë standard ndërkombëtare (290 dokumente standardizimi dhe 286 ndryshime standardesh). Është shtuar bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë, përfshirë strukturat standardizuese të Çekisë dhe Kosovës. Gjithsesi, kapaciteti i saj nevojitet të përforcohet më tej.

Ligji i vitit 2014, për akreditimin e organeve të **vlerësimit të konformitetit**, që rregullon mënyrën e funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit (GDA-së), bordin e saj akreditues, komisionet teknike dhe çështje të tjera procedural, është hartuar në përafërime të gjerë me *acquis-in*. Ekzistojnë 46 organe të akredituara për vlerësimin e konformitetit, 11 organe inspektimi dhe 6 organe të vlerësimit të konformitetit; 21 organe janë në proces akreditimi. GDA-ja është anëtare me të drejta të plota në Bashkëpunimit Evropian për Akreditim, anëtare e asociuar e Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Akreditimin e Laboratorëve, anëtare për akreditimin e organeve në Forumin Ndërkombëtar të Akreditimit dhe anëtare e Marrëveshjes Shumëpalëshe për Testimin e laboratorëve të Bashkëpunimit Evropian për akreditim. Ekziston një organ zyrtar për **metrologjinë**, që është Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë (GDM). rregulloret teknike për instrumentet e matjes u miratuan në dhjetor, me qëllim përafërimit e mëtejshëm me Direktivat për Instrumentet e Matjes. Që prej shtatorit 2015, GDM-ja ka kryer 4 101 inspektime dhe ka lëshuar 14 gjoba për shkelje të ligjit, megjithëse gjobat nuk janë mbledhur ende.

Në fushën e **mbikëqyrjes së tregut**, Inspektorati i rii Mbikëqyrjes së Tregut, i cili është përgjegjës për produktet industrial jo-ushqimore, të drejtat e produktit, të drejtat e pronës industrial dhe turizmit, u ngrit në janar dhe filloi veprimtarinë në maj 2016. Strukturat për mbikëqyrjen e tregut, që operojnë në institucionet e linjës janë fuqizuar nga ligji për të ndërmarrë masa kundër mos-konformitetit dhe produkteve me rrezik sipas një metode proporcionale, e cila fillon me paralajmërimin, ndalimin e përkohshëm deri në ndalimin e marketingut dhe tërheqje, e me penalitete përkatëse.

Fusha e harmonizuar: legjislacioni sektorial

Në aspektin e **legjislacionit të produkteve të “Përfaqesjes së Re dhe Globale”**, qeveria ka miratuar disa rregullore teknike me qëllim përafërimit me *acquis-in* për: kërkesat e rendimentit për bolierët dhe ndriçimin fluoreshent; enëve të thjeshta me presion; pajisje mbrojtëse personale; pajisje elektrike të projektuara për përdorim brenda limiteve të voltazhit; pajisje dhe sisteme mbrojtëse për përdorim në mjedise me potencial të lartë shpërthimi; përputhje

elektromagnetike, siguria e ashensorëve; makineri; emisionet e zhurmave nga pajisje të jashtme; instrumente matëse; pajisje dhe pjesë presioni e pajisjet e gazit.

Legjislacioni kombëtar për vendosjen e çmimit të produkteve mjekësore nuk është përputhur plotësisht me acquis-in. Në lidhje me **eksplozivët për përdorim vetjak**, ekziston legjislacioni për përafrimin me acquis-in dhe operatorët ekonomikë kërkojnë që të regjistrojnë të dhënat.

Në aspektin e **legjislacionit të produkteve të “Përqasjes së Vjetër”**, në mars u ndryshua ligji për menaxhimin e kimikateve, me qëllim përafrimin e pjesës së tij me dispozitat e Rregullores për Regjistrimin, Vlerësimin, Autorizimin dhe Ndalimin e Kimikateve (REACH) dhe të pjesëve të tjera respektive të acquis. Legjislacioni shqiptar parashikon regjistrimin e plehrave që nuk kanë emërtimin “EC fertiliser” për marketing, ku aktualisht janë të regjistruara gjashtë nga këto lloj plehrash. Legjislacioni kombëtar për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e kimikateve nuk është ende në përputhje me Sistemin Global të Kombeve të bashkuara për **klasifikimin dhe etiketimin e kimikateve**, megjithëse kanë filluar përgatitjet për përafrim. Në lidhje me **përbërësit e barnave**, ka një listë me substanca kombëtare të kontrolluara, që është në përputhje me listat në fushat përkatëse të acquis dhe legjislacioni ekzistues i detyron të gjithë personat fizikë dhe juridikë që të raportojnë menjëherë lidhur me ndonjë gjendje të dyshimtë. Në fushën e **masave procedurale**, ka përafrim të kufizuar: janë miratuar rregulloret teknike që kanë të bëjnë me fibrat tekstile dhe etiketimin e tyre. Më 27 prill, Këshilli i Ministrave miratoi Planin e Veprimit për Parandalimin dhe Luftën kundër Trafikimit të Objekteve Kulturore, por legjislacioni përkatës mbetet për t’u përafruar me acquis.

4.2. Kapitulli 2: Lëvizja e lirë e punëtorëve

Qytetarët e një Shteti Anëtar kanë të drejtë të punojnë në një Shtet tjetër Anëtar dhe duhet t’u

Shqipëria është në fazë të hershme në fushën e lirisë së lëvizjes për punëtorët. **Nuk është bërë progres** në këtë fushë. Vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet, në veçanti:

→ të ndjekë negocimin dhe zbatimin e marrëveshjeve dypalëshe për sigurimet shoqërore, kryesisht me Shtetet Anëtare të BE-së.

sigurohen kushte të njëjta pune dhe sociale si punëtorëve të tjerë.

Për sa i përket **aksesit në tregun e punës**, ligji për të huajt u ndryshua në gusht, me qëllim garantimin e trajtimit të barabartë për punëtorët e BE-së në tregun kombëtar të punës.

Në lidhje me **koordinimin e sistemeve të sigurimeve shoqërore**, janë nënshkruar marrëveshje dypalëshe për sigurimet shoqërore me Belgjikën, Rumaninë, Hungarinë, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Luksemburgun, Republikën e Çekisë dhe Gjermaninë. Marrëveshjet dypalëshe me Austrinë dhe Kanadanë janë gati për nënshkrim, ndërsa vijojnë përgatitjet për negociatat me vende të tjera përfshirë Kroacinë, Malin e Zi, Italinë dhe Greqinë.

4.3. Kapitulli 3: E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime

Personat fizik dhe juridik të BE-së kanë të drejtë të vendosen në çdo Shtet Anëtar dhe të ofrojnë shërbime ndërkufitare. Për disa profesione të rregulluara, ekzistojnë rregulla për njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve. Shërbimet postare po hapen gradualisht ndaj konkurrencës.

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime. Janë bërë **disa përparime** vitin e kaluar në fushën e lirisë për të ofruar shërbime. Vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet në veçanti:

→ të vijojë përafrimin e legjislacionit me Direktivën për Shërbimet dhe Direktivën për Kualifikimet Profesionale;

→ të forcojë kapacitetin institucional në fushën e të drejtës së vendosjes dhe njohjes së përbashkët të kualifikimeve profesionale.

Për sa i përket **lirisë për të ofruar shërbime ndërkufitare**, në qershor është miratuar një ligj i ri për shërbimet. Ky ligj parashikon një periudhë transitore për përfundimin e vlerësimit të legjislacionit ekzistues për sektorë dhe ngritjen e një pike të vetme kontakti funksionale. Qendra Kombëtare e Regjistrimit dhe Qendra Kombëtare e Licencimit janë zëvendësuar me Qendrën Kombëtare të Biznesit, e cila prej prillit funksionon sistemi i ofrimit të shërbimeve me një ndalesë (*one-stop-shop*) për regjistrimin e bizneseve dhe lëshimin e licencave, autorizimeve dhe lejeve. Vlerësimi i legjislacionit për sektor në fushën e tatimeve, shërbimeve sociale dhe sektorëve ligjorë për përputhshmëri me Direktivën për Shërbime u finalizua në janar. Është miratuar një plan veprimi, me qëllim arritjen e përputhshmërisë së plotë në të gjithë nën-sektorët me të drejtën e vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime, dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional.

Pjesa më e madhe e legjislacionit që lidhet me ligjin për **shërbimet postare** është miratuar.

Në lidhje me **njohjen e përbashkët të kualifikimeve profesionale**, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka miratuar organizimin e një sesioni të veçantë të testimi të shtetit për profesionet e rregulluara të fizikanëve. Ligji i ri për zejtarinë është futur në kalendar nga qeveria dhe pritet të miratohet nga Kuvendi. Për herë të parë, ligji parashikon një model “forma e dyfishtë” të arsimit dhe formimit profesional.

4.4. Kapitulli 4: Lëvizja e lirë e kapitalit

Në BE, kapitali dhe investimet duhet të jenë në gjendje të lëvizin pa kufizime dhe ekzistojnë rregulla të përbashkëta për pagesat ndërkufitare. Bankat dhe operatorët e tjerë ekonomik zbatojnë rregulla të caktuara për të mbështetur luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Në përgjithësi, Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e lëvizjes së kapitalit. Janë bërë **disa përparime** në fushën e sistemit të pagesave, me ndryshimin e rregulloreve nga Banka e Shqipërisë. Vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet, në veçanti:

→ të zbatojë legjislacionin me efikasitet dhe të forcojë kapacitetin e saj për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;

→të zbatojë planin e veprimit për blerjen e pasurive të paluajtshme nga të huajt.

Sa i përket **lëvizjes së kapitalit dhe pagesave**, plani i punës për ndryshimet legislative mbi blerjen e pasurive të paluajtshme nga të huajt nuk është zbatuar ende.

Është arritur njëfarë progresi në fushën e **sistemit të pagesave**. Në nëntor, Banka e Shqipërisë miratoi një rregullore për licencimin, që rregullon dhe mbikëqyr operatorët privatë të sistemeve të pagesave dhe kliringun e shtëpive për pagesat, me qëllim përafrimin e tij me standardet evropiane të Bankës Qendrore. Në mars, janë bërë ndryshime edhe në rregulloren për licencimin e aktiviteteve të institucioneve financiare jo-bankare që operojnë në veprimet e transferimit të parave. Bashkëpunimi mes Bankës së Shqipërisë dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare është forcuar më tej në drejtim të mbikëqyrjes së sistemeve të shlyerjes së letrave me vlerë dhe palëve të tjera qendrore. Komiteti Kombëtar i Sistemit të Pagesave zhvilloi mbledhjen e tij të parë në tetor dhe miratoi strategjinë dhe objektivat e tij kryesorë.

Sa i përket **luftës kundër pastrimit të parave**, numri i transaksioneve të dyshimta të raportuara u rrit në 1319 në vitin 2015, duke regjistruar një rritje prej 7% krahasuar me vitin 2014. Numri i dënimeve u rrit gjithashtu në vitin 2015, me 37 dënime të formës së prerë nga 20 të regjistruara në vitin e kaluar. Megjithatë, si policia ashtu edhe prokuroria ende nuk kanë akses në bazën e të dhënave të Njësisë së Inteligjencës Financiare.

4.5. Kapitulli 5: Prokurimi Publik

Rregullat e BE-së sigurojnë se prokurimi publik i mallrave, shërbimeve dhe punëve në çdo Shtet Anëtar është transparent dhe i hapur për të gjitha kompanitë e BE-së mbi bazën e parimit të mos-diskriminimit dhe trajtimit të barabartë.

Shqipëria ka **njëfarë niveli të përgatitjes** në fushën e prokurimit publik. Nevojiten përpjekje për të përmirësuar përputhshmërinë me procedurat dhe për të parandaluar korrupsionin në ciklin e prokurimeve. Vitin e kaluar **nuk është bërë progres** për saka të bëjë me përafrimin e legjislacionit me *acquis*, në veçanti për forcimin e sistemit të rishikimit të prokurimeve publike. Vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet, në veçanti:

→ të marrë masa për të përafruar sistemin e rishikimit të prokurimit publik me standardet mbi pavarësinë, të përcaktuara në *acquis* përkatëse;

→ të marrë masa për të adresuar rekomandimet e studimeve të fundit në mënyrë që të përforcohet përputhshmëria me rregullat e prokurimit dhe efienca e procedurave të prokurimit, të rrisë transparencën dhe të forcojë monitorimin;

→ të harmonizojë më tej rregullat e prokurimit publik me rregullat e BE-së, përfshirë fushën e koncesioneve dhe të mbrojtjes si dhe të ndërtojë një regjistër për koncesionet/ partneritetet publik-privat.

Kuadri institucional dhe përafrimi ligjor

Kuadri ligjor për Prokurimin Publik është në masë të gjerë në përputhje me direktivat e BE-së për prokurimin klasik dhe utilitar dhe me dispozitat përkatëse administrative e buxhetore.

Nuk është arritur ende harmonizimi i plotë me direktivat në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare, si dhe të mbrojtjes e sigurisë.

Ligji për koncesionet dhe partneritetet publik-privat është përafëruar pjesërisht me Direktivën për dhënien e kontratave koncesionare. Alternativa e dhënies së bonuseve prej 10% për propozime të pakërkua dhe përjashtimin e infrastrukturës rrugore të rëndësishme kombëtare nga objekti I ligjit duhet të përafrohen me acquis. Ndryshimet e qershorit në ligjin organik për buxhetin kanë rritur mbikëqyrjen dhe shqyrtimin e hollësishëm nga ana e Ministrisë së Financave të të gjitha koncesioneve dhe projekteve të partneritetit publik privat (PPP).

Në kuadër të **strategjisë** për menaxhimin e financave publike, duhet të adresohen rekomandimet e studimeve për menaxhimin e investimeve publike dhe prokurimin publik. **Agjencia e Prokurimeve Publike** (APP) ka shtuar numrin e stafit në 29, nga të cilat 3 vende janë vakante. Njësia e trajtimit të koncesioneve në Ministrinë e Financave dhe Tregtisë ka një staf prej 12 punonjësish.

Zbatimi dhe aftësitë zbatuese

Tregu i prokurimeve publike në raport me PBB-në është rritur në 3.48% nga 3.2% që ishte në vitin 2014. Planifikimi dhe përgatitja e procedurave të prokurimit publik në përgjithësi respektojnë parimet e transparencës dhe efikasitetit, dhe parashikimet për prokurime publike publikohen. Nuri I procedurave me negociim pa shpallje paraprake është rritur më tej gjatë vitit 2015 duke arritur në 2706, 67% e të cilave janë kryer tremujorin e parë të vitit. Në aspektin e volumit, këto procedura përbëjnë 11% të buxhetit të përgjithshëm të të gjitha procedurave. Gjithsesi, këto përfshijnë edhe zgjatjet e kontratave ekzistuese me gati 20% të vlerës, e cila tashmë do të raportohet më vete. Në vitin 2015, janë publikuar 34 njoftime për marrëveshje kuadër dhe janë firmosur 139 kontrata. Në Ministrinë e Brendshme funksionon një organ i centralizuar prokurimi për disa lloje prokurimesh. Portali qendror i prokurimit publik funksionon dhe të gjitha dokumentet e tenderimit mundësohen në format elektronik.

Deri më tani janë nënshkruar rreth 170 PPP, që përbëjnë 6.1% të PBB-së. Megjithëse parashikohet me ligj, analiza e vlerës së parasë nuk kryhet sistematikisht para miratimit të PPP-ve. Nuk ka raportime të rregullta për PPP-të, përfshirë pagesat dhe arkëtimet e dhëna përgjatë kohëzgjatjes së kontratës. Në përgjithësi, aftësitë teknike dhe kapacitetet për të hartuar dhe vlerësuar koncesione e projekte PPP duhet të përmirësohen më tej.

APP-ja ka forcuar funksionin e saj **monitorues** dhe ka lançuar përgatitjen e sistemit të monitorimit të performancës dhe përputhshmërisë së prokurimeve mbi treguesit e performancës. Nevojitet mbështetje e mëtejshme për autoritetet kontraktore, si dhe të përforcohet sistemi elektronik i prokurimit, monitorimi i zbatimit të kontratave dhe analiza e prirjeve të tregut për prokurime publike. Duhet të ndërtohet regjistri i PPP/ koncesioneve.

Aftësitë e autoriteteve kontraktore për të menaxhuar procedurat e prokurimit publik duhet të përmirësohen ndjeshëm. Përputhshmëria është e dobët në përgjithësi, sidomos në procedurat më komplekse. KLSH-ja, në vitin 2015, ka raportuar një numër të madh shkeljesh. Në vitin 2015, APP-ja organizoi një modul trajnimi 9-ditor për oficerët e prokurimit publik, por duhen ofruar mundësi të tjera trajnimi, përfshirë trajnimet mbi rolet e anëtarëve të komisioneve vlerësuese ose mbi konfliktin e interesit në mënyrë që të zvogëlohen rreziqet në prokurimin publik. KLSH-ja ka vlerësuar se humbjet financiare në buxhetin e shtetit nga

parregullsitë në prokurimin publik arrijnë vlerën e 18.8 milion Euro në vitin 2015, ose 2% të dëmit të përgjithshëm ekonomik të vlerësuar, pothuajse trefishi krahasuar me 4.8 milion Euro të llogaritura për vitin 2014.

Baza ligjore mbi zhdëmtimet

E drejta për zhdëmtim parashikohet në Kushtetutë dhe në ligjin e prokurimit publik. Kjo e drejtë është në përputhje të gjerë me Direktivën e Mjeteve Ligjore efektive. Dispozitat që përfshijnë pa-efektshmërinë e kontratave, dënimet alternative dhe njoftimet *ex ante* vullnetare të transparencës nuk janë mbuluar ende.

Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) kryen rishikimin administrativ të tenderëve publike dhe shumica e vendimeve të tij janë korrigjuese dhe mund të kundërshtohen në Gjykatën Administrative. KPP-ja ka 5 anëtarë dhe 16 staf profesional dhe administrativ. Është miratuar rekrutimi i tre punonjësve të tjerë. Pavarësia institucionale e KPP-së, si institucion nën varësinë e qeverisë, nuk është garantuar plotësisht në përputhje me *acquis*.

Në vitin 2015, KPP-ja ka marrë 1 124 ankesa, nga 834 në vitin 2014 e që korrespondon me 24.27% të prokurimeve publike të publikuara. Rreth 1 111 e ankesave lidhen me prokurimin publik, 10 me ankandet dhe 3 me koncesionet. 564 kërkesa janë konsideruar të pabaza dhe 560 janë pranuar. Shumica e ankesave lidhen me kërkesa të vlerës së vogël për procedurat e prokurimeve dhe rreth 60% e rasteve kanë të bëjnë me shërbimet e sigurisë. 49 vendime të KPP-së janë kundërshtuar në Gjykatën Administrative, nga të cilat 41 janë pranuar. Përpunimi në kohë i ankesave është sfidë. Krijimi i një baze të dhënash elektronike për gjykimet e KPP-së do të përmirësonte transparencën e sistemit të rishikimit.

Megjithëse procedura e zhdëmtimeve me mjete ligjore është e përcaktuar gjerësisht, kapaciteti i KPP-së gje Gjykatës Administrative, për të trajtuar një numër kompleks dhe në rritje të ankesave për prokurimin, duhet të rritet ndjeshëm. Rekomandohet të organizohen kurset të përbashkëta trajnimi të specializuar mbi tematika që lidhen me prokurimin publik.

4.6. Kapitulli 6: E drejta e shoqërive tregtare

BE ka rregulla të përbashkëta në lidhje me kërkesat për formimin, regjistrimin dhe dhënien e informacioneve shpjeguese të një shoqërie tregtare, me rregulla plotësuese për kontabilitetin dhe raportimin financiar, si dhe auditin ligjor.

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e së drejtës së shoqërive tregtare. Janë bërë **disa përparime** marrjen e masave për të forcuar kapacitetet dhe pavarësinë e Bordit të Mbikëqyrjes publike, rekomandim kyç i BE-së në raportin e vitit 2015, dhe gjithashtu, me krijimin e sistemit për regjistrimin elektronik. Vitin e ardhshëm, vendi duhet, në veçanti:

→ të vijojë punën për përafrimin me legjislacionin e BE-së mbi raportimin financiar dhe të garantojë transparencë të plotë të deklaratave financiare të shoqërive tregtare në regjistrin e biznesit.

Në fushën e të drejtës së shoqërive tregtare, në nëntor, u miratua ligji për Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB). QKB-ja filloi veprimtarinë në prill, duke lëshuar licence, autorizime dhe leje si dhe me regjistrimin e bizneseve në regjistrin tregtar, të miratuar në

tetor. Regjistri funksionon si bazë të dhënash shtetërore. Shërbimi i aplikimeve elektronike u vendos në punë në tetor dhe regjistrimi mundësohet përmes portalit elektronik.

Në fushën e **kontabilitetit**, janë miratuar në shtator standardet kombëtare të kontabilitetit për OJQ-të, të cilat ën janar u bënë detyruese. Versioni i konsoliduar i standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit të vitit 2015 në gjuhën shqipe u publikua në prill, në faqen e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit. Kompanitë duhet të dorëzojnë një set të vetëm të deklaratave financiare vetëm (p.sh. versioni i miratuar në kohë) në regjistrin kombëtar të biznesit, por nuk është rregulluar dorëzimi i deklaratave financiare tek subjekte të tjera nga administrate tatimore. Aksesit i publikut në deklaratat financiare të kompanive është përmirësuar me krijimin e regjistrit tregtar, gjithsesi, ai duhet të përditësohet rregullisht.

Në fushën e auditimit, në prill, parlamenti miratoi ndryshimet në ligjin për auditin ligjor, me qëllim forcimin e pavarësisë dhe kapacitetit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike. Ndryshimet e bëra çuan shndërrimin e Bordit në një strukturë të përhershme me burimet e saj financiare.

4.7. Kapitulli 7: E drejta e pronësisë intelektuale

BE ka harmonizuar rregullat për mbrojtjen ligjore të drejtave të pronësisë intelektuale (DPI) si dhe rregullat për mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe të drejtave të ngjashme me të. Rregullat për mbrojtjen ligjore të drejtave intelektuale përfshijnë, për shembull, patentat dhe markat, planet, shpikjet bio-teknologjike dhe barnat farmaceutik. Rregullat për mbrojtjen ligjore të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të ngjashme me të përfshijnë, për shembull, lirën, filmat, programet kompjuterike dhe transmetimet.

Shqipëria **ka arritur një farë niveli përgatitje** në fushën e të drejtave të pronësisë intelektuale. Vitin e kaluar janë bërë **disa përparime** me miratimin e ligjit tëri të të drejtave të autorit, me miratimin e Strategjisë së Pronësisë Intelektuale si dhe me vijimin e punimeve për ngritjen e Inspektoriatit të Mbikëqyrjes së Tregut të Brendshëm. Vitin e ardhshëm Shqipëria duhet në veçanti:

→të garantojë zbatimin efikas të ligjit të ri për të drejtën e autorit;

→të përmirësojë funksionimin e Agjencive Kolektive të së Drejtës së Autorit dhe pagesën e “royalty” tek titullarët e së drejtës.

Në fushën e **pronësisë intelektuale dhe të drejtave të ngjashme me të**, në maj, parlamenti miratoi ligjin e ri për mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe të drejtave të ngjashme me të, me qëllim përafrimin e plotë me 7 direktiva të BE-së dhe të pjesëshëm me vetëm 2 prej tyre.

Në fushën e **pronësisë industriale**, janë përgatitur dhe janë në fazën e konsultimit ndryshime të reja në ligjin për pronësinë industriale të vitit 2008. Më 20 korrik u miratua strategjia e pronësisë intelektuale 2016-2020.

Për sa i përket **shkallës së zbatimit**, Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave (DPPM) ka nënshkruar marrëveshje me Organizatën Botërore të së Drejtave të Autorit, Zyrën Evropiane të Patentave dhe Zyrën Evropiane të Pronësisë Intelektuale. Bashkëpunimi i saj me institucione të tjera është forcuar, ndërsa kapacitetet e saj janë rritur me 24 punonjës dhe 6 ekspertë. Si rezultat i aktiviteteve ndërgjegjësuere të organizuara nga Drejtoria e Përgjithshme

e Patentave dhe Markave, që prej shtatorit të vitit 2015, numri i aplikimeve për të regjistruar markat është rritur me 24.8% krahasuar me të njëjtën periudhë të 2014- 2015. DPPM-ja ka marrë pjesë në 24 çështje gjyqësore. Procedimet penale për shkelje të të drejtave të pronësisë kanë filluar kundrejt 97 subjekteve, ku 114 persona janë përndjekur penalisht dhe 23 shkelës janë dënuar.

Inspektoriati i sapo ngritur i Mbikëqyrjes së Tregut është kompetent për inspektimin, kontrollin dhe zbatimin e të drejtës së autorit dhe të drejtave të ngjashme. Ndryshimet në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale mbi shkeljet e DPI kanë mbetur pezull. Ka nevojë nxitëse për trajnimin e gjykatësve në këtë fushë dhe për të sqaruar kompetencat e gjykatës në lidhje me rastet që kanë të bëjnë me DPI. Numri i produkteve të falsifikuara në vend mbetet i lartë.

4.8. Kapitulli 8: Politika e konkurrencës

Rregullat e BE-së mbrojnë konkurrencën e lirë. Ato përfshijnë rregullat antikartel kundër marrëveshjeve kufizuese ndërmjet kompanive dhe abuzimit me pozitën dominuese. Rregullat e BE-së u ndalojnë gjithashtu qeverive dhënien e ndihmës shtetërore e cila shtrembëron konkurrencën.

Shqipëria ka arritur **një farë niveli përgatitjeje/ është mesatarisht e përgatitur** në fushën e politikës së konkurrencës. Janë bërë **disa përpertime** në përafrimin ligjor në të gjitha fushat. Gjithsesi, nevojiten përpjekje të mëdha për të përmirësuar përafrimin ligjor dhe zbatimin e tij në fushën e ndihmës shtetërore.

Vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet, në veçanti:

→ të rrisë pavarësinë operacionale të Komisionit të Ndihmës Shtetërore dhe të forcojë kapacitetet e Njësisë së Ndihmës Shtetërore.

→ Të përmirësojë rekordet e saj të zbatimit në fushën e kontrollit të ndihmës shtetërore.

Antikartel dhe bashkimet

Kuadri legjislativ është gjerësisht në pajtim me *acquis* dhe dispozitat e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Ligji për mbrojtjen e konkurrencës është gjerësisht në përputhje me nenin 101 mbi ndryshimet respektive dhe nenin 102 mbi abuzimet e qëndrimit dominues të TFEU. Gjithashtu, ai parashikon kontrolle *ex ante* të bashkimeve, në përputhje me Rregulloren e BE-së mbi Bashkimet. Legjislacioni dytësor parashikon rregulla të tjera thelbësore dhe udhëzime mbi mënyrën se si duhet të aplikohen rregullat e konkurrencës, është gjerësisht në përputhje me rregulloret përkatëse të BE-së dhe udhëzuesit e Komisionit.

Për saka të bëjë me **kuadrin institucional**, Autoriteti shqiptar i Konkurrencës (AK) është përgjegjës për zbatimin e ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Formalisht, ai është një organ që vepron i pavarur e që raporton në kuvend. Kryetari dhe katër anëtarët e bordit të saj emërohen nga kuvendi. AK-ja ka fuqitë e nevojshme investigative, të ngjashme me ato të Komisionit Evropian. Ai ka pushtetin që të miratojë legjislacion dytësor. AK-ja mund të vendosë gjoba dhe të zhëmbtojë nëse shkelen rregullat e konkurrimit dhe mund të autorizojë bashkimet, me

ose pa kushte, ose dhe ti ndalojë ato. Ai mund të kryejë hetime në sektor dhe të japë mendimet e veta mbi iniciativat dhe rekomandimet për projektligjet që mund të ndikojnë konkurrencën. Një program lehtësues për kompanitë që ofrojnë informacion mbi rastet e kartelit është gati. Palët mund të apelojnë vendimet e AK-së në gjykatë.

Për sa i përket **kapacitetit të zbatimit**, AK ka 36 anëtarë të stafit, përfshirë pesë komisionerë. Kjo është e mjaftueshme, por niveli i ekspertizës duhet të forcohet. Në lidhje me **zbatimin**, numri i vendimeve të AK-së ka shënuar rritje të lehtë gjatë periudhës 2013-2015, ku rreth gjashtë vendime për marrëveshjet e ndaluara dhe tre për abuzimet e dominimit janë miratuar në vitin 2015. Gjatë kësaj periudhe, zbatimi efektiv ka mbetur modest. Të gjitha vendimet për bashkimet ishin pozitive. AK-ja mori vetëm katër vendime, duke vendosur gjoba në vitin 2013 dhe 2014, dhe asnjë në vitin 2015. Gjambat janë të ulëta (një total prej 45 000 Euro gjatë periudhës 2013-2015). Programi i lehtësimit, në fuqi që prej vitit 2009, ende nuk është përdorur. Vonesat në procedurat gjyqësore që vijnë nga numri i kufizuar i gjyqtarëve të specializuar mbetet shqetësuese.

Ndihma shtetërore

Kuadri legjislativ është gjerësisht në pajtim me *acquis* dhe me dispozitat e MSA-së. Ligji për ndihmën shtetërore reflekton kryesisht nenet 107 e 108 të TFEU në lidhje me përkufizimin e pajtueshmërisë ose papajtueshmërisë për ndihmë shtetërore, si dhe procedurat. Ligji i ndryshuar në mars hyri në fuqi në prill dhe është përafëruar me *teq* me *acquis*, veçanërisht në ndihmën për shërbimet me interes të përgjithshëm ekonomik, ndihmës *de minimis* dhe kategoritë e tjera të ndihmës horizontale. Nevojitet përafërim i mëtejshëm me legjislacionin dytësor të BE-së për kontrollin e ndihmës shtetërore.

Për sa i përket **kuadrit institucional**, Komisioni i Ndihmës Shtetërore (KNSH) është përgjegjës për zbatimin e ligjit për ndihmën shtetërore. Njësia e Ndihmës Shtetërore, në departamentin e brendshëm të tregut të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes, shërben si sekretariat teknik i KNSH-së. KNSH-ja përbëhet nga katër nëpunës civilë dhe kryesohet nga ministri përgjegjës për çështjet ekonomike për një mandat katërvjeçar. KNSH-ja nuk mund të konsiderohet si një autoritet që vepron i pavarur, siç parashikohet në MSA.

Ligji për ndihmën shtetërore parashikon që masat e reja të ndihmës duhet t'i njoftohen KNSH-së dhe të shqyrtohet pajtueshmëria përpara se të aplikohen. KNSH-ja mund të urdhërojë rikuperim të ndihmës së papajtueshme, të dhënë në mënyrë të paligjshme. Vendimet e tij mund të bëhet ankim në gjykatë.

Me vetëm dy ekspertë në Njësinë e Ndihmës Shtetërore, **kapacitetet zbatuese** të KNSH-së dhe Njesisë së Ndihmës Shtetërore janë të pamjaftueshme dhe duhet të forcohet. Efektiviteti i **zbatimit** të ligjit për ndihmën shtetërore mbetet për t'u demonstruar. KNSH-ja ka miratuar disa vendime: nëntë në vitin 2015 (tre prej të cilëve janë bazuar në hetimet e ndërmarra me iniciativën e vet), dhe shtatë në vitin 2014 (dy ishin nismë e saj). Nuk ka pasur raste të vendimeve negative ose të kushtëzuar, apo të vendimeve që urdhërojnë rikuperimin e ndihmës së paligjshme. Inventar i skemave ekzistuese të ndihmës në Shqipëri daton që prej vitit 2008. Shqipëria deklaroi se të gjitha skemat në inventar kanë qenë në përputhje me *acquis*. Programi i trajnimit për të përmirësuar ndërgjegjësimin rreth rregullave të ndihmës shtetërore

në nivelin e qeverisjes vendore duhet të zbatohet. Duhet të forcohet përkrahje për të siguruar njoftime *ex ante* të masave për ndihmën në KNSH.

Liberalizimi

Ligji për mbrojtjen e konkurrencës dhe ligji për ndihmën shtetërore gjejnë zbatim për sipërmarrjet publike dhe sipërmarrjet me të drejta të veçanta ose ekskluzive, përveç rasteve kur zbatimi i tyre pengon kryerjen e detyrave të caktuara të shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik që u janë caktuar atyre.

Në vitin 2015, AK-ja ka kryer vlerësime *ex post* të për të drejtat e veçanta dhe ekskluzive, duke pasur parasysh mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg. Si rezultat i shqyrtimit dhe vlerësimit të të gjitha kontratave koncesionare, AK-ja njoftoi se procedura e konsultimit para dhënies së koncesioneve, siç përcaktohet në ligjin e konkurrencës nuk është respektuar në përgjithësi. Në tetor të vitit 2015, AK-ja ka nxjerrë një vendim që parashikon nevojën për të marrë vlerësimin e tij paraprak në rastet e dhënies së të drejtave ekskluzive ose të veçanta përmes kontratave koncesionare. Për sa i përket rregullave për financimin e shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik, zbatimi i tyre duhet të tregohet më tej.

4.9. Kapitulli 9: Shërbimet financiare

Rregullat e BE-së synojnë sigurimin e konkurrencës së drejtë ndërmjet institucioneve financiare dhe stabilitetin e tyre, konkretisht në sektorin bankar, sigurimet, pensionet suplementare, shërbimet e investimit dhe tregjet e letrave me vlerë.

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e shërbimeve financiare. Janë bërë **disa përparime** në këtë fushë. Janë miratuar rregulloret që lidhen me administrimin e rrezikut të kredisë dhe raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit. U plotësua struktura e bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Në vitet në vijim, Shqipëria duhet:

→ të përshpejtojë përgatitjet për zbatimin e Basel III;

→ të bëjë progres të mëtjshëm, me miratimin dhe zbatimin e ligjit për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit.

Në fushën e **bankave dhe konglomerateve financiare**, është miratuar rregullorja për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit, për të mundësuar shtrirjen deri në fund të 2016-ës të masave makro-prudenciale për përmirësimin e klimës së kreditimit. Si pjesë e planit kombëtar të veprimit për kreditë me probleme, janë ndryshuar procedurat për fshirjen nga bilanci i bankave si dhe kushtet rregullative për pronat e lëna peng. Niveli i kredive me probleme mbetet i lartë, në mbi 20% të totalit të kredive, ndërkohë që ka përparuar zbatimi i planit të veprimit në këtë fushë. Në shtator, Shqipëria u përfshi në rekomandimet e Autoritetit Evropian Bankar për ekuivalencën e regjimit të konfidencialitetit.

Në **sektorin jo-bankar**, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) vendosi të rrisë numrin e punonjësve nga 59 që është aktualisht në 97 brenda vitit 2019.

Në fushën e **sigurimeve dhe pensioneve**, AMF-ja miratoi disa rregulllore që lidhen me aktivitetin e ri-sigurimit dhe disa rregulllore e procedura të tjera për menaxhimin, monitorimin dhe raportimin në AMF. Ajo miratoi dhe kodin e etikës së aktuarëve. Përfundoi me sukses

privatizimi i kompanisë së sigurimeve shtetërore INSIG.

Për sa i përket **infrastrukturës së tregut financiar**, nuk pati progres në lidhje me ri-hapjen e bursës së Tiranës. Legjislacioni që garanton funksionimin e bursës është në fuqi, por legjislacioni i kontabilitetit nuk është ende në përputhje me të gjithë standardet ndërkombëtare përkatëse.

Për sa i përket **tregjeve të letrave me vlerë dhe shërbimeve të investimit**, janë miratuar ndryshimet në ligjin për sipërmarrjet e investimeve kolektive. Ka një mungesë të kulturës së investimit në letra me vlerë dhe të produkteve alternative të investimit në Shqipëri.

4.10. Kapitulli 10: Shoqëria e Informacionit dhe Media

BE mbështet funksionimin e mirë të tregut të brendshëm për komunikimet elektronike, tregtinë elektronike dhe shërbimet audiovizive. Rregullat mbrojnë konsumatorët dhe mbështesin disponueshmërinë universale të shërbimeve modern.

Shqipëria **është mesatarisht e përgatitur** në fushën e shoqërisë së informacionit dhe medias audiovizive. Janë bërë **disa përparime** vitin e kaluar në drejtim të konsolidimit të shoqërisë së informacionit ndërsa nuk ka patur asnjë progres në fushën e medias audiovizive. Kapacitetet e AKEP (Agjencia e Komunikimeve Elektronike dhe Postare) dhe Agjencisë Kombëtare të Teknologjisë së Informacionit janë përmirësuar ndërsa zbatimimi i agjendës digjitale dhe planit kombëtar broadband ka vijuar më tej. Shqipëria nuk përfunduar kalimin nga transmetimi analog në atë numerik dhe ka shënuar regres në drejtim të konsolidimit të pluralizmit në media. Vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet në veçanti:

→të finalizojë procesin e vonuar të kalimit në transmetim digjital;

→të vijojë me autorizimet për lejimin e shfrytëzimit të dividendit digjital për shërbimet broadband;

→të përfundojë dhe miratojë statutin e brendshëm të RTSH-së si çështje me rëndësi emergjente.

Në fushën e tregut të **komunikimeve elektronike, dhe teknologjive të informacionit dhe komunikimit**, Agjencia e Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) ka bërë progres të mëtjshëm në drejtim të zbatimit të planit të shfrytëzimit të frekuencave, ndër të tjera duke siguruar më shumë frekuenca në dispozicion për operatorët. Kapaciteti administrativ i AKEP është përmirësuar me shtimin e burimeve financiare dhe njerëzore. Që prej shkurtit, numri evropian i emergjencave 112 është funksional në të gjithë Tiranën dhe po shtrihet me shpejtësi edhe në qytetet e tjera. Duhet të trajtohen shqetësimet rreth qëndrueshmërisë financiare dhe institucionale të projektit për numrin 112.

Përdorimi i aparateve celulare mbetet i lartë me penetrim abonimi në shkallën 120% deri në fund të vitit 2015. Përdorimi i shërbimeve të telefonisë fikse kanë vazhduar me trendin zbritës gjatë viteve të fundit. Aksesimi në shërbimet e telefonisë fikse është rritur në masën 9% të mbulimit të të gjithë popullatës. Janë bërë përpjekje të mëdha të reformave për zbatimin e Direktivës 2014/61/KE mbi masat për reduktimin e kostos së vendosjes së rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë.

Në fushën e **shoqërisë së informacionit**, zbatimi i agjendës digjitale 2015-2020 si dhe i planit broadband ka vijuar. Një dokument i politikave për krimin kibernetikë 2015-2017 është miratuar në dhjetor, me qëllim plotësimin e kuadrit legjislativ për këtë fushë. Një ligj i ri për identifikimin e shërbimeve elektronike të sigurta është miratuar në tetor. Ndryshimet në ligjin për tregtinë elektronike sugjerojnë përafrim të mëtëjshëm me acquis. Numri i shërbimeve elektronike të qeverisë, të ofruara përmes portalit e-Albania është rritur, si dhe numri i përdoruesve dhe pagesave elektronike të kryera. Kapacitetet administrative i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit janë forcuar me 20 punonjës.

Në fushën e **politikave audiovizuale**, pas kërkesave për rishikim të operatorëve tregtarë, Gjykata Kushtetuese shfuqizoi kufizimet e pronësisë në rregulloren e AMA-së (*Shih edhe seksionin 2.4*). Është bërë progres i ngadaltë në zbatimin e strategjisë për të kaluar në transmetimin digjital. Një gjykatë administrative dha një vendim që Autoriteti i Medias Audiovizive (AMA) për paligjshmërinë e dhënies së licencave digjitale për operatorët e tregut. Kjo situatë ka ngritur dyshime për shkallën e pluralizmit në fushën e medias. Procesi i vendimmarrjes së AMA-s është ndikuar nga një mangësi kuorumi për disa muaj për shkak të mungesës së anëtarëve të opozitës. AMA ka lancuar një fushatë informimi publik lidhur me kalimin në transmetimin digjital. Operatori publik RTSH ka bërë përparime në ndërtimin e rrjeteve digjitale. Procesi duhet përshpejtuar për të garantuar host-in e programeve të RTSH-së dhe të operatorëve lokal në këto rrjete. Sistemi i mbledhjes së taksave nga RTSH-ja është përgjithësisht i qëndrueshëm, dhe zë pothuajse gjysmën e buxhetit të RTSH-së. Formula e re e për zgjedhjes së drejtorit të RTSH-së, e parashikuar në ndryshimet në ligj kanë shkaktuar kundërshti mbi aftësinë e saj për të garantuar një figurë politikisht kosnensuale. Nevojiten përpjekje të mëdha për të transformuar RTSH-në në televizion publik të qëndrueshëm, të pavarur dhe të besueshëm. RTSH-ja duhet të përfundojë dhe miratojë statutin e saj të brendshëm si çështje emergjente.

4.11. Kapitulli 11: Bujqësia dhe Zhvillimi rural

Politika e Përbashkët Bujqësore mbështet fermerët dhe zhvillimin rural. Kjo kërkon një sistem menaxhimi dhe kontrolli të fortë. Gjithashtu ka edhe rregulla të përbashkëta të Bashkimit Evropian mbi politikën e cilësisë dhe bujqësisë organike.

Përgatitjet janë **në fazë fillestare** në bujqësi dhe zhvillimin rural. **Ka pasur progres** të mirë në forcimin e kapaciteteve të Agjencisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Zyrtarit të Lartë Autorizues dhe Fondit Kombëtar në përpjekjet për t'i ngarkuar detyra që lidhen me zbatimin e buxhetit në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Para-Anëtarësimit për Zhvillim Rural (IPARD). Paketa e IPARD për zbatimin e buxhetit është finalizuar dhe dorëzuar në Komisionin Evropian më datë 20/09/2016 dhe aktualisht është nën shqyrtim.

Vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet në veçanti:

→ të fillojë zbatimin e IPARD;

→ të intensifikojë përpjekjet për të ngritur një regjistër të fermës funksional dhe të konsolidojë regjistrin e kafshëve (si pjesë përbërëse e sistemit të tij të integruar të administrimit dhe kontrollit).

Për sa i përket **çështjeve të përgjithshme të bujqësisë**, qeveria ka rritur mbështetjen e saj direkte si dhe skemat e investimeve kombëtare në bujqësi dhe agro-përpunim, gjithsej 14,7 milionë euro në vitin 2016⁵. Përgjegjësitë mbi statistikën bujqësore janë transferuar në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, por rezultatet e Census të vitit 2012 ende nuk janë publikuar. Në përgjithësi, duhet të forcohen kapacitetet administrative në fushat e: bashkërendimit të punës të integritit në BE për sektorin, duke përfshirë këtu: koordinimin dhe menaxhimin e projekteve; analizën ligjore dhe përafrimit; analizën e politikave dhe analizat e përgjithshme ekonomike; monitorimin dhe vlerësimin; si dhe shërbimet këshilluese.

Për fushën e **organizimit të përbashkët të tregut**, legjislacioni zbatues për ligjin e ri të vajit të ullirit është miratuar. Standardet që lidhen me marketingun e produkteve bujqësore janë nën përgatitje.

Për sa i përket **Zhvillimit Rural**, në mars u ratifikua Marrëveshja Sektoriale për menaxhimin dhe zbatimin e asistencës financiare të BE-së nën IPARD. Komiteti Monitorues për IPARD II është ngritur dhe takimi i parë është mbajtur në muajin maj. Kapacitetet për menaxhimin e decentralizuar të IPARD II në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, Zyrtarit të Lartë Autorizues dhe Fondit Kombëtar janë forcuar në përputhje me kërkesat për dhënien e besimit me detyrat e zbatimit të buxhetit. Vendet vakante të mbetura në strukturat IPARD pritet të plotësohen në vijim. Strategjia e konsolidimit të tokës është miratuar. Kapacitetet administrative në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave duhet të forcohet.

Për **politikën e cilësisë**, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave ka punuar për legjislacionin për treguesit gjeografike si dhe në draft legjislacionin për skemat e cilësisë për ligjin e ndryshuar për të drejtat e pronësisë industriale.

Për **bujqësinë organike**, kanë vazhduar dhënia e mbështetjes përmes skemave direkte dhe trajnimeve mbi prodhimin organik. Ligji për bujqësinë organike është miratuar në tetor të vitit 2016.

4.12. Kapitulli 12: Politika e sigurisë ushqimore, veterinarë dhe fitosanitare

Rregullat e higjienës së BE-së për prodhimin e produkteve ushqimore sigurojnë një nivel të lartë të sigurisë ushqimore. Shëndeti dhe mirëqenia e kafshëve dhe siguria e ushqimit me origjinë shtazore mbrohen së bashku në mënyrë të integruar me cilësinë e farës, produktet e mbrojtjes së bimëve, organizmat e dëmshëm dhe të ushqyerit e kafshëve.

Shqipëria ka arritur **njëfarë niveli përgatitje** në politikën e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe fitosanitetit. Janë bërë disa përparime në vitet e kaluara. Në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet në veçanti:

→ të trajtojë stafin dhe përmirësojë koordinimin ndërmjet institucioneve përkatëse, me synim forcimin e kapaciteteve për të përafruar legjislacionin e BE-së në këtë fushë;

⁵Skemat mbështetëse direkte kombëtare për prodhimin nuk janë në përputhje me parimin e skemave për pagesa direkte të ndara nga prodhimi sipas PPB.

→ të miratojë strategjinë për ristrukturimin e sektorit;

→ të zbatojë rregullat e sigurisë ushqimore, duke përfshirë kontrollet zyrtare, kushtet e importit dhe kërkesat e kontrollit për gjurmueshmërinë e ushqimit dhe ushqimeve të kafshëve dhe niveleve maksimale të mbetjeve të pesticideve.

Në **përgjithësi për fushën e sigurisë ushqimore**, procedurat e brendshme administrative të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit janë miratuar nga bordet e menaxhimit, por procedurat operacionale ende nuk janë miratuar. Një plan inspektimi vjetor bazuar në risk për vitin 2016 është miratuar në janar. Kapacitetet për menaxhimin e situatës në vijim të njoftimeve të RASFF janë ngritur. Nuk ka përparim në vlerësimin e riskut. Komiteti Shkencor dhe Panelet nuk janë mbledhur, për shkak edhe të mungesës buxhetore. Bashkëpunimi me institucionet e tjera të përfshira në menaxhimin e riskut mbetet i dobët.

Në fushën e **politikave veterinarë**, 2 fushata të tjera vaksinimi në masë kundër tërbimit të dhelprave të kuqe dhe të vaksinimit për zëvendësimin e kafshëve kundër brucelozës në bagëtitë e imta janë kryer me rezultate të kënaqshme. Janë bërë përpjekje për të reformuar shërbimin veterinar në përputhje me organizimin e ri territorial-administrativ dhe për ta bërë atë më efektivë. Megjithatë, ritmi i reformave është i ngadalshëm dhe shërbimi mbetet i fragmentuar dhe me personel të pamjaftueshëm. Identifikimi i kafshëve dhe regjistrimi ka vazhduar, por bazat e të dhënave të kafshëve dhe raportimit për sëmundje shoqërohen nga të dhëna të pamjaftueshme apo të pasakta në terren. Menaxhimi i mbetjeve të kafshëve mbetet një problem kritik për shkak të rrezikut të lartë të përhapjes së sëmundjeve.

Në lidhje me **hedhjen në treg të ushqimit, ushqimit të kafshëve dhe nën-produkteve shtazore**, është aprovuar plani i inspektimeve për vitin 2016, bazuar dhe në regjistrin e stabilimenteve ushqimore (AKUnet). Janë aprovuar programet vjetore të monitorimit të mbetjeve për substanca të padëshiruara si medikamentet veterinarë, bio-toksinat dhe metalet e rënda janë duke u zbatuar në bagëtitë e imta, derra, vezë, qumësht, mjaltë dhe peshk. Megjithatë, nuk janë ngritur ende kapacitetet për të monitoruar mbetjet e pesticideve në produktet me origjinë bimore.

Për sa i përket **rregullave të sigurisë ushqimore** ka filluar puna në transpozimin e Rregullores së BE-së për dhënien e informacionit mbi ushqimin për konsumatorët për vitin 2017. Nuk ka përmirësime në monitorimin mikrobiologjik të qumështit të papërpunuar, e cila ende nuk është kryer në përputhje me metodologjinë e kërkuar. Në vitin 2015, numri i mostrave të marra ka qenë shumë më i ulët se sa në vitin 2014.

Nuk janë ndërmarrë masa për të përditësuar dhe përmirësuar legjislacionin mbi **rregullat specifike për ushqimin e kafshëve**.

Në fushën e **politikave fitosanitare**, është adoptuar Ligji i ri i Mbrojtjes së Bimëve në tetor 2016. Stafit që merret me çështjet fitosanitare është nën Drejtorinë e Sigurisë Ushqimore.

Nuk ka progres në përgatitjen e legjislacionit në lidhje me organizmat e modifikuar gjenetiksht(OMGJ).

4.13. Kapitulli 13 Peshkimi

Politikat e përbashkëta të peshkimit mbrojnë burimet e gjalla detare dhe kufizojnë ndikimin mjedisor të peshkimit. Kjo përfshin kuotat e kapjes së zënies së peshkut, menaxhimin e kapaciteteve të flotës, rregullat për akuakulturën, si dhe mbështetje për peshkimin dhe komunitetet bregdetare.

Përgatitjet në fushën e peshkimit janë në **fazë fillestare**. Gjatë vitit të kaluar **nuk ka patur progres** në këtë fushë.

Në vitin në vazhdim, Shqipëria në veçanti duhet:

→ të përafrojë legjislacionin dhe procedurat me rregullat e BE-së mbi tregjet e peshkimit; të zbatojë strategjinë e sektorit;

→ të fuqizojë kapacitetet institucionale dhe administrative për të siguruar menaxhimin e duhur të burimeve peshkore dhe zbatimin e rregulloreve.

Burimet dhe menaxhimi i flotës vazhdon të jetë në vështirësi për shkak të mungesës së ndarjes së qartë të detyrave dhe përgjegjësiive, koordinimit institucional dhe kapacitetit. Regjistri i anijeve nuk është përditësuar në mënyrë të vazhdueshme. Statistikat e zënies së peshkut mbeten të pasakta. Ligji për akuakulturën është adoptuar në tetor 2016.

Kapacitet e inspektimit dhe kontrollit janë të pamjaftueshme. Drejtoria për Shërbimet e Peshkimit dhe Akuakulturën ka mungesa në drejtim të një stafi të kualifikuar mjaftueshëm për të kontrolluar dhe eliminuar peshkimin e paligjshëm. Numri i inspektorëve ka rënë nga 24 në vitin 2013 në 18 në vitin 2015. Ka pasur përpjekje në lidhje me inspektimet që kryhen në koordinim me organe të tjera si Roja Bregdetare dhe Policia e Shtetit. Megjithatë, operacione të tilla të përbashkëta kryhen në baza ad hoc nëpërmjet Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare dhe jo në bazë të një strategjie inspektimi të bazuar në risk. Nuk është gjetur një zgjidhje afatgjatë për të siguruar funksionimin e vazhdueshëm të Sistemit të Monitorimit të Anijeve, i cili nuk është plotësisht operacional gjatë gjithë vitit dhe nuk mund të gjurmohet të gjitha anijet.

Në lidhje me mbështetjen shtetërore, mbështetja direkte e qeverisë për akuakulturën vazhdoi edhe gjatë vitit 2016. Mbështetja ishte subvencionimi deri në 25 % të shpenzimeve operative (të tilla si rasate dhe ushqim), subvencionimi deri në 70% i normës së interesit apo bashkëfinancimi prej 50% i kostove të investimit.

Përsa i përket **marrëveshjeve ndërkombëtare**, Shqipëria ka filluar procedurat për nënshkrimin e marrëveshjes mbi masat portuale për të parandaluar, penguar dhe eliminuar peshkimin e paligjshëm, të pa-raportuar dhe të parregulluar.

4.14. Kapitulli 14: Politika e transportit

Bashkimi Evropian ka rregulla të përbashkëta për standardet teknike e të sigurisë, sigurinë, standardet sociale, ndihmën shtetërore dhe liberalizimin e tregut në transportin rrugor, transportin hekurudhor, rrugët ujore, transportin e kombinuar, aviacionin dhe transportin detar.

Shqipëria ka njëfarë niveli të përgatitjes në fushën e politikave të transportit. Ajo ka bërë **progres të mirë** vitin e kaluar me miratimin e legjislacionit, përgatitjen e dokumenteve strategjike dhe ndërtimin e kapaciteteve. Megjithatë, më shumë punë është e nevojshme për forcimin e kapaciteteve administrative për transportin hekurudhor dhe transportin detar. Përveç adresimit të këtyre mangësive, në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet të vazhdojë të përparojë në mënyrë të veçantë në:

→ miratimin e kodit të ri hekurudhor dhe zbatimin e legjislacionit për reformën e sektorit hekurudhor;

→ përgatitjen e plotë për vlerësimin e zbatueshmërisë së marrëveshjes “Zona e Përbashkët Evropiane e Aviacionit” (faza e parë kalimtare).

Për sa i përket **acquis së përgjithshme të transportit**, Strategjia Kombëtare e Transportit 2016-2020 dhe plani i veprimit për të gjitha llojet e transportit janë përgatitur, por mbeten për t'u miratuar. Strategjia përfshin një plan për transportin e qëndrueshëm në Shqipëri, i cili synon të përmirësojë kursimin e energjisë në transport dhe të sigurojë një rrjet të qëndrueshëm të transportit. Shqyrtimi i dytë i Planit Kombëtar të Transportit do të fillojë në vitin 2017. Përafrimi i mëtejshëm është i nevojshëm në lidhje me *acquis* për detyrimet e shërbimeve publike, duke përfshirë kontratat e shërbimit publik. Shqipëria nuk ka transpozuar ende legjislacionin për rregullat e orarit veror. Kapacitetet administrative në të gjithë sektorin e transportit duhet të përmirësohen, veçanërisht për transportin detar dhe hekurudhor. Kodi i ri hekurudhor nuk është miratuar ende. Shqipëria ka ngritur Organin Kombëtar për Hetimin e Aksidenteve/Incidentet Ajrore në vitin 2010. Ende nuk janë ngritur organet e pavarura për hetimin e aksidenteve hekurudhore dhe ujore. Burimet e alokuara për mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore janë të pamjaftueshme, duke rezultuar në përkeqësimin e mëtejshëm të shërbimeve të transportit në këta sektorë.

Në **transportin rrugor**, Shqipëria ka bërë përparim të qëndrueshëm në përafrimin e legjislacionit kombëtar me *acquis*. Në vitin 2015, vendi për afro legjislacionin për transportin e mallrave të rrezikshme, licencimin për sipërmarrësit e transportit rrugorë dhe aksesin në tregun e transportit rrugor. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit, ngarkuar me zbatimin e ligjit për mallrat e rrezikshme, duhet të miratojë dhe të zbatojë rregullat për sanksionet dhe forcimin e kapaciteteve të zyrtarëve të inspektimit, për zbatimin e këtij ligji. Përpjekje më të mëdha janë të nevojshme për përafrimin me *acquis* të ligjit për inspektimet e automjeteve tregtare dhe sistemet e menaxhimit të trafikut dhe të sigurisë rrugore. Shqipëria duhet të shtojë përpjekjet për të përfruar legjislacionin me *acquis* e sigurisë dhe për të zhvilluar kapacitetet e zbatimit. Zbatimi i legjislacionit për kontrolle në rrugë të automjeteve tregtare është në fazën fillestare. Legjislacioni për sistemet inteligjente të transportit është pjesërisht në përputhje me *acquis*.

Sa i përket **transportit hekurudhor**, kodi i ri hekurudhor ka për qëllim të rregullojë transportin hekurudhor duke ndarë veprimtarinë e hekurudhave nga menaxhimi i infrastrukturës, në përputhje me *acquis* e BE-së. Kodi hekurudhor transponon Direktivën e ndryshuar që nga fundi i vitit 2015 për “Një Zonë Hekurudhore Evropiane”, të sigurisë së BE-së dhe ndërveprimit. Si rezultat i kësaj, ndarja e veprimtarisë hekurudhore nga menaxhimi i infrastrukturës, procesi i krijimit të një autoriteti të pavarur të sigurisë dhe një autoriteti

rregullator nuk kanë filluar ende. Qeveria i ka dhënë një kompanie private një koncesion për rreth 50 km linjë hekurudhore, i cili përfshin mirëmbajtjen dhe rinovimin e infrastrukturës dhe alokimin e kapaciteteve të ndërmarrjeve të tjera hekurudhore.

Në **transportin detar**, Shqipëria duhet të vazhdojë përpjekjet deri në aplikimin për anëtarësim në “*Memorandumin e Mirëkuptimit të Parisit*” për kontrollin shtetëror portual. Përpjekjet për të përmirësuar kontrollin shtetëror të anijeve nën flamurin shqiptar dhe kontrollin shtetëror portual duhet të vazhdojnë për të reduktuar më tej normën e ndalimit të anijeve shqiptare. Legjislacioni për monitorimin e trafikut të anijeve të komunitetit dhe të sistemit të informacionit ende nuk është transpozuar për shkak të mungesës së fondeve. Shqipëria ka ratifikuar Konventën Detare të Punës në vitin 2015. Shqipëria ishte një nga shtetet e para që ratifikoi “*Protokollin 2002 të Konventës së Athinës*” lidhur me transportin e pasagjerëve dhe bagazheve të tyre me det. Kështu, Protokollin zbatohet në Shqipëri dhe në të gjithë transportin e udhëtarëve nga deti, nga ose drejt porteve shqiptare, si dhe në anijet me flamur shqiptar, që nga hyrja në fuqi në vitin 2014, siç ndodh në të gjitha shtetet anëtare të BE.

Nuk ka **zhvillime të transportin e brendshëm ujqor**. Ky transport është i kufizuar në dy liqene të cilat janë të përbashkëta me vendet fqinje dhe të rregulluara nga marrëveshje dypalëshe.

Në **aviacion**, duke pasur parasysh progresin e bërë në zbatimin e fazës së parë kalimtare të marrëveshjes për “*Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit*”, Shqipëria duhet të përgatitet për vizitën e fundit të vlerësimit pas përmbyshjes së rregulloreve të çështjeve ekonomike dhe menaxhimit të trafikut ajror. Për menaxhimin e trafikut ajror, Shqipëria ka plotësuar angazhimet e “*Qiellit të Vetëm Evropian*” për periudhën e parë transitore. Ajo tani duhet të përqendrojë përpjekjet e saj në fazën e II.

Nuk ka legjislacion kombëtar për **transportin e kombinuar**. Mundësitë për zhvillimin e këtij lloj transporti duhet të rriten më tej, duke e përfshirë në Strategjinë e re Kombëtare të Transportit.

4.15. Kapitulli 15: Energjia

Politika e BE-së për energjinë mbulon konkurrencën dhe ndihmat shtetërore, aksesin e barabartë në burimet, tregun e brendshëm të energjisë, efikasitetin e energjisë, energjinë bërthamore dhe sigurinë bërthamore dhe mbrojtjen nga rrezatimet.

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në këtë fushë. Janë bërë **disa përparime** në sektorin e gazit dhe linjat e interkonjeksionit por, në lidhje me masat e lehta të rena dakord për procesin e Berlinit, vendi ka bërë vetëm pak progres. Aksionet e rekomanduara në raportin e fundit për qëndrueshmërinë ekonomike të sektorit të energjisë elektrike dhe për zbatimin e legjislacionit në sektorin e energjisë mbeten pezull. Përveç kësaj, vitin e ardhshëm, vendi duhet në veçanti:

→ të miratojë planet kombëtare të veprimit për efikasitetin e energjisë dhe legjislacionin dytësor për zbatimin e Direktivës për performancën e energjisë së ndërtesave;

→ të qartësojë ndarjen e kompanive energjetike;

→ të krijojë Bursën e Energjisë në vitin 2017 dhe të fillojë lidhjen me tregjet fqinje.

Në lidhje me **sigurinë e furnizimeve**, Shqipëria është në fazë të hershme përgatitje. Shqipëria ende nuk ka miratuar strategjinë kombëtare për energjinë, e cila duhet të mbulojë zhvillimin e sektorit të energjisë deri në 2030. Legjislacioni kombëtar për rezervat e naftës, nga viti 2004 (ndryshuar në 2007) nuk është në përputhje me Direktivën e BE-së për këtë çështje, por përcakton se rezerva e sigurisë është e barabartë me 90 ditë mesatare shitjeje. Nuk është bërë progres lidhur me ngritjen e organit qendror për rezervat e naftës. Sistemi elektrik I Shqipërisë është ndërlidhur me sistemet fqinje të Greqisë dhe Malit të Zi që prej vitit 2014, kur Rrjeti Evropian I Operatorëve të Sistemit të Transmetimit për energjinë elektrike miratuan veprimet sinkronizuese të sistemit shqiptar të transmetimit të energjisë elektrike me sistemin kontinental evropian. Linja 400 kV e interkonjeksionit mes Shqipërisë dhe Kosovës u përfundua në qershor por nuk është vendosur ende në punë. Kjo linjë është strategjike për balancimin e tregut të energjisë elektrike të dy vendeve dhe për reduktimin e rreziqeve hidrologjike në Shqipëri. Ndërtimi I linjës 400 kV mes Shqipërisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë u miratua në qershor nga Këshilli I Ministrave, por procedura e tenderimit ka mbetur pezull. Centrali elektrik I Vlorës nuk është vendosur ende në punë. Gjithsesi, Shqipëria ka nënshkruar 2 memorandume mirëkuptimi me EON (Gjermani) dhe AXPO (Zvicër) për furnizimet me gaz.

Në fushën e **tregut të brendshëm të energjisë**, Shqipëria ka miratuar legjislacionin kuadër për gazin dhe energjinë elektrike, në përputhje me Paketën e Tretë për Energjinë, të BE-së. Gjithsesi, duke qenë se nuk ka legjislacion dytësor në fuqi dhe me ndarjen e kompanive energjetike shtetërore ende të papërfunduar ose që as nuk ka filluar kompanitë e shpërndarjes, duhet të garantohet përputhshmëria me kërkesat e tregut të brendshëm të energjisë. Për sa I përket gazit, ndarja e Albpetrol është në fazë të hershme. Deri më tani, kompania ende nuk I është nënshtruar madje dhe kërkesave të paketës së dytë për energjinë e brendshme, e për të tretën s' diskutohet.

Në lidhje me operatorët e sistemit të shpërndarjes, ende nuk ka filluar ndarja. Që prej hyrjes në fuqi të ligjit për sektorin e energjisë, në prill 2015, Enti Rregullator I Energjisë (ERE) ka miratuar disa licence. Çmimet e energjisë elektrike janë të rregulluara, por ato duhet të liberalizohen gradualisht sapo të zbatohet legjislacioni kryesor. Liria e konsumatorit për të ndërruar furnizues parashikohet me ligj por ende nuk është mundësuar. Tregu I energjisë elektrike mbetet I bllokuar nga një kontratë e rregulluar mes kompanive shtetërore prodhuese dhe furnizuese, e cila duhet të shuhet me urgjencë. Modeli I ri I tregut, I miratuar nga Kabineti I Ministrave në korrik 2016 I hap rrugën krijimit të një tregu të organizuar.

ERE-ja duhet të shndërrohet në një institucion të pavarur, me kapacitet dhe ekspertizë të mjaftueshme për sfidat e shumta. Duhet të adresohen mangësitë në transpozimin e Paketës së Tretë për Energjinë, duke pasur parasysh kompetencat e rregullatorit.

Në fushën e **hidrokarbureve**, Shqipëria nuk e ka përafuar plotësisht legjislacionin e saj me Direktivën për Licensimin e Hidrokarbureve, por është bërë njëfarë progresi me transpozimin e disa dispozitave të legjislacionit dytësor të kësaj Direktive. Direktiva për sigurinë e operacioneve të naftës dhe gazit në det të hapur nuk është transpozuar. Në korrik, qeveria prezantoi masterplanin “Masterplani i Gazit për Shqipërinë”, që vlerëson nevojat për investime për zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes së gazit deri në 2040. Linja kryesore e

interkonjeksionit për gaz, projekti i Gazsjellësit Trans-Adriatik TAP po ecën sipas programit. Ndërtimi i tij ka filluar pas marrjes së certifikatës nga TAP S.A., në prill, mbi bazën e modelit të operatorit të pavarur të transmisionit, e cila është pjesë përbërëse e Paketës së Tretë të BE-së për Energjinë. Ndërtimi i gazsjellësit Adriatiko-Jonian nuk ka përparuar.

Kuadri rregullator për **energjinë e rinovueshme** është ende në fazë të hershme. Në janar, qeveria miratoi planin e veprimit për burimet e energjisë së rinovueshme (BRE) 2015- 2020, i cili mundësoi mbylljen e procedurës së caktuar të shkeljeve sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Deri në vitin 2020, Shqipëria synon të prodhojë 38% të konsumit të përgjithshëm nga BRE-të. Projektligji për energjinë e rinovueshme nuk është miratuar dhe as nuk ka dalë ndonjë vendim për skemat mbështetëse, ndërkohë që dispozitat për kapacitetin e rrjtit në projektligjin për energjinë e rinovueshme janë ende në diskutim mes disa aptive të interesuara. Si në ministri, edhe në Autoritetin Rregullator, nuk është bërë progress në drejtim të rritjes së kapaciteteve për menaxhimin e BRE-ve. Zbatimi i kriterëve për *bio-fuels* dhe *bio-liquid* sparashikohen në një ligj më vete, i cili mbetet për t'u përfunduar.

Po përgatitet plani kombëtar i veprimit për **efiçencën e energjisë**, i mbështetur nga programi rajonal për efiçencën e energjisë për Ballkanin Perëndimor dhe në përputhje me Direktivën për Efiçencën e Energjisë. Ligji i ri, i miratuar në nëntor 2015, për efiçencën e energjisë, nuk është në përputhje të plotë me *acquis* dhe kërkon rregullore zbatuese dhe ngritjen e organeve të asociuara (Agjencia për Efiçencën e Energjisë dhe Fondi për Efiçencën e Energjisë). Deri në krijimin e tyre, Ministria e Energjisë dhe Industrisë (Drejtoria për Burimet e Energjisë së Rinovueshme dhe Efiçencën e Energjisë) është organi kryesor përgjegjës për çështjet e efiçencës së energjisë, por kapaciteti i saj mbetet i pamjaftueshëm. Është përgatitur një ligj i ri që synon përafrimin me Direktivën për Performancën e Energjisë së Ndërtesave, por nuk është miratuar ende. Duke qenë se afati i fundit për transpozimin ka përfunduar në vitin 2012, Sekretariati për Komunitetin e Energjisë i ka referuar veprimin e shkeljes, në maj, Këshillit Ministror. Për më tepër, një çështje e vitit 2013, me objekt mosmiratimin e planit kombëtar të veprimit për efiçencën e energjisë, është ende e hapur. Nuk është arritur progres në rritjen e kapaciteteve për efiçencën e energjisë dhe zhvillimin e energjisë së rinovueshme.

Nuk është arritur progres në fushën e **energjisë bërthamore, sigurisë bërthamore dhe mbrojtjes nga rrezatimet**. Shqipëria nuk ka asnjë central bërthamor në territorin e saj dhe as nuk planifikon të ketë. Ekziston Agjencia Kombëtare Bërthamore, që ka për qëllim krijimin e një sistemi për të llogaritur kërkesat për energji gjatë 20-30 viteve të ardhshme. Shqipëria ka miratuar disa udhëzime dhe urdhra për politikën dhe hapat strategjike lidhur me menaxhimin e sigurte të mbetjeve radioaktive dhe ka ratifikuar një sërë konventash ndërkombëtare. Shqipëria nuk është anëtare e Shkëmbimit të Informacionit në rast të Emergjencës Radiologjike, e Komunitetit Evropian (ECURIE) Shqipëria ka përafruar pjesërisht me *acquis* legjislaionin për kontrollin e radonit dhe po përgatitet për një plan kombëtar mbi këtë. Detyra e Autoritetit Rregullator Bërthamor në Shqipëri kryhet nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi, me Zyrën për Mbrojtjen nga Rrezatimi (e përbërë nga 10 punonjës), si organ ekzekutiv.

4.16. Kapitulli 16: Tatimet

Rregullat e BE-së për tatimet mbulojnë tatimin mbi vlerën e shtuar dhe detyrimet e akcizës si dhe aspekte të tatimit të korporative. Gjithashtu këto rregulla kanë të bëjë me bashkëpunimin

ndërmjet administratave tatimore, përfshirë shkëmbimin e informacionit për parandalimin e evazionit tatimor.

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e tatimeve. Janë bërë disa përpjekje, veçanërisht për sa i përket përafrimit legjislativ me *acquis* për tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) dhe akcizën. Performanca e të ardhurave në vitin 2015 ka tejkaluar objektivat, kryesisht si rezultat i luftës kundër ekonomisë informale. Vitin e ardhshëm, vendi duhet në veçanti:

→ të miratojë dhe zbatojë një strukturë organizative të përditësuar, duke përfshirë përgjegjësi të përcaktuara qartë brenda administratës tatimore dhe një mekanizëm të pavarur apelimi;

→ të zbatojë fazën e dytë të planit të veprimit kundër ekonomisë informale për të nxitur pajtueshmërinë vullnetare përmes pagimit të taksave.

Në fushën e **tatimit të tërthortë**, ndryshimet në ligjin për TVSH-në u miratuan në tetor të vitit 2015, të cilat lidhen me përjashtimet për makineritë dhe pajisjet e lidhura drejtpërdrejt me investimet. Ligji ende përmban përjashtime të TVSH-së (normat zero), të cilat nuk janë në përputhje me *acquis*. Rimbursimi i TVSH-së tani ndodh gjerësisht brenda afateve ligjore dhe rimbursimet e TVSH-së me rrezikshmëri të ulët përpunohen në mënyrë automatike. Akcizat janë ulur për disa prodhime vendase të birrës, dhe u fut rimbursimi për akcizën e biokarburanteve të importuara. Nevojiten hapa të mëtejshme për të përafruar normat e akcizës me *acquis*.

Në fushën e **tatimit të drejtpërdrejtë**, buxheti dhe paketa fiskale e vitit 2016 solli reduktimin e barrës së taksave për bizneset e vogla.

Për sa i përket **bashkëpunimit administrativ dhe asistencës së ndërsjellë**, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) dhe ajo e Doganave ngritën një njësi të përbashkët risku. DPT-ja merr mbështetje nga FMN-ja për të zbatuar strategjinë e menaxhimit të riskut të pajtueshmërisë, si dhe nga Shtetet e Bashkuara për rishikimet e ligjit dhe mbledhjen e borxhit/e TVSH-së. Shqipëria merr pjesë në programin e BE-së Fiscalis 2020.

Për sa i përket fushës së **kapaciteteve operacionale dhe të kompjuterizimit**, në tetor të vitit 2015 u bë funksional një model i ri TI për analizën e riskut, i cili ndihmon në evidentimin e grupit mbi të cilin do të ushtrohet kontrolli tatimor. Sistemi i ri M-TAX u lejon inspektorëve të taksave të aksesojnë dhe regjistrojnë informacionin në kohë reale. Faza e parë e luftës kundër informalitetit, e cila përfundoi në mars, ka rezultuar në regjistrimin e më shumë se 30 000 bizneseve dhe 70 000 të punësuarve. 116 raste për mashtrim tatimor dhe evazion fiskal janë raportuar në prokurori midis shtatorit 2015 dhe korrikut 2016. Mbledhja e të ardhurave ka tejkaluar objektivat për vitin 2015, dhe është rritur më tej në gjysmën e parë të vitit 2016.

4.17. Kapitulli 17: Politika monetare dhe ekonomike

Rregullat e BE-së kërkojnë pavarësinë e bankave qendrore dhe ndalojnë financimin e drejtpërdrejtë nga ana e tyre të sektorit publik. Shtetet Anëtare koordinojnë politikat e tyre ekonomike dhe janë objekt i mbikëqyrjes fiskale, ekonomike dhe financiare.

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e politikave monetare dhe ekonomike. Janë bërë **disa përpjekje**, në veçanti, me futjen e një rregulli bazë fiskal dhe me forcimin e planifikimit buxhetor afatmesëm. Vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet të bëjë përpjekje të mëtejshme për të përmirësuar politikëbërjen ekonomike, në veçanti duke:

→ zbatuar dhe ndryshuar dispozitat e reja të ligjit organik për buxhetin, mbikëqyrur partneritetet publik-privat dhe përmes ekzekutimit të buxhetit për vitin zgjedhor;

→ garantuar koordinim më të mirë të brendshëm dhe konsultim me palët e interesuara gjatë formulimit të prioritetëve të reformave strukturore.

Në fushën e **politikës monetare**, Ligji për Bankën e Shqipërisë nuk është përafuar ende me *acquis*, në veçanti për sa i përket pavarësisë së anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës dhe llogaridhënies së Bankës.

Në fushën e **politikës ekonomike**, kërkohet një përafrim i mëtejshëm me Direktivën për Kërkesat e Kuadrit Buxhetor. Shqipëria vijon të zbatojë pjesërisht Sistemin Evropian të Standardeve të Kontabilitetit (ESA 2010) në të dhënat e PBB-së vjetore. Megjithatë, përpjekje të mëtejshme duhen për të përafuar statistikën fiskale me kërkesat e ESA-së. Parashikimi i të ardhurave rezultoi tepër optimist për vitin 2015, por planifikimi i forcuar i të ardhurave sipas metodës poshtë-lart kontribuoi në mbledhjen e taksave dhe arritjen e objektivave të vendosur për shtatë mujorin e parë të vitit 2016. Ndryshimet në ligjin organik për buxhetin u miratuan në qershor, me qëllim eliminimin e prirjes optimiste në parashikimet ekonomike, forcimin e planifikimit buxhetor afatmesëm dhe vendosjen e një rregulli bazë fiskal i cili mbështetet në objektivin e borxhit afatgjatë. Megjithatë, ky rregull nuk ka një mekanizëm të korrigjimit dhe një afat përfundimtar, si dhe një organ të pavarur për monitorimin e përputhshmërisë.

Formulimi i politikës ekonomike duhet të përmirësohet përmes koordinimit më të mirë ndër-institucional dhe konsultimit me palët e interesuara, si dhe përmes forcimit të kapaciteteve teknike dhe analitike për identifikim më të mirë të reformave politike. Programi i reformës ekonomike 2016- 2018 u dorëzua në kohë. Ai përfshin një kuadër të detajuar dhe të përputhur makroekonomik dhe fiskal, si dhe identifikon masat e duhura të reformave për të nxitur konkurrencën dhe rritjen gjithëpërfshirëse. Gjithsesi, udhëzimi mbi politikën, i miratuar në maj 2015, është zbatuar pjesërisht deri në mesin e vitit 2016.

4.18. Kapitulli 18: Statistikat

Rregullat e BE-së kërkojnë që Shtetet Anëtare të jenë në gjendje që të prodhojnë statistika bazuar në pavarësinë profesionale, paanësinë, besueshmërinë, transparencën dhe konfidencialitetin. Rregullat e përbashkëta parashikohen për metodologjinë, prodhimin dhe përhapjen e të dhënave statistikore.

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e statistikave. Janë bërë **disa përpjekje** për sa i përket ESA 2010 dhe prodhimit të statistikave të biznesit, por nevojiten përpjekje të mëtejshme për të përmirësuar cilësinë e të dhënave dhe për të siguruar përputhjen e statistikave bujqësore, të turizmit, të transportit dhe sociale. Përveç adresimit të mangësive të përshkruara më lart, në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet në veçanti:

→ të forcojë pozicionin e INSTAT në administratën publike nëpërmjet rregullimeve në strukturat e pagave dhe në pozicionet e punës të nëpunësve civilë;

→ të përmirësojë pavarësinë profesionale të INSTAT nëpërmjet ndryshimeve në ligjin për statistikat, ndër të tjera, duke garantuar pavarësinë profesionale të INSTAT në rekrutim dhe plotësim të stafit.

Për sa i përket **infrastrukturës statistikore**, kuadri ligjor është pjesërisht në përputhje me Kodin e Statistikave Evropiane të Praktikës dhe klasifikimet janë në përputhje me standardet e BE-së. Duhet të rishikohet ligji për statistikat zyrtare për sa i përket procedurave të rekrutimit të Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT, sikurse përcaktuar në ligjin e nëpunësit civil si një anëtar i trupës së nivelit të lartë të nëpunësve civilë. Programi i Statistikave Zyrtare 2017–2021 është në përgatitje e sipër dhe duhet të shoqërohet me një plan veprimi të detajuar mbi burimet njerëzore dhe financiare, të nevojshme për zbatimin e tij. Një memorandum mirëkuptimi u nënshkrua me Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, ndërsa është përditësuar memorandum i mirëkuptimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Roli i INSTAT si koordinator i sistemit të statistikave kombëtare duhet të përmirësohet dhe forcohet. INSTAT duhet të nënshkruajë një marrëveshje me ruajtësit e të dhënave mbi procedurat e aksesit të të dhënave administrative dhe të ndikojë mbi zhvillimin në të ardhmen të regjistrave administrative për të lehtësuar përdorimin e të dhënave për arsye statistikore. INSTAT ka përmirësuar gamën dhe cilësinë e statistikave që publikon.

Në **statistikat makro-ekonomike**, të dhënat vjetore dhe tremujore të PBB janë prodhuar rregullisht bazuar në qasjen e prodhimit dhe shpenzimeve, në çmime aktuale dhe konstante. Sistemi Evropian i Llogarive (ESA) 2010 është harmonizuar pjesërisht. Në dhjetor 2015, INSTAT publikoi për herë të parë të dhënat e PBB bazuar në Nomenklaturën e re të Veprimtarive Ekonomike (NACE Rev. 2). Në shkurt 2016, INSTAT nxori tabelat e furnizimit/përdorimit me çmimet aktuale, si dhe nxori tabela input-i dhe output-i për vitin 2012, sipas NACE Rev. 2 dhe Nomenklaturës së Produkteve sipas Aktivitetit (CPA 2008) dhe vazhdon puna për të dhënat e vitit 2013.

Sa i përket **statistikave strukturore të biznesit**, është përmirësuar mbledhja dhe prodhimi i të dhënave. Në vitin 2015, INSTAT ka kryer për herë të parë një anketim të rregullt mbi inovacionin dhe një tjetër mbi teknologjitë e informacionit dhe komunikimit në ndërmarrjet. Në fushën e statistikave të tregtisë, INSTAT ka hetuar për herë të parë karakteristikat ekonomike të tregtarëve (TEC). Në statistikat e çmimeve, aplikohet një shportë e rishikuar për indeksin e çmimeve të konsumit. INSTAT ka filluar llogaritjen e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit, por nuk është në përputhje të plotë me standardet e BE-së. Në fushën e statistikave afatshkurtra, janë publikuar lejet e ndërtimit dhe indekset e kostove të ndërtimit. Statistikat e transportit janë mbledhur si pjesë e anketimeve afatshkurtra dhe anketimeve të biznesit, por përmbajnë vetëm të dhëna të pjesshme dhe nuk i janë transmetuar Eurostat-it. Nuk ka asnjë anketim mbi turizmin e brendshëm dhe duhen përpjekje të mëtejshme për të përmirësuar regjistrin e biznesit.

Statistikat sociale prodhohen në përgjithësi. Një studim pilot mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës (600 familje me një normë përgjigjeje 95%), është realizuar në vitin 2015 dhe është duke u përgatitur një anketim i rregullt vjetor për të nisur në vitin 2016, bazuar në një mostër prej 9 200 familjesh. Anketa e buxhetit familjar kryhet si anketë vjetore që nga viti 2014 dhe

rezultatet e para janë shpërndarë në shtator 2015. Në vitin 2015, formati i anketës së fuqisë punëtore u rrit nga 5 000 në 9 000 për të prodhuar të dhëna përfaqësuese rajonale dhe një mënyrë të re për kryerjen e intervistave u prezantua për të mundësuar monitorim më të shpejtë. Mikrodatat mbi anketimin e fuqisë punëtore duhet ti dërgohen EUROSTAT-it. Organet tatimore i kanë siguruar INSTAT-it një bazë të dhënash me informacion për të gjithë personat e punësuar në Shqipëri, duke përfshirë të dhënat e pagave. Kjo përmirëson mbulimin e statistikave administrative të tregut të punës, të cilat deri më tani kanë mbuluar vetëm sektorin publik. Rezultatet e anketës të vitit 2012 për koston e punës janë publikuar dhe të dhënat i janë transmetuar Eurostat-it, përfshirë mikrodatat. INSTAT duhet të zhvillojë një indeks të koston së punës. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të prodhuar statistika për shëndetin, arsimin, krimin dhe migrimin në përputhje me acquis.

Statistikat e bujqësisë janë pjesërisht në përputhje me acquis-në e BE-së. Statistikat e qumështit dhe të produkteve të bulmetit janë duke u mbledhur nga INSTAT në bazë të anketimeve mujore dhe vjetore, në përputhje me standardet e BE-së, por të dhënat përfundimtare të censusit të bujqësisë, i kryer në tetor të vitit 2012 nuk janë publikuar ende. Anketimi mbi strukturën e fermave nuk është zbatuar ende.

Statistikat e mjedisit dhe energjisë janë në përputhje me acquis-në e BE-së në një masë shumë të kufizuar. Balancat energjetike janë përmirësuar. Statistikat afatshkurtra janë prodhuar vetëm për energjinë elektrike. Të dhënat për shkarkimet janë prodhuar, por janë vetëm në përputhje të pjesshme me standardet e BE-së. Të dhënat tatimore lidhur me mjedisin sipas aktivitetit ekonomik janë pjesërisht në përputhje me standardet e BE-së dhe janë duke u zhvilluar në kuadër të llogarive mjedisore. Të dhënat statistikore për shpenzimet e mjedisit nuk janë prodhuar ende për shkak të mungesës së informacionit.

4.19. Kapitulli 19: Politikat Sociale dhe punësimi

Rregullat e BE-së në fushën sociale përshijnë standardet minimale për ligjin e punës, barazinë, shëndetin e sigurinë në punë dhe politikat e mos-diskriminimit. Këto rregulla promovojnë dialogun social në nivelin evropian.

Shqipëria ka **njëfarë niveli të përgatitjes** në politikat sociale dhe punë politikat sociale dhe punësim. Ka pasur **pak progres**, sidomos me miratimin e ndryshimeve në kodin e punës dhe ligjit për ndihmën ekonomike, strategjinë e mbrojtjes sociale dhe dokumentin dhe planin e veprimit 2016-2020 për politikat profesionale, të sigurisë dhe shëndetësore. Zbatimi i strategjisë kombëtare të vendeve të punës dhe aftësive ka filluar. Shkalla e punësimit dhe pjesëmarrja në tregun e punës mbeten të ulta, dhe ekonomia informale është ende një punëdhënëse e rëndësishme. Në vitin e ardhshëm, vendi duhet në veçanti:

- të zbatojë efektivisht strategjinë e mbrojtjes sociale 2015-2020, duke përfshirë progres të mëtejshëm në reformën e kujdesit social;
- të zhvillojë një qasje strategjike për të trajtuar informalitetin dhe punën e padeklaruar;
- të përmirësojë statistikat e tregut të punës dhe të zhvillojë statistikat sociale në përputhje me anketat e BE-së.

Në lidhje me **ligjin e punës**, Kodi i Punës i ndryshuar hyri në fuqi në qershor. Ligji i ri synon të transpozojë direktivat e ndryshme të BE-së që mbulon mos-diskriminimin në vendin e punës, të drejtat prindërore, të drejtën e informimit, marrëdhëniet punëdhënës-punëmarrës dhe punën në distancë (teleworking). Ky ligj gjithashtu rrit moshën minimale të punës nga 14 në 15, në përputhje me konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës. Megjithatë, dispozitat për punën e detyruar mbeten të paqarta dhe ligji nuk parashikon sanksione në rastet e shkeljes. Në qershor, ligji për zanatet u miratua nga parlamenti.

Për sa i përket **shëndetit dhe sigurisë në punë**, u miratua dokumenti dhe plani i veprimit 2016-2020 për politikën profesionale, e sigurisë dhe shëndetësore. Nëntëmbëdhjetë direktivat për sigurinë dhe shëndetin në punë janë transpozuar, por zbatimi i tyre përballët me disa kufizime në aspektin e kapaciteteve dhe performancës së inspektoratit të punës. Raportimi i aksidenteve në punë është rritur nga 121 në vitin 2014 në 125 në vitin 2015, por numri i viktimave ka rënë nga 33 në 28. Shumica e aksidenteve të raportuara kanë ndodhur në sektorin e minierave dhe gurorëve (33). Duhet të përmirësohet mbledhja e të dhënave statistikore mbi shëndetin dhe sigurinë.

Në lidhje me **dialogun social**, Këshilli Kombëtar i Punës vazhdon rregullisht takimet. Megjithatë, duhen shtuar përpjekjet për ta transformuar atë në një forum efektiv të dialogut social, për të përmirësuar marrëveshjet kolektive dhe intensifikimin e dialogut social dypalësh, veçanërisht në nivel lokal dhe në nivelin e ndërmarrjeve.

Për **politikën e punësimit**, vazhdon zbatimi i strategjisë kombëtare 2014-2020 për vendet e punës dhe aftësitë, dhe ka një mekanizëm për monitorimin e saj. Është publikuar një raport i parë vjetor, sipas të cilit ka pasur përparim në fushën e politikave të punësimit dhe shërbimeve, ndërsa progresi ishte i kufizuar në fushën e përfshirjes sociale e kohezionit territorial, si dhe sa i përket sistemit të qeverisjes së tregut të punës. Shkalla e papunësisë, sipas anketës së fuqisë punëtore, ka një rënie të lehtë nga 17.5% në 2014 në 17.1% në vitin 2015, por mbetet i lartë, veçanërisht te gratë, të rinjtë dhe personat me aftësi të kufizuara. Shkalla e papunësisë për burrat ra nga 19.2% në 2014 në 17.1% në vitin 2015, ndërsa norma e papunësisë për femrat është rritur nga 15.2% në 17.1%. Papunësia afatgjatë ka pësuar një rritje të vogël nga 11.2% në vitin 2014 në 11.3% në vitin 2015, me një rënie të meshkujt (11.7% në 2014 në 11.2% në vitin 2015), dhe një rritje të gratë (nga 10.7% në 11.3%). Statistikat e punës janë përgjithësisht në përputhshmëri me *acquis*, por duhet të përmirësohen më tej. Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi mbeten ofruesit kryesorë të punës, me 41.3% në vitin 2015 (kundrejt 42.7% në vitin 2014). Duhet të zhvillohet një qasje strategjike për të trajtuar sfidat e tregut të punës siç janë papunësisë e të rinjve dhe informaliteti. Ligji për programet e nxitjes së punësimit është finalizuar, por mbetet për t'u miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Nuk ka pasur zhvillime në **Fondin Social Evropian**.

Për sa i përket përfshirjes dhe mbrojtjes sociale, janë miratuar Strategjia e re Kombëtare për Mbrojtje Sociale 2015-2020 dhe një Dokument i Politikave për Përfshirjen Sociale. Të dy dokumentet e politikave përcaktojnë objektivat për uljen e varfërisë, monitorimin e politikave të përfshirjes ndër-sektoriale, miratimin e reformave në fushën e mos-diskriminimit dhe krijimin e një sistemi të kujdesit social. Në maj, parlamenti miratoi ligjin e ri për ndihmën

ekonomike. Ky ligj siguron një regjistër të ri elektronik në mbarë vendin të të gjitha familjeve në programin e ndihmës ekonomike, një bonus për të gjithë fëmijët e vaksinuar që ndjekin shkollën. Shumica e shërbimeve të kujdesit social mbeten nën fondet e donatorëve dhe kanë mungesa në buxhet. Shkalla e punësimit për romët dhe egjiptianët mbetet shumë e ulët, me një pjesë që janë aktiv në sektorin informal. Strategjia Kombëtare e Strehimit 2016-2025 është miratuar. Punësimi i të miturve mbetet një shqetësim i madh, duke përfshirë edhe punën e tyre në mjedise të rrezikshme. Duhet të ndërmerren më shumë masa efektive për të parandaluar punën e të miturve.

Në **politikat e mos-diskriminimit në punë dhe politikat sociale**, është rritur numri i rasteve të trajtuara nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në lidhje me punësimin, megjithatë mbetet e nevojshme një shpërndarje më e madhe dhe metodologji më proaktive. Kodi i Punës u ndryshua në dhjetor për të përfshirë ndalimin e diskriminimit me bazë gjinore e orientim seksual në vendin e punës dhe për të vendosur barrën e provës te punëdhënësit.

Për sa i përket **barazisë midis grave dhe burrave në punë dhe politikave sociale**, në dhjetor Parlamenti miratoi ndryshimet në Kodin e Punës, duke futur rregulloren për lejet vjetore, lejet e lindjes (prindërore), pushimet e papaguara, e drejta për të punuar me kohë të pjesshme, dhe e drejta për të ulur orët e punës pas lindjes së një fëmije. Rritja e papunësisë dhe papunësisë afatgjatë për gratë në vitin 2015 tregon se nuk është bërë asnjë përparim në përmirësimin e përfaqësimit të tyre në tregun e punës dhe zvogëlimin e hendekut gjinor në punësim, ndaj duhet punë në këtë drejtim. Raporti i Forumit Ekonomik Botëror për Indeks të Hendekut Gjinor 2015 e rendit Shqipërinë në vendin e 70 nga 145 vende. Shqipëria u rendit e 5-ta për barazinë e pagave për punët e ngjashme, por e 69-ta për pjesëmarrjen e grave në ekonomi. Femrat janë të mbipërfaqësuar si kontribuese në familje dhe sektori i bujqësisë punëson më shumë se 54% të të gjitha grave aktive. Si rezultat, varësia e grave te njerëzit të cilët konsiderohen si "kryetarët e familjes" është e madhe, dhe përqindja e grave në zonat rurale që përfitojnë nga leja e lindjes është 19%, dukshëm më e ulët se norma 59% në zonat urbane. Që nga viti 2015, legjislacioni siguron lejen e lindjes për gratë dhe lejen e atësisë për meshkujt, edhe pse paragjykimet me bazë gjinore vazhdojnë në lidhje me kujdesin për fëmijët dhe punët e familjes që duhet të jenë përgjegjësi e grave. Mungesa e shërbimeve shtetërore për kujdesin e fëmijëve në zonat rurale rrit rastet e punës së papaguar të grave në shtëpi.

4.20. Kapitulli 20: Ndërmarrjet dhe politika industriale

Politikat industriale të BE-së forcojnë ndryshimet strukturore të instrumenteve të konkurrencës dhe nxisin një mjedis miqësor të biznesit që inkurajon ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në këtë fushë. Janë bërë **disa përparime**, sidomos në krijimin e një Qendre Kombëtare të Biznesit dhe përafrimin e politikave me parimet e Aktit Evropian për Biznesin e Vogël. Në vitin e ardhshëm, vendi duhet në veçanti:

→ të forcojë më tej kapacitetet e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve në ofrimin e shërbimeve për investitorët dhe për promovimin e mundësive të financimit për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, duke përfshirë programin Cosme;

→të përmirësojë më tej konsultimet e politikave me bizneset.

Në fushën e **ndërmarrjeve dhe parimet e politikës industriale**, Shqipëria ka vazhduar të zbatojë Strategjinë e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2014-2020 për të lehtësuar mjedisin e biznesit. Sipas konkluzioneve të Aktit Evropian për Biznesin e Vogël 2016, që nga viti 2012 Shqipëria ka bërë progres në disa parametra, si standardizimi, rregullat teknike dhe thjeshtimi i procedurave të biznesit. Qendra Kombëtare e Biznesit u bë operative në prill të vitit 2016, duke siguruar një dritare të vetme për regjistrimin e biznesit dhe licencimin online dhe duke ofruar shërbime online për regjistrimin. Sfidat përpara përfshijnë mësimin sipërmarrës dhe sipërmarrjen e grave, inovacionin dhe gjelbërimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM-të). Biznesi vazhdon të përballet me vështirësi për shkak të vonesave gjyqësore, ndryshimet e shpeshta të legjislacionit tatimor, procedura të vështira ose të pavolitshme të daljes së tregut. Informalitet dhe korrupsion. Procedurat e vlerësimit të ndikimit rregullator ende nuk janë zyrtarizuar. Ndryshimet në ligjet në dhomat e tregtisë dhe industrisë janë dorëzuar për miratim në parlament. Ato sigurojnë, ndër të tjera, rivendosjen e tarifave të detyrueshme për anëtarësim. Kjo ka gjeneruar ankesa nga shoqatat e biznesit.

Qasja në financa mbetet një pengesë kyçe për NVM-të shqiptare, ndonëse disa financime janë siguruar nga disa fonde kombëtare, programi Italo-Shqiptar i cili ndihmon NVM-të nëpërmjet Linjës së Kredisë dhe Fondit Evropian për Evropën Juglindore. Është themeluar në qershor një fond për mbështetjen e ndërmarrjeve mikro dhe të vogla që veprojnë në zonat turistike/ historike. Nuk është siguruar ndonjë financim përmes Fondit të Inovacionit të qeverisë dhe Fondit për mbështetjen e grave sipërmarrëse. Në lidhje me iniciativat e BE-së për mbështetjen e NVM-ve, kanë filluar përpjekjet për të promovuar programin e konkurrencës COSME, por janë të nevojshme masa të mëtejshme të konsiderueshme për të rritur ndërgjegjësimin midis aktorëve të biznesit në lidhje me mundësitë e financimit në dispozicion. Pjesëmarrja e Shqipërisë në Fondin Evropian të Zhvillimit dhe Fondin e Inovacionit mbetet në pritje të nënshkrimit të marrëveshjes së zbatimit.

Për sa i përket **politikave sektoriale**, u ndryshua në prill rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Turizmit duke i ngarkuar detyrën për zbatimin e strategjisë kombëtare të turizmit, përfshi promovimin dhe marketingun. Megjithatë, nuk janë miratuar ende as strategjia e turizmit dhe as ajo për produktet industriale dhe të industrisë jo-ushqimore. Pasiguritë mbi pronësinë e pronës, mungesa e formalizimit dhe standardizimit të shërbimeve, si dhe qasja e pakët në infrastrukturën bazë, energjinë dhe menaxhimin e mbetjeve mbeten ndër pengesat kryesore për zhvillimin e turizmit. Legjislacioni dytësor për investimet strategjike dhe zhvillimin e zonave ekonomike u miratua në dhjetor, duke identifikuar sektorët me prioritet të investimeve, projektet me potencial strategjik dhe procedurat e vlerësimit të investimeve strategjike. Dy investime strategjike janë miratuar në korrik, ndërsa nuk ka ende zona ekonomike funksionale. Në fushën e minierave, janë miratuar një plan veprimi 2016-2018 për zhvillimin e veprimtarisë minerare, si dhe rregulloret për mbrojtjen e sigurisë dhe lëshimin e lejeve.

4.21. Kapitulli 21: Rrjetet trans-evropiane

Bashkimi Evropian promovon rrjetet trans-evropiane në fushat e transportit, telekomunikacionit dhe energjisë për të forcuar tregun e brendshëm dhe të kontribuojnë në rritjen ekonomike dhe punësimin.

Shqipëria ka arritur **njëfarë nivel të përgatitjes** në fushën e rrjeteve trans-evropiane. Janë bërë **disa përparime** edhe në këtë periudhë raportuese në zhvillimin e infrastrukturës rrugore dhe të rrjeteve energjetike të ndërlidhjes. Në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet në veçanti të vazhdojë të përparojë në:

→zhvillimin e rrjeteve të transportit dhe të energjisë në përputhje me prioritetet e investimeve të infrastrukturës për rrjetin kryesor, për të cilat është rënë dakord në agjendën rajonale të ndërlidhjes;

→përsheptimin e përpjekjeve për të zbatuar masat e reformës së ndërlidhjes, për të cilat është rënë dakord në “*Samitin e Vjenës në vitin 2015*”, me fokus në mirëmbajtjen e infrastrukturës së transportit dhe sigurisë rrugore.

Për sa i përket **rrjeteve të transportit**, Shqipëria ka vazhduar të marrë pjesë aktive në “*Observatorin e Transportit të Evropës Jug-Lindore dhe të Ballkanit Perëndimor 6*”, duke u fokusuar në përmirësimin e lidhjes me Ballkanin Perëndimor, si dhe me BE-në. Projektet e ndërlidhjes në transport dhe energji janë planifikuar dhe përgatitur nëpërmjet listës së vetme të projekteve vendosur për vendin.

Përmirësimi i rrjetit rrugor ka vazhduar me përfundimin e unazës (bypass)së Rrogozhinës dhe e seksionit të fundit të mbetur të rrugës Levan-Tepelenë. Puna për ndërtimin e unazës (bypass) së Fierit në korridorin Veri-Jug dhe rrugës Tiranë-Elbasan në korridorin VIII është vonuar.

Në shtator 2015, filluan aktivitetet për mirëmbajtjen e rrugëve sipas programit 5-vjeçar; duhet të sigurohen burimeve të tjera financiare për zbatimin e tij. Nuk ka pasur përparim në rrjetin hekurudhor dhe segmenti nga Librazhdi në Pogradec mbetet jo funksional për shkak të problemeve të mirëmbajtjes. Nuk ka asnjë plan 5-vjeçar për mirëmbajtjen hekurudhore. Për sa i përket infrastrukturës portuale, vazhdojnë punimet për përmirësimin e infrastrukturës në portin e Vlorës.

Për sa i përket **rrjeteve energjetike**, segmenti Shqipëri-Kosovë i linjës së interkonjeksionit 400 kV është në ndërtim e sipër. TAP po ecën sipas planit. Për ndërtimin e linjës së interkonjeksionit me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, është dhënë një tender.

4.22. Kapitulli 22: Politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore

Politika rajonale është politika kryesore e investimeve të BE-së për të realizuar rritje ekonomike të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Shtetet Anëtare janë përgjegjëse për zbatimin e saj, gjë e cila kërkon kapacitete administrative të përshtatshme dhe menaxhim financiar të saktë të hartimit dhe zbatimit të projekteve.

Shqipëria është akoma mesatarisht e përgatitur në fushën e politikës rajonale. Janë bërë disa përpjekje me përfundimin e procesit të besimit për programin kombëtar IPA 2014, megjithëse përgatitjet për menaxhimin indirekt për këtë program filluan me vonesë. Në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet veçanërisht:

→ të forcojë kapacitetet administrative, veçanërisht të Zyrës Mbështetëse të Zyrtarit Kombëtar Autorizues dhe të Autoritetit të Auditit;

→ të përshpejtojë përgatitjen e dokumenteve të projekteve për të shmangur vonesat në përdorimin e fondeve të BE-së, që u vunë re në programin IPA 2014;

→ të ngrejë kapacitetet programuese në përputhje me përfaqsimin sektoriale dhe politikën sektoriale, dhe të përmirësojë hartimin e listave të projekteve sektoriale të maturuara.

Për sa i përket **kuadrit ligjor**, kërkohej përpjekje të mëtejshme për të siguruar programimin sektorial shumëvjeçar në përputhje me përfaqsimin sektoriale sikurse përcaktuar nga kuadri IPA 2014 – 2020 dhe programi buxhetor afatmesëm kombëtar. Përpjekjet e nevojshme përfshijnë alokimin e fondeve të përshtatshme për bashkëfinancimin e projekteve të BE-së në nivel kombëtar dhe lokal.

Për sa i përket **kuadrit institucional**, Komisioni Evropian ra dakord për besimin e detyrave të zbatimit të buxhetit për programin e veprimtimit të vitit 2014 në kuadër të IPA II, nëse plotësohen një numër kushtesh. Në dhjetor, autoritetet shqiptare paraqitën paketën për dhënien e besimit për IPA 2015, dhe në qershor paketën për dhënien e besimit për menaxhimin e fondeve IPA në bujqësi dhe zhvillimin rajonal (*shiko po ashtu kapitullin 11 — Bujqësia*).

Kërkohej punë e mëtejshme për forcimin e **kapaciteteve administrative** të Njesisë Qendrore të Financimeve dhe Kontraktimeve dhe të Autoritetit të Auditit dhe veçanërisht të kapaciteteve të Zyrës Mbështetëse të Zyrtarit Kombëtar Autorizues për të marrë përsipër plotësisht funksionet e saj mbikëqyrëse në sistemin e menaxhimit indirekt.

Për sa i përket **programimit**, nevojitet të përmirësohet koordinimi mes Ministrisë së Integritimit Evropian, Ministrisë së Financave, Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive të linjës, për të zhvilluar dhe zbatuar politika dhe programe zhvillimi sektoriale realiste dhe të buxhetuara, në përputhje me programin buxhetor afatmesëm. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integritim 2015 – 2020 mbetet për t'u miratuar. Lista kombëtare e projekteve e investimeve, duke përfshirë ato për zhvillimin rajonal, duhet akoma të përputhet me programin buxhetor afatmesëm dhe planifikimin dhe menaxhimin e investimeve publike mbarëkombëtare.

Për sa i përket **monitorimit dhe vlerësimit**, tre nga katër grupet pilot të menaxhimit të integruar të politikave, të ngritura për të mbështetur Komitetin e Planifikimit Strategjik të

Qeverisë dhe komitetet e tjera ndër-ministore të nivelit të lartë, të ngarkuara për marrjen e vendimeve mbi politikat kyçe, janë plotësisht funksionalë. Grupi i menaxhimit të integruar të politikave për konkurrueshmërinë nuk është akoma plotësisht funksional. Ka nevojë të forcohen kapacitetet administrative dhe të sigurohet vazhdimësia e stafit të sekretariateve të grupeve të menaxhimit të integruar të politikave, duke përfshirë kapacitetet monitoruese. Në vitin 2016, duhet të rritet numri i grupeve të menaxhimit të integruar të politikave dhe të identifikohen sektorë të rinj. Duhet të përmirësohet përfshirja në dialogun sektorial e partnerëve për zhvillim, autoriteteve të qeverisjes vendore dhe organizatave të shoqërisë civile.

Për sa i përket **menaxhimit financiar, kontrollit dhe auditit**, si Njësia Qendrore e Financimeve dhe Kontraktimeve në Ministrinë e Financave ashtu edhe Autoriteti i Auditit patën ndryshime në nivelin e lartë menaxhues, me emërimin e drejtuesve të rinj. Autonomia financiare dhe administrative e Autoriteti të Auditit nuk është garantuar akoma.

4.23. Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore

Vlerat themeluese të BE-së përfshijnë shtetin e së drejtës dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Sistemi i duhur i funksionimit të gjyqësorit dhe lufta efektive kundër korrupsionit janë të një rëndësie madhore, siç është respektimi i të drejtave themelore të njeriut në ligj dhe në praktikë.

Shqipëria ka një farë nivel të përgatitjes në këtë fushë. Janë bërë disa përpertime. Ndryshimet kushtetuese të miratuara në korrik, nisën një proces gjithëpërfshirës të reformës në drejtësi. Ky proces trajton mangësitë ekzistuese të sektorit, duke përfshirë edhe dobësitë që lidhen me pavarësinë dhe llogaridhënien e gjykatësve dhe prokurorëve, mungesën e efikasitetit dhe profesionalizmit. Korrupsioni mbetet i përhapur në shumë fusha dhe vazhdon të jetë një problem serioz. Për sa i përket të drejtave të njeriut, nevojiten përpjekje të tjera për barazinë gjinore, mbrojtjen e fëmijëve dhe grupeve të tjera të cenuara, dhe të drejtave të pronësisë. Në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet në veçanti:

→ të avancojë zbatimin e reformës në drejtësi, duke përfshirë rivlerësimin e të gjithë gjyqtarëve, prokurorëve dhe këshilltarëve ligjorë;

→ të adresojë mangësitë që ndikojnë në sistemin e menaxhimit të çështjeve, duke zhvilluar një sistem të vetëm dhe efektiv, i cili garanton shpërndarjen sipas shortit, transparent dhe të balancuar të çështjeve;

→ të bëjë përpertime të mëtejshëm për krijimin e një historiku të qëndrueshëm të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve në luftën kundër korrupsionit në të gjitha nivelet, duke përfshirë sekuestrimin e pasurive;

→ të përmirësojë mekanizmat institucional për mbrojtjen e fëmijëve, mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe barazinë gjinore; të përmirësojë përpjekjet për të sjellë legjislacionin ekzistues për drejtësinë e të miturve në përputhje me standardet ndërkombëtare; të shtojë përpjekjet për të ndërtuar një jurisprudencë anti-diskriminim që të jetë solide dhe për të gjetur një zgjidhje të qëndrueshme afatgjatë për strehimin e minoriteteve romë dhe egjiptiane;

→ të bëjë përpertime të rëndësishëm në drejtim të përfundimit të procesit të regjistrimit, kthimit

dhe kompensimit të pronave. (Shih edhe rekomandimet specifike për sistemin gjyqësor, luftën kundër korrupsionit dhe lirinë e shprehjes në paragrafin nën 2.3 dhe 2.4.)

Funksionimi i gjyqësorit

Dokumente strategjik

Një **strategji ndër-sektoriale e drejtësisë** 2017-2020 dhe plani i saj i veprimit janë miratuar në nëntor 2016.

Organet e menaxhimit

Mbetet shqetësuese situata lidhur me transparencën, ne procesin e vendimmarrjes të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD). Vazhdon të ketë probleme me mungesën ose publikimin me vonesë të vendimeve dhe të arsytimit të vendimeve. Buxheti i KLD-së ka rënë pak në krahasim me vitin e kaluar. Dy konkurse për prokurorët janë zhvilluar në bazë të rregullores për funksionimin e Këshillit të Prokurorëve, i ndryshuar në vitin 2014 dhe manualit për ngritjen në detyrë të vitit 2015. Nëntë kandidatë janë emëruar si prokurorë.

Pavarësia dhe paanshmëria

Sistemi gjyqësor mbetet i prekur në shkallë të lartë nga politizimi, korrupsioni dhe bashkëpunimi i dobët ndërinstitucional. Procesi i reformës në drejtësi, që nisi me miratimin e ndryshimeve kushtetuese në korrik, hodhi themelet për riorganizimin e plotë të sektorit të drejtësisë. Reforma e drejtësisë synon të rrisë pavarësinë, paanshmërinë dhe transparencën e organeve gjyqësore të vendit, duke përfshirë Gjykatën Kushtetuese, Gjykatën e Lartë, organet drejtuese të gjyqësorit dhe Prokurorinë e Përgjithshme. Ndryshimet kushtetuese janë hartuar në konsultim të ngushtë me Komisionin e Venecias. Sipas mendimit të dhënë prej saj, në mars, Komisioni i Venecias shqyrtoi nëse projekt-ndryshimet ishin në përputhje me standardet evropiane dhe propozimet e shëndosha për reformimin institucional të sistemit gjyqësor shqiptar. Rreth 40 ligje, përfshirë ndryshimet e kodeve, janë në përgatitje e sipër.

Tre vendet të lira mbeten ende për t'u plotësuar në Gjykatën e Lartë.

Llogaridhënia

Seancat dëgjimore mbahen në mënyrë të vazhdueshme në zyrat e gjyqtarëve, duke favorizuar ndikimin e madh dhe korrupsionin. Shërbimet e inspektimit të KLD-së dhe të Ministrisë së Drejtësisë kanë kryer disa inspektime, në përputhje me memorandumun e tyre të mirëkuptimit. Që prej Shtatorit 2015, procedimet disiplinore kundër gjashtë gjyqtarë kanë konkluduar me një shkarkim nga detyra dhe transferimin e një gjyqtari në një gjykatë tjetër; një ankesa kundër shkarkimit nga detyra është në pritje në Gjykatën e Lartë. Janë pushuar rastet kundër tre gjyqtarëve të tjerë dhe një rast ka mbetur pezull si pasojë e rezultatit të hetimit penal në proces. Mungesa e transparencës në trajtimin e procedimeve disiplinore dhe në efikasitetin e inspektimeve janë një shqetësim i veçantë. Faqja e internetit e krijuar vitin e kaluar nga KLD-ja për dorëzimin dhe monitorimin e ankesave kundër gjyqtarëve nuk është ende funksionale.

Që nga shtatori 2015, Prokuroria e Përgjithshme (PP) ka marrë masa kundër dy prokurorëve, me propozim të Këshillit të Prokurorëve. Sanksionet e vendosura ishin qortime. Dy kërkesa për të hapur procedimin disiplinor janë në pritje. Për sa i përket procedimit penal, një prokuror

u dënua me burgim për veprën e korrupsionit dhe është në pritje gjykimi kundër një prokurori tjetër. Mungesa e transparencës në çështjen e emërimeve në PP-në, kërkesat për procedime dhe vendime disiplinore mbi pushimin nga puna duhet të adresohen. Mungesa në përgjithësi e llogaridhënies së PP-së është gjithashtu një shqetësim serioz.

Deklaratat e pasurisë së prokurorëve janë duke u verifikuar nga ILDKPKI. Që nga shtatori 2015, asnjë gjyqtar nuk është pezulluar për deklaram të rreme të pasuritë. Pas dënimit për korrupsion, KLD-ja shkarkoi një gjykatës në janar. Reforma në drejtësi adreson pjesën më të madhe të rekomandimeve të bëra nga ana e Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO) në raportin e tij të vlerësimit për parandalimin e korrupsionit në lidhje me gjyqtarët dhe prokurorët. Korrupsioni në gjyqësor mbetet një shqetësim serioz. Me miratimin në gusht të ligjit përkatës, të gjithë gjyqtarët, prokurorët dhe këshilltarët ligjorë do t'i nënshtrohen procesit të ri-vlerësimit. Për momentin, kjo ka mbetur pezull, pasi Gjykata Kushtetuese po shqyrton kushtetutshmërinë e ligjit dhe ka pezulluar zbatimin e tij.

Profesionalizmi dhe kompetenca

Vlerësimi i performancës së gjyqtarëve nuk ka përparuar. Vlerësimi për periudhën 2007-2009 është finalizuar së fundmi dhe vlerësimi për periudhën 2010-12 sapo ka filluar. Vazhdon procesi i vlerësimit të krerëve të gjykatave, inspektorëve të KLD-së dhe kryeinspektorit të KLD. Performanca e prokurorëve dhe e oficerëve të policisë gjyqësore për vitin 2014 është duke u vlerësuar.

Statusi i stafit të gjykatave dhe këshilltarëve ligjorë në gjykatat administrative do të qartësohet në kuadër të reformës. Procedurat për rekrutimin e gjyqtarëve të gjykatave administrative janë në shqyrtim për të trajtuar numrin e kufizuar të aplikimeve. Vendet e lira në gjykatat administrative janë rritur nga shtatë në nëntë. Procesit i emërimit të nëntë gjyqtarëve, të diplomuar në vitin 2015 nga Shkolla e Magjistraturës, u realizua në qershor nëpërmjet një procedure të re përzgjedhjeje.

Cilësia e drejtësisë

Duhet të përmirësohet kapaciteti i planifikimit të buxhetit dhe duhet sigurohen burime të mjaftueshme për sistemin e drejtësisë, në veçanti për zbatimin e reformës. Shkolla e Magjistraturës ka mungesë të burimeve njerëzore dhe infrastrukturës së përshtatshme: pavarësisht rritjes së buxhetit me 15% në vitin 2016, ajo mbetet e varur nga mbështetja e jashtme financiare. Trajnimi i stafit gjyqësor administrativ duhet të përshpejtohet. Shkolla e Magjistraturës ka rritur numrin e trajnimeve gjatë punës mbi acquis të BE-së.

Një sistem audio incizimi është instaluar në të gjitha gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit, me përjashtim të Gjykatës Administrative të Gjirokastrës. Përdorimi efektiv i sistemit mbetet për tu vlerësuar. Mangësitë teknike që ndikojnë sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve ICMIS duhet të adresohen pa vonesë dhe duhet gjetur një zgjidhje afatgjatë në mënyrë që një në të gjitha gjykatat të kenë një sistem të vetëm dhe efektiv që siguron shpërndarjen transparente, sipas shortit dhe të balancuar të çështjeve. Alokimet buxhetore për gjykatat mbi TI vazhdojnë të jenë të pamjaftueshme.

Sistemi i menaxhimit të çështjeve për shërbimin e prokurorisë është zbatuar plotësisht në 20 prokurori, por në prokuroritë e shkallës së parë në Tiranë, Durrës dhe shkallës së parë të Gjykatës së Krimeve të Rënda në Tiranë ai nuk është plotësisht funksional. Kushtet e përshtatshme të punës dhe sigurisë për gjyqtarët dhe prokurorët mbeten ende një problem.

Aksesi në internet në jurisprudencë mbetet ende për t'u siguruar dhe nuk ka asnjë bazë të dhënash të kërkueshme. Kur publikohen, vendimet e gjykatave shpesh nuk kanë arsyetimet e duhura dhe afatet e publikimit nuk përmbushen gjithmonë. Aftësitë përpiluese të gjyqtarëve duhet të përmirësohen. Udhëzimet për anonimizimin në publikimin e vendimeve gjyqësore janë hartuar, por duhet të zbatohen.

Që nga shtatori 2015, janë lëshuar 62 licenca të reja për ndërmjetësues, duke e çuar numrin e përgjithshëm të ndërmjetësve të licencuar në 467 kundrejt 367 që ishin në vitin 2015. Në praktikë, vetëm 63 ndërmjetës punojnë për çështjet dhe ndërmjetësimi me kusht mbetet shumë i kufizuar, edhe pse ai u rrit nga një vit më parë.

Zbatimi i vendimeve gjyqësore duhet të përmirësohet ndjeshëm. Shërbimi i përmbartimit gjyqësor është nën efikasitetin e duhur dhe shërbimet e ofruara nga përmbartuesit privatë në përgjithësi varen shumë nga kapaciteti financiar i klientëve të tyre. Sistemi i menaxhimit të rasteve të përmbartimit publik dhe privat ALBIS, duhet të integrohet dhe të bëhet plotësisht funksional, dhe duhet siguruar alkimi i nevojshëm i buxhetit për mirëmbajtjen e sistemit të integruar.

Efikasiteti

Kohëzgjatja e tepruar e procedurave gjyqësore ka mbetur një shqetësim dhe ndodh kryesisht për shkak të vonësave në gjykatat e apelit, duke përfshirë edhe Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Administrative të Apelit.

Nevojitet dispozita të reja në kodet e procedurave për të thjeshtësuar procedurat e ankimit dhe për të siguruar mekanizmat filtrimit e ankesave, veçanërisht në Gjykatën e Lartë.

Gjashtë gjyqtarë të rinj janë emëruar në Gjykatën Administrative të Apelit, por ka ende nëntë vende të lira në gjykatat administrative të rrethit dhe vendet e lira në gjykata janë të përhapura. Nevojitet një metodë më efektive për plotësimin e vendeve dhe zëvendësimin e gjyqtarëve përkohësisht jo në detyrë, veçanërisht në gjykatat administrative.

Në vitin 2016, Gjykata e Lartë trajtoi rreth 4 400 ankime, një rritje nga viti i kaluar, por aktualisht Gjykata ende po shqyrton çështje që nga viti 2012. Shpejtësia e gjykimit është përmirësuar në gjykatat e shkallës së parë edhe pse në mënyrë të pabarabartë; ajo mbeti nën nivelin e 100% në të gjitha gjykatat. Procesi i prodhimit dhe mbledhjes së të dhënave statistikore për gjykatat nuk është i sigurt dhe përpunimi i të dhënave manualisht duhet të ndahet në faza. Çështjet e mbartura janë një problem i madh, sidomos në gjykatat e larta (Gjykata e Lartë ka rreth 16 777 raste të mbetura pezull). Reforma parashikon një shpërndarje të re territoriale të gjykatave dhe gjyqtarëve. Njoftimi i procedimeve gjyqësore për palët ka mangësi të mëdha dhe duhet të ndryshohet duke marrë parasysh mungesën e një sistemi të sigurt të adresave.

Lufta kundër korrupsionit

Historiku i rezultateve

Ka patur një trend pozitiv në hetime, ndjekje penale dhe dënime të formës së prerë në rastet e korrupsionit. Numri i përgjithshëm i dënimeve të formës së prerë në gjykatën e apelit, ku përshihen zyrtarë të nivelit të ulët apo të mesëm, është rritur nga 103 në vitin 2014 në 286 në vitin 2015. Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2016, ka patur 154 dënime të formës së prerë në gjykatën e apelit, krahasuar me 132 dënime gjatë të njëjtës periudhë të vitit të kaluar.

Lidhur me dënimet e formës së prerë për zyrtarët e nivelit të lartë, një gjyqtar dhe një avokat u dënuan në gjykatën e apelit në 2015, dhe një rast ku përfshihej një gjyqtar u dërgua në gjykatë dhe rasti mbetet pezull. Në 2016 ka pasur një dënim me burg për një çështje korrupsioni të një ish-ministri; një dënim nga gjykata e shkallës së parë për një prokuror dhe rasti i një prokurori u dërgua në gjykatë.

Në 2015, ILDKPKI dërgoi 75 raste në prokurori, krahasuar me 74 raste të dërguara një vit më parë dhe vendosi 550 sanksione administrative. Nga 75 raste, në 26 ishin të përfshirë zyrtarë të nivelit të lartë (krahasuar me 21 në 2014). Në 2015, tre persona u dënuan me burgim në gjykatë e apelit lidhur me deklarimin e pasurisë. Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2016, ILDKPKI dërgoi 20 raste në prokurori. 11 nga këto raste që kishin të bënin me kryetarë komune u dërguan në gjykatë, nga të cilët shtatë u gjetën fajtor në gjykatën e shkallës së parë.

Parandalimi i konfliktit të interesit kërkon përmirësimin e kuadrit ligjor dhe më shumë kontrolle proaktive, veçanërisht në fushat me rrezik të lartë korrupsioni si për shembull prokurimet publike.

Në 2015, Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) dërgoi në prokurori 51 raste për keqpërdorim të buxhetit të shtetit ku përfshiheshin 156 zyrtarë (në 2014, pati 41 raste ku përfshiheshin 149 zyrtarë). Shpejtësia e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së nga institucionet publike mbetet e ulët.

Zyra e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit (KKK) ka instaluar sistemin e monitorimit të rasteve të korrupsionit. Është bërë pak progres me ngritjen e sistemit të unifikuar elektronik të menaxhimit të çështjeve. Duhet të sigurohet buxheti për mirëmbajtjen dhe zbatimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve në gjykata dhe prokurori.

Kryerja e hetimeve aktive dhe vlerësimet e rreziqeve në shërbimet e taksave dhe doganave është rritur por duhet të përmirësohet më shumë. Vazhdojnë përpjekjet për të adresuar korrupsionin në administratën tatimore dhe doganore, i cili mbetet një çështje shqetësuese.

Në lidhje me mekanizmat e kontrollit të brendshëm, është rritur numri i inspektimeve të Njesisë së Kontrollit të Brendshëm dhe Anti-Korrupsionit të Ministrisë së Brendshme.

Lidhur me aksesin për informacion, gjatë 2015, 274 ankesa u regjistruan në Zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave dhe u dhanë 47 vendime. Duhet të rritet numri i nëpunësve në Zyrën e Komisionerit. Një sistem që të përfshijë numrin e përgjithshëm të kërkesave bërë institucioneve shtetërore mbetet akoma për t'u krijuar.

Korniza institucionale

Për sa i përket masave parandaluese, kapacitetet e rrjetit anti-korrupsion në ministrinë e linjës, në nivel vendor dhe në Zyrën e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit kanë nevojë të forcohen.

Numri i inspektorëve të ILDKPKI-së është rritur nga 12 në 20 në dhjetor. Roli i ILDKPKI-së në zbulimin e konfliktit të interesit dhe në kontrollin e deklarimit të pasurisë është forcuar nëpërmjet miratimit të ligjit të mbrojtjes së sinjalizueseve; gjithashtu edhe nëpërmjet rolit në kuadër të miratimit të ndryshimeve kushtetuese dhe procesit të ligjit të rivlerësimit i cili parashikon që gjyqtarët, prokurorët dhe këshilltarët ligjorë duhet t'i nënshtrohen procesit të vetting-ut. Megjithatë, kapacitetet e saj administrative, teknike dhe financiare kanë nevojë të forcohen më tej, në mënyrë që të përballojë numrin e kontrolleve të deklarimit të pasurive si dhe të ndërmarrë rolin e ri nën ligjin e mbrojtjes së sinjalizueseve.

Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të forcuar rolin e Kontrollin e Lartë të Shtetit (KLSH) në kuadër të anti-korrupsionit. Çështjet e abuzimit me detyrën apo me tender publikë të referuara nga KLSH-ja në prokurori kanë rezultuar në shumë pak hetime dhe asnjë dënim.

Në lidhje me financimin e partive politike, Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) nuk është mjaftueshëm i pavarur dhe fuqiptë për të kontrolluar financimin e partive. KQZ duhet të përcaktojë përgjegjësi të qarta brenda vetes për mbikëqyrjen e financimit të partive dhe duhet të kryejë inspektime thelbësore që shkojnë përtej qasjes veçse formale të kontrollimit të deklarimeve të partive politike. Hapësirat në kuadrin ligjor dhe institucional duhet të adresohen urgjentisht, duke përfshirë mundësinë për të ushtruar normalisht funksionet e mbikëqyrjes dhe monitorimit të shpenzimeve gjatë fushatave elektorale dhe zbulimin e financave të fushatës parazgjedhore, para ditës së zgjedhjeve.

Shkolla e Administratës Publike ka prezantuar një kurrikul të re trajnimi për zyrtarët publikë mbi mirë-qeverisjen dhe anti-korrupsionin. Është ngritur një sistem i menaxhimit të riskut të integritetit.

Qeveria ka vazhduar së zbatuari fushatën e ndërgjegjësimit të lançuar në 2015 dhe procedurën e unifikuar të ankesave për korrupsion. Mekanizmi i raportimit ka rezultuar të jetë një iniciativë pozitive. Megjithatë menaxhimi i ankesave të qytetarëve mbetet i vështirë në nivelin vendor për shkak të burimeve njerëzore të limituara.

Spektori i edukimit mbetet një fushë me rrezik të lartë korrupsionit. Emrat dhe renditja e mësuesve të cilët kaluan testin kombëtar dhe atyre të sapo rekrutuar duhet të publikohen online në mënyrë që të ketë transparencë të plotë në procedurat e rekrutimit.

Përfshirja e shoqërisë civile në ndërgjegjësimin e publikut, monitorimin dhe denoncimin e korrupsionit, si dhe mbikëqyrjen e performacës së trupës anti-korrupsion mbetet e dobët.

Mbi zbatimin e ligjit, reforma kushtetuese e miratuar në korrik si dhe ligji organik përkatës i miratuar në tetor i hapin rrugën krijimit të një zinxhiri organesh hetimore anti-korrupsion, të cilët janë të specializuar dhe të pavarur, dhe që përbëhet nga Byroja Kombëtare e Hetimit, prokuroria dhe gjykata speciale.

Është përmirësuar aksesimi i policisë dhe prokurorisë në bazat e të dhënave publike (*shih kapitullin 24 – Lufta ndaj krimit të organizuar*). Prokuroria e Përgjithshme ka rritur numrin e stafit të saj në sektorin e antikorrupsionit. Megjithatë mbetet shqetësuese lëvizja e shpeshtë e stafit dhe bashkëpunimi jo i mjaftueshëm ndër-institucional. Nevojitet të forcohen burimet financiare, njerëzore dhe teknike të organeve ligjzbatuese.

Kryerja e hetimeve proaktive dhe të efektshme duhet të rritet ndjeshëm për të zhvilluar rezultate bindëse me hetime, ndjekje penale dhe dënime në çështjet e korrupsionit. Mbeten akoma për tu bërë amendamentet ligjore në lidhje me përgjimin dhe survejimin, limitet kohore për hetime dhe pranimin e provës para gjykatës.

Sekuestrimi dhe konfiskimi i aseteve kriminale duhet të kryhet sistematikisht me qëllim kapjen dhe ndërprerjen e lëvizjeve financiare të rrjeteve kriminale. Kryerja e hetimeve dhe ndjekjeve së krimeve financiare dhe pastrimin e parave vuajnë mungesën e një baze të dhënash që t'i mundësojë policisë aksesin për kryerjen e një analize të thelluar të transaksioneve të dyshimta. Analiza për identifikimin e sektorëve me rrezik për korrupsion nuk kryhen sistematikisht.

Bashkëpunimi ndërmjet policisë, prokurorisë, Këshillit të Lartë të Kontrollit dhe shërbimit të prokurimeve për të luftuar korrupsionin në sektorin e prokurimeve ka nevojë të përmirësohet. Policia ka mbetur e cenuar ndaj korrupsionit pavarësisht rritjes së konsiderueshme të hetimeve të brendshme.

Kuadri ligjor

Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve u miratua në qershor. Ligji i integritetit të zyrtarëve të lartë shtetëror është miratuar në dhjetor, duke vënë bazat ligjore për promovimin e integritetit në shërbimin civil. Ligji për ngritjen e prokurorisë speciale dhe gjykatës për të luftuar korrupsionin u miratua në tetor 2016.

Mbeten për tu miratua amendamente të Kodit të Procedurës Penale për të përmirësuar kuadrin për hetime efektive dhe të jepet një përkufizim i qartë i “zyrtar i nivelit të lartë”.

Raporti i vitit 2016 nga Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO) gjeti që Shqipëria ka përafërsisht legjislacionin e saj me rekomandimet e bëra në raundit e katër për parandalimin e korrupsionit të deputetëve, gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Kuadri strategjik

Implementimi i Strategjisë Ndër-sektoriale Anti-korrupsion (2015-20) dhe plani i veprimit (2015-17) monitorohet nga grupi tematik kundër korrupsionit, si pjesë e grupit ndër-institucional për menaxhimin e politikave të integruara. Grupi tematik kryesohet nga Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit dhe përbëhet nga ministritë e linjës dhe institucionet e pavarura, përfshirë përfaqësues të pikave të kontaktit për anti-korrupsion. Çdo institucion zbatues duhet të raportojë mbi progresin e zbatimit të planit të veprimit.

Raportimi vjetor i monitorimit mbi zbatimin e planit të veprimit në 2015, i cili u finalizua në prill, gjeti që shumica dërmuese e masave janë zbatuar. Megjithatë është treguar që niveli i llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së rrjetit të anti-korrupsionit është i dobët. Ndërkohë që plani i veprimit përmban indikatorët specifikë dhe buxhetim për shumicën e aktivitetet, ka

akoma një boshllëk financiar. Për më shumë, duhet të ngrihet një kornizë e mirëfilltë për vlerësimin e performancës. Indikatorët tregues të vlerësimit të performancës duhet të përmirësohen më shumë. Mbetet shqetësuese mungesa e burimeve njerëzore dhe financiare për zbatimin e masave dhe raportimin e progresit.

Të drejtat themelore

Shqipëria vijon përputhjen me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Ajo ka ratifikuar shumicën e konventave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe humanitare. Gjithsesi, ajo duhet të ndërmarrë veprime të mëtejshme për të garantuar zbatimin e plotë të tyre.

Shqipëria vijon të garantojë bashkëpunimin e mirë me Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ). Që prej shtatorit të vitit 2015, kjo Gjykatë ka konstatuar të paktën një shkelje të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) në nëntë gjykime, që lidhen kryesisht me të drejtën për gjykim të drejtë dhe mbrojtjen e pronës. Një numër i përgjithshëm prej 166 aplikimesh të reja i janë caktuar një organi vendim-marrës, duke e çuar numrin e aplikimeve të mbetura pezull në 486. Në mars, GJEDNJ-ja filloi shqyrtimin e çështjeve që lidhen me ngjarjet e 21 janarit 2011.

Në fushën e promovimit dhe zbatimit të të drejtave të njeriut, Avokati i Popullit vijon promovimin në mënyrë aktive të të drejtave të grupeve të cenuara. Në 2015, nga 349 rekomandime të adresuara, vetëm 160 janë pranuar, 68 kanë mbetur pa përgjigje dhe 54 të tjera janë refuzuar, ndërsa pjesa tjetër po shqyrtohen. Puna e Avokatit të Popullit vazhdon të jetë e kufizuar për shkak të mungesës së fondeve dhe personelit, dhe burimet e zyrave qendrore e vendore duhet të rriten për të garantuar veprimtarinë e kënaqshme të tyre. Në vitin 2016, alokimi në buxhetin e tij u rrit paksa, gjë e cila do të mundësojë rekrutimin e Komisionerëve për të Drejtat e Fëmijëve dhe për Parandalimin e Torturës. Gjithsesi, dy komisionerët nuk janë miratuar ende, ose për shkak të numrit të pamjaftueshëm të kandidatëve, ose për shkak të mospërmbushjes së kërkesave ligjore nga ana e tyre.

Shumica e ankesave të dorëzuara në institucionin e Avokatit të Popullit vijojnë të lidhen me të drejtat sociale, kryesisht kujdesin shëndetësor, çështjet e pensionit, punësimin, arsimin dhe strehimin, si dhe dështimin e administratës shtetërore për të vepruar brenda afateve ligjore të parashikuara me ligj.

Për sa i përket të drejtës për të jetuar, rekomandimet dhe rezoluta e parlamentit, e marsit të vitit 2015, mbi gjakmarrjen kërkon ndjekje të çështjes. Duhet të riaktivizohet Këshilli Koordinues.

Për parandalimin e torturës dhe keqtrajtimit, mekanizmi kombëtar parandalues ka kryer 130 inspektime dhe vizita monitoruese për vitin 2015. Rezultojnë se 67 rekomandime janë pranuar dhe shumica e tyre janë adresuar. Në vitin 2015, mekanizmi kombëtar parandalues dhe Zyra e Avokatit të Popullit ka trajtuar 42 ankesa për përdorim jo-proporcional të forcës dhe dhunës nga ana e oficerëve të policisë dhe rojeve të burgut, nga të cilat 10 janë gjetur të ketë arsye të vlefshme. Këto raste janë ende nën hetim.

Sa i përket sistemit të burgjeve, lirimi i 968 të burgosurve nëpërmjet amnistisë së janarit 2016, ka ulur ndjeshëm numrin e të burgosurve. Megjithatë, mbipopullimi mbetet një çështje e

ndjeshme dhe rrit rrezikun për të arritur tek trajtimi çnjerëzor dhe degradues i te burgosurve. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka hartuar një dokument politikash për uljen e mbipopullimit. Kjo, së bashku me hapjen e dy objekteve të reja të paraburgimit në Fier dhe në Berat dhe rinovimin e burgut në Tiranë, duhet të kontribuojnë në uljen e mbipopullimit. Konfidencialiteti i bisedave të paraburgosurve me vizitorët, dhe standardet adekuate shëndetësore dhe të higjienës mbeten për t'u siguruar. Shqetësime serioze vazhdon te ketë lidhur me mungesën e një instituti mjekësor dhe shërbimet e duhura shëndetësore për të burgosurit me sëmundje mendore. Mendërisht te ndaluarit e sëmurë vazhdojnë të mbahen në kushte të papërshtatshme në spitalin e burgut te Krujës.

Përdorimi i dënimeve alternativave për paraburgim është rritur me 48%, nga 4 003 raste në vitin 2014 në 5 927 në vitin 2015. Përdorimi i monitorimit elektronik është rritur gjithashtu, nga tetë raste në vitin 2013 në 15 raste në vitin 2015. Numri i stafit të shërbimit të provës mbetet ende i vogël, nevojitet rritje e numrit te stafit. Memorandumi i bashkëpunimit midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë mbi ngritjen e kurseve profesionale në burgje si pjesë e programeve të para-lirimit është ende për t'u zbatuar në praktikë. Legjislacioni i burgjeve ekzistuese duhet të zbatohet në mënyrë efektive dhe në përputhje me standardet. Korrupsioni në sistemin e burgjeve mbetet ende një shqetësim serioz.

Në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave vazhdon të jetë me staf të paplotësuar. Numri i përgjithshëm i ankesave të dorëzuara në zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave u rrit në 477 gjatë periudhës së raportimit, nga 232 ankesa që ishin vitin e kaluar për të njëjtën periudhë. Numri falas i telefonit dhe mekanizmi elektronik për bërjen e ankesave vazhdon të jetë funksional. Numri i fushatave ndërgjegjësuere është rritur, ndërsa numri i sesioneve trajnuese për stafin e zyrës së Komisionerit duhet të rritet më tej.

Fusha e përgjegjësisë dhe ngarkesa e punës së Komisionerit është rritur për shkak të dispozitave ligjore që e ngarkojnë atë me detyrën e monitorimit të zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit. Gjithsesi, kjo shtrirje e mandatit të saj nuk është shoqëruar edhe me rritje të kapacitetit e buxhetit të tij. Nuk janë ndërmarrë hapa për të siguruar pavarësinë e Komisionerit, në veçanti për emërimet dhe shkarkimet. Publikimi i vendimeve gjyqësore nuk respekton gjithmonë parimet e mbrojtjes së të dhënave.

Liria e mendimit, ndërgjegjës dhe besimit janë respektuar në përgjithësi. Një nismë e qeverisë për futjen e edukatës dhe historisë fetare si lëndë e detyrueshme në shkolla, që synon të parandalojë radikalizmin dhe të mbështesë dialogun ndërfaqetor, është kritikuar nga akademikët dhe shoqëria civile. Nuk janë ndërmarrë masa për zbatimin e kësaj nisme. Kisha Ortodokse Autoqefale në Shqipëri ngriti shqetësimet rreth zbatimit të marrëveshjes me qeverinë për kthimin e pronave të konfiskuara gjatë regjimit komunist.

Në fushën e lirisë së shprehjes, në vitin 2016, janë raportuar dhe janë ndjekur nga prokuroria dy raste të ushtrimit të dhunës fizike ndaj gazetarëve. Mediat kanë raportuar raste që kanë të bëjnë me kërcënime kundër gazetarëve, megjithëse mbetet për t'u verifikuar nëse këto janë nxitur nga puna e gazetarisë apo nga interesat private a të biznesit.

Zbatimi i ligjit për median audio-vizuale ka qenë i ngadaltë në përgjithësi, kjo për shkak të mungesës së kuorumit brenda bordit të Autoritetit të Medias Audiovizive (AMA) dhe vonesave në plotësimin e vendeve vakante. Vendet vakante në bord u plotësuan në korrik. AMA ka filluar një fushatë publike të informimit rreth procesit të digjitalizimit dhe po punon me televizionin publik mbi kushtet e shërbimeve të digjitalizuar që ajo do të ofrojë. Gjithsesi, AMA dështoi në dhënien e licencave digjitale për operatorët tregtarë brenda afatit. AMA është ristrukturuar dhe ka shtuar stafin. AMA, gjithashtu, ka miratuar Kodin e Etikës dhe Kodin e Sjelljes së anëtarëve të saj, si dhe ka ngritur Këshillin e Etikeve.

Një propozim i qeverisë në nëntor për të ri-kriminalizuar shpifjen dhe fyerjen, u tërhoq pas kritikave të rënda nga organizatat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe komuniteti i medias. Nuk ka pasur raste të padive gjyqësore për shpifje nga politikanët kundër gazetarëve. Gjithsesi, nevojiten masa të mëtejshme për të garantuar zbatimin efikas të ndryshimeve për shpifje dhe udhëzimet për përcaktimin e dëmeve në nivel të arsyeshëm. Mjetet kryesore për arritjen e kësaj janë trajnimet për gjyqësorin. Nevojiten përpjekje të mëtejshme edhe për zbatimin e rregullave për ankimet e publikut kundër mediave, siç parashikohet në ligjin për median audiovizive dhe për të ngritur organe e nisma që adresojnë ankesat e lexuesit/shikuesit me efikasitet. Në korrik, këshilli drejtues i televizionit publik (RTSH) krijoi Këshillin e Shikuesve dhe Dëgjuesve.

Pas krijimit të këshillit drejtues të RTSH-së në prill, problemet në procesin e votimit çuan në vonesën për emërimin e drejtorit të përgjithshëm dhe për pasojë, dështimin e RTSH-së për të miratuar statutin e saj, zgjedhur strukturat menaxhuese dhe për të miratuar udhëzimet e tjera. Në maj u zgjodh drejtori i ri, pas ndryshimeve në ligjin për median audiovizive, që prezantoi një metodë të re zgjedhjeje.

Financimi i televizionit publik është relativisht i qëndrueshëm, falë mbledhjes së taksave nga dhënia e licencave. RTSH-ja duhet të miratojë statutin e saj të brendshëm, duke i kushtuar vëmendje të veçantë përgjegjësisë në të gjitha nivelet e menaxhimit dhe mbrojtjes me mjete të duhura të pavarësisë editoriale. Televizioni publik duhet, gjithashtu, të përfundojë strategjinë e tij institucionale dhe udhëzuesit editorial.

Në maj, me kërkesë të kompanive më kryesore të medias audiovizive, Gjykata Kushtetuese suprimoi kufizimet e zotërimit në rregulloret e medias audiovizive, duke anuluar kështu mekanizmin ligjor që kërkon garantimin e pluralizmit në pronësinë e medias. Në mënyrë që të garantojë transparencë në financimin e mediave, Shqipëria duhet të prezantojë dispozitat ligjore për reklamimet shtetërore që përputhen me standardet më të mira ndërkombëtare. Media vijon të përdoret si mjet për promovimin e interesave politike dhe private.

Duhet të miratohen ndryshimet që kërkojnë vendosjen e rregullave në kuadër të rregullimit të tregtisë elektronike (e-commerce) për komentet mbi faqet e internetit. Vetë-rregullimi i medias elektronike duhet të prezantohet në mënyrë që të kufizojë gjuhën e urrejtjes së prodhuar nga përdoruesi. Gjuha e urrejtjes në internet (online) duhet të përcaktohet me terma që janë të ngjashme me përkufizimin gjuhës së urrejtjes offline (p.sh. si gjuha që nxit dhunën) në mënyrë që përkufizimi të mos ndryshojë në varësi të llojit të teknologjisë së përdorur.

Liria e tubimit dhe organizimit është respektuar. Në përgjithësi, janë organizuar protesta dhe demonstrata politike por pa incidente madhore.

Lidhur me te drejtat e pronës, ligji i ri për kompensimin e pronave të konfiskuara gjatë periudhës së komunizmit u miratua në dhjetor. Ai parashikon ngritjen e një mekanizmi kombëtar për kompensim, së bashku me një formulë të kompensimit dhe mjetet financiare për zbatimin e procesit. Ligji ka hyrë në fuqi në shkurt. Megjithatë, kushtetutshmëria e saj është sfiduar në Gjykatën Kushtetuese pas ankesave rreth mungesës së transparencës, sigurisë juridike dhe barazisë së trajtimit, dhe rrezikun e efektivitetit të ligjit i penguar nga mungesa e një kadastrë të plotë. Me kërkesë të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni i Venecias miratoi një *curiaebrief curiae*, duke vlerësuar pajtueshmërinë e ligjit me normat evropiane. Komisioni i Venecias theksoi se përputhshmëria do të varet nga zbatimi efektiv i ligjit dhe ekzekutimi i tij nga ana e autoriteteve.

Në zbatimin e vendimeve të GJEDNJ-së, kompensimi financiar është në vazhdim, por shumat kanë mbetur ende te papaguara, duke përfshirë dhe kamatëvonesat. Strategjia 2012-2020 për të drejtat e pronësisë duhet të përmirësohet duke pasqyruar dispozitat e reja ligjore dhe të sigurojë koordinim mes proceseve të kthimit, kompensimit dhe legalizimit. Duhet të emërohet një koordinator kombëtar për të drejtat e pronësisë. Procesi i vazhdueshëm i regjistrimit dhe planifikimit të pronës, duke përfshirë procesin e digjitalizimit të pronës, duhet të finalizohet dhe duhet të ndahet pronësia që ka mbivendosje.

Në fushën e politikave anti-diskriminuese, Komisioneri për Mbrojtjes ndaj Diskriminimit (KMD) ka dorëzuar një numër pak më të vogël të rasteve, ndërkohë që ka rritur numrin e veprimeve që ka ndërmarrë me iniciativën e tij. Pjesëmarrja e tij në procese gjyqësore është dyfishuar, krahasuar me vitin 2014. Për periudhën e raportimit, KMD-ja ka vendosur 11 masa ndëshkimore.

Në fushën e krimeve të urrejtjes, Policia e Shtetit ka caktuar pikën fokale. Gjithsesi, numri i rasteve të raportuara mbetet i papërfillshëm dhe nuk është filluar asnjë ndjekje gjyqësore. Vijon mungesa e mbledhjes së të dhënave për krimet e urrejtjes. KMD-ja ka trajtuar çështje të gjuhës së urrejtjes që shënjestrojnë komunitetin LGBTI dhe në dy raste, KMD-ja ka vendosur gjopa ndaj autorëve. KMD-ja vijon të organizojë fushata ndërgjegjësimi dhe aktivitete trajnuese. Jurisprudenca anti-diskriminim duhet të zhvillohet më tej dhe zbatimi i saj duhet të përmirësohet.

Në fushën e barazisë gjinore mes burrave dhe grave, është përgatitur një strategji kombëtare për barazinë gjinore, por ende nuk është miratuar. Një sërë ligjesh vazhdojnë të përmbajnë dispozita diskriminuese me bazë gjinore. Mbeten shqetësimet mbi diskriminimin kundër dhe mungesa e legjislacionit të përshtatshëm apo masave për mbrojtjes e grave dhe vajzave që i përkasin grupeve të marginalizuara apo të pa-favorizuara. Nevojitet punë e mëtejshme për të siguruar aksesin e lirë të grave në sistemin e drejtësisë, rritjen e ndërgjegjësimit për ligjet ekzistuese dhe për të garantuar ekzekutimin e urdhrave të gjyqit për të forcuar të drejtat e grave. Vitin e kaluar, qeveria ka shtuar përpjekjet për të bërë barazinë gjinore qendrore në planifikimin dhe buxhetimin për zhvillimin kombëtar dhe integrimin në BE, duke prezantuar buxhetin e përgjithshëm gjinor në nëntë ministri dhe duke e filluar atë në shtatë bashki. Përfshirja gjinore në programin buxhetor afatmesëm, në nivel bashkie, duhet të reflektohet në legjislacionin kombëtar përkatës. Pikat fokale të barazisë gjinore nuk janë ngritur ende në nivel kombëtar e vendor.

Nërkohë që përforcimi i politikave për barazi gjinore, në përgjithësi, ka avancuar, zbatimi i tyre mbetet sfidë. Dhuna familjare mbetet shqetësimi serioz. Në vitin 2015, policia ka raportuar 3886 raste të dhunës familjare dhe krimeve të tjera në familje, ku 2148 rezultojnë të kenë fituar urdhra mbrojtje. Për 1300 raste të dhunës në familje janë filluar procedurat penale dhe janë dërguar për ndjekje. 74% e viktimave të dhunës në familje janë gra, që tregojnë dhe dallimin me bazë gjinore të dhunës.

Sistemi elektronik për raportimin e dhunës me bazë gjinore ende funksionon në vetëm 29 nga 61 bashki. Nevojitet koordinim më i mirë mes organeve të barazisë dhe palëve përkatëse në të gjitha nivelet, përfshirë mekanizmin kombëtar të referimit, në mënyrë që të maksimizojë rezultatet në luftën kundër dhunës me bazë gjinore. Shërbimet për viktimat e dhunës familjare duhet të përmirësohen në cilësi, sasi, akses dhe mbulim gjeografik.

Në fushën e të drejtave të fëmijëve, ka filluar rishikimi i ligjit aktual për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Në tetor ka përfunduar krijimi i sistemit gjithëpërfshirës për mbrojtjen e fëmijës. Në vazhdim të çështjes, në dhjetor u publikua dokumenti i politikave që përcakton vizionin e qeverisë për sistemin e ardhshëm të integruar.

Direktiva e përbashkët, e miratuar nga katër ministri në fillim të vitit 2015, është zbatuar gjithnjë e më shumë për të garantuar bashkëpunimin mes organeve qendrore dhe institucioneve të varësisë për rastet që kërkojnë masa mbrojtëse.

Gjatë vitit 2015, 243 fëmijë që jetojnë ose punojnë në rrugë dhe familjet e tyre, si dhe 102 fëmijë të tjerë gjatë gjysmës së parë të vitit 2016 janë marrë në mbrojtje. Shërbimet e ofruara për këto familje përfshijnë këshillimin, regjistrimin e fëmijëve në shkollë, kopshte dhe çerdhe, aplikimet për asistencë financiare dhe kujdesin shëndetësor.

Nevojitet të përmirësohen mekanizmat e mbledhjes së të dhënave dhe raportimit dhe po ashtu të përmirësohen koordinimi ndër-sektorial dhe ndër-institucional e mekanizmat koordinuese.

Reforma territoriale ka patur një ndikim prishës në funksionimin e njësive për mbrojtjen e fëmijëve, për shkak të riorganizimit të madh të stafit, në veçanti, të stafit të trajnuar për mbrojtjen e fëmijëve dhe për shkak të reduktimit të numrit të punonjësve për mbrojtjen e fëmijëve për person, kjo në veçanti në zonat rurale. Është e rëndësishme madhore që të përmirësohen shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve.

Emigrimi i të miturve të pashoqëruar nga Shqipëria drejt Shteteve Anëtare mbetet shqetësim serioz. Në tetor është ngritur një grup ndër-institucional për të rishikuar legjislacionin përkatës duke pasur parasysh trajtimin e këtij fenomeni. Gjatë periudhës shtator 2015- mars 2016, 18 raste janë kallëzuar në prokurori për keqtrajtim të të miturve.

Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të përafruar legjislacionin ekzistues me standardet ndërkombëtare dhe për t'u tërhequr nga metoda ndëshkuese për të rinjtë që shkelin ligjin. Janë rishikuar një sërë ligjesh në kuadër të reformës në drejtësi, për të përafruar gjykimin e të rinjve në përputhje me standardet e Kombeve të Bashkuara. Po hartohen një kod i veçantë juridik për të rinjtë dhe një strategji për drejtësinë e fëmijëve. Në vitin 2015, 130 fëmijë më pak sesa në vitin 2014 janë dërguar në mjediset e paraburgimit dhe koha mesatare e mbajtjes në paraburgim është reduktuar. Gjithsesi, ende mungojnë planifikimi, buxheti dhe ri-edukimi i përshtatshëm i bazuar në komunitet dhe programet e ri-integrimit të fëmijëve që

shkelin ligjin. Disa kategori të fëmijëve, siç janë ato nga minoritetet etnike, fëmijët me aftësi të kufizuara, vajzat dhe fëmijët që jetojnë në zonat rurale, përballen me sfida në marrjen e mbrojtjes juridike.

Në fushën e personave me aftësi të kufizuara, kuadri ligjor është në fuqi dhe është në përputhje të pjesshme me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (CRPD). Një sërë nenesh, në veçanti, neni 12 i CRPD-së, nuk janë transpozuar ende në legjislacionin kombëtar. Një vendim i qeverisë, për të hequr barrierat mjedisore dhe infrastrukturore në ofrimin e shërbimeve publike, u miratua ën dhjetor. Plani i Veprimit për personat me aftësi të kufizuara 2016- 2020, u miratua në qershor. Gjithsesi, bashkitë dhe shumica e ministrive të linjave ende nuk kanë emëruar një zyrtar përgjegjës për çështjet e aftësive të kufizuara, siç parashikohet me ligj.

Në përgjithësi, personat me aftësi të kufizuara vazhdojnë të përballen me vështirësi në arsim, punësim, kujdes shëndetësor, shërbime sociale dhe vendim-marrje, përfshirë pengesat që nuk i lejojnë të ushtrojnë lirshëm të drejtën e votës. Monitorimi i zbatimit të masave që lidhen me aftësitë e kufizuara pengohet nga mungesa e të dhënave në dispozicion. Pavarësisht disa përpjekjeve, numri i mësuesve ndihmës nëpër shkolla, për të ndihmuar fëmijët me aftësi të kufizuara, është i pamjaftueshëm.

Në fushën e të drejtave të personave lesbike, homoseksualë, biseksualë, transeksualë dhe ndërgjinorë (LGBTI), është miratuar në maj një plan veprimi për të drejtat e LGBTI 2016-2020. Orientimi seksual dhe identiteti gjinor janë fusha të mbrojtura nga diskriminimi në Kodine Punës.

Qendra “Streha” për personat LGBTI, që mbështetet tërësisht nga donacionet, vazhdon të ofrojë shërbime për anëtarët e komunitetit në nevojë. Në shkurt, u firmos marrëveshja e bashkëpunimit mes ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe strehës. Në maj u organizua një event për mbledhjen e burimeve të nevojshme për të vazhduar veprimtarinë e strehës. Po ashtu, në maj, janë organizuar një sërë evente rreth ditës ndërkombëtare kundër homofobisë, transfobisë dhe biofobisë. Ndërgjegjësimi i publikut dhe pranimi në shoqëri mbetet në nivele të ulëta, në veçanti në zonat rurale. Ndryshimet në kodin e familjes, për të prezantuar konceptin e bashkëjetesës së çifteve të të njëjtit seks, ende nuk janë miratuar.

Çështjet e të drejtës së punës dhe të bashkimit në sindikata mbulohen në kapitullin e 19.

Në fushën e të drejtave procedural, duhet më shumë punë për të garantuar të drejtën e informimit, aksesin në ndihmë dhe këshillim ligjor dhe masë sigurimi të veçantë për të dyshuarit, personat e akuzuar dhe viktimat e krimit. Disa masa sigurimi procedurale bazë janë në fuqi, por nevojiten më shumë përpjekje për të rritur nivelin e mbrojtjes së ofruar nga legjislacioni ekzistues. Megjithëse të drejtat bazë procedural për viktimat dhe familjet e tyre parashikohen me ligj, kërkohen përpjekje të mëtejshme për të garantuar zbatimin e duhur, i cili mbron viktimat dhe familjet e tyre në kontekstin e procedurave penale, përfshirë ofrimin e ndihmës ligjore falas. Nuk ka dispozita ligjore në fuqi që cilat garantojnë të drejtat e viktimave për të aksesuar shërbime mbështetëse, përfshirë mbështetjen procedural, emocionale dhe psikologjike, sipas nevojave të viktimave dhe anëtarëve të familjes. Për aksesin në drejtësi, Komisioni Shtetëror për Ndihmë Ligjore ende nuk ka zhvilluar ndonjë mekanizëm për shtrirjen dhe aksesin e shërbimeve të tij, përfshirë ato në nivel rajonal. Pjesa më e madhe e

rasteve që përfshijnë grupet e cenuara trajtohen nga organizatat e shoqërisë civile, me mbështetjen e donatorëve. Parashikohet një reformë në sistemin e ndihmës ligjore në kuadër të reformës në vazhdim të drejtësisë.

Për sa i përket respektimit dhe mbrojtjes së minoriteteve, janë ndërmarrë disa hapa për përmirësimin e kuadrit ligjor. Ministria e Punëve të Jashtme ka ngritur një grup pune për të hartuar një ligj gjithëpërfshirës për mbrojtjen e minoriteteve. Është zhvilluar një proces i gjerë konsultimesh me përfshirjen e institucioneve të pavarura, shoqatat e minoriteteve, organizata të shoqërisë civile dhe ndërkombëtare. Grupi i punës tashmë duhet të përfundojë punën shpejtë dhe të finalizojë procesin e hartimit të ligjit që duhet të ketë për qëllim garantimin e aksesit të barabartë për personat e të gjitha minoriteteve. Shqipëria ende nuk ka miratuar Kartën Evropiane për gjuhët rajonale dhe minoritare. Funkzioni dhe kapaciteti i Komitetit Shtetëror për Minoritetet mbetet i kufizuar dhe duhet të përforcohet. Në përgjithësi, marrëdhëniet ndër-etnike mbeten të mira.

Romët dhe Egjiptianët vazhdojnë të përballen me kushtet e vështira dhe diskriminimin e shpeshtë, në veçanti, në aksesimin e arsimit, punësimit, strehimit, shëndetit dhe regjistrimit civil. Plani i veprimit për integrimin e romëve 2016- 2020 u miratua në dhjetor. Buxheti i shtetit do të financojë 55% të veprimeve, ndërsa pjesa tjetër do të sigurohet nga donatorët. Konferenca e tretë BE- Shqipëri për përfshirjen e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, e mbajtur në prill, doli në disa konkluzione operacionale, të cilat përcaktuan prioritetet kryesore për dy vitet e ardhshme.

Kushtet e jetesës mbeten të dobëta, ku një pjesë e romëve nuk kanë akses në furnizimin me ujë të rrjedhshëm në shtëpi. Është miratuar strategjia kombëtare për strehim 2016- 2025. Kjo strategji synon të përmirësojë kuadrin institucional, ligjor dhe rregullator për shtëpitë me të ardhura të pakta ose mesatare, përfshirë Romët. Fëmijët rome që jetojnë ose punojnë në rrugë mbeten shqetësuar, pavarësisht përpjekjeve për të reduktuar këtë fenomen duke marrë në mbrojtje fëmijët e rrugës dhe familjet e tyre. Martesa me fëmijë mbetet një praktikë shqetësuese, e cila përfshin rreth 2.9% të fëmijëve rome, të grupmoshës 15-18 vjeç. Regjistrimi civil është përmirësuar, por nevojiten përpjekje të mëtejshme, në veçanti për të lehtësuar transferimin e regjistrimit mes bashkive dhe të fëmijëve të lindur jashtë vendit. Mungesa e regjistrimit shpesh pengon aksesin në mbështetjen sociale.

Përfshirja e fëmijëve rome në sistemin e arsimit vijon të përmirësohet, por mbetet në nivelet më të ulëta në rajon. Shkëputja nga shkolla është çështje tepër shqetësuese. Sistemi elektronik i mbledhjes së të dhënave “Romalb” funksionon pjesërisht dhe kërkohen trajnime gjatë punës për të garantuar përdorimin e tij nga të gjitha njësitë e qeverisjes vendore.

Si rezultat i dialogut të mbajtur në bashkinë e Tiranës me 72 familje që preken nga shpronësimi i planifikuar në zonën e Bregut të Lumit, shpronësimi ka ndaluar dhe po bëhen përpjekje për gjetjen e zgjidhjeve alternative të strehimit. Kjo ka shënuar progres të qartë në trajtimin e çështjes së shpronësimi, krahasuar me rastin e mëparshëm tek liqeni artificial i Tiranës, ku rreth 44 familje u shpronësuan në tetor 2015 pa dialoguar në mënyrën e duhur me familjet në fjalë. Shqipëria ende ka për të miratuar udhëzimet për shpronësimet, në përputhje me standardet ndërkombëtare, si dhe për të trajnuar institucionet vendore dhe kombëtare për procedurat që duhet të ndiqen para, gjatë dhe pas shpronësimit.

4.24. Kapitulli 24: Drejtësia, liria dhe siguria

Bashkimi Evropian ka rregulla të përbashkëta për kontrollin kufitar, vizat, migracionin e jashtëm dhe azilin. Bashkëpunimi Schengen përbën ngritjen e kontrolleve kufitare brenda BE-së. Ka gjithashtu bashkëpunim në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit, si dhe bashkëpunimin gjyqësor, policor dhe të doganave.

Shqipëria ka arritur një **nivel të mirë të përgatitjes** për zbatimin e *acquis* dhe të standardeve Evropiane në këtë fushë. Janë bërë **disa përparime**. Janë marrë masa për të përmirësuar kapacitetin institucional për menaxhimin e kufijve, azilin dhe luftën kundër terrorizmit. Drejtoria e Anti-terrorit ka rritur kapacitetin e saj. Ndryshimet organizative në agjencitë ligjzbatuese janë paraqitur dhe legjislacioni baze është adaptuar, veçanërisht me organizimin e ri të policisë. Megjithatë, policia nuk ka akoma akses të drejtpërdrejtë në regjistrat kyç publik. Pak progres është arritur në përmbushjen e rekomandimeve të vitit të kaluar. Numri i hetimeve të përbashkëta të bazuar në informacion sekret mbetet i kufizuar. Numri i aplikimeve të pabazuara të azilit ngritur nga bashkëkombësit shqiptarë në BE mbetet në një nivel të qëndrueshëm dhe kërkon veprim konkret. Në vitin që vjen, Shqipëria duhet në veçanti:

→ të rrisë numrin e hetimeve të bazuar në informacion sekret dhe hetimeve financiare për pastrimin e parave dhe trafikimin e drogës dhe të rrisë konfiskimet e pasurisë së fituar me rrugë kriminale;

→ të rrisë më shumë kapacitetet operationale dhe logjistike të Drejtorisë së Anti-Terrorit, veçanërisht për sa i përket investigimeve speciale dhe operacioneve siç janë mbikëqyrja dhe përgjimet;

→ të tregojë progres të mëtjshëm në ngritjen e një historiku solid të investigimeve, ndjekjeve dhe dënimeve në luftën kundër krimit të organizuar;

→ të ndërmarrë veprime të menjëhershme dhe të vendosur, duke përfshirë edhe mekanizmin e monitorimit të procesit pas liberalizimit të vizave, për të adresuar efektivisht aplikimet e pabazuara të azilit në BE dhe të përmirësojë më tej kapacitetin e saj për tu marrë me flukset e përziera të migracionit.

(referojuni dhe rekomandimeve të veçanta mbi luftën kundër krimit të organizuar në seksionin 2.3)

Migracioni ligjor dhe i parregullt

Kuadri institucional dhe përafrimi ligjor

Kuadri ligjor është gjerësisht në përputhje me *acquis*. Në mars, Shqipëria miratoi ligjin për identifikimin dhe regjistrimin e shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit. Ndryshimet në ligjin për të huajt (që mbulojnë migrimin ligjor/ e parregullt) janë miratuar në parlament në korrik.

Mungesa që nga viti 2010 e një **strategjie** kombëtare ndër-sektoriale për migracionin mbetet një çështje shqetësuese. Masat e marra për të integruar çështjet e migracionit në disa strategji sektoriale kombëtare, përfshirë mbrojtjen dhe përfshirjen sociale, punësimin, biznesin dhe

zhvillimin, menaxhimin e integruar të kufirit dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, prodhuan rezultate të kufizuara.

Periudha e zbatimit të strategjisë për ri-integrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer përfundoi në vitin 2015. Puna në për një strategji të re ende nuk ka filluar. Një seksion i veçantë për migracionin është përfshirë në strategjinë kombëtare për zhvillim dhe integrim 2015-2020, të miratuar në maj.

Profili i zgjeruar i migracionit 2012-2014 u miratua në dhjetor. Ministria e Brendshme zbaton dhe koordinon politikën e migracionit në bashkëpunim me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Zbatimi dhe kapaciteti zbatues

Stafi i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Kufirit dhe Migracionit është i kufizuar (1 653 punonjës), në mënyrë të veçantë kundrejt sfondit të krizës së migracionit që ka prekur të gjithë rajonin. Shqipëria duhet të sigurojë trajnimin e duhur të stafit të rojeve kufitare, në përputhje me standardet themelore të trajnimit të rojeve kufitare të BE-së, si programi i përbashkët i Agjencisë së rojës bregdetare dhe e kufijve europian (Frontex).

Shqipëria ka një qendër pritjeje për emigrantët e parregullt në Karrec, me një kapacitet total prej 150 shtretër. Qendra është e pajisur për të akomoduar burra, gra dhe familjet në tre departamente. Nuk ka një objekt për të miturit e pashoqëruar. Mirëmbajtja e dobët e qendrës ka çuar përkeqësimin e saj dhe kërkohet ndërhyrje e menjëhershme. Në vitin 2015, 294 persona u ndaluan në Karrec, ndërsa në gjysmën e parë të vitit 2016 ka pasur 363 persona të ndaluar.

Shqipëria duhet të rrisë kapacitetin e saj për të pritur emigrantët e parregullt, sidomos në afërsi të kufirit me Greqinë. Në vitin 2015, janë kapur 2009 emigrantë të parregullt, kryesisht duke hyrë nga Greqia. Pjesa më e madhe e këtyre kanë ndodhur gjatë gjysmës së parë të vitit 2015 (1 971). Gjysma e dytë e vitit ka shënuar një rënie të papritur, pasi ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë bëri ndryshime legjislative që u sigurojnë refugjatëve/ emigrantëve lirinë e lëvizjes gjatë 72 orëve. Megjithë arrestimin e disa kontrabandistëve, nuk ka asnjë të dhënë deri më tani mbi rrjetet aktive të organizuara të kontrabandës në Shqipëri.

Numri i njerëzve të kthyer në mënyrë efektive në vendin e tyre të origjinës mbetet i ulët. Vetëm dy persona janë kthyer vullnetarisht në 12 muajt e fundit. Shumica e emigrantëve të parregullt u kthyen në vendin e tyre nga shteti përmes të cilit ato hynë në Shqipëri (kryesisht Greqia) me një urdhër-largim vullnetar.

Marrëveshja e ri-pranimit me BE-në është zbatuar në mënyrë të kënaqshme. Megjithatë, vendi duhet të finalizojë negociatat për marrëveshjen e saj të ri-pranimit me Rusinë dhe protokollet e zbatimit me Greqinë dhe Spanjën. Shqipëria gjithashtu duhet të nënshkruajë marrëveshje ri-pranimi me një sërë vendesh të origjinës së migrimit të parregullt, përfshirë Marokun, Afganistanin, Irakun dhe Iranin.

Duhet përpjekje të mëtejshme për të siguruar që kuadri i politikave të emigrimit për qëllime punësimi është koherent dhe që zbatimi nuk dobësohet nga dispozitat ligjore kontradiktore.

Azili

Kuadri institucional dhe përafrimi ligjor

Shqipëria është palë në Konventën e Gjenevës dhe ka miratuar një ligj i ri për azil në vitin 2014, duke përafruar kuadrin e saj ligjor gjerësisht në përputhje me *acquis*. Megjithatë, duke qenë se disa direktiva të BE-së janë përditësuar, mbeten për t'u adresuar disa çështje mbi masat mbrojtëse procedurale dhe garancive. Në veçanti, Shqipëria duhet të shmangë arrestimin e personave në nevojë dhe të miturve, të sigurojë të drejtën e ndihmës juridike për azilkërkuesit dhe të sigurojë akses në informacion në lidhje me të drejtat dhe procedurat për shtetasit e vendeve të treta të arrestuar për azil.

Shqipëria duhet të forcojë kapacitetin e saj të pritjes për azilkërkuesit, sidomos afër kufirit me Greqinë. Në mars, qeveria miratoi një listë të vendeve të treta të sigurta, e cila përfshin të gjithë Shtetet Anëtare të BE-në dhe NATO-s.

Vendi ka institucionet dhe procedurat e nevojshme për të trajtuar kërkesat për azil. Drejtoria për azil është organi i shkallës së parë në Ministrinë e Brendshme, e cili është gjithashtu përgjegjëse për koordinimin e përgjithshëm të politikave në këtë fushë. Ankesat mund të depozitohen në parim në Komisionin Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët. Megjithatë, Komisioni nuk është ngritur plotësisht deri tani, megjithëse se ngritja e tij u miratua në mars.

Ankimi përfundimtar gjyqësor mund të paraqitet në Gjykatën e Lartë. Në shtator të viti 2015, Shqipëria ka përgatitur plani i kontigjencës për një dyndje të mundshme të emigrantëve dhe azilkërkuesve, duke përfshirë një plan operacional që mbulon aktivitete të reagimit dhe përgjigjes, si dhe nevojat që lidhen me to e analizën e boshllëqeve. Plan i kontigjencës është përditësuar në prill; Megjithatë, ai ende nuk është hapur për konsultime publike dhe ende nuk është miratuar zyrtarisht.

Zbatimi dhe kapaciteti zbatues

Drejtoria për azil tashmë ka staf të përshtatshëm (gjashtë persona). Në lidhje me procedurën për azil, kapaciteti për të vlerësuar kërkesat individuale për azil mbetet i dobët. Duhet më shumë trajnim në këtë drejtim, veçanërisht mbi vendet e origjinës, si dhe rastet ku përfshihen njerëzit e cenuar dhe njerëzit që kanë hyrë në vend në mënyrë të parregullt.

Mekanizmat e dobëta të referimit dhe disponueshmëria e kufizuar e përkthyesve janë një çështje shqetësuese. Nevojitet trajnimi i përkthyesve për çështjet që lidhen me ligin për refugjatët dhe teknikat e intervistimit. Përpjekjet për të lehtësuar integrimin social dhe ekonomik të refugjatëve duhet të mbështeten nga një buxhet të besueshëm. Menaxhimin i të dhënave gjithashtu duhet të forcohet. Edhe pse të dhënat biometrike të mbledhura nga policia kufitare dhe e migracionit janë regjistruar në një regjistër, Drejtoria për azil nuk ka qasje në këtë bazë të dhënash, duke kufizuar aftësinë e saj për të menaxhuar në mënyrë efektive rastet. Nuk janë raportuar raste të dëbimit në kufi.

Në vitin 2015, 586 persona aplikuan për azil, nga të cilat 480 ishin nga Muxhahedinët Popullorë të Iranit (PMOI) dhe 106 të kombësive të tjera. Drejtoria për azil lëshuar 39 vendime pozitive, tre për mbrojtjen plotësuese dhe dy vendime negative. Në fund të vitit 2015, 830 azilkërkues janë në pritje të përcaktimit të statusit. Shkalla e njohjes për ata që i nënshtrohen një procedure të plotë për azil është mbi 50%, të gjitha kombësitë të kombinuara. Nga janari deri në gusht të vitit 2016, 1 443 persona aplikuan për azil, nga të cilat 1 355 ishin

nga PMOI. Deri tani, Shqipëria është ende një vend transit. Me përjashtim të zhvendosjes të mirë-organizuar të internuarve PMOI iraniane dhe ish-banorët e lokacionit Camp Hurriya transit të përkohshëm në Irak, shumica e azilkërkuesve zhduken në rrjedhën e procedurës së azilit.

Nuk është një qendër pritjeje në Babrru me një kapacitet prej 80 shtretër, të cilat mund të zgjerohet në një maksimum prej 100 shtretër. Nuk ka strehim i përshtatshëm për të miturit e pashoqëruar. Mungesa e kapacitetit të duhur të pritjes në Tiranë dhe në veçanti përgjatë kufirit jugor të vendit është një burim shqetësimi. Shqipëria bashkëpunon me Zyrën Evropiane Azilit Mbështetjes (EASO), por ky bashkëpunim nuk është i bazuar në një marrëveshje formale. Në 2015 stafi i Ministrisë së Brendshme ka marrë pjesë në tri seancat e trajnimit të organizuara nga EASO.

Politika e vizave

Shqipëria ka ende për të harmonizojë legjislacionin e saj me listat 'pozitive' dhe 'negative' të BE. Gjatë muajve të verës, Shqipëria heq regjimin e vizave për disa vende në listën negative të BE-së. Regjimi i udhëtimit pa viza mes Shqipërisë dhe BE-së ka vazhduar pa pengesa. Megjithatë, fluksi i aplikimeve qartësisht të pabazuara për azil në shtetet anëtare të BE-së dhe vendeve të asociuara të Shengen mbetet në një nivel të qëndrueshëm, me një mesatare prej mbi 2 400 aplikime në muaj në tetë muajt e parë të vitit 2016. Në vitin 2015, shtetas shqiptarë paraqitur 68 750 azil kërkesat në Shtetet anëtare të BE-së dhe vendeve të asociuara Shengen, një rritje prej 297% në vitin 2014. nga janari deri në gusht të vitit 2016, ka qenë pothuajse 20 000 kërkesa për azil. Shtetasit shqiptarë ishin grupi më i madh i azilkërkuesve nga vendet pa viza të Ballkanit Perëndimor (54%) dhe numri më i madh i personave me qëndrim të paligjshëm dhe që kaluan në mënyrë të paligjshme kufirin. Shqipëria ka forcuar procedurat e kontrollit kufitar, por ndërgjegjësimi ishte i kufizuar në paraqitje sporadike publike nga zyrtarët e qeverisë.

Rënia e numrit të kërkesave për azil të paraqitura nga shtetas shqiptarë në shtetet anëtare të BE dhe vendeve të asociuara Schengen që nga shtatori 2015 ishte kryesisht për shkak të masave nga vendet më të prekura, dhe më pak për shkak të masave proaktive të marra nga Shqipëria. Shqipëria duhet të forcojë në mënyrë të konsiderueshme përpjekjet e saj për të adresuar këtë dukuri negative, dhe për të marrë veprim të menjëhershëm dhe të vendosur me anë të mekanizmit të vizave post-monitorues i liberalizimit. Vendi ka nevojë në mënyrë të veçantë për të përmirësuar shkëmbimin e informacionit me vendet e destinacionit, dhe të fillojnë analizimin e të dhënave për të kthyerit në mënyrë që ajo mund të hartë zonat më të prekura gjeografike në vend dhe prioritet rritjen e ndërgjegjësimit dhe mbështetjes socio-ekonomik në përputhje me rrethanat. Të gjitha përpjekjet duhet të vazhdojnë në mënyrë sistematike dhe me alokimin adekuat të burimeve.

Të miturit e pashoqëruar nga Shqipëria mbeti një çështje shqetësuese. Shqipëria ka nevojë për t'u angazhuar në ngritjen e vetëdijes në mesin e aktorëve të qeverisë për të siguruar se të miturit e pashoqëruar janë identifikuar dhe të mbrojtura.

Zona Schengen dhe kufijtë e jashtëm

Kuadri institucional dhe përafrimi ligjor

Ligji mbi kontrollin kufitar, që ka hyrë në fuqi në Gusht, dhe aktet e tij nënligjore janë në përputhje me *acquis*. Megjithatë, **kuadri legjislativ** për menaxhimin e kufijve të jashtëm të Shqipërisë nuk është përshtatur ende me standardet e BE-së. Drejtoria e Përgjithshme për Kufijtë dhe Migracionin është një trup i specializuar Brenda Ministrisë së Brendshme. Ajo ka një njësi të analizës së riskut në nivelin qendror dhe njësi vendore të riskut në të gjitha shtete zyrtar rajonale. Ajo përfshin shtete zyra rajonale dhe stacione vendore, duke përfshirë një njësi të lëvizshme. Staf i saj, duke përfshirë 1566 roje kufitare, kanë marrë trajnim bazë dhe në njëfarë mase trajnim të specializuar nga Akademia e Policisë dhe nëpërmjet marrëveshjes së përfunduar me FRONTEX. Shqipëria duhet të vazhdojë trajnimin e analizës së riskut në të gjitha nivelet dhe të sigurojë trajnim të mjaftueshëm për policinë kufitare, veçanërisht duke përfshirë menaxhimin e migracionit në kurrikulën e Akademisë së Policisë.

Strategjia aktuale e menaxhimit të integruar të kufirit 2014- 2020 është plotësisht e përputhur me standardet evropiane.

Zbatimi dhe kapaciteti zbatues

Strategjia e Integruar e Kufirit dhe zbatimi i saj, si edhe plani i veprimit kanë vazhduar rrjedhshëm me një fokus në kuadrin rregullues dhe institucional; burimet njerëzore dhe trajnim; komunikim dhe këmbim informacioni; si edhe infrastrukture dhe pajisje për kontrollin kufitar dhe mbikëqyrjen.

Dy pika kufitare me Malin e Zi dhe Kosovën janë duke u ri-ndërtohen. Në korrik, Shqipëria ka filluar të kryejë kontrole në kufirin me Kosovën. Rrjeti i komunikimit special me radio "TETRA" është vetëm pjesërisht funksional. Nga 150 anije peshkimi, vetëm 80 janë të pajisura me kuti blu. Syzet për të parë gjatë natës dhe kamera termografike janë në përdorim për mbikëqyrjen e kufirit jeshil. Me shumë burime duhen kushtuar ndaj modernizimit të infrastrukturës së kufirit dhe përsheptimin e mbikëqyrjes së kufijve blu dhe jeshile.

Bashkëpunimi ndër-agjencie midis rojeve kufitare dhe doganave ka funksionuar mirë, duke përfshirë akses të përbashkët në bazat e të dhënave. Qendra Ndër-Operacionale e Operacioneve Detare dhe mbikëqyrja e doganave janë plotësisht funksionale. Dallimi i dokumenteve false ka mbetur i ulët, veçanërisht në aeroportet ndërkombëtare. Një historik për zbulimet, hetimet dhe procedimin e krimin ndërkufitar në koordinim me të gjitha komponentët e autoriteteve ligjzbatuese është duke u krijuar gradualisht. Fuqitë hetuese të policisë kufitare duhen forcuar, veçanërisht për dallimin e trafikimit të njerëzve dhe çështjeve të trafikimit.

Bashkëpunimi me vendet fqinje ka vazhduar të jetë i mirë, veçanërisht në nivelin teknik. Vendi ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi mes policive ndërkufitare me Malin e Zi, Kosovën dhe ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Janë ngritur qendra bilaterale për bashkëpunimin policor ndërkufitar me Kosovën dhe Maqedoninë. Protokollin mbi ngritjen dhe funksionimin e qendrës trepalëshe në Plav duhet miratuar. Puna po vazhdon për të ngritur një qendër tjetër në kufirin me Greqinë. Marrëveshjet mbi kontrollin e përbashkët kufitar janë nënshkruar me Malin e Zi për dy pika kufitare dhe po ashtu me Kosovën për tre të tjera.

Marrëveshja me Frontex duhet përditësuar. Për sa i përket masave anti-korrupsion, 64 masa disiplinore janë marrë kundër stafit të policisë kufitare në gjysmën e parë të 2016.

Bashkëpunimi gjyqësor në fushën civile dhe penale

Shqipëria ka intensifikuar bashkëpunimin gjyqësor në fushën civile dhe penale, edhe me Shtetet Anëtare të BE-së. Megjithatë, bashkëpunimi ndërkombëtar duhet përmirësuar më tej, veçanërisht për ratifikimin në kohë dhe zbatimin e instrumenteve shumëpalëshe dhe kapacitetit institucional. Për sa i përket bashkëpunimit gjyqësor në fushën penale, Shqipëria duhet të shfrytëzojë më shumë instrumentet ekzistuese, veçanërisht në ngritjen e skuadrave të përbashkëta hetuese sipas nenin 20 të Protokollit të dytë shtesë të Konventës së Këshillit të Evropës për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale.

Shqipëria ka adresuar rekomandimet e EUROJUST mbi standardet e mbrojtjes së të dhënave; negociatat për një marrëveshje bashkëpunimi duhet të fillojnë përpara fundit të vitit. Në vitin 2015, Shqipëria u përfshi në 12 çështje (4 në 2014) të regjistruara në Eurojust. Italia dhe Greqia regjistruan numrin më të madh të çështjeve ku përfshihet Shqipëria, të cilat lidhen kryesisht me trafikimin e drogës.

Lufta kundër krimit të organizuar

Kuadri institucional dhe përafrimi ligjor

Në shtator të 2015, qeveria ka miratuar rregulloren e re për Policinë e Shtetit për të garantuar zbatimin efektiv të ligjit për policinë e shtetit, i cili hyri në fuqi në Mars të vitit 2015. Rregullorja është në përputhje me rekomandimet kryesore të Kodit Evropian të etikës së policisë të Këshillit të Evropës. Në dhjetor, Shqipëria ka ratifikuar Konventën e Këshillit të Evropës mbi trafikimin e organeve njerëzore. Disa hapa janë marrë për të ndryshuar udhëzimet e përbashkëta mbi menaxhimin e drogës së sekuestruar dhe substancave narkotike. Legjislacioni për proceset e kampionimit, tharjes dhe të magazinimit nuk është në përputhje me *acquis* dhe standardet ndërkombëtare.

Shqipëria ka përditësuar dhe vijon zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit për luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikimit. Strategjia për sigurinë kibernetike 2015-2017 është miratuar nga qeveria në dhjetor. Strategjia për luftën kundër trafikimit njerëzor 2014-2017 dhe plani i saj i veprimit janë miratuar në nëntor. Në shkurt, si pjesë e strategjisë së saj për luftën kundër trafikimit njerëzor, qeveria miratoi planin e veprimit për ri-integrimin social-ekonomik të grave dhe vajzave viktime/viktimave të mundshme të trafikimit. Në mars, Ministria e Brendshme miratoi planin e veprimit për parandalimin dhe luftën kundër kultivimit të bimëve narkotike 2016. Grupet e Punës janë ngritur në nivele kombëtare dhe vendore për të zbatuar planin e veprimit.

Zbatimi dhe kapaciteti zbatues

Policia ka pësuar ndryshime rrënjësore organizative për të modernizuar strukturat dhe *modus operandi* të saj. Struktura e re policore organizative u miratua në dhjetor në përputhje me ndarjen e re administrative të vendit. 12 drejtori vendore të policisë, 50 komisariate policore dhe 15 stacione policie janë parashikuar në reformë. Lufta kundër korrupsionit të brendshëm ka vazhduar. Numri i procedimeve disiplinore në 2015 ishte 172, e krahasuar me 153 në vitin

2014. Policia akoma është e përfshirë nga korrupsioni dhe presioni politik, duke penguar hetimin në thellësi të krimit të organizuar.

Në tetor të vitit 2015, Akademia e ri-ngritur e Sigurisë ka inauguruar vitin e parë të saj akademik me lançimin e programeve studimore mbi sigurinë publike dhe hetimin e krimit. Rifillimi i arsimit të lartë i policisë pas më shumë se një dekadë është një hap i rëndësishëm drejt zhvillimit të një force policie profesionale.

Janë bërë disa përparime në sigurimin e policëve dhe prokurorëve me akses të drejtpërdrejtë në regjistrat kombëtare publike elektronike, si regjistri i gjendjes civile, regjistri i gjendjes gjyqësore (të dhënat penale), sistemi i menaxhimit elektronik. Një memorandum është nënshkruar në gusht midis Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për akses në sistemin e automatizuar të të dhënave doganore dhe regjistrin e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/ Ndërtimeve Informale.

Në mars, Prokuroria e Përgjithshme ka nënshkruar një memorandum mirëkuptimi me Ministrinë e Drejtësisë për të pasur akses në regjistrat e mëposhtëm: Zyrën e Përmbartimit Gjyqësor, Regjistrin Noterial, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe në sistemin e integruar të menaxhimit të çështjeve gjyqësore. Megjithatë, për arsye teknike, aksesimi në këto baza të dhënash nuk është siguruar akoma.

Policia shkëmben informacion në një kohë shumë të shpejtë me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave/ Njësinë e Hetimit Financiar, duke përdorur platformën elektronike të zhvilluar në vitin 2014. Megjithatë, policia ende nuk ka akses në 24 baza të dhënash kombëtare publike dhe të kompanive të telefonisë celulare, si dhe në të dhënat e përdoruesve të shërbimeve të internetit. Kjo shkakton vonesa dhe pengon hetimet proaktive.

Në vitin 2015, Instituti i Mjekësisë Ligjore ka hedhur 124 profile në sistemin e kombinuar të indeksit të ADN-së dhe 1200 identifikime nëpërmjet sistemit të automatizuar të identifikimit të gjurmëve të gishtërinjve dhe sistemit të avancuar të informacionit për pasagjerët. Në dhjetor, Ministria e Brendshme, Prokuroria e Përgjithshme dhe policia shtetërore shqiptare kanë nënshkruar një memorandum mirëkuptimi për ngritjen e një task force, e cila do të jetë përgjegjëse për rishikimin çështjeve të trafikimit njerëzor që ishin pushuar ose nuk ishin filluar.

Për sa i përket historikut të Shqipërisë për krimet që lidhen me **organizatat kriminale dhe grupet e strukturuar kriminale** (nenet 333 dhe 333a të kodit penal), në vitin 2015 numërohen 18 procedime të reja penale që përfshinin disa shkelës të ligjit dhe në gjysmën e parë të vitit 2016 numëroheshin gjashtë procedime. Numri i të akuzuarve që janë dënuar u rrit paksa, megjithëse mbetet ende i ulët. Në vitin 2015, Gjykata për Krimeve e Rënda ka dhënë katër verdikte përfundimtare të fajësisë dhe 13 në gjashtëmuorin e parë të vitit 2016.

Kuadri për luftën ndaj **trafikimit njerëzor** është zhvilluar më tej dhe sanksionet janë rënduar. Megjithatë, Shqipëria duhet të shtojë përpjekjet për parandalimin e trafikimit njerëzor, duke i kushtuar vëmendje të veçante fëmijëve të pashoqëruar dhe fëmijëve që janë viktimat e trafikimit, veçanërisht fëmijëve në situatë rruge. Kuadri ligjor duhet të përafrohet më tej me acquis të BE-së. Shqipëria është një ndër pesë vendet jo-anëtare të BE-së me numrin më të lartë të viktimave të trafikimit njerëzor të regjistruara. Megjithatë, numri i dënimeve të për këto vepra mbetet i ulët. Policia ka raportuar 69 raste të trafikimit njerëzor në vitin 2015

(krahasuar me vitin 2014 ku u regjistruan 34 raste) dhe 38 në gjysmën e parë të vitit 2016. Shumica e kallëzimeve përfshijnë të rritur, ndërsa trafikimi i fëmijëve raportohet në rritje. Në vitin 2015, 21 persona kanë marrë vendime të formës së prerë për trafikim njerëzor, dhe vetëm dy në gjysmën e parë të vitit 2016. Identifikimi i minoreneve që janë viktime të trafikimit vazhdon të jetë i ulët. Nuk ka bashkëveprim me mekanizmat e tjerë të identifikimit, siç janë grupet e punës që identifikojnë fëmijët në situatë rruge.

Numri i vendimeve të formës së prerë në fushën e **krimit kibernetik** mbetet i ulët, me vetëm pesë në vitin 2015 dhe gjashtë në vitin 2014.

Në fushën e **pastrimit të parave**, numri i raportimit të transaksioneve të dyshimta është rritur në 1319 në vitin 2015, me një rritje prej 7% krahasuar me vitin 2014. Në vitin 2015, tetë persona janë dënuar për pastrim parash të fituara nga krimi dhe katër për gjysmën e parë të vitit 2016. Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda ka lëshuar 11 vendime për sekuestrimin e pronës, që mbulojnë llogaritë bankare, veturat, apartamentet, restorantet, tokat dhe hotelet. Megjithatë, nuk ka pasur vendime të formës së prerë për konfiskimin e pronës nga Gjykata e Krimeve të Rënda për vitin 2015.

Në përgjithësi, rritja e numrit të operacioneve të policisë ka çuar në rritjen e shkallës së zbulimit të veprave penale dhe në arrestimin e më shumë shkelësve të ligjit. Megjithatë, kjo prapë nuk e rrit numrin e vendimeve të formës së prerë për shoqatat e organizuara kriminale, që mbetet i papërfillshëm.

Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit është thelbësore për të luftuar infiltrimin e krimit në sistemet politike, ligjore dhe ekonomike.

Lufta kundër terrorizmit

Sipas Ministrisë së Brendshme dhe Shërbimit Sekret Shtetëror (SHISH), rreth 120 shtetas shqiptar i janë bashkuar luftës në Lindjen e Mesme. Sipas burimeve të njëjta, raportohet se asnjë luftëtar i huaj, që nuk është shqiptar nuk është larguar nga Shqipëria që nga viti 2015. Në maj, Gjykata për Krimet e Rënda e Tiranës ka dënuar tre imamë të vetë-shpallur dhe gjashtë bashkëpunëtorë, të cilët akuzohen për rekrutimin e të paktën 70 luftëtareve të huaj. Qeveria ka deklaruar se do të përfshijë një lëndë të veçantë në kurrikulën e shkollave mbi historinë e besimit fetar, në një mënyrë që të parandalojë radikalizmin dhe të mbështesë dialogun ndër-fetar.

Kuadri institucional dhe përafrimi ligjor

Shqipëria ka një **kuadër ligjor** gjithëpërfshirës për parandalimin dhe luftën kundër financimit të terrorizmit. Vendi është palë me të gjitha konventat e Këshillit të Evropës mbi luftën kundër terrorizmit, përfshirë sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi dhe financimi i terrorizmit. Në qershor, qeveria ka ratifikuar protokollin shtesë të Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin e terrorizmit. Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës penale janë ndryshuar në vitin 2014 për të përfshirë një dispozitë që parashikon deri në 15 vjet burg për shtetasit që përfshihen në konflikte të armatosura jashtë territorit të Shqipërisë.

Strategjia kombëtare kundër terrorizmit përfundoi në dhjetor të vitit 2015. Një strategji e re është duke u përgatitur dhe pritet të përfundohet deri në fund të vitit 2016. Në nëntor, qeveria

miratoi një strategji kombëtare dhe plan veprimi për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm (CVE), që ka për fokus shtrirjen në komunitet, edukimin, policimin, kundërvënien ndaj propagandës ekstremiste. Janë ndërmarrë disa hapa për zbatimin e strategjisë dhe për ngritjen e një qendre rajonale CVE në Tiranë. Në gusht, qeveria emëroi një koordinator kombëtar të CVE.

Institucioni kryesor përgjegjës për luftën kundër terrorizmit është Drejtoria Anti-Terror në Policinë e Shtetit shqiptar. Personeli i policisë për policim në komunitet përfshihet në parandalimin e radikalizmit dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm. Një komitet ndër-ministral dhe sekretariati i tij teknik janë ngritur në Ministrinë e Brendshme për të rritur koordinimin mes institucioneve publike për luftën kundër terrorizmit.

Zbatimi dhe kapaciteti zbatues

Policia shqiptare e shtetit ka rritur përpjekjet për parandalimin e radikalizmit nëpërmjet policimit në komunitet dhe bashkëpunimit të ngushtë me komunitetet fetare përkatëse. Drejtoria e Anti-terrorit ka rritur kapacitetin e saj nëpërmjet trajnimeve shtesë, shtimit të personelit dhe pajisjeve. Megjithatë, kapacitetet e saj operacionale dhe logjistike mbeten të kufizuara, veçanërisht për hetime dhe operacione speciale si mbikëqyrja dhe ndërhyrjet.

Në vitin 2015, janë raportuar 11 vepra penale që kanë të bëjnë me terrorizmin në Prokurorinë e Krimeve të Rënda dhe tre për gjashtëmujorin e parë të vitit 2016. Në vitin 2015, janë kryer katër operacione të përbashkëta ndërkombëtare me Italinë, Shtetet e Bashkuara dhe Norvegjinë, dhe një operacion i ri në gjashtëmujorin e parë të vitit 2016 me Bosnje dhe Hercegovinën. Nuk është raportuar asnjë rast financimi të terrorizmit nëpërmjet pastrimit të parave nga Njësitë e Hetimit Financiar.

Sekretariati teknik i komitetit ndër-ministral për luftimin e terrorizmit nuk është plotësisht funksional. Puna e komitetit është penguar nga shkëmbimi i kufizuar ndër-institucional i informacionit dhe bashkëpunimi i dobët me policinë. Strategjia e re e kundër terrorizmit duhet ta ngrejë sekretariatit si organ të përhershëm dhe t'i sigurojë mjetet për të mbështetur punën e tij si organ efikas koordinimi. Marrëveshjet dypalëshe për bashkëpunim në luftën kundër terrorizmit janë nënshkruar me Kosovën dhe Slloveninë.

Bashkëpunimi në luftën kundër drogës

Bashkëpunimi me Qendrën Evropiane të Monitorimit për Drogat dhe Varësinë Nga Droga ka vazhduar. Në shkollë janë ndërmarrë programe edukimi për drogën për të parandaluar përdorimin e drogës tek të rinjtë. Sipas organeve të specializuara të OKB-së, përfitimet nga tregtia e paligjshme e opatit vazhdojnë të mbeten nxitës të rëndësishëm financiar për grupet e organizuara kriminale në Shqipëri. Të ardhurat ilegale të narkotikeve përbëjnë një përqindje të rëndësishme të GDP së Shqipërisë. Të ardhurat ilegale nga bimët narkotike llogariten se zënë një pjesë të madhe të PBB-së së Shqipërisë (2.60 % krahasuar me 0.07-0.19% për vendet si Franca, Gjermania, Italia dhe Mbretëria e Bashkuar).

Shqipëria ka intensifikuar luftën kundër kultivimit të drogës (kryesisht atë të llojit kanabis sativa), që mbetet një sfidë serioze. Në vitin 2015, policia ka kryer 240 operacione kundër kultivimit dhe trafikimit të drogës, të cilat rezultuan në identifikimin e 4634 parcelave të kultivuara, si dhe arrestimin e 402 kriminelëve dhe shkatërrimin e 797 422 bimëve narkotike,

24 6008 më shume se në vitin 2014. Prirja pozitive ka vazhduar edhe në vitin 2016, me konfiskime të mëdha të drogës dhe shkatërrimit të bimëve narkotike të llojit kanabis sativa gjatë verës. Prirjet e fundit kanë treguar se kultivimi i kanabisit kryhet edhe në sera. Nevojiten më shumë përpjekje për të përmirësuar asgjësimin e plantacioneve me kanabis.

Në fushën e trafikimit të drogës, në vitin 2015 janë sekuestruar 36.9 kg drogë të llojit heroinë, mbi 11 ton marijuanë dhe 27.1 kg kokainë (kundrejt 73.5 kg heroinë, 97 ton marijuanë dhe 10.3 kg kokainë të sekuestruara në vitin 2014). Kjo rënie e sekuestrimit mund të shpjegohet me ri-zhvendosjen e trafikut të paligjshëm përmes vendeve të tjera, e shoqëruar kjo me mungesën e shërbimeve të përshtatshme sekrete dhe për pasojë me numrin e ulët të kapjeve. Pas miratimit të ligjit të ri për strukturën e organizimit të policisë, hapja e tetë komisariateve të reja duhet të sigurojë një kontroll më të mirë të territorit për qëllime të parandalimit dhe shkatërrimit të kultivimit të drogës.

Pavarësisht intensifikimit të luftës kundër kultivimit dhe trafikimit të drogës, numri i dënimeve të formës së prerë mbetet i ulët. Dënimet dhe gjobat nuk janë parandalues efikas dhe konfiskimi i asteve kriminale është i kufizuar. Hetimet dhe procedimet nuk arrijnë deri në nivelet më të larta të zinxhirit të drogës dhe nuk shoqërohen sistematikisht me hetime paralele financiare. Në vitin 2015, policia ka dorëzuar në prokurori 1 008 raste që lidhen me prodhimin dhe trafikimin e drogës (344 më pak se në vitin 2014). Vetëm 359 janë dërguar në gjykatë (nga 372 në vitin 2014).

Kapacitetet për të menaxhuar, magazinuar dhe shkatërruar drogat mbeten shumë të dobëta. Duhet përmirësuar procedura e shkatërrimit të bimëve narkotike të sekuestruara. Duhet përgatitur një protokoll që i ngarkon Ministrisë së Mjedisit detyrën e menaxhimit të bimëve narkotike, siç janë monitorimi dhe kampionimi i ajrit dhe dheut. Drogat duhen asgjësuar menjëherë ose direkt pas sekuestrimit dhe duhen mbajtur vetëm kampionë të vegjël për analiza në Institutin Shkencor. Përveç kësaj, duhet ngritur një njësi e trajnuar, e cila do të trajtojë çështjen e laboratorëve të paligjshëm për sintezën e drogave të paligjshme.

Bashkëpunimi i doganave

Sistemi i monitorimit 24 orë me kamera digjitale vazhdon të funksionojë plotësisht. Numri i rasteve të abuzimit me detyrën nga zyrtarët e doganave është rritur, krahasuar me vitet e mëparshme. Për sa i përket rasteve të korrupsionit, Drejtoria e Investigimit të Brendshëm dhe Anti-korrupsionit ka hapur 33 çështje në vitin 2014, 38 çështje në vitin 2015, dhe mbi 40 çështje deri në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2016. Sipas Ministrisë së Financave, në vitin 2015, janë marrë 131 masa disiplinore kundër zyrtareve të doganave, përfshirë 25 përfundime të marrëdhënies së punës. Në gjysmën e parë të vitit 2016 ka pasur 45 masa të tilla, përfshirë nëntë përfundime të marrëdhënies së punës.

4.25. Kapitulli 25: Shkenca dhe kërkimi

BE-ja ofron mbështetje të rëndësishme për hulumtim/ose kërkimin dhe inovacionin. Të gjitha Shtetet Anëtare mund të përfitojnë nga programet e kërkimit të BE-së, sidomos aty ku ka përsosmëri shkencore dhe investim solid në kërkim.

Përgatitjet janë në **fazë të hershme** në fushën e shkencës dhe kërkimit. **Disa përparime** janë bërë gjatë vitit të kaluar. Në vitin e ardhshëm, vendi duhet në veçanti:

→ të miratojë një strategji gjithëpërfshirëse për kërkim dhe inovacion;

→ të ngrejë kapacitetet dhe të rrisë investimet në fushën e kërkimit në përputhje me prioritetet e Zonës Evropiane të Kërkimit Shkencor.

Për sa i përket **politikave të kërkimit shkencor dhe inovacionit**, strategjia kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin 2015- 2020 ka ende për t'u miratuar. Investimet në kërkimin dhe masat për forcimin e kapaciteteve kërkimore dhe inovacionit në nivel kombëtar kanë nevojë për t'u rritur. Niveli i investimeve në kërkim është shumë i ulët në rreth 0.4% të PBB-së⁶. Bashkëpunimi ndërinstytucional duhet të forcohet, në veçanti në lidhje me vendimet për masat e inovacionit.

Për sa i përket **programeve kuadër**, Shqipëria bën pjesë në programin kuadër të kërkimit dhe inovacionit të BE-së 'Horizon 2020' si vend partner. Gjatë vitit 2015-2016, numri i aplikantëve shqiptarë u rrit në 146, nga 66 në 2014-2015. Megjithatë, numri i kandidatëve të suksesshëm mbetet relativisht i ulët. Pjesëmarrja e sektorit privat në program mbetet shumë e ulët. Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit iu nënshtrua ristrukturimit dhe u bë Agjencia Kombëtare për Kërkim dhe Inovacion. Aktualisht në kuadër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, agjencia ka zgjeruar përgjegjësitë, përfshi të qenit koordinator i pikave kombëtare të kontaktit për Horizon 2020 dhe që menaxhon bazën e të dhënave kombëtare për kërkimin, infrastrukturën dhe publikimet e hulumtuese/kërkuesve PhD.

Lidhur me integrimin në **Zonën Evropiane të Kërkimit**, janë nënshkruar memorandume të mirëkuptimit dypalësh me Austrinë, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Slloveninë.

Për sa i përket **Inovacionit të Unionit**, qeveria miratoi vendimet lidhur me krijimin e Fondit të Inovacionit dhe një skemë kupon, por ato mbeten ende për t'u zbatuar.

4.26. Kapitulli 26: Arsimi dhe kultura

BE mbështet bashkëpunimin në fushën e arsimit dhe kulturës përmes programeve të financimit dhe përmes metodës së hapur të koordinimit. Shtetet anëtare duhet të parandalojnë diskriminimin dhe lehtësojnë arsimimin e fëmijëve të punëtorëve emigrantë të BE-së.

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e arsimit dhe kulturës. Janë bërë **disa përparime** në arsim, sidomos me miratimin e strategjisë së arsimit parauniversitar dhe zbatimin e reformës së arsimit të lartë. Përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme për të zhvilluar koordinimin me punëdhënësit, zhvillimin e vazhdueshëm të kurrikulës dhe skemat e integruara të të mësuarit me bazë punën. Gjatë vitit të ardhshëm, Shqipëria duhet në veçanti:

→ të sigurojë që strategjia e arsimit parauniversitar dhe ligji mbi arsimin e lartë të zbatohen në mënyrë efektive, dhe për të përmirësuar trajnimin e mësimdhënësve;

→ të miratojë ligjin mbi arsimin profesional dhe trajnim (APT), të rrisë lidhjet midis aftësive dhe kërkesës për punë, të zhvillojë bazat e të dhënave dhe të burimeve në internet në

⁶Kjo e dhënë është ende objekt diskutimi mes INSTAT dhe palëve të tjera të interesuara përderisa nuk përfshin investimet e sektorit të biznesit në R&D

dispozicion për ofruesit e APT.

Në fushën e **arsimit, trajnimit dhe rinisë**, Shqipëria ka miratuar strategjinë e arsimit parauniversitar dhe ka filluar zbatimin e ligjit për arsimin e lartë. Megjithatë, cilësia e arsimit duhet të vlerësohet dhe përmirësohet, sidomos duke qenë se emigracioni nga njerëzit e rinj e të kualifikuar është i lartë, ndërsa mundësitë për punë janë më të ulëta. Ashtu sic tregojnë rezultatet e PISA, Shqipëria është shumë më poshtë se mesatarja e OECD dhe BE-së në drejtim të aftësive bazë të moshës 15 vjeçare. Ka nevojë për më shumë bashkëpunim mes institucioneve arsimore dhe sektorit të biznesit për të përgatitur më mirë të diplomuarit për zhvillim të tregut të punës. Ligji i ri për APT, lidhur me zbatimin e mekanizmave të legjislacionit dhe të sigurimit të cilësisë është ende për t'u miratuar. Mungesa e një kuadri ligjor modern të APT-së është një pengesë e madhe për zbatimin e një sërë masash në strategjinë e vendeve të punës dhe aftësive në mënyrë efektive. Përfshirja e sektorit privat në hartimin dhe zbatimin e tregut të punës dhe politikave të APT-së mbetet një nevojë kritike. Punësimi dhe shërbimet APT duhet të shtrihen në zonat rurale dhe grupet më të cënueshme. Arsimi mbetet një sektor me rrezik të lartë për korrupsion dhe ndikim politik, veçanërisht në arsimin e lartë.

Normat e regjistrimit për fëmijët romë dhe egjiptianë janë rritur lehtë gjatë vitit akademik 2015/2016. Regjistrimi i tyre në arsimin parashkollor është rritur me 4.9%, në shkolla fillore me 25%, në shkollën nëntëvjeçare dhe shkollën e mesme me 27% dhe në arsimin parauniversitar me 22%. Megjithatë, shkalla e regjistrimit mbeten në përgjithësi shumë e ulët. (Shih gjithashtu Kapitullin 19 - Politika sociale dhe punësimi) Duhet bërë më shumë për të shpërndarjen e burimeve të duhura njerëzore dhe financiare për të siguruar që çdo fëmijë të arsimohet.

Shqipëria vazhdon të marrë pjesë në mënyrë aktive në programin Erasmus +.

Për sa i përket **kulturës**, një ligj i ri për trashëgiminë kulturore është përgatitur për të përmirësuar mbrojtjen, vlerësimin dhe administrimin e trashëgimisë kulturore, përfshi edhe luftën kundër trafikut të paligjshëm të mallrave kulturore. Shqipëria ka vazhduar të marrë pjesë në programin Creative Europe të BE-së.

4.27. Kapitulli 27: Mjedisi dhe ndryshimet klimatike

BE nxit masa të forta për klimën, zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit. Ligji i BE-së përmban dispozita që trajtojnë ndryshimet klimatike, cilësinë e ujit dhe ajrit, menaxhimin e mbetjeve, mbrojtjen e natyrës, ndotjen industriale, kimikatet, zhurmën dhe mbrojtjen civile.

Shqipëria **ka një farë niveli të përgatitjes** në fushën e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike. Janë bërë **disa përparime** në përafrimin dhe zbatimin e legjislacionit. Janë bërë përpjekje për të integruar rekomandimet në lidhje me ndryshimet klimatike në politika të tjera sektoriale. Megjithatë, kontrolli dhe monitorimi industrial i emetimeve, cilësia e ujit dhe menaxhimi i mbetjeve mbeten ende të dobëta. Burimet dhe investimet mbeten të kufizuara. Vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet, në veçanti:

→ të përmirësoje kuadrin e politikave dhe atë ligjor lidhur me fushën e mjedisit dhe të ndryshimeve klimatike, në veçanti duke miratuar strategjitë kombëtare sektoriale;

→ të forcojë monitorimin e cilësisë së mjedisit duke rritur kapacitetet administrative dhe ato financiare, numrin e stacioneve matëse, cilësinë dhe shpeshësinë e të dhënave, transparencën dhe aksesin e publikut tek të dhënat;

→ të avancojë me financimin e investimeve madhore, të konsolidojë projektin kombëtar infrastrukturor/ planet e investimit dhe të reflektojë prioritetet në buxhetin afatmesëm 2017-2019;

→ të krijojë një planifikim strategjik sistematik për ndryshimet klimatike si dhe të ndjekë zbatimin e Marrëveshjes së Parisit mbi Klimën.

Mjedisi

Për sa i përket **legjislacionit horizontal**, nuk është miratuar ende strategjia ndër-sektoriale e mjedisit 2015-2020. Shqipëria është ende në fazën e ngritjes së kapaciteteve administrative për të zbatuar legjislacionin. Është zhvilluar kapaciteti i inspektimit, por gjithsesi duhet të forcohet më tej. Përafrimi me Direktivën për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM) është në një fazë të hershme. Cilësia dhe zbatimi i VNM-ve duhet të përmirësohet, sidomos në sektorin e hidrocentraleve dhe minierave. Në sektorin e energjisë nuk zbatohen kërkesat strategjike mjedisore të vlerësimit, të cilat do të zgjerohen për të mbuluar të gjitha planet dhe programet përkatëse. Përafrimi dhe zbatimi i Direktivës mbi Përgjegjësinë Mjedisore është ende në fazë fillestare. Direktiva INSPIRE⁷ dhe Direktiva për Krimin Mjedisor nuk janë transpozuar ende.

Përafrimi legjislativ me acquis në fushën e **cilësisë së ajrit** ka avancuar relativisht. Direktiva e Këshillit që lidhet me përmbajtjen e sqfurit të disa lëndë djegëse është transpozuar së fundmi, duke reflektuar dhe disa shkelje të cilat kanë ndodhur për shkak të transpozimit të vonshëm. Direktiva për Tavanet e Emetimeve Kombëtare për disa ndotës atmosferikë nuk është transpozuar ende. Strategjia kombëtare për cilësinë e ajrit u miratua në vitin 2014, por ende nuk është zbatuar. Plani Kombëtar i Veprimit për cilësinë e ajrit është duke u përgatitur. Monitorimi i cilësisë së ajrit nuk i përmbush plotësisht standardet e përcaktuara nga direktivat përkatëse të BE-së. Nuk ka plane vendore të cilësisë së ajrit të ambientit dhe nuk ende nuk ka filluar ndonjë aktivitet për parandalimin e shkeljeve të njohura të vlerave limit.

Përafrimi legjislativ me acquis në fushën e **menaxhimit të mbetjeve** ka avancuar me përjashtim të acquis për riciklimin e anijeve, minierat dhe mbetjet elektronike. Në shtator 2016, u miratua një ndryshim i ligjit të vitit 2011 për menaxhimin e integruar të mbetjeve. Ai synon përafrimin e mëtejshëm me acquis si dhe lejon importin e mbetjeve, megjithëse këtë të fundit vetëm për qëllime riciklimi. Zbatimi i ligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve kërkon që Shqipëria të zhvillojë infrastrukturën e nevojshme, institucionet dhe një sistem për monitorimin, kontrollin dhe raportimin e lëvizjeve të mbetjeve. Zonat e shkarkimit të mbetjeve gjenden në mbarë vendin dhe priten të mbyllen e të përmirësohen. Rregullat për kontrollin e mbetjeve të anijeve të gjeneruara nga transporti detar duhet të përforcohen.

⁷ Direktiva 2007/2/KE e marsit 2007 që përcakton infrastrukturën për informacion hapësinor në Komunitetin Evropian

Ndarja e mbeturinave është jo-ekzistente dhe grumbullimi i tyre për qëllime riciklimi është kryesisht informal. Kapaciteti institucional për menaxhimin e mbetjeve mbetet ende i dobët në të gjitha nivelet. Eliminimi i mbetjeve mbetet kryesisht jo në përputhje me standardet për mbrojtjen e mjedisit. Menaxhimi i mbetjeve industriale është i dobët për shkak të mungesës së investimeve dhe zbatimit të dobët të ligjit. Ende nuk janë zbatuar strategjia kombëtare e menaxhimit të mbetjeve dhe plani i saj i veprimit, e miratuar në vitin 2011 dhe që aktualisht po rishikohet, si dhe planet rajonale. Ka filluar ndërtimi i landfilleve rajonale në rajonin e Korçës dhe një studim fizibiliteti për Vlorën. Së fundmi vendi ynë ka miratuar ndërtimin e dy impianteve në Elbasan dhe Fier.

Përafrimi legjislativ me acquis në fushën e **cilësisë së ujit** dhe kapaciteti administrativ për menaxhimin e ujit janë të dobëta. Direktiva Kuadër e Ujit dhe Direktiva për Ujërat e Larjes janë transpozuar në pjesën me të madhe dhe përgjegjësitë lidhur me to janë sqaruar pjesërisht në ligjin e vitit 2015 për qeverisjen vendore. Gjithsesi, përafrimi me Direktivat për trajtimin e mbetjeve urbane, të ujit të pijshëm dhe të ujërave nëntokësore është i pamjaftueshëm dhe mungojnë rregulloret që përforcojnë zbatimin. Kuadri strategjik është pjesërisht në fuqi, përfshirë edhe Strategjinë Kombëtare të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2011-2017 e cila është përditësuar së fundmi, një master plan për furnizim me ujë dhe kanalizime, dhe një listë të projekteve prioritare nën Kuadrin e Investimeve për Ballkanit Perëndimor (2015). Ekziston vetëm një plani i menaxhimit të basenit lumor (për lumin e Matit), por që ende nuk është zbatuar. Megjithatë, vijon puna për hartimin e planeve të menaxhimit të baseneve të lumenjve me ujë për tre lumenj të tjerë (Drin-Bunë, Seman dhe Shkumbin) dhe pritet të përfundojë deri në vitin 2018.

Mungojnë dokumentet e politikave, strategjive dhe të veprimit, si edhe një plan kombëtar i konsoliduar i investimeve përkatës për menaxhimin e integruar të ujërave. Monitorimi i cilësisë së ujit është nën përgjegjësinë e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, përfshirë raportimin vjetor të ujërave për larje për Agjencinë Mjedisore të BE-së që prej vitit 2013. Megjithatë, mbetet pa u raportuar cilësia e ujit të pijshëm dhe ujërave nëntokësore. Cilësia e ujërave për larje nuk është e kënaqshme, me rreth 40% të stacioneve bregdetare të cilësisë së ujit të klasifikuara si të dobëta sipas Direktivës së rishikuar të BE-së mbi cilësinë e ujit, kjo duke u bazuar në të dhënat e periudhës 2012-2015. Është rritur numri i impianteve funksionale të trajtimit të ujit është rritur nga 5 në 7, duke i shërbyer kështu vetëm 13% të popullsisë. Kapaciteti i tyre duhet të rritet ndjeshëm, veçanërisht në zonat bregdetare, urbane dhe turistike. Është realizuar harta e kërcënimeve dhe rreziqeve nga përmytjet për rajonin e Shkodrës dhe në vitin 2016 pritet të fillojë edhe për qarkun e Vlorës.

Në fushën e **mbrojtjes së natyrës**, përfshirë dhe Direktivën për Zogjtë dhe Habitatet, ka një harmonizim të pjesshëm. Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit 2016-2020 është miratuar në janar. Miratimi i 5 faqeve të internetit për NATURA 2000 për vitin 2017 është duke u përgatitur. Ndalimi i gjuetisë tregoi progres në mbrojtjen e faunës, duke zgjatur afatin e ndalimit edhe për 5 vjet. Ndikimet ekologjike të hidrocentraleve dhe projekteve nuk janë vlerësuar si duhet për të siguruar përputhshmërinë me legjislacionin përkatës të BE-së për natyrën. 44 nga 71 hidrocentrale janë ende në ndërtim e sipër në kuadër të zonave të mbrojtura. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura ka zhvilluar një bazë të dhënash mbi ndërtimet e hidrocentraleve. Shqipëria duhet gjithashtu të marrë në konsideratë ndikimin kumulativ të investimeve të tilla si hidrocentrale në peizazhe, burime ujore, faunën

dhe florën. Në shkurt, parlamenti miratoi një moratorium 10-vjeçar për shfrytëzimin e drurit të pyjeve për qëllime të biznesit. Është arritur njëfarë progresi në forcimin e kapaciteteve të inspektimit. Rregulloret mbi drurin dhe për zbatimin e ligjit për pyjet, administrimin dhe tregtinë mbeten ende për t'u përafuar.

Në fushën e **ndotjes industriale dhe menaxhimit të rrezikut**, nevojitet investim në shkallë të gjerë për të siguruar përputhshmëri të plotë me Direktivën për Shkarkimet Industriale. Janë transpozuar Direktivat për Impiantet e Mëdha të Djegies dhe për Kontrollin e Parandalimin e Integruar të Ndotjes (IPPC). Nuk ka përparim në monitorimin e zbatimit. Direktiva e Seveso III nuk është përafuar. Ka pasur pak progres në forcimin e kapaciteteve inspektuese, por nevojiten më shumë përpjekje për të krijuar një sistem të qëndrueshëm të inspektimit. Përputhshmëria me IPPC/ emetimet industriale mbetet një shqetësim. Nuk ka përparim në aspektin e cilësisë së lejeve. Janë lëshuar një numër i madh i lejeve, të cilat nuk janë në përputhje me kërkesat ligjore.

Për sa i përket fushës së **kimikateve**, Shqipëria është pjesërisht në përputhje me kërkesat e BE-së për REACH; eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme; në rregulloren për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave dhe përzierjeve; ndotësit organikë të qëndrueshëm; eksperimentet e kafshëve; asbestit; biocideve; dhe Mërkurit. Ligji kuadër për menaxhimin e kimikateve u miratua në mars të vitit 2016, por disa pjesë të legjislacionit dytësor kanë mbetur pezull. Në tetor të vitit 2015, në Elbasan, është krijuar qendra për grumbullimin dhe trajtimin e kimikateve të rrezikshme. Gjithashtu duhet të avancojë puna për miratimin e legjislacionit dytësor. Mbeten për t'u hartuar politikat për mbrojtjen e mjedisit dhe praktikat për përdorimin e kimikateve në bujqësi. Të dhënat për zbatimin e legjislacionit për kimikatet as nuk është raportuar dhe as nuk është publikuar. Shqipëria ka ratifikuar Konventën Minamata për zhivën, Konventën e Roterdamit mbi procedurën e njoftimit të pëlqimit paraprak për disa kimikate të rrezikshme dhe pesticide në Tregtinë Ndërkombëtare, dhe Konventa e Stokholmit mbi ndotësit organikë të qëndrueshëm.

Në fushën e zhurmave në mjedis, harmonizimi me *acquis* është në fazë të hershme. Standardet e nivelit të zhurmës për përdorim të jashtëm të pajisjeve u miratuan në dhjetor, por mbeten për t'u miratuar aktet nënligjore që lidhen me të dhe kapaciteti zbatues mbetet i dobët. Mbeten të vazhdueshme shkeljet e kufijve të zhurmës në disa qytete. Planifikimit hapësinor nuk mbuluan zhurmën në tërësinë e saj. Nuk ka programe të veçanta apo statistika mbi efektet e zhurmës në shëndet. Raportimi për zbatimin e planit kombëtar të zhurmës nuk ka shënuar progres.

Për sa i përket **mbrojtjes civile**, Shqipëria nuk është pjesëmarrëse në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të BE-së, por së shpejti do të nisë përgatitjet. Rregullat për bashkëpunim nga ana e institucioneve në situatat e emergjencës civile vendosen në dhjetor të vitit 2015. Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Rrezikut të Fatkeqësive dhe Mbrojtja Civile është në pritje të miratimit. Është shënuar progres me ministritë e linjës për ngritjen e zyrave të informacionit dhe menaxhimit të emergjencave civile dhe krizave, por megjithatë nuk është shënuar progres në nivel lokal apo rajonal. Shqipëria po zbaton gradualisht sistemin e komunikimit emergjent, në përputhje me numrin e vetëm evropian të urgjencës 112. Kapaciteti institucional dhe

bashkëpunimi ndërmjet institucioneve monitoruese duhet të forcohen për të siguruar përgjigje efektive ndaj situatave emergjente.

Në fushën e **ndryshimeve klimatike**, niveli i përafrimit dhe kapacitetet administrative mbeten të kufizuara, pavarësisht njëfarë progresit të arrirë për nivelin e politikave dhe rritjen e ndërgjegjësimit për klimën. Ka filluar puna për Strategjinë Kombëtare për Ndryshimet Klimatike, planin kombëtar të veprimit për ndryshimet klimatike dhe një ligji të veçantë për ndryshimet klimatike. Strategjia, ndër të tjera, shqyrton kontributin e synuar të përcaktuar në nivel kombëtar- INDC (synimet e 2030 dhe 2050). Grupi Ndërmintorror i Punës për Ndryshimet Klimatike koordinon integrimin e rekomandimeve për ndryshimet klimatike, përfshirë objektivat e INDC-së në strategji të tjera sektoriale, kryesisht në fushat e energjisë, industrisë, transportit dhe infrastrukturës. Shqipëria, gjithashtu, duhet të garantojë koherencën mes Strategjisë për Klimën me kuadrin e BE për klimën dhe politikat energjetike 2030. Përshtatja me ndryshimet klimaterike, gjithashtu, është pjesë e strategjive të shumta horizontale dhe ndër-sektoriale në fushën e mjedisit si edhe në nivel rajonal dhe lokal. Shqipëria merr pjesë në Rrjetin Global për Përshtatje.

Sipas Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, Shqipëria po përfundon raportin e 3-të Kombëtar të komunikimit, si dhe plani kombëtar për përshtatje, i cili vlerëson rreziqet që lidhen me klimën dhe skenarët e përshtatjes për rajonin bregdetar. Në 2015 Shqipëria ratifikoi Marrëveshjen e Parisit për Klimën. Grupi Ndërmintorror i Punës, i ngritur nga Ministria e Mjedisit për Ndryshimet Klimatike koordinon punën midis ministrive të linjës, kryesisht mbi çështjet e transportit dhe energjisë.

Në fushën e **transparencës së veprimeve klimatike**, Shqipëria aktualisht po përfundon vendimin mbi Rregulloren e Mekanizmave të Monitorimit. Sa i përket zvogëlimit të emetimeve nga transporti, është përgatitur draft-plani i transportit të qëndrueshëm. Duhet bërë përpjekje të mëtejshme për përafrimin e rregulloreve mbi substancat ozon-holluese dhe gazet serë të fluorinuara, sikurse dhe direktivave për tregtimin e emetimeve dhe depozitim gjellogjik të CO₂.

4.28. Kapitulli 28: Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit

Rregullat e BE-së mbrojnë konsumatorët në lidhje me sigurinë e produktit, imitimet e rrezikshme dhe përgjegjësinë për produkte defektive. BE siguron gjithashtu standarde të larta të përbashkëta për kontrollin e duhanit, gjakut, indeve, qelizave dhe organeve, të drejtat e pacientëve dhe sëmundjet ngjitëse.

Në fushën e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Shëndetit përgatitjet janë ende në **fazë fillestare**. Janë bërë **disa përparime** gjatë vitit të kaluar, sidomos me miratimin e strategjisë kombëtare për mbrojtjen e konsumatorit dhe mbikëqyrjes së tregut, si dhe ngritjen e Inspektoriatit të Mbikëqyrjes së Tregut. Në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet në veçanti:

→ të përafrojë më tej legjislacionin me acquis-në legjislacionin për kontrollin e duhanit, substancat me origjinë njerëzore dhe produkteve mjekësore;

→ të zbatojë strategjinë kombëtare për mbrojtjen e konsumatorit dhe mbikëqyrjen e tregut;

→ të sigurojë funksionimin e Inspektoriatit për Mbikëqyrjen e Tregut.

Në aspektet horizontale të **mbrojtjes së konsumatorit**, strategjia kombëtare për mbrojtjen e konsumatorit dhe mbikëqyrjen e tregut 2020 u miratuar nga qeveria në shtator 2015. Mbetet ende për tu miratuar vendimi për kriteret që duhet të përmbushë struktura për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtëgjyqësorit, me qëllim përafrimin me Direktivën për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve për konsumatorët. Njësia për Mbrojtjen e Konsumatorit nuk është e plotësuar me staf, por është trajnuar më shumë.

Sa i përket **çështjeve që lidhen me sigurinë**, në janar u ngrit Inspektoriati për Mbikëqyrjen e Tregut, por nuk është ende funksional.

Për **çështjet që nuk lidhen me sigurinë**, është përgatitur një projekt-kontratë standarde e cila lidhet midis konsumatorëve dhe agjencive të udhëtimit, për t'u zbatuar nga agjencitë e udhëtimit.

Për sa i përket aspekteve ndër-sektoriale të **shëndetit publik**, sipas të dhënave nga INSTAT plotësimi i regjistrimeve të vdekjes së fëmijëve është vlerësuar në vetëm 57%, ndaj nevojiten përpjekje të mëdha për të përmirësuar cilësinë dhe mbulimin e statistikave për harmonizimin me udhëzuesit përkatës të BE-së. Janë nënshkruar marrëveshje për bashkëpunim ndërkombëtar me Kroacinë dhe Izraelin në fushën e shëndetësisë dhe të mjekësisë. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të forcuar qeverisjen e spitaleve publike dhe cilësinë e kujdesit shëndetësor në bazë të standardeve të BE.

Në fushën e **kontrollit të duhanit**, është zbatuar ligji për mbrojtjen e shëndetit kundër produkteve të duhanit.

Në fushën e **sëmundjeve ngjitëse**, në mars, parlamenti miratoi ligjin për kontrollin e sëmundjeve infektive, me qëllim përafrimin me *acquis*-në përkatëse të BE-së. Personat me HIV / AIDS kanë ende vështirësi për të aksesuar kujdesin shëndetësor. Mbetet ende për t'u miratuar një strategji për kontrollin e mushkonjave dhe plani i veprimtimit. Sistemet e raportimit për sëmundjet ngjitëse dhe laboratorët mikrobiologjik nuk janë të integruara në sistemin kombëtar të regjistrimit elektronik shëndetësor. Duhet të forcohen kapacitetet e laboratorëve të mikrobiologjisë për të siguruar mbikëqyrje efektive të sëmundjeve dhe mbështetje për veprimet kundër rezistencës antibiotike.

Në fushën e **gjakut, indeve, qelizave dhe organeve**, legjislacioni shqiptar nuk është në përputhje të plotë me *acquis* për sigurinë e gjakut.

Legjislacioni për **farmaceutikën** nuk është plotësisht në përputhje me *acquis*. Janë miratuar vendimet mbi rimbursimin e barnave dhe mbi rregullat për kontrollin e veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

Nuk ka zhvillime për tu raportuar në fushën e **shëndetit mendor**.

Sa i përket **pabarazive shëndetësore**, ndryshimet në ligjin për kujdesin shëndetësor të detyrueshëm janë miratuar për të siguruar vizita falas tek mjekët e familjes edhe për personat e pasiguruar. Kjo masë synon veçanërisht grupet vulnerabël, përfshirë komunitetet romë dhe egjiptianë, të cilëve u është dhënë mundësia për tu pajisur me kartat shëndetësore deri në prill 2016. Qeveria është duke mbështetur një iniciativë të shoqërisë civile për të identifikuar dhe

trajnuar ndërmjetësuesit shëndetësor Romë. Nevojitet punë e mëtejshme për të luftuar kequshqyerjen e fëmijëve.

Mbetet ende për tu krijuar një strukturë mbi shërbimet e kontrollit të kancerit, si dhe një sistem për regjistrimin e kancerit. Janë ndërmarrë disa aktivitete sensibilizuese për diagnostikimin e kancerit të gjirit në të gjithë vendin. Janë në pritje të miratimit udhëzimet dhe protokollet për kancerin e qafës së mitrës bazuar në kujdesin shëndetësor parësor.

4.29. Kapitulli 29: Bashkimi Doganor

Të gjitha Shtetet Anëtare janë pjesë e bashkimit doganor të BE-së dhe ndjekin të njëjtat rregulla dhe procedura doganore. Kjo kërkon përafrimin legjislativ si dhe kapacitetet e duhura zbatuese dhe akses në sistemet doganore të përbashkëta të kompjuterizuara.

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e Bashkimit Doganor. Disa përpertime janë bërë në përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit me *acquis* dhe në adresimin e informalitetit. Vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet në veçanti:

- të ndjekë luftën kundër kontrabandës dhe importeve të produkteve të falsifikuara;
- të përgatisë dispozitat ligjore, të zhvillojë dhe testojë një Sistem i ri i Kompjuterizuar Transit (NCTS) kompatibël;
- të vazhdojë luftën kundër korrupsionit dhe keqpërdorimeve në administratën doganore.

Sa i përket **legjislacionit doganor**, Nomenklatura e Kombinuar e Mallrave 2016 dhe rregullat për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, të cila përafrojnë *acquis* të BE-së në këtë fushë, u miratuan në dhjetor dhe hyrën në fuqi në janar. Ligji për akcizat është ndryshuar në Dhjetor dhe rregulloret përkatëse u miratuan në janar. Përmes këtyre janë krijuar pulla fiskale për magazinat fiskale, është shtrirë mbikëqyrja e prodhimit dhe depozitimit të lëndëve të para për produktet e duhanit dhe janë rritur gjohat. Ndryshimet në ligjin për akcizat në Tetor 2015 ulën “tarifën e skanimit” për deklaratat doganore dhe korrigjuan çështjen e pagesave të dyfishta. Megjithatë, ligji për akcizën vazhdon të jetë në kundërshtim me nenin 33.1 të MSA-së, i cili ndalon futjen e detyrimeve doganore ose tarifave me efekt të njëjtë në tregtinë ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë. Kanë filluar përgatitjet për zbatimin e Sistemit të transitit të kompjuterizuar; është kryer edhe një vlerësim mbi boshllëqet dhe nevojat bazuar në metodën e projekteve doganore.

Sa i përket **kapaciteteve administrative dhe operacionale**, ka përfunduar sistemi elektronik doganor, por nuk është ende plotësisht i ndërlidhur me sistemet e tjera qeveritare. Gjithsesi, që nga fillimi i këtij viti, policia dhe prokuroria kanë qasje të drejtpërdrejtë në të dhënat doganave. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD) ka marrë pjesë në mënyrë aktive në fushatën kombëtare kundër informalitetit. Inspektimet nga tetori 2015 deri në gusht 2016 kanë rezultuar në marrjen e vendimeve në lidhje me detyrimet e papaguara doganore me vlerë 22.9 milion euro dhe gjoha administrative prej 51.1 milionë euro. DPD është angazhuar në operacionet ndërkombëtare për luftën kundër kontrabandës së cigareve dhe produkteve të duhanit. Të ardhurat nga doganat janë rritur në gjysmën e parë të 2016. DPD ka vazhduar të rrisë kompetencën profesionale të zyrtarëve të saj nëpërmjet trajnimit të mëtejshëm, si dhe ka vazhduar çrrënjosjen e korrupsionit. Gjatë periudhës shtator 2015-korrik 2016, janë marrë 90

masa disiplinore ndaj zyrtarëve të doganave, duke përfshirë 13 ndërprerje të marrëdhëneve të punës.

4.30. Kapitulli 30: Marrëdhëniet me jashtë

BE ka politika të përbashkëta tregtare ndaj vendeve të treta, bazuar në marrëveshjet shumëpalëshe dhe dypalëshe dhe masat autonome. Ekzistojnë gjithashtu rregulla të BE-së në fushën e ndihmës humanitare dhe politikave të zhvillimit.

Shqipëria **mbetet mesatarisht e përgatitur** në fushën e marrëdhënieve me jashtë. Janë bërë **disa përparime**, në veçanti me Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT), me ratifikimin e Marrëveshjes e Lehtësimit të Tregtisë. Në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet, në veçanti:

→të forcojë kapacitetet e organeve që koordinojnë politikat e tregtisë;

→të marrë masa të mëtjshme në përafrimin e legjislacionit kombëtar me *acquis* në fushën e kontrollit të eksporteve të mallrave me përdorim të dyfishtë dhe rritjen e kapaciteteve administrative dhe të kontrollit.

Shqipëria ka vijuar koordinimin e politikës së saj tregtare me **politikën e përbashkët tregtare** të BE-së dhe linjës së saj në OBT. Në maj të vitit 2016, Shqipëria pranoi Marrëveshjen me OBT për Lehtësimin e Tregut dhe gjithashtu ka përfunduar ciklin e dytë të Rishikimit të Politikave Tregtare. Shqipëria ka ngritur një Grup Kombëtar Ndër-ministror për koordinimin dhe lehtësimin e politikave tregtare.

Përgatitjet për përafrimin me *acquis* të legjislacionit për kontrollet e eksportit dhe të mallrave me përdorim të dyfishtë, janë në fazë të hershme. Pranimi në Marrëveshjen Wassenaar mund të lehtësojë përgatitjet për zbatimin e *acquis* mbi kontrollin e eksporteve të mallrave me përdorim të dyfishtë.

Në fushën e **marrëveshjeve dypalëshe me vendet e treta**, Shqipëria ka nënshkruar tractate dypalëshe investimi me Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Kosovën, si dhe një memorandum mirëkuptimi me Lituaninë në fushën e bashkëpunimit turistik. Vazhdojnë negociatat për marrëveshje dypalëshe të mbrojtjes së investimeve me Kanadanë dhe Islandën, si dhe për marrëveshje bashkëpunimi teknik dhe ekonomik me Kinën. Gjithashtu, Shqipëria ka një marrëveshje të tregtisë së lirë me Turqinë, por ende nuk ka filluar negociatat për liberalizimin e tregtisë në shërbime dhe investime. Ajo vazhdon të marrë pjesë aktive në aktivitetet e Marrëveshjes së Evropës Qendrore për Tregti të Lirë.

Nuk ka pasur progres në përafrimin me *acquis* të legjislacionit në fushën e politikave zhvillimore ose ndihmës humanitare. Vendi duhet të bashkohet në Mekanizmin e BE-së për Mbrojtje Civile.

4.31. Kapitulli 31: Politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes

Shtetet anëtare duhet të jenë të afta të zhvillojnë dialog politik në kuadrin e politikës së jashtme, sigurisë dhe mbrojtjes, për të qenë në linjë me deklaratat e BE-së, për të marrë pjesë në veprimet e BE-së dhe për të zbatuar sanksionet dhe masat shtrënguese të rëna dakord.

Shqipëria ka një **nivel të mirë të përgatitjes** në politikat e sigurisë së jashtme dhe të mbrojtjes dhe ka **bërë disa përparime** gjatë vitit të fundit. Shkatërrimi i municioneve konvencionale të tepërta ka përfunduar. Regjistri online i armëve dhe municioneve nën administrimin e Policisë së Shtetit është plotësisht funksional. Në politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë Shqipëria ka vazhduar të demonstrojnë përkushtim të qartë në mbështetjen e qëndrimeve të promovuara nga BE-ja për paqe dhe siguri dhe është pozicionuar, kur është ftuar, me të gjitha politikat përkatëse të përbashkëta, deklaratat e BE-së dhe vendimet e Këshillit. Është nënshkruar marrëveshja për shkëmbimin dhe mbrojtjen reciproke të informacionit të klasifikuar me BE-në. Shqipëria ka vazhduar të marrë pjesë në misionet e menaxhimit të krizave civile dhe ushtarake. Në vitin e ardhshëm, vendi duhet, në veçanti:

→tëfinalizojë shkatërrimin e rezervave të mbetura të armëve të vogla e armëve të lehta dhe të përmirësojë gjendjen e depove.

Dialogu i rregullt politik ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë për çështjet e politikave të jashtme e të sigurisë ka vazhduar.(Për më shumë informacion mbi marrëdhëniet me vendet e tjera të zgjerimit dhe shtetet anëtare të BE-së, referojuni kriterit politik pika 2.3 - Çështjet rajonale dhe detyrimet ndërkombëtare).

Në fushën e **politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë**, Shqipëria ka qenë në harmoni të plotë me të gjitha deklaratat përkatëse të BE-së dhe konkluzionet e Këshillit. Shqipëria ka qenë në harmoni të plotë me **masat kufizuese** të paraqitura nga BE-ja.

Në lidhje me **mos-përhapjen**, Shqipëria ka bërë progres të mëtjshëm në zbatimin e planit të veprimit për shkatërrimin e tepicës së armatimeve. Shkatërrimi i municioneve konvencionale të tepërta u përfundua në janar. Pastrimi i pikave të nxehta është në rrugën e duhur. Duhet përfunduar heqja e kimikateve të rrezikshme dhe mbyllja e depove të panevojshme si dhe rregullimi i depove të përhershme. Ende nuk është kryer shkatërrimi i 4 500 armëve të vogla dhe të lehta (SALWs).Përmirësimi i sigurisë së armatimeve dhe magazinimit duhet përmirësuar. Regjistri online i armëve dhe municioneve nën administrimin e Policisë së Shtetit është plotësisht funksional. Në qershor, u krijua Komision Kombëtar Ndërinstitucional për armët e vogla dhe të lehta SALWs, edhe pse ende nuk ka filluar veprimtarinë. Qëllimi i këtij komisioni është që të koordinojë, monitorojë dhe të inspektojë të gjitha aktivitetet që lidhen me kontrollin e armëve në Shqipëri, duke përfshirë regjistrimin, ndjekjen, kontrollin e importit dhe eksportit, si dhe ndërgjegjësimin. Ka nisur puna për një strategji për kontrollin e SALWs. Strategjia duhet të miratohet deri në fund të vitit 2016. Shqipëria duhet të përafrojë legjislacionin e saj me *acquis* të BE-së për çështjet që lidhen me importin dhe eksportin e mallrave ushtarake dhe mallrave për përdorim të dyfishtë.

Janë ndërmarrë disa hapa për zbatimin e Strategjisë Kombëtare Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (CVE) dhe Strategjia e re për Luftën Kundër Terrorizmit është duke u hartuar.(Në lidhje me Gjykatën Ndërkombëtare Penale, shih Kriterin Politik 2.3 - Çështjet rajonale dhe detyrimet ndërkombëtare).Duhet të intensifikohen përpjekjet për kontrollin e kufirit dhe krijimin e një sistemi të fortë kontrolli të eksportit në lidhje me kërcënimet kimike, biologjike dhe radio-bërthamore. Ligji i vitit 2007 për kontrollin e import-eksportit të mallrave ushtarake

dhe mallrave për përdorim të dyfishtë si dhe teknologjive duhet të jetë në përputhje me *acquis* më të fundit të BE-së, e cila merr në konsideratë sfidat kryesore të sigurisë.

Shqipëria ka vazhduar të angazhohet në mënyrë aktive duke **bashkëpunuar me organizatat ndërkombëtare**. Ajo ka pasur tre vëzhgues në misionin e OSBE në Ukrainë.

Në lidhje me **masat e sigurisë**, marrëveshja e sigurisë me BE-në për shkëmbimin dhe mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar u nënshkrua në Tiranë në muajin mars. Shqipëria ka vazhduar të marrë pjesë në operacionet e menaxhimit të krizave civile dhe ushtarake në kuadër të **politikës së përbashkët të sigurisë dhe mbrojtjes**, veçanërisht në misionin EUFOR Althea në Bosnje-Hercegovinë (me një oficer ushtarak), dhe në Misionin e Trajnimit të BE-së në Mali (me tre oficerë ushtarak).

4.32. Kapitulli 32: Kontrolli financiar

Bazuar në standardet ndërkombëtare, BE-ja promovon reformimin e sistemeve kombëtare të qeverisjes për të rritur besueshmërinë menaxheriale dhe menaxhimin e shëndoshë financiar të të ardhurave dhe shpenzimeve. Rregullat e kontrollit financiar mbrojnë interesat financiare të BE-së nga mashtrimi në menaxhimin e fondeve të BE-së dhe Euron nga falsifikimi.

Shqipëria **është mesatarisht e përgatitur** në këtë fushë. Janë bërë **disa përparime** vitin e shkuar, sidomos me ndryshimet e bëra në ligjin për kontrollin e brendshëm financiar publik (KBFP), në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke e përqendruar funksionin e Njësisë Qendrore të Harmonizimit (NJQH) në aktivitetet më strategjike dhe përditësimin e manualeve të auditimit të jashtëm në përputhje me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI). Megjithatë, shumë institucione nuk e zbatojnë parimin e llogaridhënies menaxheriale dhe kontrollit të brendshëm në përputhje me ligjin për KBFP-në. Kjo ndikon në zhvillimin e duhur të auditimit të jashtëm, pasi KLSH-ja vazhdon të përqendrohet kryesisht në auditimet e përputhshmërisë dhe zbulimin e parregullsisë. Në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet, në veçanti:

→ bëjë një vlerësim të institucioneve që kryejnë shpenzime të mëdha, të cilat ende nuk zbatojnë/ nuk kanë zbatuar rregulloren dhe procedurat e brendshme për menaxhimin dhe kontrollin financiar, dhe auditimin e brendshëm si dhe të sigurojë që qeveria nxjerr udhëzime dhe rekomandime për këta institucione në mënyrë që operacionet e tyre të jenë në përputhje me kërkesat ligjore;

→ sigurojë ndjekje me efikasitet në vlerësimin vjetor të KBFP-së duke adresuar dobësitë sistematike kryesisht në fushën e delegimit të detyrave dhe raportimit të performances;

→ të rrisë numrin e auditimeve pilote financiare dhe rregullatore/të përputhshmërisë nga KLSH-ja në përputhje me manualin e përditësuar të auditit dhe me standardet audituese të INTOSAI.

Kontrolli i brendshëm financiar publik

Reforma në **KBFP**, e përcaktuar në Dokumentin e Politikave të KBFP-së, po zbatohet në përputhje me **strategjinë e reformës në menaxhimin financiar publik** dhe planit të saj të veprimit. Në mars, qeveria ka miratuar raportin vjetor të monitorimit 2015 mbi zbatimin e

strategjisë. Kjo tregon që reformat e kontrollit të brendshëm janë po avancojnë gradualisht. Këshilli i KBFP-së, një organ këshillues i Ministrisë së Financave, duhet vendoset në punë.

Stafi i **Njërive Qendrore të Harmonizimit (NJQH)** për kontrollin dhe menaxhimin financiar dhe për auditimin e brendshëm është shtuar. Këto njësi sigurojnë udhëzimet metodologjike dhe monitorojnë zbatimin e kontrolleve të brendshme, përfshirë auditimin e brendshëm, duke analizuar raportet e vlerësimit dhe duke kryer vizita në vend. Raporti vjetor i vitit 2015 mbi zbatimin e KBFP-së është miratuar dhe është dorëzuar në parlament në qershor. Ky raport analizon menaxhimin e buxhetit dhe indikatorët e kontrollit të menaxhimit financiar, sikurse dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm, duke siguruar rekomandime për tu mbështetur nga qeveria. NJQH-te sigurojnë udhëzimet dhe monitorojnë mënyrën e zbatimit të rekomandimeve nga institucionet. Megjithatë, qeveria duhet të sigurojë një ndjekje më sistematike të rekomandimeve.

Legjislacioni parësor dhe dytësor mbi **kontrollin dhe menaxhimin financiar** është ndryshuar dhe është përgjithësisht në përputhje me kuadrin e kontrollit të brendshëm të modelit të Komitetit të Organizatave Sponsorizuese dhe udhëzimet e INTOSAI. Zbatimi nuk është sistematik në të gjitha institucionet. Rreth 104 institucione buxhetore (93%) kanë procedura të kontrollit të brendshëm. Menaxhimi i riskut është akoma në një fazë të hershme, megjithëse institucionet janë duke përgatitur vazhdimisht regjistra të riskut. Mungojnë rregullat e shkruara dhe praktikat për të njoftuar parregullsitë, ashtu si edhe besimi në delegimin e përgjegjësive nga oficerët autorizues tek varësit e tyre. Kontrolli i brendshëm, përfshirë raportimin, është konsideruar vetëm financiar dhe nuk përfshin informacion mbi performancën. Ligji për **inspektimin e centralizuar financiar**, që plotëson kontrollin e brendshëm, është ndryshuar.

Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik në Ministrinë e Financave ka 4 inspektore të cilët asistohen nga rreth 85 inspektorë nga institucione të ndryshme mbi bazën e rast pas rasti. Pesë inspektime janë kryer në 2015 dhe dhjetë në gjysmën e parë të 2016. Dy çështje janë kallëzuar në Prokurorinë e Përgjithshme. Menaxhimi i keq i fondeve publike lidhet kryesisht me emergjencat civile, pagesat e detyrimeve të prapambetura, ndërtimet, furnizimet dhe kontratat e shërbimeve. Mbikëqyrja e sipërmarrjeve shtetërore është e kufizuar.

Legjislacioni për **auditimin e brendshëm** është në përputhje me standardet ndërkombëtare. Manualet, kodet e etikes dhe kartat e kontrollit të brendshëm janë hartuar. Auditimi bazohet në planet vjetore. Përvitin 2015, 28 nga 103 njësi të auditimit të brendshëm kishin mungesë stafi. Shkalla e auditorëve të certifikuar në sektorin publik u rrit deri në 90% në vitin 2015 nga 82% që ishte në vitin 2014. Skema e rishikuar e certifikimit nuk është gati ende. Në vitin 2015, konstatimet kryesore të auditimit të brendshëm kanë të bëjnë me dobësitë në sistemet e kontrollit të brendshëm dhe mbivendosjen e shërbimeve të auditimit të brendshëm midis institucioneve kryesore dhe atyre të varësisë. Megjithëse roli i auditorëve të brendshëm është qartësuar, ata përdoren ende në mënyrë sistematike për inspektimet. Numri i rekomandimeve është i madh, 7459, megjithatë ata fokusohen kryesisht në aspektet financiare. Kërkohet të rritet vëmendja në përmirësimin e proceseve të biznesit dhe performancës.

Auditimi i jashtëm

Pavarësia funksionale, financiare dhe operationale e KLSH-së përcaktohet në **kuadrin kushtetues dhe ligjor** në përputhje me standardet e INTOSAI. Duhet të sigurohet zbatimi i mëtejshëm dhe i plotë i kuadrit ligjor.

Për sa i përket **kapacitetit institucional**, në vitin 2015, KLSH-ja kishte 125 auditorë nga rreth 170 punonjës, e krahasuar me 119 që ishin në vitin 2014 dhe 113 në vitin 2013. KLSH-ja përqendrohet në auditimin e përputhshmërisë që përcakton dëmin ekonomik dhe shkeljet e

rregullave, e jo në auditimet që mund do të ndihmonin në parandalimin e dëmeve të tilla që në fillim. Auditimet financiare ende nuk rezultojnë në opinione profesionale auditimi megjithëse KLSH-ja ka filluar t'i adresojë ato.

Sicpërcaktohet në planin strategjik të zhvillimit 2015-2017, KLSH-ja është e angazhuar për të përmirësuar **cilësinë e punës së** auditit në përputhje me standardet e INTOSAI. Manualët e përputhshmërisë dhe kontrollit financiar janë përditësuar dhe po zbatohen. KLSH-ja ka miratuar planin e auditimit 2016 sipas një metodologjie të përcaktimit të riskut.

Ndikimi i punës së auditit mbetet i kufizuar për shkak të fokusit mbi kontrollet e përputhshmërisë dhe zbulimit të parregullsive. Në vitin 2015, KLSH-ja ka kryer 158 auditime, duke konstatuar parregullsi që arrijnë vlerën 919.9 milion Euro, gjysma e së cilave lidhen me auditimin e operatorit shtetëror të shpërndarjes së energjisë. Kjo përbën një rritje të madhe krahasuar me vitin 2014, kur parregullsitë u konstatuan në vlerën 87.5 milion Euro. KLSH-ja ka paraqitur 51 raste në Prokurorinë e Përgjithshme, të lidhura me 159 zyrtarë (nga të cilët 56 ishin zyrtarë të lartë), pra më shumë sesa 41 raste që lidheshin me 149 zyrtarë në vitin 2014. Rekomandimet e KLSH-së përfshinin masa legjislative, administrative, organizative dhe kompensimi, si edhe rekomandime për padi penale. Ministria e Financave ka zhvilluar një plan veprimi për të ndjekur konstatimet e KLSH-së, por nevojitet zbatim më sistematik. Nga 2510 rekomandimet organizative të KLSH-së në vitin 2015, 817 janë zbatuar plotësisht dhe 335 janë zbatuar pjesërisht. Gjysma e masave administrative dhe disiplinore janë ndjekur plotësisht. Raportet e auditit janë përmbledhur çdo tre muaj dhe janë publikuar rregullisht në faqen e internetit të KLSH-së. Auditimi vjetor i KLSH-së 2015 është dorëzua në parlament por akoma nuk është diskutuar.

Mbrojtja e interesave financiare të BE-së

Për sa i përket **përafrimit me acquis**, elementet kryesore ekzistojnë. Bazuar në ndryshimet e ligjit për inspektimin financiar, **Shërbimi Kombëtar i Koordinimit të Anti-Mashtrimit (AFCOS)** u ngrit brenda Ministrisë së Financave, por ka akoma kapacitet të kufizuar operacional. Një rrjet AFCOS është ngritur, duke përfshirë autoritete të tjera të rëndësishme. Manuali i menaxhimit të parregullsive është miratuar dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet e rëndësishme kombëtare janë nënshkruar në vitin 2016. **Bashkëpunimi i saj me Komisionin Evropian** përfshin raportimin e parregullsive dhe bashkëpunimin gjatë misioneve në vend. Nuk ka strategji anti-mashtrim që do të adresonte interesat financiare të BE-së. Ministria e Financave ka akses në Sistemin e Manaxhimit të Parregullsive që prej vitit 2015, me një çështje të raportuar deri tani nëpërmjet sistemit. Duhet të sigurohet kapaciteti efektiv për të kryer hetime dhe një historik i qëndrueshëm për hetimet dhe nevojat e raportimit duhet zhvilluar me tej.

Mbrojtja e euros nga falsifikimi

Shqipëria nuk ka ratifikuar ende Konventën Ndërkombëtare për Parandalimin e Falsifikimit të Valutës, të vitit 1929. Përafrimi me legjislacionin Evropian është i pjesshëm me përkufizimin e kartëmonedhave dhe monedhave të falsifikuara si dhe të procedurave për mbledhjen, ruajtjen dhe tërheqjen e tyre nga qarkullimi. Shqipëria ka nënshkruar një marrëveshje me Europolin për bashkëpunimin në luftën kundër falsifikimit të monedhës dhe mjeteve të pagesës që prej vitit 2014. **Analiza teknike** e parave të falsifikuara kryhet nga Qendra Kombëtare e Analizës (QKA) në Bankën e Shqipërisë, që ka 3 punonjës. **Bashkëpunimi** në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar është i vazhdueshëm. **Marrëveshje e bashkëpunimit** me Komisionin Evropian për monedhat është në fuqi, ndërsa një marrëveshje e ngjashme për kartëmonedhat me Bankën Qendrore Evropiane nuk është arritur akoma. Shqipëria merr pjesë rregullisht në programin Pericles 2020 dhe në iniciativën rajonale Rrjeti Ballkanik për

Mbrojtjen e Euros.

4.33. Kapitulli 33: Dispozitat financiare dhe buxhetore

Rregullat e financimit të buxhetit të BE-së përcaktojnë kontributet e bazuara kryesisht në të ardhurat kombëtare bruto të secilit Shtet Anëtar si dhe në tatimin mbi vlerën e shtuar dhe tarifatat doganore.

Shqipëria ka një farë niveli të përgatitjes në këtë fushë. Janë bërë disa përparimeme ndryshimin e ligjit organik të buxhetit duke përcaktuar elementet bazë të rregullit fiskal. Po krijohen struktura koordinimi të qëndrueshme, kapacitete administrative dhe rregulla

Nuk ka pasur zhvillime të mëdha në **burimet vetjake tradicionale, burimet bazuar në TVSH dhe burimet bazuar tek të ardhurat kombëtare bruto**. Standardet ESA 2010 janë zbatuar pjesërisht dhe ka nevojë për përpjekje të mëtejshme për të mbushur boshllëqet e statistikave ndër vite. Përpjekje të konsiderueshme janë të nevojshme për të siguruar plotësimin e llogarive kombëtare dhe llogaritjeve të të ardhurave kombëtare bruto. Përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme për të siguruar masa efektive për formalizimin e ekonomisë informale dhe për të luftuar evazionin fiskal dhe mashtrimet në detyrën doganore. (Shikoni gjithashtu kapitujt 17-Politikat Ekonomike dhe Monetare, 18-Statistikat, 16-Tatimet, 29-Bashkimi Doganor dhe 32-Kontrolli Financiar).

Sa i përket **infrastrukturës administrative**, Shqipëria do të duhet të punojnë për ngritjen e institucioneve përkatëse, trupave koordinuese dhe rregullave zbatuese për të siguruar se do të jetë në gjendje, pas integrimit, për të llogaritur saktë, për të parashikuar, për të mbledhur, për të paguar, kontrolluar dhe raportuar BE-së mbi burimet vetjake në përputhje me acquis.

Shtojca I – Marrëdhëniet midis BE-së dhe Shqipërisë

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit midis Shqipërisë dhe BE-së ka hyrë në fuqi në prill të vitit 2009. Shqipëria paraqiti aplikimin për anëtarësim në Bashkimin Evropian më 28 prill 2009. Pas kërkesës nga Këshilli, Komisioni dhe Opinionin e tij në lidhje me aplikimin e Shqipërisë në nëntor të vitit 2010. Në dhjetor të vitit 2010, Këshilli theksoi se hapja e negociatave për anëtarësim do të merrej në konsideratë pasi Komisioni të kishte arritur në vlerësimin se vendi kishte arritur nivelin e nevojshëm të përputhshmërisë me kriteret e anëtarësimit dhe, në veçanti, që vendi kishte përmbushur prioritetet kyçe të përcaktuara në Opinionin e Komisionit. Duke marrë në konsideratë progresin e arritur nga Shqipëria, Komisioni rekomandoi në tetor të vitit 2013 që Shqipërisë t'i jepet statusi i vendit kandidat, duke patur mirëkuptimin që vendi duhet të vazhdojë të ndër marrë veprime në lidhje me luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, dhe Komisioni identifikoi 5 prioritete kyçe për hapjen e negociatave të anëtarësimit. Në dhjetor, Këshilli deklaroi se do të vendoste nëse do të jepte statusin e vendit kandidat në qershor të vitit 2014, pas publikimit të një raporti të Komisionit që përqendrohej në zbatimin nga ana e Shqipërisë së strategjisë për reformën e gjyqësorit dhe për luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Këshilli theksoi se zbatimi i qëndrueshëm i reformave dhe përmbushja e të gjitha prioritetëve kyçe janë të domosdoshme për hapjen e negociatave. Në një raport të publikuar në qershor të vitit 2014, Komisioni konfirmoi rekomandimin e tij që Këshillit duhet t'i jepte Shqipërisë statusin e vendit kandidat. Këshilli i Evropës i qershorit 2014 mbështeti vendimin e Këshillit të Punëve të Përgjithshme duke i dhënë Shqipërisë statusin e vendit kandidat.

Gjatë vitit të shkuar, Shqipëria ka zbatuar pa probleme detyrimet e saj në kuadrin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA). Dialogu i rregullt politik dhe ekonomik midis BE-së dhe Shqipërisë ka vijuar përmes strukturave përkatëse në kuadrin e MSA-së. Komisioni dhe Këshilli i Stabilizim Asociimit u mblodhën përkatësisht në prill dhe në maj të vitit 2015. Janë zhvilluar edhe takime të nën komisioneve dhe të grupit të veçantë për reformën në administratën publike. Komisioni Parlamentar për Stabilizim dhe Asociim ka zhvilluar takime në nëntor dhe maj. Për kapërcimin e polarizimeve nga ana e Shqipërisë midis maxhorancës qeverisëse dhe opozitës, është arritur në një deklaratë të përbashkët në takimin e zhvilluar në maj. Shqipëria ka vijuar të marrë pjesë aktive në takimet e dialogut të nivelit të lartë. Takimi i fundit u zhvillua në mars të këtij viti në Tiranë.

Shqipëria ka bërë progres të vazhdueshëm në trajtimin e pesë **prioriteteve kyçe** për hapjen e negociatave të anëtarësimit, duke nisur një sërë reformash të nevojshme për të ecur përpara në rrugën drejt integritit në BE. Arritjet që lidhen me administratën publike vazhdojnë të konsolidohen. Në fushën e sundimit të ligjit, ndryshimet kushtetuese u miratuan në korrik të këtij viti, duke i hapur rrugën reformës së thellë dhe gjithëpërfshirëse në sistemin gjyqësor. Shqipëria duhet të tregojë progres për sa i përket krijimit të një historiku të qëndrueshëm për hetimet, ndjekjet penale dhe dënimet e formës së prerë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në të gjitha nivelet. Zbatimi i masave efikase për të përforcuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtat e popullatës Rome dhe grupeve të tjera të cënueshme në shoqëri, dhe politikat kundër diskriminimit, si dhe zbatimi i të drejtave mbi pronën, mbeten të një rëndësie tepër të madhe. Shqipëria duhet të vijojë me reformat ekonomike me synim

rritjen e konkurrueshmërisë dhe trajtimin e papunësisë së lartë, si dhe të përmirësojë mjedisin e biznesit.

Përtej kuadrit të pesë prioritetëve kyçe, Shqipëria ka arritur të miratojë ligjin për **përfshirjen e shkelësve të ligjit nga funksionet publike**. Ky përbën një zhvillim të rëndësishëm legjislativ. Zbatimi po vijon, pas miratimit në mars të akteve nënligjore dhe të gjitha zyrtarët e kandiduar dhe të zgjedhur duhet të dorëzonin vetë-deklarimet e tyre për pasuritë dhe rekordet kriminale. Ky proces është kyç për të dërguar një shenjë shtesë të angazhimit të qartë për vlerat e integritetit dhe profesionalizmit në të gjithë sektorin publik. Kanë filluar përgatitjet për reformën zgjedhore. Politizimi i administratës zgjedhore dhe çështjet që lidhen me transparencën e financimeve partiake kërkojnë vëmendje të madhe, ndër rekomandimet e tjera përkatëse të OSCE-ODIHR.

Liberalizimi i vizave për qytetarët shqiptarë që udhëtojnë në zonën *Shengen* është në fuqi që prej dhjetorit të vitit 2010. Si pjesë e mekanizmit të monitorimit të vendosur që prej liberalizimit të vizave, Komisioni ka vlerësuar rregullisht progresin e vendit në zbatimin e reformave të ndërmarra në kuadrin e udhëzuesit të vizave. Mekanizmi i monitorimit përfshin gjithashtu një mekanizëm alarmi, të bashkërenduar nga Frontex, për të parandaluar abuzimin. Që prej vitit 2006 ka hyrë në fuqi një marrëveshje ri-pranimi midis Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë.

BE-ja i ka ofruar Shqipërisë asistencë financiare në kuadrin e **Instrumentit të Ndhmës së Para Anëtarësimit (IPA)** për periudhën 2007-2013 në një shumë të përgjithshme prej 594 milion Euro. Asistenca është zbatuar kryesisht nën administrimin e drejtpërdrejtë të Delegacionit të BE-së në Tiranë. Modaliteti i administrimit jo të drejtpërdrejtë është paraqitur përmes një qasjeje pilote për programin kombëtar të IPA 2013. Në kuadrin e IPA II, Shqipëria do të vijojë të përfitojë nga asistenca e para anëtarësimit për periudhën 2014-2020 në përputhje me prioritetet e përcaktuara në dokumentin strategjik, me një shumë të përgjithshme prej 649 milion Euro. Marrëveshja Kuadër për IPA II hyri në fuqi në prill. Programi i veprimit për Shqipërinë 2014 siguron rreth 67 milion Euro për promovimin e reformave në sektorë kyçë si demokracia dhe qeverisja dhe sundimi i ligjit dhe të drejtat themelore. Programi përfshin një operacion për mbështetjen e buxhetit për menaxhimin e financave publike dhe një grup veprimesh për të mbështetur reformën në administratën publike, pjesëmarrjen në programet e bashkimit dhe fuqizimin ekonomik dhe shoqëror të grupeve minoritare, si dhe një instrument për integrimin në BE. Shqipëria vijon të përfitojë nga mbështetja në kuadrin e programeve shumëvendëshe të IPA-s. Vendi vijon të marrë pjesë në pesë programe bashkëpunimi ndërkuftar me vendet fqinjë të Ballkanit Perëndimor dhe Shtetet Anëtare, si dhe në programe të bashkëpunimit tranzitor në kuadrin e Fondit Evropian të Zhvillimit Rajonal dhe Programi IPA i Adriatikut ndërkuftar. Shqipëria merr pjesë në programet e mëposhtme të BE-së me mbështetjen e IPA: Erasmus+, Evropa Krijuese (fushat e Kulturës dhe Medias), Inovacioni Shoqëror dhe në Punësim, Horizont 2020, Doganat 2020, Fiscalis 2020, Programi i Konkurrueshmërisë së Ndërmarrjeve dhe Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (COSME).

Shtojca II – Shtojca Statistikore

TË DHËNAT STATISTIKORE (deri më 5.10.2016)

Shqipëria

Të dhëna bazë	Shënim	2003	2011	2012	2013	2014	2015
Popullsia (në mijë)	1)	3 045e	2 907e	2 902e	2 898e	2 895e	2 892e
Sipërfaqja totale e vendit (km ²)		28 748	28 748	28 748	28 748	28 748	28 748

Llogaritë Kombëtare	Shënim	2003	2011	2012	2013	2014	2015
Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) (milion ALL)		677 738	1 300 624	1 332 811	1 350 053	1 394 419p	1 435 751p
Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) (milion Euro)		4 929	9 268	9 586	9 625	9 962p	10 274p
PBB (euro për frymë)		1 600	3 200	3 300	3 300	3 400	3 600
PBB (sipas Standardeve të Fuqisë Blerëse (PPS) për frymë)		:	7 300	7 800	7 700	8 300	8 600
PBB (sipas Standardeve të Fuqisë Blerëse (PPS) për frymë), krahasuar me mesataren e BE (BE-28 = 100)		:	28	30	29	30	30
Norma e rritjes së PBB-së reale: ndryshimi nga viti paraardhës i volumit të PBB-së (%)		5.5	2.5	1.4	1.0	1.8p	2.8p
Rritja e punësimit (Të dhënat e llogarive kombëtare) krahasuar me vitin parardhës në %		:	:	:	:	:	:
Rritja e produktivitetit të punës: Rritja e PBB-së (në çmime konstante) për person të punësuar, krahasuar me vitin paraardhës në %		:	:	:	:	:	:
Rritja e kostos së punës për njësi krahasuar me vitin paraardhës në %		:	:	:	:	:	:
** Ndryshimi trevjeçar (T/T-3) indeksin e rritjes së kostos nominal së punës për njësi (2005=100)		:	:	:	:	:	:

Produktiviteti i punës për person të punësuar: PBB (PPS) për person të punësuar, krahasuar me mesataren e BE (BE-27=100)		:	:	:	:	:	:
Vlera e shtuar bruto sipas sektorëve kryesorë							
Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi (%)		25.0	21.0	21.7	22.4	22.9p	22.1p
Industria (%)		9.4	13.5	13.3	14.6	14.7p	14.6p
Ndërtimi (%)		18.0	14.6	13.1	11.8	10.0p	10.8p
Shërbimet (%)		47.6	50.9	51.9	51.2	52.4p	52.5p
Shpenzimet e konsumit final, si përqindje e PBB-së (%)		91.4	89.3	88.8	91.1	93.0p	:
Formimi bruto i kapitalit fiks, si përqindje e PBB-së (%)		35.9	29.4	26.5	26.1	24.6p	:
Ndryshimet në inventar si përqindje e PBB-së (%)		:	2.0b	1.8	2.0	2.2p	:
Eksportet e mallrave dhe shërbimeve, në raport me PBB-në (%)		20.8	34.0	33.4	28.7	28.2p	:
Importet e mallrave dhe shërbimeve, në raport me PBB-në (%)		46.2	56.7	52.0	47.0	47.2p	:
Formimi bruto i kapitalit fiks nga sektori i qeverisë së përgjithshme, si përqindje e PBB-së (%)		:	:	:	:	:	:

Biznesi	Shënim	2003	2011	2012	2013	2014	2015
Indeksi i volumit të prodhimit industrial (2010 =100)		:	111.9	118.7	135.1	139.2	142.4
Numri i ndërmarrjeve aktive (shifër)	2)	51 945	109 039	106 837	111 083	112 537	152 288
Norma e krijimit: numri i ndërmarrjeve të krijuara në periudhën e referuar (t) pjesëtuar me numrin e ndërmarrjeve aktive në t (%)		15.3	11.8	12.0	10.9	15.4	:
Norma e mbylljes: numri i ndërmarrjeve të mbyllura në periudhën e referuar (t) pjesëtuar me numrin e ndërmarrjeve aktive në t (%)		:	:	:	:	:	:
Personat e punësuar në SME si përqindje e të gjithë personave të punësuar (në ekonominë e bizneseve jo financiare) (%)		74.1	81.5	81.7	81.0	79.6	:

Vlera e shtuar nga SME-të (në ekonominë e bizneseve jo financiare) (milion Euro)	3)	479	1 596b	2 126	1 961	2 062	:
Vlera e shtuar e përgjithshme (në ekonominë e bizneseve jo financiare) (milion Euro)	3)	886	2 316b	3 077	2 948	3 080	:

Norma e Inflacionit	Shënim	2003	2011	2012	2013	2014	2015
Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK), % ndryshim nga viti paraardhës	4)	3.3	1.7	2.4	1.9	0.7	2.0
**Ndryshimi vjetor në indeksin e deflatuar të çmimeve të banesave (2010=100)		:	:	:	:	:	:

Bilanci i pagesave	Shënim	2003	2011	2012	2013	2014	2015
Bilanci i pagesave: totali i llogarive korrente (milion Euro)	5)	-350	-1 225	-978	-1 049	-1 287	-1 105
Llogaria korrente e bilancit të pagesave: bilanci tregtar (milion Euro)	5)	-1 177	-2 242	-1 999	-1 979	-2 216	-2 299
Llogaria korrente e bilancit të pagesave: shërbimet neto (milion euro)	5)	-72	135	213	226	323	525
Llogaria korrente e bilancit të pagesave: të ardhura neto (milion euro)	5)	132	-25	-72	24	-119	-99
Llogaria korrente e bilancit të pagesave: transferata korrente neto (milion euro)	5)	767	906	880	680	725	768
nga të cilat transferata qeveritare (milion euro)	5)	53	29	33	17	9	6
**Mesatarja e 3 viteve të fundit e bilancit të llogarisë korrente krahasuar me PBB (%)	5)	-7.9	-13.3	-11.6	-11.4	-11.3	-11.7
**Ndryshimi pesëvjeçar në pjesën e eksporteve botërore të mallrave dhe shërbimeve (%)		:	:	:	:	:	:
Investime të Huaja Direkte hyrëse neto (IHD) (milion euro)	5)	156.9	608.9	647.8	923.2	811.5	818.4
Investime të Huaja Direkte (IHD) jashtë vendit (milion euro)	5)	0.0	21.4	17.9	21.6	57.7	71.9
nga të cilat IHD të ekonomisë e raportuar në vendet e BE-28 (milion euro)		:	:	:	:	:	:
Investime të Huaja Direkte (IHD) në	5)	156.9	630.4	665.8	944.8	869.2	890.4

ekonominë e raportuar (milion euro)							
nga të cilat IHD të BE-28 në ekonominë e raportuar (milion euro)		:	:	:	:	:	:
**Pozicioni neto i investimeve ndërkombëtare, krahasuar me PBB (%)		:	:	:	:	:	:
Norma e ndryshimit të përvitshëm në hyrjen e remitancave bruto (në valutën kombëtare) nga punonjësit emigrantë (%)	5)	:	-3.9	1.6	-19.6	8.5	0.7

Financat Publike	Shënim	2003	2011	2012	2013	2014	2015
***Deficiti/suficiti total i qeverisë, në raport me PBB-në (%)		-4.9	-3.5	-3.4e	-5.0	-5.2	-4.0
***borxhi total bruto i qeverisë, në raport me PBB-në (%)		58.8	59.4	62.1	70.4	71.8	72.5
Të ardhurat totale të qeverisë, në përqindje të PBB-së (%)		24.1	25.4	24.8	24.2	26.2	26.3
Shpenzimet totale të qeverisë, në përqindje të PBB-së (%)		29.0	28.9	28.2	29.2	31.3	30.3

Indikatorët Financiarë	Shënim	2003	2011	2012	2013	2014	2015
Borxhi i huaj bruto i të gjithë ekonomisë, në raport me PBB-në (%)		25.1	53.5	57.5	66.1	69.6	73.9
Borxhi i huaj bruto i ekonomisë, në raport me vëllimin total të eksporteve (%)	5)	122.7	157.3	172.3	230.3	246.3	281.5
Oferta e parasë: M1 (kartëmonedha, monedha, depozita 1-ditore, milion euro)		1 033	1 973	2 023	2 109	2 524	2 749
Oferta e parasë: M2 (M1 plus depozitat me maturim deri në 2 vjet, milion euro)		2 555	4 611	4 816	4 942	5 161	5 181
Oferta e parasë: M3 (M2 plus instrumentet e tregtueshme, milion euro)		3 225	7 626	8 080	8 192	8 538	8 717
Kreditimi total i institucioneve financiare monetare për banorët rezidentë (i konsoliduar) (milion euro)		381	3 862	3 990	3 906	4 001	3 914
** Ndryshimi vjetor në detyrimet e sektorit financiar (%)		:	:	:	:	:	:
** Rrjedha e kredisë private, e konsoliduar, krahasuar me PBB (%)		:	:	:	:	:	:
** Borxhi privat, i konsoliduar, krahasuar		:	:	:	:	:	:

me PBB (%)							
Normat e interesit: norma ditore e parasë, për vit (%)	6)	:	5.07	3.96	3.53	2.55	1.92
Norma e interesit të huadhënies (një vit), për vit (%)	7)	12.23	11.17	10.28	9.52	7.66	7.77
Normat e interesit të depozitave (një vit), për vit (%)	8)	8.31	5.87	5.38	4.17	1.92	1.35
Kursi i këmbimit të Euros: mesatarja e periudhës (1 euro = ... valuta kombëtare)		137.51	140.33	139.04	140.26	139.97	139.74
Indeksi efektiv i kursit të këmbimit (2005 =100) i ponderuar për tregtinë		:	:	:	:	:	:
** Ndryshimi trevjeçar (T/T-3) në indeksin efektiv të kursit të këmbimit të ponderuar për tregtinë, 42 vende (2005=100)		:	:	:	:	:	:
Vlera e aktiveve rezervë (përfshirë arin) (milion euro)		818	1 912	1 972	2 015	2 192	2 880

Tregtia e mallrave me jashtë	Shënim	2003	2011	2012	2013	2014	2015
Vlera e importeve: të gjitha mallrat, të gjithë partnerët (milion euro)		1 648	3 867	3 797	3 699	3 941	3 882
Vlera e eksporteve: të gjitha mallrat, të gjithë partnerët (milion euro)		89	1 400	1 531	1 761	1 827	1 728
Bilanci tregtar: të gjitha mallrat, të gjithë partnerët (milion euro)		-1 559	-2 467	-2 267	-1 938	-2 114	-2 154
Termat tregtarë (indeksi i çmimeve të eksportit / indeksi i çmimeve të importit * 100) (shifër)		100	78	83	86	86	86
Pjesa e eksportit drejt BE-28 si vlerë e eksporteve totale (%)		77.3	72.8	75.6	76.7	77.4	75.5
Pjesa e importit nga BE-28 si vlerë e importeve totale (%)		76.1	65.3	63.2	64.3	61.1	61.8

Demografia	Shënim	2003	2011	2012	2013	2014	2015
Norma bruto e rritjes natyrale të popullsisë (norma e rritjes natyrale): numri i lindjeve minus vdekjet (për një mijë banorë)		9.3	:	:	5.3e	5.2e	3.7e
Norma e vdekshmërisë foshnjore e fëmijëve nën 1 vjeç (për 1000 lindje të gjalla)		8.4	:	:	7.9	7.9	:
Jetëgjatësia e pritshme në lindje: meshkuj		:	:	:	:	76.4e	:

(vite)							
Jetëgjatësia e pritshme në lindje: femra (vite)		:	:	:	:	80.3e	:

Tregu i punës	Shënim	2003	2011	2012	2013	2014	2015
Norma e aktivitetit ekonomik për personat 20–64 vjeç: përqindja e popullsisë e moshës 20–64 vjeç që është ekonomikisht aktive (%)		:	75.6e	71.9e	67.6e	68.6e	71.3e
*Norma e punësimit për personat 20–64 vjeç: përqindja e popullsisë e moshës 20–64 që janë të punësuar (%)		:	64.9e	62.4e	56.7e	56.6e	59.3e
Norma e punësimit të meshkujve të moshës 20–64 (%)		:	72.8e	70.1e	64.8e	65.2e	68.1e
Norma e punësimit të femrave të moshës 20–64 (%)		:	57.2e	54.9e	49.3e	48.5e	50.7e
Norma e punësimit për personat e moshës 55–64: përqindja e popullsisë e moshës 55–64 që janë të punësuar (%)		:	54.7e	56.3e	51.1e	51.2e	53.6e
Punësimi sipas sektorëve kryesorë							
Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi (%)	9)	:	45.4e	46.1e	44.0e	42.7e	41.3e
Industria (%)	9)	:	10.6e	9.1e	9.7e	11.0e	11.6e
Ndërtimi (%)	9)	:	8.2e	8.2e	7.1e	6.4e	6.9e
Shërbimet (%)	9)	:	35.7e	36.6e	38.8e	39.4e	40.2
Përqindja e personave të punësuar në sektorin publik në raport me punësimin total për personat e moshës 20–64 (%)		:	:	15.7e	17.8e	17.5e	16.7e
Përqindja e personave të punësuar në sektorin privat në raport me punësimin total për personat e moshës 20–64 (%)		:	:	84.3e	82.2e	82.5e	83.3e
Shkalla e papunësisë: përqindja e fuqisë punëtore që është e papunë (%)	10)	15.0	14.0e	13.4e	15.9e	17.5e	17.1e
Përqindja e fuqisë punëtore meshkuj të papunë (%)	10)	12.9	13.6e	14.6e	17.8e	19.2e	17.1e
Përqindja e fuqisë punëtore femra të papuna (%)	10)	18.2	14.4e	11.7e	13.5e	15.2e	17.1e
Shkalla e papunësisë e rinisë: pjesa e fuqisë punëtore e moshës 15–24 që është e papunë (%)		:	23.6e	29.8e	31.4e	39.0e	39.8e
Shkalla e papunësisë afatgjatë: pjesa e fuqisë punëtore e papunësuar për 12 muaj		:	10.2e	10.3e	11.5e	11.2e	11.3e

ose më shumë (%)							
Shkalla e papunësisë për personat (mosha 25–64) që kanë përfunduar të paktën arsimin e mesëm të ulët (ISCED 0–2) (%)		:	12.1e	10.5e	13.6e	13.4e	12.0e
Shkalla e papunësisë për personat (e moshës 25–64) që kanë përfunduar arsimin terciar (ISCED 5& 6) (%)		:	10.1e	11.8e	11.7e	13.7e	15.9e

Kohezioni Social	Shënim	2003	2011	2012	2013	2014	2015
Pagat dhe rrogat mesatare mujore nominale (valuta kombëtare)		21 325	46 665	50 093	52 150	53 025	54 000
Indeksi i pagave dhe rrogave reale (indeksi i pagave dhe rrogave nominale pjesëtuar me indeksin e inflacionit) (2000 =100)		127.8	223.5	238.2	:	234.4	243.6
Koeficienti GINI		:	:	:	:	:	:
Hendeku i varfërisë (%)		:	:	3.0	:	:	:
*Braktisja e hershme e shkollës dhe formimit profesional: pjesa e popullatës e moshës 18–24 që kanë më së shumti arsim të mesëm të ulët dhe që aktualisht nuk merr mësim ose formim profesional (%)		:	35.2e	31.6e	30.6e	26.0e	21.3e

Standardi i jetesës	Shënim	2003	2011	2012	2013	2014	2015
Numri i automjeteve në raport me popullsinë (numri për 1000 banorë)		57.4	103.5	102.4	117.7	130.6	139.6
Numri i abonimeve në shërbime celulare në raport me numrin e popullsisë (numri për 1000 banorë)		361.6e	1 841.8	2 015.0	1 822.5s	1 686.5	1 687.0
Shkalla e penetrimit të telefonisë së lëvizshme (për 100 banorë)		:	:	:	:	:	:
Shkalla e penetrimit të telefonisë fikse (për 100 banorë)		:	:	:	:	:	:

Infrastruktura	Shënim	2003	2011	2012	2013	2014	2015
Dendësia e rrjetit hekurudhor (linja në funksion për 1000 km ²)		15.0	13.9	13.9	12.0	12.0	13.2s

Gjatësia e rrugëve ndër-qytetase (kilometra)		3	:	:	:	:	:
--	--	---	---	---	---	---	---

Inovacioni dhe kërkimi shkencor	Shëni m	2003	2011	2012	2013	2014	2015
Shpenzimet publike për arsimin në raport me PBB-në(%)		3.0	3.2	3.3	3.3	3.3	:
*Shpenzimet e brendshme bruto për kërkim-zhvillim, në raport me PBB-në (%)		:	:	:	:	:	:
Alokimet ose shpenzimet e buxhetit të shtetit për kërkim-zhvillim (GBAORD), si përqindje e PBB (%)		:	:	:	:	:	:
Përqindja e familjeve që kanë shërbim interneti në shtëpi (%)		:	:	14.3	:	:	:

Mjedisi	Shëni m	2003	2011	2012	2013	2014	2015
*Indeksi i emetimeve të gazrave serë, ekuivalente të CO ₂ (1990=100)		99	:	:	:	:	:
Intensiteti energjetik i ekonomisë (kg të barasvlershme naftë për 1.000 euro PBB me çmimet konstante të 2010)		:	:	:	:	:	:
Elektriciteti i prodhuar nga burime të rinovueshme në raport me konsumin bruto të elektricitetit (%)		29	26	31	35	28	33p
Transporti rrugor i mallrave si përqindje e transportit të brendshëm të mallrave (bazuar në ton - km) (%)		:	:	:	:	:	:

Energjia	Shëni m	2003	2011	2012	2013	2014	2015
Prodhimi parësor i të gjitha produkteve energjetike (mijë TOE)		1 016	1 494	1 676	2 041	2 021	1 984p
Prodhimi parësor i naftës bruto (mijë TOE)		360	895	1 031	1 207	1 368	1 273p
Prodhimi parësor i antracitit dhe linjitit (mijë TOE)		19	2	2	2	0	0p
Prodhimi parësor i gazit natyror (mijë TOE)		12	15	15	16	28	30p
Importet neto të të gjitha produkteve energjetike (mijë TOE)		1043	668	320	567	653	420p
Konsumi i brendshëm bruto i energjisë (mijë TOE)		2 058	2 162	2 014	2 346	2 340	2 203p

Prodhimi i energjisë elektrike (mijë GWh)		4.8	4.0	4.7	7.0	4.7	5.9
---	--	-----	-----	-----	-----	-----	-----

Bujqësia	Shëni m	2003	2011	2012	2013	2014	2015
Indeksi i vëllimit të prodhimit bujqësor për mallrat dhe shërbimet (çmimet e prodhuesit) (viti pararendës=100)		102.9	105.0	103.9	100.8	101.1	:
Sipërfaqja bujqësore e përdorur (mijë hektarë)		1 121	1 201	1 201	1 190	1 178	1 175
Numri i gjësë së gjallë: gjedh të gjallë (mijë kokë, fundi i periudhës)		684	492	498	498	500	504
Numri i gjësë së gjallë: derra të gjallë (mijë kokë, fundi i periudhës)		132	163	159	152	172	171
Numri i gjësë së gjallë: të imta të gjalla (mijë kokë, fundi i periudhës)		2 919	2 517	2 619	2 723	2 804	2 850
Prodhimi dhe përdorimi i qumështit në ferma (qumështi i paskremuar) (mijë ton)		1 060	1 101	1 105	1 131	1 133	1 131
Prodhimi i të mbjellave: drithëra (përfshirë orizin) (mijë ton)		488	701	697	703	700	696
Prodhimi i të mbjellave: panxhar sheqeri (mijë ton)		0	0	0	0	0	0
Prodhimi i të mbjellave: perime (mijë ton)		675	890	914	924	950	1 030

: = nuk ka

b = shkëputje në seri

e = vlerë e përlogaritur

p = provizore

s = përlogaritje e Eurostat

* = tregues “Evropa 2020”

** = tregues i Procedurës së Imbalancës Makroekonomike (MIP)

*** = Të dhënat e deficitit dhe borxhit të qeverisë së vendeve të zgjerimit publikohen “siç janë” dhe pa verifikime në lidhje me cilësinë e tyre dhe përputhjen me rregullat ESA.

Fundshënime:

- 1) 2002 dhe 2010–12: bazuar në llogaritjen retro të INSTAT.
- 2) 2010–14: bazuar në ESA 2010.
- 3) 2012–14: Burimi, Eurostat.
- 4) Burimi, Eurostat.
- 5) 2014: llogaritje e shpejtë bazuar në të dhënat e tremujorit.
- 6) 2010–14: pjesët e përbërësve të shpenzimeve të PBB-së nuk arrijnë në shumën 100% për shkak të mospërputhjeve statistikore.
- 7) 2002: ndryshime në inventarë dhe mospërputhje statistikore.
- 8) 2002: ndryshim midis dhjetorit të një viti krahasuar me dhjetorin e vitit paraardhës.
- 9) 2013 dhe 2014: bazuar në balancën e pagesave, edicioni manual 6 (BPM6).
- 10) Të dhëna të shpërndara nga Banka e Shqipërisë.
- 11) Mesatarja vjetore e kursit ditor të këmbimit në tregun e parasë.
- 12) Norma mesatare e ponderuar aplikuar për huatë 12 mujore gjatë periudhës përkatëse, me maturim 12 mujor.
- 13) Norma e interesit të depozitave përfaqëson normën e ponderuar mesatare për depozitat e pranuar në muajin përkatës, me maturim 12-mujor.
- 14) 2013 dhe 2014: shuma e pjesëve në analizën e punësimit sipas aktivitetit nuk është e barabartë me 100% për shkak të rasteve kur personat nuk kanë ose nuk mund të klasifikohen në një aktivitet të veçantë.
- 15) 2002: të dhëna administrative.